



# Libri i mësuesit



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER





“**Paketa e Gjelbër Junior**” është hartuar me qëllimin për t’iu ofruar mësuesve dhe nxënësve një material original, tërheqës dhe me një metodologji të thjeshtë mësimi për përvetësimin e njohurive në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm në klasat e arsimit fillor (nga 6 deri 11 vjeç). Paketa përmban 12 tema, në formatin e planeve mësimore për mësuesit, dhe fletë pune me tregime edukative dhe lojëra për nxënësit. Të gjitha temat janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe janë në përshtatje me kurrikulën e re të arsimit fillor, për t’u përdorur gjatë orëve të mësimit dhe aktiviteteve jashtë shkollore.

Përgatitja e “**Paketa e Gjelbër Junior**” për Shqipërinë u mundësua përmes bashkëpunimit dhe vullnetit të mirë të shumë mësuesve dhe ekspertëve të edukimit në Shqipëri dhe në Rajonin e Evropës Juglindore, të cilët dhanë kontributin e tyre për përmbajtjen e Paketës.

Autorët (në rend alfabetik): **Daniela Ruçi ■ Doris Buxhuku ■ Dhurata Hysko ■ Eniana Veli ■ Enkeleda Jata (Rada) ■ Gjergj Vangjeli ■ Kliment Mindjov ■ Kornelija Radovanoviq ■ Mihallaq Qirjo**

Redaktimi dhe editimi: **Daniela Ruçi (Tola) ■ Mihallaq Qirjo ■ Sylvia Magyar**

Përkthimi Anglisht-Shqip: **Ogerta Ujkashi**

Korrektimi në gjuhën shqipe: **Genta Hoxha ■ Ogerta Ujkashi**

Dizajni artistik: **Sylvia Magyar**

Ilustrimet: **Laszlo Falvay ■ Stoyan Nikolov**

Koordinimi i projektit: **Daniela Ruçi (Tola)**

Botimi: **Gent Grafik**

©2018 Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri

“Paketa e Gjelbër Junior” është përgatitur në kuadër të programit “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENiOR-II), i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

Përmbajtja e Paketës është përgjegjësi e Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Shqipëri dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Paketa e gjelbër Junior : libër mësuesi / shkroi e red. Daniela Ruçi, etj. ; Il. Laszlo Falvay, Stoyan Nikolov. – Tiranë : Gent grafik, 2018  
192 f. : me il. 21 x 29.7 cm.

ISBN 978-9928-202-86-4

I.Ruçi, Daniela, etj.

1.Arsimi 9-vjeçar 2.Edukimi mjedisor 3.Tekste për mësuesit

373.3 .017 :502 (072)

# Përmbajtja

<b>Parathënie</b>	3
<b>Përdorimi i “Paketës së Gjelbër Junior”</b>	5
<b>■ Ndërlidhja</b>	7
<b>■ Atmosfera</b>	19
<b>■ Uji</b>	29
<b>■ Dheu</b>	47
<b>■ Energjia</b>	63
<b>■ Shumëllojshmëria biologjike</b>	79
<b>■ Burimet natyrore</b>	111
<b>■ Popullsia</b>	119
<b>■ Konsumi dhe mbetjet</b>	129
<b>■ Shoqëria dhe mjedisi</b>	149
<b>■ Jetë e shëndetshme</b>	165
<b>■ Ndryshimet klimatike</b>	181
<b>Certifikata</b>	191





# Parathënie

■ Edukimi Mjedisor dhe ai për Zhvillimin e Qëndrueshëm janë një proces që zgjat gjithë jetën: fillon nga fëmijëria e hershme, në edukimin e brezave të rritur dhe shkon përtej edukimit formal. Vlera të tilla si mënyra e jetesës dhe qëndrimet fitohen që në fëmijëri, prandaj roli i edukimit merr një rëndësi të veçantë sidomos për fëmijët. Ai duhet të përshkojë programet mësimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë edukimin profesional, trajnimin për mësuesit dhe edukimin e vazhdueshëm për profesionistët.

Institucionet e edukimit formal luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve që në moshë të vogël, duke dhënë njohuri dhe duke ndikuar në mënyrën e qëndrimit dhe të sjelljes. Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit dhe studentët të marrin njohuritë e duhura mbi edukimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe të jenë të informuar për ndikimin që kanë vendimmarrjet që nuk mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm. Çdo institucion edukativ, në tërësinë e tij, duke përfshirë nxënësit dhe studentët, mësuesit, pedagogët, menaxherët dhe pjesën tjetër të personelit si dhe prindërit, duhet të ndjekë parimet e sjelljeve miqësore me mjedisin.

Duke e vlerësuar tejet të rëndësishëm këtë proces, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) ka hartuar në vitin 2006-të të parën kurrikul të plotë për edukimin mjedisor në Shqipëri, për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të quajtur “Paketa e Gjelbër”. Me ndihmën e Drejtorive Arsimore Rajonale, kjo Paketë është shpërndarë në të gjitha shkollat 9-vjeçare të vendit.

Ky material i ri arsimor hapi një kapitull të ri në përpjekjet tona që të zgjerohet grupi qëllimor dhe t’u prezantohet “Paketa e Gjelbër” fëmijëve të arsimit fillor përmes zhvillimit të një “Pakete të Gjelbër Junior”.

Bazuar në përfshirjen e hershme të specialistëve të Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), si dhe të specialistëve të tjerë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mund të thuhet se Paketa e Gjelbër Junior është plotësisht e integruar me informacionin e kurrikulës së arsimit fillor dhe programeve lëndore të këtij cikli. Informacioni i kësaj pakete konsiderohet si plotësues dhe krijon një urë të konsoliduar në lidhje me njohuritë që nxënësi do të marrë në të gjitha vitet e arsimit bazë. Për më tepër, informacioni ka karakter të përgjithshëm dhe për rrjedhojë, mund të përshtatet shumë mirë si për shkollat e zonave urbane ashtu edhe për ato rurale, duke i lënë në dorë mësuesit të përshtasë materialin sipas zonës ku ndodhet.

“Paketa e Gjelbër Junior” përmban mjete plotësuese edukative, të zhvilluara si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët mes ekipit të REC dhe grupeve të mësimdhënësve dhe ekspertëve kompetentë nga shkollat fillore dhe institucionet e tjera arsimore në Shqipëri. Ky produkt është dhe një tjetër tregues i suksesshëm i lidhur me përpjekjet e REC për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe të trajnerëve në mbështetje të zhvillimit të institucioneve dhe programeve që e rrisin cilësinë e arsimit për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri.

“Paketa e Gjelbër Junior” ndihmon në zhvillimin e vlerave të reja tek nxënësit dhe një model të ri të sjelljes në shkollë, shtëpi dhe shoqëri. Me këtë, fëmijët do të bëhen ambasadorë të qëndrueshmërisë së një shoqërie dhe do t’ua transmetojnë njohuritë dhe shprehitë e tyre të reja miqje dhe rrethit familjar.

Kjo paketë është rezultat konkret i përpjekjeve tona që të ndërtojmë komunitete të forta për të tashmen dhe të ardhmen.

Dëshiroj t’u shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim autorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në hartimin e këtij materiali të ri arsimor, si dhe Qeverisë Suedeze dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri për mbështetjen e tyre të sinqertë, e cila ishte shtysë kryesore e jona gjatë hartimit të “Paketës së Gjelbër Junior”.

**Mihallaq Qirjo**  
Drejtor REC Shqipëri  
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)



■ Ne ende jemi të verbër përballë forcave të reja, që mund të rrezikojnë të ardhmen tonë. Por një gjë tashmë e dimë: E ardhmja jonë kërcënohet nga pasiguria mjedisore. Prandaj, për shoqërinë tonë është koha të mbjellë kulturën mjedisore. “Paketa e Gjelbër Junior” është si një fidanishte e shoqërisë së ardhme, që do të përballet me sfidat e reja mjedisore. Ky edukator i mirë mjedisor bën që, aty ku ka patur një qytetar mbrojtës të mjedisit, të lindin mijëra të tillë, aty ku ka patur një ide për zhvillimin tonë në harmoni me natyrën, të lindin qindra të tilla, pra ajo mbjell në vendin tonë shpresën për një vend natyror të sigurt, të qëndrueshëm dhe produktiv.

**Xhemal Mato**  
Drejtor i Qendrës “Ekolëvizja”

■ Marrëdhënia mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit është e ndërsjellë dhe komplekse. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm konsiderohet nga ekspertët si: filozofi, parim, metodologji mësimdhënieje, proces të menduari, repertor sjellor i shkollarit në raport me mjedisin. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, e orienton sistemin e arsimit drejt një procesi i cili mundëson që fëmijët dhe të rinjtë të pajisen me **njohuri, aftësi, qëndrime, vlera** që janë thelbësore për projektimin dhe krijimin e një shoqërie të qëndrueshme, referuar mjedisit, ekonomisë, shoqërisë.

Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm në arsimin parauniversitar nënkupton përfshirjen në mësimdhënie të çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm. Përbushja e tij kërkon aplikimin e metodologjive të mësimdhënies dhe të nxënies që motivojnë dhe nxisin fëmijët të moderojnë qëndrimet e tyre dhe të ndërmarrin veprime konkrete për zhvillimin e qëndrueshëm.

**Prof.as.dr. Marjana Sinani**  
Eksperte në Edukim

■ “Paketa e Gjelbër Junior” na prezanton me thjeshtësi, qartësi dhe prakticitet mundësinë e arritjes së kompetencave kyçe të fushës shkenca e natyrës. Kjo paketë u vjen në ndihmë mësuesve dhe nxënësve të arsimit fillor për të thelluar njohuritë mbi kujdesin ndaj mjedisit.

Përdorimi i saj krijon mundësi për identifikimin një problemi mjedisor, përdorimin e strategjive të ndryshme, eksplorimin nëpërmjet vëzhgimit, hulumtimit, punëve praktike. Duke synuar në të mësuarin e qëndrueshëm gjatë gjithë jetës, “Paketa e Gjelbër Junior” aftëson nxënësit të vleresojnë veten dhe të tjerët, lidhur me kujdesin ndaj mjedisit.

**Enkeleda Jata**  
Mësuese e arsimit fillor Tiranë

# Përdorimi i “Paketës së Gjelbër Junior”

Zhvillimi bashkëkohor i shoqërisë sonë moderne tregoi se njohuritë tona mbi natyrën kanë ecur shumë më përpara sesa zgjuarsia jonë për përdorimin e tyre. Si rezultat, ne po rrafshojmë pyjet, po shkatërrojmë malet, po ndotim lumenjtë, po “asfaltojmë” fushat, po modifikojmë klimën, po ndotim ajrin dhe po infektojmë gjakun tonë. Me fjalë të tjera, ne po krijojmë një botë që nuk ka asgjë nga ato që duam ne. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm është një nga mjetet themelore në ndryshimin e modeleve të sjelljes sociale dhe ekonomike dhe të pasojave të tyre ndaj mjedisit tonë jetësor.

Roli më specifik për edukatorët dhe mësuesit është të mësuarit e fëmijëve dhe i të rriturve për mjedisin — si funksionon ai, si ekzistenca jonë varet prej tij dhe si ne ndikojmë tek ai. Këto mësim janë të fokusuar kryesisht për fëmijët. Ky lloj edukimi do të çojë në lindjen e një gjenerate të re qytetarësh të interesuar për mjedisin dhe të përgjegjshëm ndaj përdorimit të burimeve natyrore.

Një nga qëllimet madhore të procesit të edukimit është t’u japësh njerëzve mjetet e duhura që iu nevojiten për t’u bërë qytetarë të përgjegjshëm. Mësimdhënia për mjedisin thjesht do të zgjerojë të kuptuarit e qytetarisë për të nënvizuar përgjegjësitë e tyre si qytetarë të planetit Tokë.

“Paketa e Gjelbër Junior”, të cilën e mbani në duart tuaja, është zhvilluar që të ndihmojë mësuesit në edukimin e një brezi të ri qytetarësh të përgjegjshëm. Përmes një materiali origjinal, lehtësisht të kuptueshëm dhe tërheqës, mësuesit mund të japin mësim rreth çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, duke filluar nga klasa e parë në shkollat fillore.

Libri i mësuesit është ndarë në 12 tema, të cilat trajtojnë çështje thelbësore të zhvillimit të qëndrueshëm. Temat e përfshira në këtë libër janë:

- |                                      |                               |
|--------------------------------------|-------------------------------|
| ■ <b>Ndërlidhja</b>                  | ■ <b>Burimet natyrore</b>     |
| ■ <b>Atmosfera</b>                   | ■ <b>Popullsia</b>            |
| ■ <b>Uji</b>                         | ■ <b>Konsumi dhe mbetjet</b>  |
| ■ <b>Dheu</b>                        | ■ <b>Shoqëria dhe mjedisi</b> |
| ■ <b>Energjia</b>                    | ■ <b>Jetë e shëndetshme</b>   |
| ■ <b>Shumëllojshmëria biologjike</b> | ■ <b>Ndryshimet klimatike</b> |

Këto tema janë përzgjedhur me qëllim që të kuptohet se ekzistenca e njerëzimit është e lidhur ngushtë me mjedisin, por njëkohësisht, dhe ndikimin e madh të njeriut mbi mjedisin në të cilin jetojmë. Çdo temë përbëhet nga një plan mësimor ku janë mirë përcaktuar rezultatet e të nxënësve, por dhe situatat e të nxënësve. Për secilën prej temave mësuesi mund të gjejë materiale mbështetëse të nevojshme për organizimin e mësimin në klasë dhe jashtë mjediseve të saj. Meto dologjia e sjellë nga kjo paketë ka në qendër të saj mënyrën ndëraktive të mësimin nëpërmjet diskutimeve, shkëmbimit të ideve, lojës, zgjidhjes së problemeve dhe aktiviteteve të shumta që zhvillohen në natyrë, jashtë mureve të shkollës apo klasës, sa më pranë luleve dhe shpendëve. Pjesë e Paketës së Gjelbër Junior janë dhe testet e aktiviteteve me të cilat nxënësit vlerësohen apo vetë vlerësohen në për vetësimin e informacionit të dhënë. Koha e propozuar në çdo plan mësimor mund të ndryshohet varësisht nga nevojat e mësimin. Ato mund të fotokopjohen dhe t’u shpërndahen nxënësve si pjesë përbërëse e vetë përmbajtjes.



Paketa ka rreth 60 orë mësimore. Mësuesi duhet të ketë kujdes në përzgjedhjen e aktiviteteve dhe përmbajtjen e tyre, për t'i përdorur në përputhje me moshën, klasën dhe aftësitë psikofizike të nxënësve. Gjithashtu, mësuesi duhet të zgjedhë sasinë e informacionit, aktivitetet dhe llojin e materialeve, në mënyrë që të përdorë vetëm ato aktivitete dhe situata të nxëni të kuptueshme dhe të pranueshme për nxënësit e tij. Nga materialet dhe planet mësimore të ofruara në këtë Paketë, mësuesi duhet të zgjedhë ato që janë të përshtatshme për moshën e nxënësve dhe me programin mësimor i cili duhet të realizohet, si dhe në përputhje me karakteristikat e mjedisit dhe të vendbanimit të fëmijëve.

Nëpërmjet mësuesve dhe nxënësve, mesazhet kryesore të "Paketës së Gjelbër Junior" gjithashtu mund t'u transmetohen edhe anëtarëve tjerë të familjes dhe shoqërisë. Kjo do të mundësojë që ata të mendojnë në mënyrë kritike lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë dhe të jenë qytetarë aktivë përmes zbatimit praktik të njohurive të tyre.

"Paketa e Gjelbër Junior", transmeton njohuritë, zhvillon aftësi dhe kultivon vlera drejt një të ardhme të qëndrueshme.





## Ndërlidhja

Njerëzit për herë të parë kanë arritur ta shohin planetin Tokë nga hapësira gjatë shekullit të kaluar. Ajo çka ata panë ishte një sferë e madhe e mbuluar me ujë nga detet dhe oqeanet, me shkëmbinj dhe male, fusha dhe shkretëtira, e mbështjellë nga atmosfera. Toka është pjesë e Sistemit Diellor. Rreth saj rrotullohet Hëna. Është vështirë t'i përgjigjemi pyetjes nëse jemi të vetëm në këtë hapësirë. Jeta në Tokë ka filluar para shumë, shumë vitesh. Kushtet themelore për jetën në Tokë janë: dielli, dheu, uji dhe ajri.

**Atmosfera** — Atmosfera jonë është një përzierje e azotit, oksigjenit, dyoksidit të karbonit, avujve të ujit dhe një numër grimcash të vogla të ngurta (grimcat e pluhurit). Jeta e bimëve dhe e kafshëve varet nga baraspesha e këtyre elementëve dhe kur kjo baraspeshë prishet, pasojat reflektohen në jetën në Tokë. Ndonjëherë, problemet kanë shkaqe natyrore por, më së shumti, njeriu është shkaktari kryesor i problemeve në atmosferë dhe i ndotjes së ajrit.



**Uji** — Uji gjendet kudo rreth nesh. Ai mbulon dy të tretat e sipërfaqes së Tokës. Edhe në trupin e njeriut rreth dy të tretat janë ujë. Edhe tek organizmat e tjerë uji gjendet në mënyra të ndryshme. Uji është i rëndësishëm për çdo organizëm. Ai është, gjithashtu, përgjegjës për motin dhe klimën e Planetit Tokë.

**Dheu** — Dheu është shtresa e sipërme e Tokës. Dheu është baza për jetën në Tokë. Bimët i shtrijnë rrënjët e tyre në dhe, për të thithur ujin dhe lëndët minerale të nevojshme. Dheu është i pasur me organizma të shumëllojshëm. Ai është mjedisi jetësor i tyre.

**Dielli** — Energjia e diellit vjen deri në Tokë duke depërtuar nëpër atmosferë dhe duke ngrohur planetin tonë. Drita e diellit, së bashku me ujin, janë kushti themelor në krijimin e ushqimit për organizmat e gjallë.



**Biosfera** — Biosfera është pjesa e Tokës ku zhvillohet jeta. Ajo përfshin dhe ajrin, ujin, shtresat e sipërme të dheut dhe të gjitha organizmat e gjalla në planetin tonë. Oksigjeni dhe dyoksidi i karbonit në ajër, uji në liqene e lumenj dhe mineralet në tokë, së bashku me karakteristikat klimatike të një rajoni, përcaktojnë ekzistencën dhe zhvillimin e bimëve dhe të kafshëve të ndryshme, duke krijuar atë që quhet shumëllojshmëria biologjike (biodiversiteti). Bimët dhe kafshët e përshtatura me kushtet mjedisore të Tokës janë të shumta dhe të ndryshme.

**Ekosistemi** — Ekosistemi është një grup organizmash që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin përreth. Ekosistemet janë sisteme dinamike, ku ushqimi dhe energjia janë në qarkullim të vazhdueshëm ndërmjet organizmave të gjallë dhe mjedisit jo të gjallë. Edhe zonat urbane janë ekosisteme, me organizma të përshtatur në këtë mjedis të veçantë. Aktivitetet njerëzore që zhvillohen në zonat urbane janë burim i dëmtimit mjedisor që iu shkaktohet ekosistemeve ekzistuese.

**Pasuritë natyrore dhe energjia** — Zhvillimi i një vendi kërkon burime natyrore dhe energji. Me burime natyrore njerëzit kuptojnë atë çfarë ata marrin nga mjedisi për të kënaqur nevojat dhe dëshirat e tyre. Në përgjithësi, burimet ndahen në të ripërtëritshme (ata nuk shterojnë pothuajse asnjëherë: energjia e diellit, energjia e erës, energjia e ujit, kafshët dhe bimët) dhe jo të ripërtëritshme (ekzistenca e tyre është e kufizuar dhe e përkohshme: nafta, qymyri, mineralet, uji i pijshëm).



Në ditët e sotme, konsumi është bërë një pjesë e rëndësishme e jetës së njeriut. Rritja e konsumit do të thotë përdorim më i madh i burimeve natyrore dhe i energjisë dhe ndotje të mëtejshme të mjedisit.



Shoqëritë janë të strukturuar në mënyrë të tillë që të ofrojnë mallra, hapësirë për të jetuar, punë dhe argëtim. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e njerëzve, shoqëritë moderne ndikojnë mbi burimet dhe ekosistemet e Tokës, kapacitetet e të cilave, në thelb, janë të shterueshëm.

Sot, si kurrë më parë, qytetërimi i Tokës po përballet me sfidat e përmirësimit të jetës së njerëzve, por duke ruajtur burimet natyrore. Këto sfida duhet të plotësohen në kushtet kur popullsia në mbarë botën po rritet dhe kërkesat për ushqim, ujë, strehim, kanalizime, energji, shërbime shëndetësore dhe siguri ekonomike gjithashtu janë në rritje të vazhdueshme.

Një nga mjetet më të fuqishme për të ndihmuar shoqëritë tona për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm është arsimiti. Një rol i veçantë për edukatorët sot është mësimi i fëmijëve për lidhjen ndërmjet mjedisit dhe shoqërisë: si funksionojnë ato, si varen nga njëri-tjetri dhe si ndikojnë tek ne. Kultivimi i mirëkuptimit që në fëmijëri do të prodhojë qytetarë të ndërgjegjshëm në të ardhmen.





## Planifikimi ditor i temës Ndërlidhja

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Gjithçka rreth nesh është e ndërlidhur
<b>Kohëzgjatja</b>	3 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon kushtet e nevojshme për ekzistencën e jetës në planetin Tokë;</li> <li>Tregon se çdo gjë që ekziston rreth tij/saj është e ndërlidhur.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Të fshehtat e çantës së shkollës. Loja: “Qilimi fluturues”. Lojë: Sa hapësirë na është e lejuar?
<b>Fjalët kyç</b>	Lidhshmëria, atmosfera, biosfera, dheu, drita, temperatura, lagështia, pasuritë natyrore dhe energjia, ujërat nëntokësore, fuqia e erës.
<b>Burimet materiale</b>	Çanta e shkollës dhe sendet në të, fletë pune, markera, karton, ngjyra, foto, copë/beze, dy shishe plastike dy litra, një kapak shisheje, një ngjitës në formë rrote, një varg pambuku të prerë rreth 15 cm të gjatë, ujë i distiluar, pleh lulesh, disa bimë të vogla me rrënjë të bashkangjitura, krimba “shiu ose shumëkëmbësh,” ose një kërmill toke.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuhë shqipe, Arte, Dituri natyre.

### Ora I – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të shfaqin mendimet e tyre rreth pyetjes:

- Cilat janë kushtet kryesore për të jetuar në planetin tonë, Tokë?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen të strukturuar në tabelë.

Më pas ndahet fleta e punës faqe 15 “Jeta varet nga...” ku në dritaret bosh në fillimin e fletës së punës nxënësit ftohen të shkruajnë emrat e kushteve kryesore që mundësojnë jetën në Tokë. Nxënësit të tregojnë se cilët nga shembuj e dhënë në fletën e punës janë të rëndësishëm dhe se cilët nuk janë të tillë.

Diskutohen punët e nxënësve dhe theksohet se nuk ka jetë pa diell, ajër, ujë, tokë, ushqim dhe vend për jetesë.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të hulumtojnë në çantën e tyre të shkollës. Gjithashtu nxënësve u jepet fleta e punës faqe 16 “Të fshehtat e çantës sime” për punë individuale. Pas vëzhgimit të sendeve të çantës, nxënësit ftohen të lidhin me vijë gjashtë sendet në dritaret me prejardhjen e materialeve. Pas përfundimit të punës mësuesi/ja zhvillon diskutim me nxënësit duke u mbështetur në pyetjet e mëposhtme:

- Prej çfarë materiali është bërë çanta e shkollës? (P.sh, material plastik – lidhet çanta e shkollës me fletën me shigjetë);
- Çfarë është tjetër e nevojshme dhe e domosdoshme që të prodhohet një çantë e shkollës? (p.sh, energji, ujë, vizatohet një shigjetë prej çantës së shkollës deri te uji dhe fabrika që furnizohet me energji);



- Prej çfarë materiali bëhet libri? (letër, që prodhohet nga një masë në formë qulli – vizatohet një shigjetë drejt bimës, fabrikës dhe ujit);
- Prej çfarë materiali bëhet lapsi? (drurit – vizatohet një shigjetë drejt një masë në formë qulli);
- Çfarë na duhet për të bërë një sanduiç? (bukë, mish, perime, ujë dhe energji për pjekje);
- Për çfarë kanë nevojë kafshët dhe bimët që të jetojnë dhe të rriten? (ajër, ujë, tokë, diell).

Gjithashtu diskutimi mund të thellohet me pyetje shtesë në lidhje me prodhimin e mbetjeve e gjatë prodhimit të këtyre mjeteve dhe ku përfundojnë këto mbetje.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja fton disa nxënës të prezantojnë punët e tyre që kanë realizuar nëpër fletët e punës. Theksohet se gjërat e thjeshta që na rrethojnë janë të lidhura me njëra-tjetrën, por baza është nevoja për: ajrin, ujin, tokën, bimët, kafshët dhe energjinë.

Më pas, mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletën e punës faqe 18. “Çdo gjë rreth nesh është e ndërlidhur” dhe u shpjegon çdo koncept i cili është i paraqitur si një tematikë më vete tek libri i “Paketës së Gjelbër Junior”.

Në fund mësuesi/ja u shpërndan nxënësve testin “Përreth nesh” në faqen 14 fleta e punës. Nxënësit punojnë të pavarur dhe më pas diskutohen përgjigjet e tyre.

### Vlerësimi

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës individuale, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë orës.

### Detyrë shtëpie

Nxënësit duhet të shkruajnë ose vizatojnë shembuj të tjerë si fleta e punës që tregojnë ndërlidhjen e sendeve që përdorin në jetën e përditshme.

## Ora II – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja e hap orën e mësimit me lojën “Qilimi fluturues”. Nxënësit i ndajmë në grupe me 6-7 pjesëmarrës. Çdo grup qëndron mbi një letër të bardhë ose copë/beze. Mësuesja/si nën ritmet e muzikës zvogëlon sipërfaqen e qilimit (copës). Nxënësit qëndrojnë me një këmbë në “Qilimin fluturues”, derisa qëndrimi i tyre në këtë hapësirë bëhet i pamundur. Në analogji kështu ndodh edhe në jetë me zvogëlimin e hapësirave.

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4-5 nxënës. Fton nxënësit të lexojnë dilemën “Një fabrikë e re” në faqen 14 të fletës së punës. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të diskutojnë vendimet që do të merrnin dhe arsyet pse e morën këtë vendim duke u bazuar dhe në pyetjet e dhëna.

Më pas plotësojnë tabelën shkak – pasojë për çdo vendim të marrë.

Shkaku	Pasoja

Pas përfundimit të punës nxënësit diskutojnë vendimet e njëri-tjetrit, shkaqet dhe pasojat që rrjedhin nga këto vendime.



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësve sipas grupeve u shpërndahet fleta të punës “Pemët e pyllit” në faqen 17. Mësuesi/ja shkruan në tabelë: “Në një fshat do të ndërtohet një rrugë e re dhe duhet patjetër që të priten pylli i vjetër”.

Fton më pas nxënësit të diskutojnë rreth pyetjeve:

- Si do të ndryshojë mjedisi nëse priten pemët?
- Si do të ndikojë prerja e pemëve në ndryshimin e peizazhit të natyrës (tek kafshët, bimët, uji, temperatura, drita etj)?

Nxënësit duhet të përpiqen të japin përgjigje dhe ta plotësojnë tabelën në fletën e punës si më poshtë:

Faktorët	Pylli i paprerë	Pylli i prerë
<b>Drita</b>	E dobët	E fuqishme
<b>Temperatura</b>	Më e ulët	Më e lartë
<b>Lagështia</b>	Më e lartë	Më e ulët
<b>Ujërat nëntokësorë</b>	Rrjedhin më afër sipërfaqes	Rrjedhin më thellë në tokë
<b>Fuqia e erës</b>	E kufizuar	E pakufizuar
<b>Kafshët</b> (shpendët, insektet etj.)	Kafshë të ndryshme që jetojnë vetëm në pyje	Kafshët e pyllit shpërngulen
<b>Bimët</b> (shkuret dhe bari)	Larmi e madhe bimësh, shkurresh dhe lulesh	Bota bimore ka pak lloje dhe është e varfër

Pasi nxënësit kanë plotësuar tabelën, prezantojnë punët sipas grupeve dhe mësuesi/ja bën ndërhyrjet e nevojshme dhe të domosdoshme.

Si përfundim theksohet se ndryshimet në pyll çojnë edhe në ndryshime tjera në natyrë.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë lojën — “Sa hapësirë na është e lejuar?” Përmes kësaj loje nxënësit do të mësojnë se hapësira në planetin Tokë është e kufizuar, ndërkohë të gjitha organizmat e gjallë duhet të jetojnë në barazpeshë dhe të kenë mundësi të barabartë në pasuritë natyrore.

Për të zhvilluar lojën nevojiten: 3 kartonë, 3 markera, ngjyra druri, fotografi letre, maketa dhe pjesë të prera nga gazetatat.

Secilit grup i jepet nga një karton, marker, ngjyra druri dhe maketa letre ose kartoni (pjesë të prera nga gazetata) të ndërtesave, shkollave, parqeve, fabrikave etj. Në karton paraqitet një qytet me rrethinën e tij. Në të tre kartonët me marker është shënuar kufiri i qytetit dhe ai është i ndryshëm për secilin grup. Për të parin, kufiri është më i madh, pothuajse deri në skajet e kartonit, në të dytin më i vogël, ndërsa në të tretin unaza është e vogël kështu që mbetet një hapësirë e madhe e zbrazët përreth. Nxënësit duhet vetë ta paramendojnë hapësirën, t’i vendosin maketat e letrës në hapësirë, t’i lidhin me rrugë, të vizatojnë objekte me ngjyra për ta pasuruar posterin. Kur përfundojnë një përfaqësues i çdo grupi përshkruan punën e kryer dhe tregon pse i kanë zgjedhur ato objekte. Mësuesi/ja orienton diskutimet e nxënësve duke u bazuar dhe në pyetje (të shkruara në tabelë) të tilla si:

- A ka qenë hapësira e kartonit e mjaftueshme për t’i vendosur të gjitha fotografitë dhe maketat?
- Me vendosjen e objekteve a mundësohet jetesë normale e njeriut, bimëve dhe kafshëve?
- Cilat fotografi u kanë mbetur meqë nuk ka pasur hapësirë të mjaftueshme në poster?
- Çfarë tjetër është vizatuar dhe pse?
- Cilat objekte nuk janë prezantuar dhe a janë të domosdoshme?

Në fund arrihet konkluzioni se të gjithë organizmat e gjallë duhet të mbijetojnë në hapësirë të kufizuar dhe të kenë mundësi të barabartë të pasuritë natyrore të domosdoshme.

## Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë prezantimeve, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë orës.

## Detyrë shtëpie:

Ftohen nxënësit të bëjnë një vizatim të lagjes së tyre duke shprehur dëshirat e tyre. Gjithashtu të përshkruajnë me fjalë arsytet e ndryshimeve që ata kanë menduar të bëjnë në lagjen e tyre.

## Ora III – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja e hap orën e mësimit me duke lexuar tekstin e mëposhtëm:

Unë jam ekolog.

A e dini se gjithçka në Tokë në një farë mënyre është e ndërlidhur? Në planetin tonë jetojnë një numër shumë i madh gjallesash dhe organizmash (disa prej tyre janë aq të vegjël sa ne nuk mund ti shohim me sy të lirë). Të gjitha këto organizma të gjallë duhet të bashkëveprojnë jo vetëm me njëra tjetrën por ato duhet të ndërveprojnë dhe me lëndën jo të gjallë, siç është dheu, uji, mineralet dhe rrezet e diellit.

Termi “ekosistem” do të thotë një sistem “ekologjik”. Një ekosistem mund të jetë aq i madh sa e gjithë Toka jonë ose aq i vogël sa një pellg me ujë. Mendoni një pellg si një ekosistem, aty ka ujë, ushqim dhe strehë për kafshët që jetojnë në pellg dhe përreth tij. Njerëzit që studiojnë ekosistemet quhen “Ekologë”.

Kur festojmë Ditën e Tokës, në fakt, ne festojmë ditën e ekosistemit tonë të madh, planetit në të cilin jetojmë, por festojmë dhe për të gjitha ekosistemet më të vogla që gjenden brenda tij.



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja


Ndërtimi i një ekosistemi në një shishe.

Mësuesi/ja pyet nxënësit përkatësisht:

- A mund të ndërtojnë në klasë një ekosistem?
- A do të dëshironit të ishit një ekolog dhe të krijonit ekosistemin tuaj për ta studiuar?

Ne të gjithë së bashku mund të krijojmë një ekosistem në një shishe. (Në klasë mund të ftohet dhe një nga prindërit e fëmijëve për ti ndihmuar ata në këtë proces, si p.sh që të presin shishet plastike, sepse kjo mund të jetë e vështirë për fëmijët.)

Nxënësit porositen një ditë më parë për materialet që duhet të sjellin në klasë për të përdorur në krijimin e një ekosistemi:





- Hapi 1: Prisni dy shishet plastike siç tregohet në figurën më lart;
- Hapi 2: Duke përdorur ngjitësin rrotë, lidhni tri pjesët siç tregohet në figurën e mesit;
- Hapi 3: Hapni një vrimë në kapakun e poshtëm dhe vendosni një fill prej pambuku;
- Hapi 4: Mbusheni pjesën e sipërme me 8-10 cm dhe (pleh bimor);
- Hapi 5: Mbushni pjesën e poshtme me ujë në mënyrë që kapaku të jetë vetëm mbi vijën e ujit;
- Hapi 6: Mbillni dy ose tre bimë të vogla;
- Hapi 7. (Opsionale) Vendosni disa insekte, krimba, ose kërmij në dhe (plehun ku janë mbjellë lulet).

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur

Mësuesi/ja tregon maketin e ekosistemit të realizuar së bashku me nxënësit. Ajo ju thotë që ata tashmë kanë krijuar një ekosistem të plotë si pjesë e projektit të tyre për Ditën e Tokës. Nxënësit mbajnë një fletore dhe regjistrojnë çdo ditë atë që ndodh brenda ekosistemit të veçantë. Gjithashtu, nxënësit mund të identifikojnë “ekosisteme” të tjera ndërsa ecin për në shkollë apo kur luajnë përreth pallatit, shtëpisë së tyre.

### Vlerësimi

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit gjatë punës në grup, prezantimeve, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë orës.

### Detyrë shtëpie

Ftohen nxënësit të bëjnë një vizatim të një ekosistemi.



## ? DILEMA Një fabrikë e re

Ju jeni një biznesmen. Ju dëshironi të ndërtoni një fabrikë të re. Në vendim që do të duhet të merrni është e rëndësishme që merrni parasysh:

- Sa do të kushtojë vendi në të cilën do të ndërtoni fabrikën dhe makineritë që do t'ju duhen për të blerë;
- Nëse keni mjaftueshëm lëndë të parë dhe energji për fabrikën tuaj;
- Si do të ndikojë fabrika në cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit;
- Si do të ndikojë fabrika mbi bimët e kafshët e zonës përreth saj;
- Ndikimi dhe roli i fabrikës për njerëzit në qytet dhe fshatrat që janë afër saj;
- Faktorë të tjerë.



## TEST Përreth nesh


	E SAKTË	E GABUAR
1 Jeta në Tokë varet nga pozicioni që ka Toka ndaj diellit dhe planeteve të tjerë të sistemit tonë diellor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Ajri nuk ndikon ndaj ujit dhe tokës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Pa ujë, tërë jeta në Tokë do të shuhet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Energjia e diellit ka rëndësi vetëm për bimët.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Shtresa e dheut vazhdimisht krijohet dhe shkatërrohet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Biosfera shtrihet nëpër tërë planetin.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Çdo gjë në natyrë është e ndërlidhur dhe ndërvepron midis tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Njerëzit janë gjithashtu pjesë e këtij rrjeti kompleks dhe ndikojnë jo pak zhvillimin e jetës në Tokë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E saktë 4. E saktë 5. E gabuar 6. E saktë 7. E saktë 8. E saktë





FLETË PUNE  
Jeta varet nga...






 Ajri	 Auto- mjetet	 Telefoni	 Ushqimi
 Mbetjet	 Librat	 Uji	 Energjia elektrike
 Lekët	 Vend- banimi	 Vesh- mbathjet	 Dielli



FLETË PUNE










# Të fshehtat e çantës sime





## FLETË PUNE

# Pemët e pyllit

Faktorët	Pylli	Pyll i prerë
		
 <p><b>Drita</b></p>		
 <p><b>Temperatura</b></p>		
 <p><b>Lagështia</b></p>		
 <p><b>Ujërat nëntokësore</b></p>		
 <p><b>Fuqia e erës</b></p>		
 <p><b>Kafshët</b> (shpendët, insektet etj.)</p>		
 <p><b>Bimët</b> (shkurret dhe bari)</p>		



FLETË PUNE

# Çdo gjë rreth nesh është e ndërlidhur

Atmosfera

Uji

Dheu

Energjia

Larmia biologjike



Burimet natyrore

Popullsia

Konsumi dhe mbetjet

Zhvillimi shoqëror  
dhe mjedisi jetësor

Mënyra e shëndetëshme  
e jetesës



## Atmosfera

Shtresa e ajrit që rrethon Tokën quhet atmosferë. Ajri i pastër në atmosferë nuk ka as ngjyrë, as aromë. E meqë ne nuk e shohim dot ajrin, themi se “gota është e zbrazët” ose “nuk ka asgjë në korridor”.

**Çfarë është ajri?** Ajri është përzierje e azotit (78%), e oksigjenit (21%), e dyoksidit të karbonit, e grimcave të imta dhe e **avujve të ujit**. Ndotësit natyrorë të ajrit janë pluhuri dhe hiri vullkanik, ndërsa ndotësit e tjerë janë rezultat i aktivitetit njerëzor.

Ajri në atmosferë është i nevojshëm për frymëmarrjen. Atmosfera, ndër të tjera, shërben:

- për të rregulluar temperaturën në sipërfaqen e Tokës, çka u mundëson jetë organizmave të gjallë;
- për të ruajtur klimën e Tokës;
- për të mbrojtur njerëzit, bimët dhe kafshët nga rrezet e dëmshme të diellit;
- për të shpërndarë tymrat dhe gazrat e dëmshme të lëshuara në atmosferë, si pasojë e proceseve natyrore dhe e aktivitetit njerëzor;
- si rezervuar për gazrat e ndryshme të rëndësishme për jetën;
- për qarkullimin e ujit;
- për transmetimin e tingujve dhe shpërndarjen e aromave të ndryshme në mjedis.



Ajri përdoret në shumë procese pune në jetën e përditshme. Për shembull, me ajër fryjmë gomat e makinës apo të biçikletave, me ajër punojnë balonat që ngrihen lart në qiell. Alpinistët dhe zhytësit përdorin **bombola me oksigjen** kur ngjiten në male të larta ose zhyten thellë në ujë.

Bimët dhe kafshët e bazojnë jetesën e tyre tek **gazet në atmosferë**. Bimët thithin dyoksidin e karbonit në atmosferë, të nevojshëm për kryerjen e fotosintezës dhe çlirojnë oksigjenin, ndërsa kafshët thithin oksigjenin dhe nxjerrin dyoksidin e karbonit.



Djegia e karburantit, përpunimi i mbetjeve, transporti, bujqësia dhe aktivitete të tjera njerëzore e ndotin ajrin.

**Ajri i ndotur** është i dëmshëm për shëndetin e njeriut, bimët, kafshët dhe mjediset natyrore, dhe gjithashtu mund të sjellë ndryshime të klimës. Gazrat që çlirohen nga automjetet, për shembull, përmbajnë më shumë se 200 lloje elementësh kimikë, shumica e tyre të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Në varësi të kushteve atmosferike, ndotësit kryesorë mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë përreth vendit ku ata çlirohen. Pjesa më e madhe e grimcave të imta ndotëse zhvendosen në

zonat afër burimit të ndotjes. Disa ndotës mund të kenë ndikim jo vetëm në mjedisin përreth, por dhe më larg tij.

Substancat kimike të shpërndara në atmosferë konsiderohen ndotëse, kur ato janë në përqendrime të larta, duke dëmtuar shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ndotësit e zakonshëm të ajrit janë: oksidet e sulfurit ( $\text{SO}_x$ ), oksidet e azotit ( $\text{NO}_x$ ), monoksidi i karbonit (CO), plumbi, grimcat e imta të pluhurit dhe përbërësit organik të avullueshëm (VOC).

Ndotësit e ajrit që konsiderohen si më të dëmshëm janë: kadiumi, mërkuri, arseniku, fibrat minerale (si pluhuri dhe asbesti) të cilat mund të thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes), gazrat inorganike (klori, fluori, cianuri) dhe substancat organike të avullueshme (hidrokarburet aromatike, dioksinat).

Një prej dukurive më të rrezikshëm në ajër është **smogu**, i cili krijohet nga përzierja e avujve të ujit dhe gazrave të dëmshme. Smogu është i pranishëm në qytetet ku ka trafik të dendur makinash.

Shumica e ndotësve të ajrit janë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve, sepse shkaktojnë:

- infeksion të syve dhe rrugëve të frymëmarrjes;
- helmim;
- alergji dhe sëmundje tjera.





### Planifikimi ditor i temës Atmosfera

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Atmosfera
<b>Kohëzgjatja</b>	3 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rendit përbërësit kryesorë të ajrit;</li> <li>• Përshkruan përmes shembujve nga vëzhgimet se organizmat e gjalla kanë nevojë për ujë, ajër, ushqim për të jetuar;</li> <li>• Shpjegon rëndësinë e ajrit të pastër për organizmat e gjalla.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lepuri mburravec.</li> <li>• Pa ajër nuk mundemi.</li> <li>• Vallëzimi ajror.</li> <li>• Përshtjellimi i ndotjes së ajrit.</li> </ul>
<b>Fjalët kyç</b>	atmosfera, ajër, oksigjen, smogu, ndotës të ajrit, fotosinteza, asfiksi.
<b>Burimet materiale</b>	Bimë, foto kafshësh, kukulla pelushi, ose plastike, foto bimësh, letër, gërshërë, ngjyra, laptop, projektor, insekte të ndryshme, qese, 4-5 shishe 2 litërshe transparente pa etiketë, 4 pigmente (ngjyra), lugë druri, një gotë e pastër etj.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha shqipe.

## Ora I – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ushtroni nxënësit të lexojnë vetë tregimin “Lepuri mburravec” në faqen 28 të librit të mësuesit. Ftoni nxënësit që të plotësojnë tabelën e mëposhtme.

Personazhi	Çfarë bëjnë?	Si ndihen?	Si ndiheni ju në raport me personazhin?
Lepuri			
Lule Blea			
Zymbyli			
Manushqja			
Urithi			
Miu Griçko			

Mësuesi/ja këmbëngul në dhënie të mesazhit të pjesës për ruajtjen e kafshëve, bimëve të çfarëdo lloji qofshin ata, për këtë i jep përparësi nxënësve të personazhi “Po ju”?



## Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Zbatohet loja “Vallëzimi ajror”. Ndani nxënësit në dy reshta që të jenë përballë njëri tjetrit. Sqarojuni se njëri resht paraqet bimët ndërsa reshti tjetër kafshët. Secili prej nxënësve le të zgjedh një bimë ose kafshë që dëshiron të jetë dhe pastaj le t’u tregojë tjerëve se cilën e ka zgjedhur. Sqaroni se kafshët dhe bimët marrin frymë në mënyrë të ndryshme, por të gjitha thithin oksigjen dhe lëshojnë dyoksid karboni. Bëhet dramatizimi i pjesës. Tregojuni nxënësve që kanë zgjedhur kafshë që të lëvizin midis bimëve dhe të marrin frymë, ndërsa ata që kanë zgjedhur bimë të qëndrojnë në vend, të marrin frymë dhe nga pozicioni i përkulur ngadalë të drejtohen dhe të demonstrojnë rritje. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë se edhe kafshët marrin frymë edhe pse kjo nuk vërehet. Pyesni nxënësit çfarë u nevojitet bimëve dhe kafshëve për tu rritur dhe për të lëvizur (ajër, ujë, diell, ushqim).

## Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Klasa ndahet në tetë grupe të vogla në formë rrethi sipas teknikës “Gushëkuqi rrethor”. Zgjidhet krahu dhe kahja e kalimit të fletës nga një nxënës tek tjetri. Letra përthyeret në formë fizarmonike ku secili nxënës shkruan idenë e tij se çfarë na mësoi tregimi “Lepuri mburravec”.

Bëhet diskutimi i mendimeve të dhëna nga grupet për të gjitha çështjet së bashku, me të gjithë klasën.

Nxënësit vizatojmë temën e lirë: “E gjithë bota e gjallë — njerëzit, kafshët dhe bimët — kanë nevojë për ajër të pastër, për shëndet më të mirë dhe jetë cilësore”. Prezantohen punët dhe vendosen në një ekspozitë.

## Vlerësimi

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.

## Detyrë shtëpie

Ftoni nxënësit që me anë të vizatimeve të prezantojnë një mbyllje tjetër për tregimin “Lepuri mburravec”.

## Ora II – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ftoni nxënësit që të grupohen në grupe duke u bazuar tek ajo çfarë ata pëlqejnë më shumë si p.sh, mund të jetë pylli, parku, liqeni, lumi apo plazhi.

Nxënësit nxiten të tregojnë përvojat dhe ndjenjat e tyre në lidhje me ajrin gjatë një shëtitje në pyll, park, plazh, liqen apo lum.

Në tabelë vizatoni disa balona dhe shkruani fjalinë e paplotësuar: “Ajri mund të jetë...”.

Ftoni nxënësit që të mendojnë fjalët plotësuese nga eksperiencia dhe përvoja e tyre për të plotësuar këtë fjali. Shkruani përgjigjet tek balonat: Disa prej përgjigjeve mund të jenë: i pastër, i ndotur, i nxehtë, etj.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësve ju jepet informacioni për “Atmosferën”. Në klasë zbatohet teknika “INSERT\*” individualisht dhe më pas mësuesi/ja punon bashkërisht në tabelë me nxënësit. Nxënësit lexojnë materialin në heshtje dhe shënojnë në tekst si më poshtë:

V/Kjo shenjë tregon që e di këtë informacion	+/Informacion i ri	-/Kundërshton atë që di	?/Jam në dilemë për këtë informacion

\*INSERT është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm (Interactive Noting System for Effective Reading and Thinking)





Ndahet klasa në grupe duke numëruar nga 1-5. Nxënësve u parashtrohet pyetja: Çfarë gjendet në ajër? Në punë në grup nxënësit plotësojnë tabelën.

Përbërësit e ajrit	Ndotësit e ajrit

Diskutohen punët e grupeve dhe jepet dhe informacion shtesë duke bërë pyetje të tilla si:

- Si do të ndihen njerëzit dhe organizmat tjerë nëse ajri është i ndotur me tym duhani?
- Në lajmet në TV ju keni dëgjuar se shumë njerëz kanë humbur jetën e tyre nga asfiksia gjatë rënies së zjarrit. Pse ndodh kjo? Sa gjatë mund të jetojnë qeniet e gjalla pa ajër? Kur nxënësit janë gjendur në një situatë të ngjashme çfarë ka ndodhur?

Inkurajoni nxënësit që t’i rrëfejnë para nxënësve tjerë.

Në momentin që prezantohet puna në grup, pjesëtarët e grupit do të marrin frymë thellë dhe le ta mbajnë frymën, por jo më shumë se gjysmë minute. Ftojini edhe këta nxënës që të sqarojnë nxënësit e tjerë se si janë ndjerë gjatë përpjekjes, para prezantimit.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutohet dilema “Kundravajtësi” që gjendet në faqen 25. Përfytyroni sikur jeni një person i rëndësishëm në qytetin tuaj. Një ditë, ju jeni duke e ngarë makinën tuaj dhe policia ju ndalon, sepse makina juaj çliron shumë tym. Polici ju vë një gjobë për ndotjen e ajrit dhe ju thotë se duhet që ta paguani sa më shpejt.

Çfarë do të bëni?

- Do të kërkonte të gjeni disa njerëz që e njohin policin që ai t’ua heq gjobën që ju ka vënë;
- Do ta shisni makinën meqenëse ajo është e prishur.
- Do të mundoheni që ta ndryshoni ligjin, kështu që makina juaj do të jetë në rregull.
- Do ta paguani gjobën në lekë dhe do ti shmangeni policisë në të ardhmen.
- Do ta paguani gjobën me lekë dhe do ta çoni makinën tuaj për riparim.
- Apo diçka tjetër.



### Vlerësimi:

Vlerësoni ata nxënës të cilën zgjidhin drejt dilemën dhe japin argumentat të sakta mbi zgjedhjen që kanë bërë.

### Detyrë shtëpie:

Nxënësit me ndihmën e prindërve bëjnë një listë me disa nga efektet negative të pirjes së duhanit brenda në shtëpi dhe rreziqet e tij për shëndetin e fëmijëve.

## Ora III – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me diskutimin e rezultateve të eksperimentit që u dha për detyrë shtëpie në orën e dytë: “Sa gjatë mund të jetojnë qeniet e gjalla pa ajër?”.

Parashtrohet pyetja: Pse atmosfera është e rëndësishme për Tokën dhe organizmat e gjalla?

Shkruani përgjigjet në tabelë. Plotësoni përgjigjet e nxënësve, duke u ndihmuar nga informacioni për “Atmosferën”.



Më pas diskutimi me nxënësit fokusohet rreth pyetjes: Si është cilësia e ajrit në një hapësirë të mbyllur? Studimet tregojnë se ajri në vend të mbyllur mund të jetë shumë më i ndotur sesa ajri në vend të hapur, madje edhe se ai që gjendet në qytetet industriale. Për shembull, edhe në një klasë/shtëpi me kondicioner ka pluhur/ndotje ajri nga mobilet dhe shtrojat e dyshemesë, nga avullimi i preparateve për pastrim, nga ngrohëset, nga çlirimi i dyoksid karbonit nga frymëmarrja e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, nga avullimi parfumeve dhe preparateve të ndryshme higjienike, nga tymi i duhanit etj.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja realizon veprimtarinë “Pëshjtjellimi i ndotjes së ajrit”. Duke ndjekur këto hapa:

1. Mbushni shishe 2 litërshë me ujë. Lëri nxënësit të imagjinojnë sikur uji në shishe është ajri në zonën ku ata jetojnë apo mësojnë.
2. Mbushni gotën e pastër me ujë dhe lëri nxënësit të vendosin çdo shishe në tavolinë dhe rreth çdo shisheje caktoni 4-5 nxënës.
3. Hapni shishe me pigmente ngjyrash. Para se të hidhni pikat prej secilit pigment, trazoni ujin me lugën. Më pas hidhni nga një pikë pigment në çdo shishe dhe lëri nxënësit të përhapet në ujë për disa minuta. Mësuesi/ja mund të lëvizë nga grupi në grup duke hedhur pigmentet. Përsëriteni këtë proces 3 herë radhazi, por me pigmente të ndryshme. Lëri nxënësit të përzihen në rrugë të natyrshme, përreth 5 minuta.
4. Ndërkohë mësuesja/si shpjegon se çdo ngjyrë përfaqëson disa burime të ndotjes së ajrit. Shembull:
  - E kuqja- Makinat dhe automjetet e tjera;
  - Jeshile-Nafta dhe karburantet;
  - Blu- Djegia e plehrave, etj.
5. Pasi i përzieni nxënësit mirë, krahasoni ujin në shishe me ujin e pastër në gotë. Pyetini nxënësit: Cilin ujë do të preferoni të pini? Pse? Po në rast se në vend të ujit do të kishte ajër, do të pëlqenin të thithnin atë me ngjyrë apo të pastrin? Mendoni se ajri i pastër është i rëndësishëm për njeriun? Cilët janë disa nga ndotësit e ajrit që njihni ju?

Mendoni se mund të bëni diçka për të ndikuar në pakësimin e kësaj ndotjeje, nëse po çfarë?

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutohet me nxënësit rreth pyetjes: Si mund të jetë Toka pa ajër? Ndhmoni nxënësit të kuptojnë se Toka pa ajër do të ndryshonte dhe jeta do të ishte e pamundur (do të ishte shumë më ftohtë, nuk do të kishte ajër për frymëmarrje, bimët nuk mund të prodhonin ushqim, proceset e djegies do të ishin të pamundura, do të kishte shumë ndryshime klimatike, nuk do të kishte tinguj ose aroma etj).

Zbatohet teknika “Pyetja ime” Klasa ndahet në tre grupe. Ku secili grup duhet t’i kthejë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Cili është problemi?
2. Cila është zgjidhja që propozoni?
3. Kush mund ta zgjidhë problemin?

Zgjidhet një përfaqësues grupi me rolin e raportuesit, kurse të tjerët lëvizin në grupet e tjera në interval kohe çdo pesë minuta duke dëgjuar raportuesin, por edhe duke e plotësuar përgjigjen me ide të tjera në qoftë se kanë. Raportimet e grupeve ngjiten në tabelë.

Ndani fletën e punës të faqes 26 “Pse atmosfera është e rëndësishme për Tokën?”. Nxënësit shkruajnë përgjigjet dhe diskutohen punët e nxënësve.

### Vlerësimi

Ndajuni nxënësve kopje të testit faqe 25: “A e njohim ajrin?” dhe le ti përpunojnë në mënyrë të pavarur. Diskutohen përgjigjet e tyre.

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna për fletën e punës faqe 25.

### Detyrë shtëpie:

Ndajuni nxënësve kopje të fletëve të punës “Si ta mbajmë ajrin të pastër brenda në shtëpi?” në faqen 27. Nxënësit realizojnë diagramin e Venit midis këtyre rregullave dhe gjendjes reale në shtëpitë e tyre.



## DILEMA Kundravajtësi

Përfytyroni sikur jeni një person i rëndësishëm në qytetin tuaj. Një ditë, ju jeni duke e ngarë makinën tuaj dhe policia ju ndalon, sepse makina juaj çliron shumë tym. Polici ju vë një gjobë për ndotjen e ajrit dhe ju thotë se duhet që ta paguani sa më shpejt. Çfarë do të bëni?

- Do të kërkonti të gjeni disa njerëz që e njohin policin që ai t'ua heq gjobën që ju ka vënë;
- Do ta shisni makinën meqenëse ajo është e prishur.
- Do të mundoheni që ta ndryshoni ligjin, kështu që makina juaj do të jetë në rregull.
- Do ta paguani gjobën në lekë dhe do ta shmangeni policisë në të ardhmen.
- Do ta paguani gjobën me lekë dhe do ta çoni makinën tuaj për riparim.
- Apo diçka tjetër.



## TEST A e njohim ajrin?

	E SAKTË	E GABUAR
1 Atmosfera është si një “batanie e ngrohtë” që mbështjell planetin.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Ajri është shtresa rreth Tokës, në të cilën krijohet klima.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Oksigjeni është gaz i rëndësishëm për ajrin.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Kur marrim frymë, thithim dyoksid karboni.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Fabrikat dhe automjetet janë ndotës më të mëdhenj të ajrit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Jeta dhe shëndeti i organizmave varet nga cilësia e ajrit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Pa ajër, Toka do të ishte një planet i shkretë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>


Përgjigjet: 1. E saktë 2. E saktë 3. E saktë 4. E gabuar 5. E saktë 6. E saktë 7. E saktë



FLETË PUNE

# Pse atmosfera është e rëndësishëm për Tokën?

Vetëm gjashtë nga pohimet e mëposhtme janë të sakta. Fotokopjoni fletën e punës për të gjithë nxënësit që ta plotësojnë ose shkruani përgjigjet e sakta në tabelë.



Mundëson motin dhe klimën

I furnizon njerëzit me naftë

Këtu ndodh fotosinteza

I furnizon njerëzit me materiale për ndërtim

Luan rol kyç në qarkullimin e ujit

Mundëson djegien

Mundëson frymëmarrjen

Lejon përhapjen e aromave dhe tingujve

Përmban oksigjen që e thithin organizmat



## FLETË PUNE

# Si ta mbajmë ajrin të pastër brenda në shtëpi



Mos pini duhan!



Pastroni dhe ajrosni dhomat rregullisht, edhe në dimër.



Mbani bimë, të cilat mund të ndihmojnë në zvogëlimin e përqendrimit të lëndëve të dëmshme në ajrin e brendshëm.



Kufizoni përdorimin e kimikateve në shtëpi.



Zëvendësoni qilimat e bërë prej materialeve artificiale me mbulesa dysHEMEJE nga fibrat natyrore si pambuku dhe leshi.



Kufizoni përdorimin e kimikateve në mjedise të mbyllura dhe i ruani kimikatet e nevojshme në vende të sigurta.



## FLETË PUNE

### Lepuri mburravec

Në pyll jetonte një lepur mburravec. Një ditë, ai bleu një motorr dhe shkoi me të në livadh, duke bërë shëtitje lart e poshtë që ta shikonin të gjitha kafshët e pyllit. Me motorr ai i shkeli pothuajse të gjitha bimët: lule delja u shpërnda në të gjitha anët, zymbylit i fluturuan fletët, ndërsa manushaqja u shtyp në tokë. Urithi doli nga vrima që të marrë ajër të pastër, por thithi veç gaz karbonik dhe i ra të fikët.

Lepuri mburravec nuk u shqetësua aspak dhe vazhdoi që të mburret duke shëtitur me motorrin e tij. Të gjithë u habitën dhe u larguan nga lëndina nga sjellja e keqe e lepurit.

Në këtë moment mbërriti miu Griçko dhe tha:

– Kini durim derisa lepurin mburravec ta zërë gjumi, atëherë do t’ia tregojmë ne atij!

I lodhur nga shëtitjet që bëri dhe nga zhurma e motorrit, lepurin, shumë shpejt e zuri gjumi.

Kafshët e tjera të pyllit shkuan tek vendi ku po flinte lepurit dhe filluan të bisedonin dhe qeshnin me zë të lartë. Lepuri u zgjua i mërzhitur dhe si në ëndërr filloi t’ju lutej kafshëve që ta ndërprisnin zhurmën, duke iu premtuar atyre se nuk do të shëtiste më me motorr në pyll.





## Uji

Uji është **element unik** në planetin tonë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë. Për këtë arsye, Toka është quajtur ndryshe dhe **Planeti i kaltër**. Për fat të keq, pjesa më e madhe e ujit të Tokës (97%) është i kripur dhe nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga njerëzit. Pjesa tjetër e ujit, prej 3%, është i ëmbël (jo i kripur) dhe gjendet në lumenj dhe liqene, nën sipërfaqen e tokës, në akullnajat në pole dhe në majat e larta të maleve. Uji gjendet, gjithashtu, tek të gjithë organizmat e gjallë. Sipas studimeve, njerëzit shfrytëzojnë vetëm 1% të sasisë së ujit që gjendet në planetin tonë.

### Karakteristikat fizike dhe kimike të ujit

- Uji është e vetmja substancë që gjendet në natyrë në tre forma: të ngurtë, të lëngshme, të gaztë.
- Uji i pastër vlon në 100 gradë C dhe ngrin në 0 gradë C.
- Në lartësi të mëdha, ku presioni i ajrit është më i vogël, pika e vlimit të ujit është më e ulët se 100 gradë.
- Kur tretim një substancë në ujë, pika e ngrirjes së ujit ulët nën 0 gradë. Për këtë arsye, në dimër, për të parandaluar ngrirjen e borës, hidhet kripë në rrugë.
- Uji quhet tretës universal. Ai mund të tretë më shumë substanca se çdo tretës tjetër.
- Uji, përmes molekulave të tij, mund të ngjiten pas çdo sendi, si gotat, pambuku, bimët apo toka.



### Rëndësia e ujit për jetën

- Pothuajse të gjitha substancat bëhen më të rënda dhe më të forta kur kalojnë nga gjendja e lëngshme në të ngurtë. Megjithatë, uji e rrit volumin e tij dhe bëhet më i lehtë kur shndërrohet në akull. Kjo veti është e rëndësishme për ruajtjen e jetës së gjallë në sistemet ujore gjatë dimrit.



- Kur bie shi, pikat e ujit tretin gazrat që gjenden në ajër. Kur arrin në Tokë, shiu ndikon në cilësinë e dheut, të liqeneve dhe të lumenjve.
- Uji mund të grumbullojë sasi të mëdha energjie, e cila mund t'i shndërrojë oqeanet, detet dhe liqenet në rezervuarë gjigantë për ngrohje. Kjo cilësi e veçantë e ujit ndikon në klimën e rajoneve që janë afër baseneve ujore. Gjithashtu, falë cilësisë së tij për ruajtjen e energjisë, uji përdoret për freskim dhe për transferimin e ngrohjes në procese termike dhe kimike.



- Pjesa më e madhe e trupit të njeriut përbëhet nga uji. Njerëzit duhet të pinë rreth dy litra ujë në ditë në mënyrë që të ruajnë funksionimin normal të organizmit.

### Pasuritë ujore

Vendi ku ruhet uji në tokë quhet rezervuar. Ujë i ëmbël (jo i kripur) gjendet:

- në lumenj, liqene, pellgje ujore (uji sipërfaqësor);
- në trupin e kafshëve, të njerëzve, rrënjët e bimëve, gjethet dhe frutat;
- nën sipërfaqen e tokës (ujërat nëntokësore).



### Ndikimi i njeriut

- Uji përdoret për ujitje në bujqësi, për ngrohje ose ftohje në industri, dhe në jetën e përditshme: për të pirë, për higjienë personale, për pastrim, për çlodhje, etj.
- Njerëzit mund të ndotin ujin apo të dëmtojnë burimet ujore në shumë mënyra, si:
  - Hedhja e mbetjeve në ujë ul cilësinë e ujit dhe shkatërron ekosistemet ujore.
  - Aktivitetet bujqësore, si përdorimi i pesticideve, i plehëruesve dhe i lëndëve të tjera kimike, shkaktojnë ndotje të rëndë të ajrit dhe të ujit.
- Ndërtimi i një ure ose zhvendosja e një shtrati lumi mund të shkaktojë ndryshime në rrjedhën e lumit ose të nivelit të ujërave nëntokësore.
- Marrja e rërës dhe e gurëve nga lumi shkatërron brigjet e lumenjve.
- Ujërat industriale që derdhen në lumenj, pa u trajtuar siç duhet, janë të dëmshme për bimët dhe kafshët e ujit dhe ndikojnë në shëndetin e njerëzve.
- Fermat e derrave dhe të shpendëve krijojnë shumë mbetje. Hedhja e këtyre mbetjeve në lumenj, pa trajtimin e duhur, mund të shkaktojë vdekje të bimëve dhe të kafshëve ujore, dhe sigurisht ndikon në shëndetin e njerëzve.
- Derdhja e prodhimeve të naftës në ujë dëmton ekosistemet ujore.
- Lumenjtë shpesh ndoten nga ujërat e zeza dhe nga rrjedhat e ujërave sipërfaqësore.
- Shumë qytete nuk kanë stacione për pastrimin e ujërave të zeza. Derdhja e drejtpërdrejtë e ujërave të zeza në lumenj shkatërron ekosistemet ujore.





## Planifikimi ditor i temës Uji

Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	II
Tema mësimore	Domosdoshmëria e ujit
Kohëzgjatja	2 orë mësimore
Rezultatet e të nxënit	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>përshkruan fazat e qarkullimit të ujit në natyrë.</li> <li>demonstron nëpërmjet shembujve të ndryshëm cilësitë e ujit.</li> <li>tregon rëndësinë e ujit për organizmat e gjalla.</li> </ul>
Situata e të nxënit	Tregimi “Lumi dhe përrenjtë e vegjël” Vjersha “Uji”
Fjalët kyç	Uji, qarkullim, tretje.
Burimet materiale	Gotë, ujës, një qelq i hollë, tas i mbushur me ujë, sfungjer, lule e bardhë, ngjyrë, akull, kripë, sheqer.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuhë shqipe, Arte, Dituri natyre.



## Ora I – Qarkullimi i ujit Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Vjersha: Uji ose tregimi “Lumi dhe përrenjtë”

Mësuesi/ja zbaton teknikën e “Leximi i imët me kodim” Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se do të lexojnë një tekst për burimet e ujit. Ajo/ai shënon në tabelë shenjat që do të përdoren për kodin dhe i shpjegon ato. Sa herë që në tekst flitet për lumin shënoni L.

Sa herë që në tekst flitet për përrenjtë e vegjël shënoni P. Sa herë që në tekst flitet për retë dhe shiun shënoni R/Sh. Udhëzohen nxënësit që të punojnë në dyshe për leximin e vendosjen e kodeve. I jepet në dispozicion për leximin e kodimin një hapësirë kohore rreth 15-18 minuta.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë vjershën e “Ujit”. Ajo/ai i fton nxënësit të gjejnë se sa fjalë në këtë vjershë kanë në përmbajtjen e tyre ujë.

Çdo njeri  
Ka një burim,  
që e ndjek  
në udhëtim.

Çdo njeri  
E ka një lumë  
Që i shfaqet  
Dhe në gjumë.

Çdo njeri  
E ka një det,  
Që në zemër  
i buçet.

Vetë njeriu  
Trup statujë  
Tre të katërtat  
i ka ujë.



Ftoni nxënësit të shfaqin mendimet e tyre rreth pyetjeve: Ku e gjejmë tjetër ujin në tokë? Pse uji është shumë i rëndësishëm për njeriun?



**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen se “Ku shkon uji i kovës pasi kemi larë me të pllakat e dyshemesë së klasës?” Dhe për ti dhënë zgjidhje kësaj pyetjeje ajo e ndan klasën në grupe me numërimin 1, 2, 3, 4, 5, 6.

Në secilin grup shpërndahet shkrimi “Qarkullimi i ujit” e ndarë në shumë pjesë. Nxënësit i lexojnë dhe i rendisin bashkërisht ashtu siç mendojnë ata. Lexohet tregimi nga një përfaqësues grupi. Mësuesi/ja nuk bën komente, por u thotë nxënësve të plotësojnë pazëllin e “Qarkullimit të Ujit” dhe të shohin se kush e ka renditur saktë shkrimin.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ftohen nxënësit në grupe të plotësojnë fletën e punës faqe 40 “Qarkullimi i ujit” dhe të emërtojnë fazat e ndryshme të qarkullimit të ujit.

Çdo grup prezanton fletën e punës “Qarkullimi i ujit” dhe komenton fazat e ndryshme të qarkullimit të ujit.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.



**Detyrë shtëpie:**

Shkruajnë në fletore një pesëvargësh për ujin. Nxënësit ndërtojnë një pesëvargësh për “Ujin”.

1. Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër-p.sh. Uji);
2. Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (zakonisht dy mbiemra);
3. Rreshti i tretë janë tri fjalë që shprehin veprim të temës;
4. Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë, që shpreh qëndrimin për temën;
5. Rreshti i fundit është një fjalë sinonime, që ripërcakton thelbin e temës (p.sh. Jetë).

Nxënësit vendosin në dy shishe të njëjtën lule, por në njëren shishe hedhin ngjyrues në ujë.

**Ora II – Uji, një element unik i planetit tonë  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja u jep nxënësve tabelën e mëposhtme “Burimet e ujit” që gjendet më poshtë. Nxënësit gjejnë burimet e ujit (oqean, ajsberg, shiu, ujvar, retë).

O	Q	E	A	N	T
V	S	A	L	A	Q
K	U	J	V	A	R
L	P	S	M	S	P
M	Q	B	D	D	A
R	S	E	E	F	R
S	R	R	E	T	Ë
E	E	G	G	G	V
SH	I	U	I	U	K



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Ftoni nxënësit të renditin disa cilësi të ujit me anë të teknikës së Braimstorming. Mësuesi/ja pyet nxënësit për detyrën e shtëpisë se çfarë kishin vënë re tek lulja e vendosur në ujin me ngjyrë të errët dhe pse është i rëndësishëm uji për bimët. Ajo e ndan klasën në aq grupe sa eksperimente do të realizojë, të tilla si: Gjendja e ujit, Temperatura e ngrirjes dhe vlimit, Tretja, Thithjen e ujit me një qelq të hollë me një sfungjer. Mësuesja plotëson tabelën e të koncepteve për ujin. Duke u bazuar në informacionin për “Ujin” në fillim të këtij kapitulli, mësuesi/ja u tregon nxënësve për cilësi të tjera të ujit dhe rëndësinë e tij për organizmat e gjalla.

Uji	3 Gjendje	Vlon	Ngrin	Lartësi	Tretje	Bima
Natyrë	E lëngët/ e ngurtë/ e gaztë	100°C	0°C	Vlimi më i ulët	Universal	Ngjitet deri në majë

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja ushtron nxënësit në punë dyshe për të diskutuar dhe treguar:

- Pse krijohet akull në sipërfaqen e ujërave në lumenj dhe liqene?
- Cila është rëndësia e kësaj cilësie për mirëmbajtjen e jetës në dimër?
- Pse detet dhe oqeanet nuk ngrijnë në dimër në gjerësi të mesme gjeografike?
- Pse dimrat janë më të butë, ndërsa verërat më të freskëta në afërsi të liqenit ose detit në krahasim me vendet më në brendësi të vendit?

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna.

### Detyrë shtëpie:

Nxënësit me ndihmën e prindërve plotësojnë hartën e lumenjve në Shqipëri.





Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	II
Tema mësimore	Uji dhe njerëzit
Kohëzgjatja	4 orë mësimore
Rezultatet e të nxënësit	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>tregon për domosdoshmërinë e ujit në jetën e përditshme të gjallesave;</li> <li>bëhet i vetëdijshëm se me ndryshime të vogla në sjellje mund të kursejnë shumë ujë;</li> <li>dallon burime të ndryshme të ndotjes së lumenjve.</li> </ul>
Situata e të nxënësit	Hulumtuesit e ujit Higjiena personale Përroi dhe peshku i vogël Qarkullimi i ujit
Fjalët kyç	Uji, qarkullim, ndotje, higjienë, kursim.
Burimet materiale	Shishe prej 1 litër, testi, “Sa kemi njohuri për ujin”, Fleta e punës, “Përdorimi i ujit”, 2 gota plastike, gjilpërë e gjatë, gozhdë, shirit prej celofani, kronometër, fletë pune “Burimet e ndotjes së ujit”, një shishe plastike e ndarë më dy pjesë, letër kuzhine, rërë, zhavorr, pambuk, ujë i ndotur, copa letrash dhe copa të vogla buke peshku, fletë për vizatim format-A4, ngjyra, markerë.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuha shqipe, Arte, Dituri natyre, Matematikë.

## Ora I – Hulumtuesit e ujit Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja zbaton teknikën “Ngrij/formo dyshe”. Nxënësit çohen në këmbë dhe lëvizin në mënyrë të lirshme nëpër klasë, duke u përzier me të tjerët. Mësuesja thotë “Ngrij” dhe nxënësit ndalojnë në vend. Mësuesi/ja thotë “Formo dyshe” dhe nxënësit bashkohen në dyshe me personin që kanë pranë, duke u ulur në karriget që mund të jenë të lira aty pranë.

Pasi gjen shokun flasin bashkë për të paktën 5 minuta për përdorimin e ujit nga eksperiencia e tyre (për nevoja personale; për pije; gatim; higjienë personale larje; pushim dhe rekreacion në ujë etj; për qëllime ekonomike: ujitjen e drithërave, prodhimin e mallrave të ndryshme dhe ofrimin e shërbimeve, për trafikun). Pastaj të gjithë fëmijët ngrihen para klasës e prezantojnë përdorimin e ujit. Mësuesja mban shënimet e përdorimit në tabelë. Më pas diskutimi me nxënësit fokusohet rreth pyetjes: “Pse njerëzit e moshuar në fshat zgjidhen gjurmues të ujit për të gjetur një burim të ri të ujit?” Mësuesi/ja shpjegon se duke e parë nga perspektiva historike, të gjitha vendbanimet ku jetojnë njerëzit gjithmonë kanë qenë të lidhur me ujin dhe afër tij (detet, lumenjtë, liqenet etj). Mësuesi/ ja plotëson diagramin e Venit të vizatuar në tabelë, duke krahasuar numrin e burimeve me numrin e shumtë të përdorimit të ujit në natyrë, përkatësisht: higjiena personale/pastrimin/gatim/ujë/ujitje etj.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja zbaton teknikën “Dy të vërteta dhe një gënjeshtërt”. Secilit nxënës i kërkohet të shkruajë tre fjali për tekstin e dhënë. Dy prej fjalive duhet të jenë të vërteta dhe një e gënjeshtërt. Mësuesi/ja i poroset që gënjeshtër të mos jetë e dukshme. Pas pak minutash disa nxënës lexojnë fjalitë e tyre. Nxënësit e tjerë në klasë do të gjejnë se cila prej thënieve është e gënjeshtërt.

Diskutimi me nxënësit vazhdon rreth rëndësisë së shfrytëzimit të ujit duke e kursyer atë, sepse bota ballafaqohet me një krizë botërore në lidhje me ujin dhe ndotjen e tij. Bisedohet me nxënësit se në cilat raste uji mund të përdoret më ekonomikisht.

Nxënësit shprehin idetë e tyre për kursimin e ujit në rastet që vijojnë:

- Larjen e frutave dhe perimeve;
- Larjen e pjatave;
- Larjen e rrobave me lavatrice;
- Vadtjen e kopshtit;
- Larjen e makinës.



**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja në këtë fazë zbaton teknikën “Lapsat në mes”. Tërhiqet vëmendja mbi rregullat e diskutimit gjatë kësaj teknike. Shoku që vë lapsin e tij në mes të tavolinës ka radhën të flasë për pyetjen “Pse uji është i domosdoshëm në jetën e përditshme të njerëzve?”. Pasi të kenë folur secili nga një herë radhën e ka dikush që do të flasë për herë të dytë. Ai që nuk ka mendim ia pason shokut.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna gjatë diskutimeve.

**Detyrë shtëpie:**

Ftoni nxënësit të përgatitin detyrë shtëpie një plan kurse se si mund të kursehet uji në shtëpitë e tyre. Për këtë ftohen të bisedojnë dhe me prindërit e tyre.

## Ora II – Uji dhe higjiena personale Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja shpërndan fletët e punës faqe 42, “Përdorimi i ujit” dhe fton nxënësit që pasi ta lexojnë të sjellin shembuj nga jeta e tyre e përditshme se si kanë vepruar ata në situata të tilla. Theksohet se me disa ndryshime të vogla në sjellje secili nga ne mund të kursejë ujë. Mësuesi/ja u tregon nxënësve se do ta vërtetojnë këtë me ndihmën e një shembulli dhe një problemi matematikor.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të demonstrojnë eksperimentin në vijim:

- Merrni dy gota prej letre dhe bëni disa vrima të njëjta në fund të gotave (Pesë ose gjashtë). Përdorni një gjilpërë të madhe për njëërën gotë dhe një gozhdë të madhe për tjetrën.
- Ngjitni një shirit prej celofani nga ana e jashtme në fundin e gotës.
- Ftoni dy vullnetarë që t’i mbushin të dy gotat me ujë me një sasi të barabartë. Pastaj në të njëjtën kohë hiqni shiritat prej fundit të tyre. Nxënësit masin se sa kohë është e nevojshme që të rrjedh uji. Përsëriteni eksperimentin nëse ka nevojë.
- Tregojuni nxënësve se kjo paraqet një mënyrë të thjeshtë që të kursehet ujë gjatë bërjes dush. Në ditën e sotme ne treg mund të gjesim rubinete dhe dushe të ndryshme, me funksione të ndryshme, ndërsa disa prej tyre mund të kursejnë ujë pikërisht në mënyrë të tillë.

Tregojuni nxënësve që t’u japin “këshillë profesionale” prindërve të tyre, kur do të vendosin të blejnë një dush të ri për shtëpinë e tyre.

Ilustroni problemin matematikor në vijim:

- Pyesni nxënësit sa herë në ditë i lajnë dhëmbët. Kërkonin një nxënës vullnetar që të shkojë deri në lavaman dhe të tregojë se si bëhet kjo (vërejtje: në rast se nuk ka ujë në klasë, nxënësi mund ta përshkruajë procedurën).
- Diskutoni rreth mundësisë nëse mund të gjendet një mënyrë tjetër e kursimit të ujit kur i lajmë dhëmbët. Ai që i lan dhëmbët duhet ta hapi çezmën e ujit vetëm kur duhet të lagë furçën ose dhëmbët, ndërsa e mbyll gjatë kohës kur i pastron dhëmbët me furçë.





- Tregojuni nxënësve se përshtypja e parë është se kjo mënyrë e kursimit nuk ka efekt të rëndësishëm gjatë kursimit të ujit. Mes tjerash, në realitet, nëse secili e bën këtë ndryshim të vogël mund të ketë një efekt shumë të madh. Që ti bindni ata që dyshojnë ftoni nxënësit që ta zgjedhin problemin në vijim: Përfytyro sikur secili anëtar i familjes do t'i lajë dhëmbët me ujin që rrjedh tërë kohën. Kur ju t'ju tregoni se të gjithë mund të kursejnë ujë, ata binden që t'i ndryshojnë mënyrën e tyre dhe ta përdorin ujin vetëm kur do të duhet të lagin furçën dhe shpëllajnë dhëmbët.

Eksperimenti përfshinë të dhënat në vijim:

- Familja juaj përbëhet nga 5 anëtarë të familjes.
- Çdo anëtar i lan dhëmbët dy herë në ditë.
- Pastrimi i dhëmbëve përafërsisht zgjat rreth 3 minuta, ndërsa rrjedha mesatare e ujit është 2 litra në minutë.
- Me metodën e kursimit të ujit kursehet 1 litër për person.



Ftoni nxënësit që së bashku me prindërit e tyre të llogarisin:

- Sasinë e ujit që e përdor familja kur e lë ujin që të rrjedhë vazhdimisht.
- Sasinë e ujit që e përdor familja kur e zbaton mënyrën për kursim.
- Sasia e ujit që mund të kursehet për një ditë nga familja.
- Çfarë mund të ndodhë nëse njëqind familje të qytetit tuaj e ndjekin këtë shembull?

#### Përgjigje:

- a)  $3 \times 2 \times 2 \times 5 = 60$  litra në ditë

Sqarojuni nxënësve se nëse respektohet kjo një vit, rezultati do të jetë:  
 $60 \times 365 = 21.900$  litra

- b)  $1 \times 2 \times 5 = 10$  litra në ditë

Sqarojuni nxënësve se nëse respektohet kjo një vit, rezultati do të jetë:  
 $10 \times 365 = 3.650$  litra

- c) **60 litra - 50 litra = 10 litra në ditë**

Së bashku llogariteni ujin e kursyer të familjes për një vit (18.250 litra). Për lehtësim, rrethoni shifrën prej 20.000 litra ose 20 metra kub për familje.

- d) **50 litra x 100 = 5.000 litra në ditë**

Së bashku llogariteni ujin e kursyer të 100 familjeve për një vit — 1.825.000 litra (1.825 metra kub) ose nëse e keni zgjedhur që të rrumbullakoni — rreth 2.000 metra kub.

Sqarojuni se me 2.000 metra kub mund të mbushni një pishinë të madhe si pishina e olimpiadës (50 m x 20 m x 2 m).

#### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi /ja fton nxënësit të prezantojnë zgjidhjen e problemit. Më pas shpërndan fletën e "Dilemës" dhe nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth situatës.

#### Detyrë shtëpie:

Ftoni nxënësit të përgatisin një poster me temë: "Miq të ujit" duke punuar në grupe. Prezantoni punët e nxënësve në ditën e 22 Marsit, sepse kjo është Dita Botërore e Ujit.

### Ora III – Përroi dhe peshku i vogël Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tregimin "Përroi dhe peshku i vogël" në faqen 46. Mësuesja zbaton teknikën "Ditari i të nxënit". Nxënësit plotësojnë tabelën në mënyrë individuale dhe më pas së bashku me mësuesen/in në tabelën e klasës.

Fjali	që i bëjnë përshtypje	që i çudisin	që i entuziazmojnë	që i zemërojnë

Jepuni nxënësve një përfundim se me ndikimin e tyre negative i shkatërrojnë gjërat e mrekullueshme që i rrethojnë dhe pastaj nuk janë të vetëdijshëm për dëmet që i shkaktojnë.

Ftojini nxënësit të renditin disa nga ndotësit e ujit. Shkruajini ato në tabelë.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit vizatojnë një lumë dhe ngjisin fotografitë e prera nga fleta e punës “Burimet e ndotjes së ujit” dhe i vendosin në lumin e vizatuar në një fletë tjetër. Vizatoni edhe ju një lumë në tabelë. Diskutoni me nxënësit për llojet e ndryshme të burimeve të ndotjes së ujërave. Ftoni që çdo nxënës që të tregojë para klasës se në çfarë mënyre ndotësi i tij e zvogëlon cilësinë e ujit. Përpuni që nxënësit të kuptojnë se të gjitha aktivitetet e njeriut përgjatë lumit kanë ndikim negativ në cilësinë e ujit. Sqaroni se në miliona vite bota e gjallë e lumenjve, bimët dhe kafshët janë përshtatur në kushtet natyrore për jetë. Ndërsa kur aktivitetet e njeriut e ndërrojnë mjedisin jetësor, bota e gjallë nuk ka shumë kohë që të përshtatet dhe shumë shpejt vdes.

Kujtojini nxënësit se së bashku me organizmat tjerë të gjallë, njerëzit gjithashtu varen nga pastërtia e shtratit të ujërave, që i shfrytëzojnë për pije, në kuzhinë, industri, ferma, sport dhe argëtim në ujë.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4-5 veta. Ftoni nxënësit sipas grupeve të bëjnë një listë me ide dhe të japin shembuj për aktivitete të ndryshme të dedikuara për mbrojtjen e lumenjve.

Ndotja e Ujit	
Shkaku	Pasoja

Kushtojuni vëmendje atyre që janë të lidhura ngushtë me shprehitë e ditës (hedhje e mbeturinave ose ujë kanalizues në lumenj, dëmtimin e brigjeve të tyre etj).

Nxënësit sipas grupeve prezantojnë punën e tyre dhe shprehin mendime për punët e njëri-tjetrit.

Mësuesi/ja realizon veprimtarinë: Pastrimi i ujit. Ai/ajo jep udhëzimet e mëposhtme:

1. Vendosni gjysmën e sipërme të shishes mbrapsht (në formë hinke), brenda gjysmës së poshtme. Gjysma e sipërme do të shërbejë për të bërë filtrin, kurse gjysma e poshtme do të mbledhë ujin e filtruar.
2. Shtroni materialin e filtrit brenda gjysmës së sipërme të shishes transparente. Në varësi të ndotjes që mund të mbajnë materialet e filtrimit, mendoni për radhën e vendosjes së tyre në hinkën e improvizuar. Do të ishte një sfidë e vërtetë nëse do të mund të filtronit ujin vetëm me dy materiale filtrimi.
3. Hidheni ujin e ndotur në filtër. Si ju duket uji pasi është filtruar?
4. Hiqni materialet e filtrit dhe shikoni shtresat e ndryshme të tij. A mund të dalloni se cilët nga ndotësit kanë mbetur në secilën prej shtresave të filtrit të vendosura prej jush?

Pastroni pjesët e shishes dhe bëjeni edhe njëherë eksperimentin. Vendosni materialet e filtrimit në radhë tjetër ose përdor lloje materiale në sasi të ndryshme.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna gjatë diskutimit dhe prezantimit të fletës së punës faqe 43-45, “Burimet e ndotjes së ujit”.

### Detyrë shtëpie:

Të gjejnë informacione për pasuritë natyrore të qytetit apo fshatit tuaj dhe në shtetin tonë. Të tregojnë se çfarë kujdesi tregohet për to.



## Ora IV – Qarkullimi i ujit Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të bëjnë aktivitetin në vijim për të mësuar se si qarkullon uji nëpër gurë, rërë dhe argjilë.

Në një enë me vrima në fund vendosni gurë të imët, në tjetrën rërë dhe në të tretën argjilë.

Për të demonstruar se uji nëntokësor qarkullon nëpër pjesët e shkëmbit nën tokësor, derdhni ujë në secilën prej enëve. Fton nxënësit të vëzhgojnë dhe më pas diskutohen për rezultatet.

- Cila enë më shpejtë e lëshon ujin?
- Cila më ngadalë?
- Si ndikojnë materiet e ndryshme ndaj qarkullimit të ujit në sistemin natyror?

Sqarojini nxënësit se si lloje dhe madhësi të ndryshme të tokës kontribuojnë për qarkullimin e ujit

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi /ja fton nxënësit të zhvillojnë lojën “Qarkullimi i ujit”. Zgjidhni tre nxënës që të “bëhen” ujë. Nxënësit tjerë do të jenë material guri.

- **Qarkullimi i ujit nëpër gurë**  
Nxënësit që luajnë rolin e gurëve zgjasin duart duke takuar njëri tjetrin. Qëllimi i nxënësve, të cilët janë në rolin e ujit, është që të kalojnë (rrjedhën) duke kaluar nëpër nxënësit, të cilët i janë në rolin e gurëve të vegjël që janë në anën tjetër të klasës.
- **Qarkullimi i ujit nëpër rërë**  
Nxënësit bëhen rërë duke i hapur duart, duke i lakuar bërrylat dhe duke prekur belin me majat e gishtërinjve. Nxënësit – kokrriza rëre duhet të qëndrojnë kështu që beli e tyre pothuajse takohen. Nxënësit – pika uji do të kenë vështirësi gjatë lëvizjes, por ende do të mund të arrijnë në anën tjetër.
- **Qarkullimi i ujit nëpër shtresat e argjilës**  
Nxënësit bëhen pjesë nga argjila duke i mbajtur duart të lëshuara pranë trupit dhe të afruar njëri pranë tjetrit. Ata duhet të jenë shumë afër njëri tjetrit, duke bërë pengesë për pikat e ujit. Pa qenë të ashpër, nxënësit – pika uji duhet ngadalë të depërtojnë nëpër argjilë. Ndoshta të gjithë nuk do të mund të kalojnë nëpër argjilë. Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë kuptuan nga kjo lojë dhe diskutoni për ndotjen dhe pastrimin e ujit në tokë.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit gjejnë gjëgjëzën e mëposhtme dhe shkruajnë secili edhe një varg tjetër mbyllës. Më pas zbatohet teknika “Karrigia e autorit” për mbylljen më të bukur.

Lëng floriri  
që s’matem dot,  
po s’ më pate,  
të vjen ndot,  
sa habitesh edhe ti,  
bëhesh pis,  
s’të njeh njeri.

.....,  
.....

Ftoni nxënësit të plotësojnë fletën e punës në faqe 41 si dhe testin “A e njohim ujin?” në fletën e punës, faqe 39. Diskutoni përgjigjet e nxënësve. Në fund në diskutimi me nxënësit jepet një përfundim se: ndikimi negativ i njerëzve i shkatërron gjërat e mrekullueshme që na rrethojnë sepse nuk jemi të vetëdijshëm për dëmet që shkaktojnë.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për testin: “A e njohim ujin”.

**Detyre shtëpie:**

Fëmijët do të hapin një ekspozitë me lloje të ndryshme fotosh të çezmave që përdoren në Shqipëri. Ekspozita është titulluar “Çezma më e bukur e Shqipërisë”, e cila hapet në javën “Miqhtë e ujit”.





## DILEMA

## Pikë pas pike

Ju shkoni për vizitë tek një shok i klasës dhe në oborrin e shtëpisë së tij, shikoni babain e tij, që me një tub uji në duar, po përgatitet që ta lajë makinën. Çfarë do të bëni ju:

- Do ti ofroni ndihmë;
- Do ti propozoni të përdori një kovë me ujë për larjen e makinës, që të kursejë ujin;
- Do ti propozoni që makinën ta lajë në lavazhin për makina;
- Nuk do ti flisni fare, sepse jeni një fëmijë i turpshëm dhe mendoni se kjo nuk është puna juaj;
- Apo diçka tjetër.



## TEST

## A e njohim ujin?

	E SAKTË	E GABUAR
1 Më pak se gjysma e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Uji në Tokë gjendet në dy forma.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Uji mbart sasi të mëdha energjie.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Kur materiale të ndryshme treten në ujë, temperatura e ngrirjes së ujit rritet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Vetëm 3% ujë që e përdorin njerëzit shërben për t'u pirë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Është e arsyeshme që të përdoret i njëjti uji si për t'u pirë, si për vaditjen e luleve e bimëve, por dhe për pastrimin e trotuarit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Nuk ka asnjë problem nëse për të larë dhe freskuar frutat lemë çezmën hapur dhe përdorim ujin e rrjedhshëm të saj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Ndotësit kryesor të ujit janë industria dhe transporti uJOR.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Pa ujë, Toka do të ishte një planet i shkretë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E gabuar 2. E gabuar 3. E saktë 4. E saktë 5. E gabuar 6. E saktë 7. E gabuar 8. E saktë 9. E saktë



## FLETË PUNE

### Qarkullimi i ujit



**Avullimi** — Meqë dielli e ngroh ujin, ai avullohet dhe ngjitet në ajër si avull i padukshëm.

1



**Transpirimi** — Uji avullon nga gjethet dhe bimët përmes procesit të quajtur transpirim/avullim.

2



**Kondensimi** — Avulli i ujit ngrihet në shtresat e larta të atmosferës, ku ftohet dhe shndërrohet në pika uji — lëng. Kur temperaturat janë shumë të ulëta, ai shndërrohet në gjendje të ngurtë (si akull, breshër ose borë).

3



**Reshjet** — Sasia e reshjeve, në formë të shiut, borës ose breshërit vjen nga retë.

4



**Rrjedha ujore** — Ujin që nuk mund të thithet nga toka, rrjedh në formën e përrenjve të, lumenjtë apo dhe liqenet.

5



**Pastrimi natyror i ujit** — Shirat dhe bora që shkrihen rrjedhin nëpër tokë, pastrohen prej grimcave më të mëdha dhe depërtojnë nëpër të çarat dhe porët e tokës dhe gurëve.

6



**Ujërat nëntokësore** — Ujërat nëntokësore qëndrojnë në të çarat dhe hapësirat e shkëmbinjve. Ky ujë mund të përdoret përmes hapjes së puseve.

7



**Niveli i ujit nëntokësor** — Niveli deri ku uji ngritet në pus të hapur.

8



# FLETË PUNE Sa ujë ka në...?

The illustration shows a blue water splash with various food items and a jellyfish. A complex maze of black lines is drawn over the splash. At the bottom, there is a horizontal scale from 40 to 100 with a percentage sign.

Food Item	Percentage
Tomato	40
Green cheese	50
Meat	60
Mushroom	70
Egg	80
Jellyfish	90
Swiss cheese	100





## FLETË PUNE

# Përdorimi i ujit

### Higjiena personale



- Mos e lini ujin që të rrjedh derisa të lani dhëmbët, duart apo fytyrën.
- Mendoni se a është më mirë të bëni një banjë (me 100-200 litra) apo një dush (me rreth 80 litra).
- Mos hidhni mbetjet në tualet.

### Pastrimi



- Para se ti lani enët, pastroni mbetjet e ushqimeve nga pjatat.
- Mos i lani enët e palara nën ujin që rrjedh, por në vend të kësaj, mbusheni lavamanin me ujë. Kjo mënyrë kursen gjysmën e sasië së ujit që do t'iu nevojitet.
- Vendoseni lavatriçen vetëm kur ajo është e mbushur plot me rroba që duhen larë.
- Lani makinën tuaj duke përdorur ujin e një kove dhe vetëm në fund përdorni për shpëlarje tubin me ujë të rrjedhshëm.
- Pastroni ballkonet me ujë shiu.
- Përdorni fshesën për ti fshirë gjethet që kanë rënë dhe jo zorrën e ujit.

### Gatimi/pija



- Vendosni mbyllës në lavaman kur i pastroni perimet dhe frutat.
- Mos i ftohni ushqimet ose pijet me ujin që rrjedh nga çezma.
- Nëse dëshironi ujë më të ftohtë, atëherë mos prisni që të ftohet uji duke rrjedhur nga çezma, por mbani shishe me ujë të ftohtë në frigorifer.

### Ujitja



- Mos e përdorni ujin e pijshëm për vaditjen e kopshtit – përdorni ujë prej burimeve ose shirave të mbledhura më herët.
- Evitoni vaditjen e kopshtit kur koha është me erë ose shumë e nxehtë sepse atëherë uji avullon më shpejt.
- Përdorni vaditje me spërkatës, me anë të të cilit kursehet një sasi e madhe uji.
- Mbuloni vendet e vaditura me kashtë ose gjethe që ta kufizoni avullimin.



## FLETË PUNE

## Burimet e ndotjes së ujit



**Anijet, barkat me motor, dhe skuterët në ujë**  
Sportet e ujit e ndotin ujin me vaj dhe naftë.



**Plehërat dhe kimikatet bujqësore**  
Plehërat dhe kimikatet bujqësore ndotin liqenet dhe lumenjtë kur uji e shpërllan tokën nga fushat e punuara.



**Kafshët dhe fermat**  
Mbetjet organike të kafshëve që rriten në ferma shpesh përfundojnë në shtretërit e ujërave pa u trajtuar, duke ndotur ujërat dhe shkatërruar mjediset ujore.



**Ujërat e ndotura**  
Qendrat për trajtimin e ujërave të ndotura mund të shkaktojnë ndotjen e ujit nëse nuk punojnë në mënyrë të rregullt. Vetëm uji i filtruar mund të shkarkohet në lumenj, liqene apo dhe det.



**Mbetjet në plazh**  
Kur shkoni në plazh mblidhni mbetjet tuaja dhe hidhini ato në kosh.





FLETË PUNE

## Burimet e ndotjes së ujit (vazhdon)



### Ndryshime në brigjet e lumenjve

Ndërtimi i urave dhe ndryshimi i brigjeve të lumenjve mund të ndryshojnë rrjedhën e lumenjve dhe ujërave nëntokësore.



### Nxjerrja e rërës dhe gurit

Nxjerrja e rërës dhe gurit nga lumenjtë i shkatërron brigjet dhe e rrit ndotjen.



### Shiu acid

Shiu acid dëmton lumenjtë, liqenet, peshqit dhe bimët që jetojnë në to.



### Automjetet

Shpesh njerëzit i lajnë makinat e tyre afër ose në shtratin e lumit.



## FLETË PUNE

## Burimet e ndotjes së ujit (vazhdon)

**Hedhja e mbetjeve**

Hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit e zvogëlon cilësinë e ujit dhe i shkatërron mjediset ujore.

**Shesh ndërtimesh**

Përdorimi i bojrave, vajrave dhe materialeve të ndërtimit në afërsi të burimeve ujore, mund të ndosë lumenjtë dhe pellgjet ujëmbledhëse.

**Gjuetarët ilegalë**

Teknikat e palejuara për gjueti dhe peshkim mund ta dëmtojnë cilësinë e ujit dhe ti shkatërrojnë bashkësitë ujore të kafshëve.

**Shirat e rrëmbyeshëm**

Lumenjtë shpesh ndoten prej ujërave, dhe rrjedhave ujore sipërfaqësore, që vijnë si rezultat i shirave, rrebesheve dhe katastrofave të tjera natyrore.





FLETË PUNE

## Përroi dhe peshku i vogël



Atë ditë përroi e pa peshkun e vogël se si po largohej nga ujërat e tij dhe i çuditur e pyeti:

– Peshk i vogël, për ku je nisur?

– Po iki sa më larg nga ky ujë me me baltë dhe i qelbur.

– E pse? – u habit përroi.

– Po këtu nuk mund të gjejë më një shtëpi të qetë. Nuk ka më bimë ku të fshihem, nuk ka më as krimba, buburreca, dhe gafore me të cilat ushqehem... gjithnjë e më tepër jam i uritur. Patjetër duhet të gjej një zgjidhje, sepse edhe oksigjeni i mungon ujit.

Përroi u ofendua prej fjalëve të peshkut të vogël dhe me buzëqeshje e pyeti:

– Po ku do të shkosh?

– Do të kërkoj një përrua më të pastër, atje lart në mal, ku nuk ka njerëz që ta turbullojnë ujin e pastër të burimit.

– Por, peshk i vogël – u ankua përroi, duke u bërë xheloz ndaj ujit të pastër të burimit.

– Prit, mos më braktis, të lutem, do të mundohem që ti pastroj ujërat e mija!

– Por, si?

– Një gjyshe plakë më ka treguar se nëse kaloj nëpër 40 gurë, do të bëhem i pastër si loti i saj.

– Hah, por njerëzit përsëri do të ndotin – ia ktheu peshku i vogël duke mos i besuar.

– Atëherë, nuk kam shpëtim. Dhe, kur të gjitha burimet e ujit do të bëhen si unë, njerëzit do të duhet patjetër ta pinë ujin e ndotur dhe të gjithë do të jemi në rrezik...





## Dheu

Dheu është shtresa e **sipërme** e sipërfaqes së tokës dhe është baza për jetën tokësore në planetin tonë. Ai mendohet si një sistem jetësor, ku jetojnë organizma të gjallë të shumëllojshëm dhe është në proces të vazhdueshëm formimi dhe shkatërrimi (erozioni). Dheu ka një veti të veçantë –  **pjellorinë**.

**Krijimi i dheut** është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar, rezultat i qarkullimit të vazhdueshëm të lëndëve dhe të energjisë ndërmjet organizmave të gjallë (bimëve, kafshëve dhe mikroorganizmave) dhe natyrës jo të gjallë (gurëve dhe mineraleve). Meqë ky proces është shumë i gjatë, dheu mund të mendohet si burim natyror që nuk ripërtërihet. Rreth 65% e sipërfaqes së pjesës kontinentale të planetit është e mbuluar me dhe. Nga kjo sipërfaqe, më pak se një e treta mund të përdoret drejtpërdrejt për aktivitete bujqësore: kullota, livadhe dhe tokë e punueshme që jep prodhime bujqësore.

**Faktorët** që ndikojnë në krijimin e dheut (shtresa pjellore e tokës) janë: organizmat e gjallë (bimët, kafshët, aktiviteti njerëzor, mikroorganizmat), klima dhe moti.

Dheu përbëhet nga katër pjesë:

- Pjesa e ngurtë – mineralet dhe lëndët organike;
- Pjesa e lëngët – uji;
- Pjesa e gaztë – ajri;
- Pjesa me organizmat e gjallë – mikroorganizmat dhe insektet e tokës.



Në shtresën e sipërme të dheut (tokës) gjenden **mikroorganizma**, siç janë bakteret, kërpudhat, krimbat dhe larvat. Kërmijtë, minjtë dhe krimbat paraqesin 50%-75% të organizmave të gjallë në tokën e punueshme. Rrënjët e bimëve dhe organizmat që jetojnë në tokë i shndërrojnë lëndët organike në humus, i cili më pas përzihet me lëndët minerale të tokës, duke e bërë tokën më pjellore. Krahas kësaj, krimbat e bëjnë dheun të butë, e rëndësishme kjo për rrënjët e bimëve.

Dheu (toka) kryen shumë **funksi**o të ndryshme:

- Është bazë për prodhimin e biomasës dhe të ushqimit për bimët, kafshët dhe njerëzit. Gjithashtu, dekompozimi i bimëve dhe i kafshëve të vdekura ndodh në tokë.
- Pastron ujërat nëntokësore dhe luan rolin e filtruesit dhe të stabilizuesit natyror.
- Shërben si vendbanim për bimët dhe kafshët.
- Është burim i lëndës së parë për ndërtim dhe i burimeve të ripërtëritshme të lëndëve djegëse (p.sh. kashtë, torfë, mbetjet e drurit).
- Ai është mjedis historik, që ruan vlerën e trashëgimisë historike dhe kulturore.



Shtresa e dheut në Tokë është holluar dhe në shumë vende cilësia e tij është **përkeqësuar**. Ne duhet të përpiqemi të ndalojmë procesin e shkatërrimit të dheut (tokës), në mënyrë që dheu të kryejë funksionet e veta. Problemet më serioze dhe kërcënimet kryesore ndaj tokës janë erozioni, acidifikimi, ndotja, ngjeshja dhe kripëzimi.



Pjelloria e dheut (tokës) në të gjithë planetin është zvogëluar ndjeshëm për shkak të lagështirës dhe të nxehtësisë së pamjaftueshme. Një prej fakteve më shqetësues është se, për shkak të menaxhimit jo të mirë, toka pjellore po humb në sasi të mëdha çdo vit, çka çon në përdorimin gjithnjë e më shumë të tokave natyrore (livadheve, pyjeve dhe kullotave) për prodhim bujqësor.

Mbrojtja e dheut (tokës) është shumë e rëndësishme. Dheu i thith shumë lehtë lëndët e dëmshme të lëshuara nga burime të ndryshme ndotëse.

Për dallim nga ajri dhe uji, toka mund të jetë **pronësi private**, që e vështirëson mbrojtjen e saj, sepse ajo varet nga vullneti i pronarëve.

## Planifikimi ditor i temës Dheu

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Koncepti i dheut. Studimi i tokës.
<b>Kohëzgjatja</b>	2 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>tregon funksionet kryesore të tokës për organizmat e gjallë;</li> <li>rendit karakteristikat themelore të dheut;</li> <li>bëhet i vetëdijshëm se formimi i dheut bëhet për një kohë të gjatë.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Përbërësit e dheut. Përralla “Toka është flori”
<b>Fjalët kyç</b>	Dheu, korja e Tokës, ngjyra, lagështia dhe dendësia e Tokës.
<b>Burimet materiale</b>	Tabelë, marker, shkumës, fleta pune për ngjyrosje, kavanoz i madh prej qelqi ose plastike, rërë e trashë, rërë, gjethet, krimbat dhe insektet artificiale (mund të bëhen nga letra), uji, lugë e madhe, qelq zmadhues, dhe i mbledhur nga vende të ndryshme 3-4 qelqe laboratorike, letër, thikë, letër që thithë ose letër-filtër.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Dituri natyre, Arte, Gjuha shqipe.



## Ora I – Çfarë është dheu? Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të thonë mendime mbi:

- Çfarë gjendet në tokë?

Bazuar dhe në mendimet e nxënësve mësuesi/ja shpjegon se nuk mund të shihen të gjitha pjesët përbërëse të tokës në shikim të parë. Materiet jo të gjalla, siç janë rëra e trashë, rëra dhe balta, janë të përziera me materie të organizmave të gjallë. Gjithashtu, në të janë përzier uji dhe ajri.
- Mësuesi/ja shpjegon se koncepti “Tokë” është shtresa e sipërme e kores së tokës, që përfshin lëndën minerale, lëndën organike, pjesën e lëngshme, pjesën e gaztë, pjesën biotike dhe që përmbush funksionet
  - funksionet natyrore, si krijuese të bazës së jetës dhe hapësirës për jetesën e njerëzve, të faunës dhe të florës; si pjesë përbërëse e pasurisë natyrore, që zotëron cilësinë e veçantë të pjellorisë natyrore, në të cilën qarkullojnë uji e lëndët ushqyese; si mjet formimi, shpërbërjeje dhe ruajtjeje për bashkëveprimin e lëndëve, në bazë të vetive filtruese, shtytëse e transformuese të tyre, në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e ujërave nëntokësore;
  - funksionet si arkiv i historisë së natyrës dhe të kulturës;
  - funksione të tjera në dobi të njeriut.
- Mësuesi/ja u kushton kujdes tre faktorëve: *Klimës, vendndodhjes dhe kohës* që e përcaktojnë krijimin e tokës. Në bashkëbisedim me nxënësit shpjegon se: *Klima* luan rol të rëndësishëm në shpejtësinë, me të cilën ndodhin proceset në tokë. Vendet e nxehta janë të përshtatshme për krijimin e tokës. *Vendndodhja* ka të bëjë me atë nëse toka është në mal apo në fushë dhe nëse zona është e pjerrët ose e sheshtë. Është shumë e vështirë që të parandalohet humbja e tokës atje ku rajoni është i pjerrët, prandaj njerëzit mendojnë se mbrojtja e tokës në male është më e rëndësishme. Gjithashtu theksohet se toka nuk mund të krijohet vetëm me një përzierje të thjeshtë të pjesëve të saj përbërëse, për arsye se nevojitet edhe *kohë*.



Për të vërtetuar pohimin e fundit, bëni demonstrimin në vijim me ndihmën e disa nxënësve:

- Vendosni pak rërë të trashë, rërë të imët dhe baltë në një kavanoz të zbrazët. Shtoni disa gjethe dhe krimba dhe insekte artificiale. Tundeni përsëri. Shtoni pak ujë, por mos e mbushni kavanozin deri te gryka. Pyesni nxënësit nëse mendojnë se ky është *dheu* i vërtetë.
- Ndani klasën në grupe dhe ftoni që çdo grup të gërmojë dhe të sjellë dy-tre grushta të dheut të vërtetë (kjo detyrë mund t'u jepet disa vullnetarëve një ditë më parë). Ftoni nxënësit që ta krahasojnë dheun e sjellë me atë të eksperimentit. Shpjegoni se në këtë përzierje, po ashtu ka edhe ajër, i cili është i domosdoshëm për kafshët dhe për rrënjët e bimëve. Shikojeni këtë me lente zmadhuese.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Në vazhdim të diskutimit mësuesi/ja zbaton teknikën “Bashkohu dhe shkëmbe”. Nxënësit të vendosur në rreth numërojnë në mënyrë të përsëritur 1, 2, 1, 2 (n.q.s gjendet një tek numër fut edhe një nxënës tjetër në lojë).

- 1) Numri 2 vendoset jashtë rrethit përbri numrit 1.
- 2) Numri 1 pyet dhe numri 2, është i detyruar të përgjigjet.
- 3) Ndërroni vendet e fëmijëve duke shtuar pyetje të reja për diskutim.
- 4) Në një qoshe të klasës mësuesja vendos “Kutinë e shembujve”.

#### “Kutia e Shembujve”

- Cilat janë funksionet kryesore të tokës (dheut) për organizmat e gjallë, njerëzit, bimët dhe kafshët?
- A është dheu bazë për prodhimin e biomasës dhe ushqimit për bimët, kafshët dhe për njerëzit?
- Jep shembuj që dheu i pastron ujërat nëntokësore dhe ka rol filtrues dhe stabilizues natyror?
- Jep shembuj që toka shërben si vendbanim i bimëve dhe kafshëve?
- Jep shembuj që toka (dheu) shërben për marrjen e materialeve për ndërtim?
- Jep shembuj që toka (dheu) shërben si burim i lëndës djegëse natyrore (p.sh, kashtë, torfë, lënda drusore)?
- Jep shembuj që toka (dheu) është mjedis historik, që e ruan vlerën e trashëgimisë historike dhe kulturore?

Mësuesja/si ndihmon e plotëson përgjigjet e nxënësve. Duke respektuar radhën e nxënësve.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja/si zbaton teknikën “Ngrij/shkrij/formo dyshe”. Mësuesi/ja shpërndan fishat në të cilat ka shkruajtur fjali të tilla si:

Shtresa e sipërme,  
pjesë e kores së Tokës.

Mbulon tërë planetin.

Toka krijohet...

Toka ka lagështirë,  
është e ngurtë, pjellore.

Pjelloria e tokës...

Kombinim i ndërlikuar nga  
natyra e gjallë dhe e vdekur.

Toka do të mbrohet...

1. Nxënësit çohen në këmbë dhe lëvizin në mënyrë të lirshme nëpër klasë, duke u përzier me të tjerët.
2. Mësuesi thotë “Ngrij” dhe nxënësit ndalojnë në vend.
3. Mësuesi thotë “ Shkrij/Formo dyshe” dhe nxënësit bashkohen në dyshe me personin që kanë pranë, duke u ulur në karriget që mund të jenë të lira aty pranë duke lexuar fishat. Fishat që përputhen në krijimin e një fjalie ulen në bankë. Loja vazhdon me nxënësit e tjerë derisa të gjithë nxënësit krijojnë fjali për dheun. Fton nxënësit sipas grupeve të diskutojnë rreth dallimeve që shihen si dhe kërkon të thonë se nga se varet krijimi i tokës. Theksohet se krijimi i tokës është proces i gjatë që zgjat shumë vite dhe varet nga materialet fillestare, organizmat e gjallë (bimët, kafshët, aktivitetet e njeriut dhe mikroorganizmat), klima, pozicioni dhe kushtet kohore. Sqarohet se të gjitha ato kushte nuk mund të krijohen në klasë. Në përfundim theksohet se toka duhet të vlerësohet dhe të mbrohet.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.

### Detyrë shtëpie:

Të mbledhin lloje të ndryshme dheu (për nga ngjyra). Nxënësit ftohen të vrojtojnë lloje të ndryshme dheu për ta hulumtuar në orën e ardhshme.

Nxënësit ndahen në grupe 5-she dhe kanë për detyrë krijimin e një këngë marsh me titullin “Toka” duke e shoqëruar me mjete të ndryshme si daulle, gur, shkopinj për orën e ardhshme të mësimit.

## Ora II – Le ta studiojmë tokën dhe tokën e lagjes sime Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimit fillon me këngën marsh “Toka”. Nxënësit realizojnë vlerësim të ndërsjellë.

Mësuesja/si u shpërndan fëmijëve përrallën e faqes 61, “Toka është flori” dhe fëmijët e lexojnë në mënyrë zinxhir.

Mësuesi/ja pyet nxënësit për fragmentin më të bukur, të komentuar nga ata. Nxënësit ndihmohen nga tabela e punuar në fletore.

Fragmenti	Komenti

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë shënuar mendimet e tyre, u kërkon disa prej tyre ti thonë para klasës. Pyetini nxënësit : Cili është mesazhi i kësaj përrallë?

Edhe mësuesi bën mirë që ti thotë idetë e tij për këtë tregim dhe pse iu dukën të rëndësishme. Ky demonstrim u tregon nxënësve procesin e të menduarit .

Mësuesi/ja u jep nxënësve disa kuti të mbushura me dhe të marrë në vende të ndryshme. Fton nxënësit të thonë disa cilësi të tokës duke u bazuar në dheun që shikojnë ose në njohuritë e tyre të mëparshme. Më pas u shpjegon nxënësve se toka ka shumë cilësi, por ju sot do të hulumtoni tri nga këto: ngjyrën, lagështinë dhe dendësinë dhe do të plotësoni tabelën e mëposhtme.

Toka	Ngjyra	Lagështia	Dendësia





**Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja**

Ndahet klasa në grupe. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se ngjyra e tokës varet nga prania e lëndëve të ndryshme dhe ujit. Ftohen nxënësit të vrojtojnë dheun që kanë sjellë në klasë dhe të renditin tre ngjyra kryesore të tij: Ngjyrë e zezë, ngjyrë kafe, ngjyrë e hirtë. U shpjegon nxënësve se:

- Ngjyra e zezë – është për shkak të pranisë së humusit (mbetjet e organizmave të gjallë);
- Ngjyra kafe (ngjyrë e kuqërremtë, ngjyrë ndryshku) – është për shkak të pranisë së mineralit të hekurit;
- Ngjyra e hirtë (ngjyrë qumështi) – është për shkak të pranisë së mineraleve.

Shpjegoni se ka qindra lloje të tokës në botë dhe se emrat e tyre shpesh janë të lidhura me ngjyrën e tyre, p.sh: e zezë, e kuqe etj. Theksohet se tokat më të lagështa gjithmonë duken më të errëta. Çdo grup shkruan rezultatet që ka vërejtur në kolonën e parë të tabelës.

Lagështia e tokës varet nga prania e ujit në momentin e studimit. Ajo mund të përcaktohet afërsisht nga letra, e cila e thith. Fton disa nxënës të shqyrtojnë lagështinë e dheut të sjellë në klasë. Në diskutim me nxënësit theksohen përkufizimet e mëposhtme.

- Toka e thatë – kur e prekni, ajo shndërrohet në pluhur dhe nuk e lag letrën;
- Toka e freskët – kur e prek, ajo është e ftohtë, por nuk e lag letrën;
- Toka e lagët – kur e mbani në duar, bëhet me topa dhe e lag letrën;
- Toka me ujë – kur e mbani në duar, nga ajo pikon ujë dhe ngjitet.

Çdo grup shkruan rezultatet që kanë vërejtur në kolonën e dytë të tabelës.

Më pas mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se dendësia e tokës mund të përcaktohet me përdorimin e thikës (kujdes përdorimin e thikës). Fton disa nxënës ta provojnë këtë dhe më pas shkruhen përkufizimet:

- Shumë e dendur – thika nuk mund të depërtojë në tokë;
- Mjaft e dendur – thika shumë lehtë depërton në tokë;
- E shkrifët – toka derdhet lehtë.

Çdo grup shkruan rezultatet që kanë vërejtur në kolonën e tretë të tabelës.

Nxënësit sipas grupeve prezantojnë rezultatet e tabelës të plotësuar gjatë zhvillimit të eksperimenteve.

**Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit lëvizin të lirshëm në klasë për të plotësuar tabelën më parë me emrat e shokëve, sipas karakteristikave të dheut të sjella nga ata. Fiton ai nxënës i cili plotëson tabelën i/e pari.

Dheu i/e ..... ka ngjyrë kafe.	Dheu i/e ..... nuk ka lagështirë, është i thatë	Dheu i/e ..... ka shumë dendësi.
Dheu i/e ..... ka ngjyrë të zezë.	Dheu i/e ..... ka lagështirë.	Dheu i/e ..... ka pak dendësi.
Dheu i/e ..... ka ngjyrë të hirtë.	Dheu i/e ..... ka lagështirë dhe është i butë	Dheu i/e ..... është i shkrifët

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për hartimin dhe interpretimin e marshit «Toka».

**Detyre shtëpie:**

Cilët janë disa nga ndotësit që shkaktojnë ndotjen e tokës në Shqipëri ? A ka vende në botë pa ndotje? Pritni foto nga artikujt që mund të gjeni në revista dhe gazeta dhe ngjitini mbi një letër duke krijuar një poster. Shkruani disa fjali për të përmbledhur artikullin duke u përqendruar tek ndotja e tokës bujqësore. Ky poster mund të bëhet edhe në grup nxënësish me 4-5 nxënës.

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	HI
<b>Tema mësimore</b>	Toka dhe njerëzit Pjesët e mollës Çfarë e ndot tokën? Ndotja e tokës Tingulli i farave
<b>Kohëzgjatja</b>	4 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon se sasia e tokës në botë është e kufizuar;</li> <li>• rendit ndotësit e tokës;</li> <li>• tregon se çfarë e rrezikon tokën;</li> <li>• vlerëson rëndësinë e ruajtjes së tokës për bimët, kafshët dhe njerëzit;</li> <li>• përshkruan procesin e mbirjes së një fare.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Kopshti në vjeshtë Molla Dheu Ndotja e tokës Tingulli i farave Tregimi për milingonën dhe karkalecin
<b>Fjalët kyç</b>	Dheu, pjelloria, ndotje, gërryerja e tokës (erozioni), kripshmëria, farë, mbirje
<b>Burimet materiale</b>	Një mollë, thikë xhepi për eksperimentin: qese e plastikës, qelq zmadhues, termometër, etiketa, pjesë të vogla të mbetjeve (metal, mbështjellëse e çamçakëzit, gotë e plastikës, kanoçe e zbrazët e pijeve, pjesë të rrobave të pambukut, copë prej qelqit, copë letre, lëvore të bananes), pak dhe nga kopshti, letra të punës për ngjyrosje.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Arte pamore, Dituri natyre, Matematikë.



## Ora I – Sa dhe ka në planetin tonë? Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë dhe plotësojnë dilemën “Kopshti në vjeshtë” në fletën e punës faqe 58. Nxënësit shfaqin mendimet e tyre dhe komentojnë zgjedhjen e bërë. Mësuesi/ja fton nxënësit të shfaqin mendimet e tyre rreth pyetjeve: Pse është e rëndësishme pjelloria e tokës? Duke dhënë sqarimin se “Pjelloria e tokës bujqësore” është aftësia natyrore e tokës për sigurimin e njëkohshëm të ujit dhe të elementeve ushqyese për bimët dhe krijimi i kushteve të përshtatshme fizike dhe biokimike për to.

- A është pjellore e gjithë toka që gjendet në Planetin tonë?

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja pyet nxënësit “A ka shumë tokë pjellore në botë”? Pasi dëgjon mendimet e nxënësve rreth pyetjeve të mësipërme ajo u tregon atyre një mollë të cilën mund ta krahasojmë me Tokën. Mësuesi/ja sqaron nxënësit se me demonstrimin e ardhshëm do t’u tregoj se në botë ka më pak tokë pjellore se sa duket:

- Ndani mollën në katër pjesë të barabarta dhe tri pjesë i lini mënjanë. Sqaroni se tri të katërtat e sipërfaqes së tokës janë dete dhe oqeanë.
- Ndani pjesën e katërt në dy gjysma dhe lëreni gjysmën mënjanë. Sqaroni se këtë pjesë të Tokës e zënë shkretëtirat, ku nuk mund të kultivohen prodhime bujqësore.

- Ndani pjesën e tetë të mbetur prej mollës në katër pjesë dhe lini mënjanë tri prej tyre. Sqaroni se pjesët që i latë mënjanë paraqesin pjesë nga sipërfaqja e tokës që e zënë shkëmbinjtë dhe gurët — kjo pjesë nuk është pjellore.
- Tregoni nxënësve se pjesa tjetër paraqet 1/32 e sipërfaqes së Tokës — pjesë që llogaritet si pjellore. Qëroni lëvoren e kësaj pjesë, duke u sqaruar se kjo është në të vërtetë shtresa e sipërme — e tokës, që i ushqen bimët dhe prodhon ushqim për të gjithë kafshët dhe njerëzit. Theksoni se ndërtimi i rrugëve, shtëpive dhe fabrikave në tokë pjellore e zvogëlon sipërfaqen e tokës, që është e aftë të prodhojë ushqim dhe produkte bujqësore.



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ftohen nxënësit të shkruajnë në grup (4-5 nxënës) një pesëvargësh për tokën dhe rëndësinë e tokës pjellore.

Gjithashtu mësuesja iu lexon fëmijëve përrallën e faqes 60 “Lulet e milingonës Ana dhe karkalecit Ardi”. Më pas ata diskutojnë rreth saj.

### Vlerësimi :

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna gjatë prezantimit të pesëvargëshit për rëndësinë e tokës pjellore.

### Detyre shtëpie:

Ftoni nxënësit të tregojnë përrallën në shtëpi për motrat e vëllezërit më të vegjël.

## Ora II – Çfarë e ndot tokën?

### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi hapet me galerinë e posterave të realizuara nga detyra e shtëpisë të dy orëve më parë. Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe fton nxënësit të renditin ndotësit e tokës që ata panë në galeri.

Shkruhen në tabelë ndotësit kryesorë të tokës, sipas peshave specifike.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të organizojnë hulumtimin e mëposhtëm. Këtë hulumtim mësuesi/ja mund ta zhvillojë gjatë dy- tri javëve.

- Mbushni dy të tretat e një qeseje plastike me dhe nga kopshti. Shtoni disa copa të vogla të mbetjeve (metal, mbështjellës të çamçakëzimit, gotë të plastikës, kanoçe të zbrazët, pjesë të rrobave të pambukut, copë prej qelqi, copë letre, lëvore të bananes). Përziejini mirë dhe shtoni ujë. Mbylleni mirë qesen dhe ngjiteni në të etiketën me shënim se çfarë keni futur në të, si dhe datën.
- Vendoseni qesen afër dritares, në diell (në qoftë se e kryeni hulumtimin gjatë sezonit të ngrohtë veror) dhe afër ngrohjes (por jo mbi të) nëse është dimër.
- Çdo ditë në dy apo tri javët e ardhshme hulumtoni dhe shënoni vëzhgimet tuaja për temperaturën, aromën, pamjen e jashtme, dhe ndryshimet e dukshme. Nëse dheu në qese është i thatë, shtoni pak ujë.

Diskutim i gjetjeve: Pas dy ose tre javësh, ftoni nxënësit që t’i analizojnë ndryshimet dhe të përgatisin një raport të shkurtër në grup në të cilin do të përgjigjen në pyetjet në vijim:

- A mund të vëreni ndonjë lloj të organizmave në përzierje?
- Cilat ndryshime të temperaturave i vëreni gjatë hulumtimit?
- Cilat mbetje kanë ndryshuar, ndërsa cilat janë si më parë?



**Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Mësuesi /ja fton nxënësit të prezantojnë gjetjet e tyre. Nxënësit tregojnë se cilat mbetje janë shpërbërë në tokë, ndërsa cilat kanë mbetur të pandryshuara. Theksoni se ruajtja e pastërtisë së tokës është me rëndësi të madhe për cilësitë e saj dhe për pamjen e jashtme të mjedisit jetësor. Cilat lloje tjera të mbetjeve, sipas mendimit të nxënësve, nuk janë shpërbërë duke qëndruar në tokë? Ftoni nxënësit që të ndajnë përvojën personale dhe përshtypjet nga ndotja e tokës me mbetje, plehra, dhe përdorimin e kimikateve në bujqësi.

**Vlerësimi:**

Mësuesi/ja zhvillon testin “Çfarë dimë për tokën?” faqe 58 tek fleta e punës. Diskutohen përgjigjet e nxënësve.

**Detyrë shtëpie:**

Ftohen nxënësit të llogarisin qeset plastike që mbledhin në shtëpi gjatë 1 jave dhe më pas gjatë një muaji. Të llogarisin si klasë numrin e qeseve të përdorura. Të groposin një qese plastike dhe pas një jave të shikojnë se çfarë ka ndodhur me të, duke mbajtur shënime të përkatëse.



## Ora III – Çfarë e rrezikon tokën? Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Mësuesja/si paraqet foto të ndotjes së mjediseve të ndryshme dhe komenton bashkë me nxënësit: Cilët janë ndotësit kryesor të tokës? Me pak fjali, përpiquni të përshkruani ç’po ndodh në atë foto/pikturë. Çfarë mesazhi përpiqet të japë kjo pikturë/foto? Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe i fton që t’i vëzhgojnë në oborrin e shkollës ose rreth mjedisit të shkollës, ndotësit e tokës, por më parë të shohin se çfarë ka ndodhur me qeset e groposura. (Jepni idenë e trastave prej robe). Nxënësit mbajnë shënime dhe në klasë analizojnë dhe përgatitin tabela ose grafikë për ndotësit që kanë vëzhguar. Grupet prezantojnë punët e tyre para klasës dhe nxënësit e tjerë komentojnë dhe bëjnë pyetje.

**Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja**

Mësuesi/ja ndan fletën e punës faqe 59 “Çfarë e rrezikon tokën?” Nxënësit plotësojnë vendet bosh me fjalët e dhëna në fund të fletës. Ata lexojnë rreziqet kryesore ndaj tokës si : Gërryerja e tokës, acidifikimi, ndotja, ngjeshja, kripshmëria duke i kërkuar që ti konkretizojnë me shembuj nga jeta e përditshme. Mësuesja zbaton teknikën “Rri një, ikin tre”. Fton nxënësit të grupohen me 4-5 anëtarë dhe t’u përgjigjen me shkrim njëres prej pyetjeve të mëposhtme:

- Pse gjendja e tokës është e lidhur me pjesët tjera të përbërëse të natyrës — ajri, uji, organizmat e gjallë.
- Cilët janë shkaktarët kryesorë të rreziqeve që po i kanosen tokës?

Nxënësit prezantojnë punët e tyre dhe bëjnë pyetje dhe komente për njëri-tjetrin.

**Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Më pas ftohen nxënësit në punë në grup të tregojnë se si mund të mbrohet toka në oborrin e shkollës, lagjes, fermës etj.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen nga mësuesja/si për përgjigjet e dhëna gjatë diskutimeve dhe në punën e tyre në grup.

**Detyrë shtëpie:**

Ftoni nxënësit të përgatisin duke u organizuar në punë në grup një poster me temë: “Mbroni tokën!”. Organizoni një ditë për mbrojtjen e mjedisit dhe prezantoni punët e nxënësve. Dita e Tokës festohet çdo vit në datën 22 Prill.



<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Toka është një filtër i madh
<b>Kohëzgjatja</b>	1 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënësve</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbulon se tokat fizikisht dhe kimikisht filtrojnë papastërtitë nga uji;</li> <li>• zbulon rolin e tokës për ujin të pijshëm.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënësve</b>	Kopshti në vjeshtë Molla Dheu Ndotja e tokës Tingulli i farave Tregimi për milingonën dhe karkalecin
<b>Fjalët kyçe</b>	Dheu, pjelloria, ndotje, gërryerja e tokës (erozioni), thartësimi, ngjeshmëria, kripshmëria, farë , mbirje.
<b>Burimet materiale</b>	3 gota plastike të vogla dhe 5 gota plastike më të mëdha. Rërë Toka e imët, Ngjyra, p.sh. ngjyrosje të gjelbër, të kuq, portokall, të verdhë.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Arte, Dituri natyre, Matematikë.

### Ora I – Toka është një filtër i madh Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Pyetjet:

- Çfarë është një filtër? (Trego një filtër kafeje ose një qese çaj për të ndihmuar në diskutimin.)
- Mund të jetë toka një filtër?
- A funksionojnë të gjitha tokat njësoj?

Mësuesja shpjegon shkurtimisht me gojë eksperimentin. Pyeten nxënësit:

- Çfarë do të ndodhë me ujin e ndotur?
- Çfarë ngjyre do të dalë nga fundi?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesja organizon klasën në punë me grupe dhe orienton nxënësit për zhvillimin e eksperimentit sipas udhëzimeve të mëposhtme.

Merrni një gotë plastike të cilës i keni hapur disa vrima të vogla dhe e mbushim pak më shumë se gjysma me rërë. Vendoseni atë mbi një gotë tjetër. Hidhni pak ujë të ndotur në gotën lart.

Vëzhgoni	Çfarë ndodh me gjërat që lundrojnë në ujë?
Regjistroni	Shkruani gjetjet nga vëzhgimet...

Përsëriteni eksperimentin me ujë me ngjyrë. Vëreni dhe krahasoni:

Vëzhgoni	Çfarë ngjyre është uji që mblidhet në kupën e poshtme?
Regjistroni	Shkruani vëzhgimet tuaja në tabelë...
Krahasoni	A ka uji në gotën e poshtme të njëjtën ngjyrë për të dy tokat?
Regjistroni	Shkruani vëzhgimet tuaja në tabelë...

Provojini këto eksperimente tani me dhe nga pjesë të ndryshme si: dhe me ngjyrë të kuqe, me ngjyrë të zezë.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit plotësojnë tabelat dhe bëjnë prezantimin e gjetjeve. Nxënësit komentojnë dhe vlerësojnë njëri – tjetrin. Mësuesja kërkon nga nxënësit të krahasojnë mendimet e tyre në fillim të orës me gjetjet e tyre nga eksperimenti që zhvilluan. Theksohen konkluzionet të cilat shkruhen në tabelë:



*Toka natyrisht filtron ujin që bie si shi dhe shkon në lumenj.*

*Toka filtron shumë kimikate nga uji ashtu siç bëri me ujin me ngjyrë.*

Këto teknika që u përdorën në eksperiment, përdoren për të pastruar ujërat e zeza që vijnë nga shtëpitë, qytetet, industria dhe fermat e mëdha të ushqyerjes së kafshëve. Një tokë e shëndetshme është e rëndësishme për ujë të mirë e të pijshëm.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin gjatë punës në grup si dhe në prezantimin dhe komentimin e gjetjeve.

### Detyrë shtëpie:

Mësuesja fotokopjon fletën e punës në faqe 62. Ajo u jep detyrë shtëpie nxënësve të ngjyrosin vizatimin dhe të gjejnë një titull të përshtatshëm për të.





## DILEMA

### Kopshti në vjeshtë

Është një ditë vjeshte. Kur ktheheni nga shkolla në shtëpi, gjeni të gjithë familjen tuaj duke mbledhur gjethet e rëna nga pemët në oborr. Ju vendosni:

- Të ndihmoni për grumbullimin e gjetheve;
- Të propozoni që të hapet një gropë ku do të groposen gjethet, të cilat do të kalben dhe në këtë mënyrë do të bëhet kopshti juaj më pjellor.
- Të vërtetoni se djegia e gjetheve është ide e mirë;
- Të mos bëni asgjë dhe të shkoni të shikoni TV.
- Të bëni diçka tjetër.



## TEST

### Çfarë dimë për tokën?

Në fjalitë më poshtë ka çifte shprehjesh që janë më të theksuara. Nënvizoni atë të cilën mendoni se është gabim, në mënyrë që të formoni fjali të sakta.

- 1 Dheu e **mbulon** / **nuk e mbulon** tërë sipërfaqen e Tokës.
- 2 Cilësia më e rëndësishme e tokës është **dendësia** / **pjelloria** e saj.
- 3 Organizmat e gjallë **nuk marrin pjesë** / **marrin pjesë** aktive në krijimin e tokës.
- 4 Për shkak të përbërjes së saj, toka **filtron** / **nuk filtron** shumë ndotës.
- 5 Aktivitetet e njeriut kanë ndikim **të keq** / **të mirë** ndaj gjendjes së tokës në ditët e sotshme.
- 6 Djegia e parcelave të tokës pas korrjes **është mirë** / **nuk është mirë** për tokën.
- 7 Përdorimi i kimikateve kundër dëmtuesëve **e ndot** / **nuk e ndot** tokën.
- 8 Gjendja e tokës **varet** / **nuk varet dhe** nga gjendja e elementëve të tjerë në natyrë – ajër, ujë dhe organizma të gjallë.

Përgjigjet: 1. nuk e mbulon 2. pjelloria 3. marrin pjesë 4. filtron 5. të keq 6. nuk është e mirë 7. e ndot 8. varet



## FLETË PUNE

# Çfarë e rrezikon tokën?

**Gërryerja (erozioni), Thatësira, Ndotja, Ngjeshja e tokës, Kripshmëria e tokës.**

..... — Shtresa e sipërme pjellore e tokës është e mirë për bujqësinë, ajo siguron kullota për kafshët dhe përmban lëndë ushqimore për bimët. Kur pemët, shkurret priten dhe shkulen nga toka, atëherë, toka është e pambrojtur dhe fillon të shkatërohet. Si rezultat i erës dhe shiut dhe rrjedhave ujore sipërfaqësore toka fillon të dëmtohet e të humbasë shtresën e saj prodhuese. Shkatërimi i tokës prodhuese mund të jetë pasojë e aktiviteteve të ndryshme të njeriut, të cilat bëjnë të mundur që shtresa prodhuese e tokës të ekspozohet më shumë ndaj erës dhe rrjedhave të ujit. Aktivitetet bujqësore, siç janë hapja e terracave, largimi i dheut apo shtresës prodhuese të tokës, rritja e numrit të kafshëve që kullojnë, kontribuojnë për shkatërimin më të madhe të tokës.

..... — Në vartësi të vendit se ku gjendet toka, ajo mund të përmbajë sasi të ndryshme të lagështirës, psh afër një kënete, apo në periferi të një qyteti. Bimët që rriten atje janë përshtatur në këto nivele lagështie, ndërsa ndryshimi i saj mund t'i dëmtojë ato. Aktivitetet e njeriut shpesh e rrisin thartësirën e tokës, meqë ata hapin puse për të përdorur ujin, i cili i merret tokës përreth.

..... — Në shumicën e rasteve toka është e ndotur nga metalet, kimikatet, vajrat, nafta, pesticidet, eksplozivët dhe gazrat toksike, lëndët radioaktive ose biologjike, si dhe substanca të tjera të dëmshme. Shpesh këto ndotje vijnë nga mbetjet e zonave urbane apo ato të fabrikave që shkarkohen të gjitha mbi dhe nën tokë.

..... — Toka mund të ngjeshet si pasojë e shtypjes që i bëjnë makinat e rënda që njerëzit përdorin gjatë aktiviteteve të ndryshme, si ndërtimi i rrugëve, urave, fabrikave e minierave.

..... — Toka mund të ngopet me kripëra për shkak të përdorimit të madh nga njerëzit të plehrave kimike. Ky proces është i papërshtatshëm për organizmat e gjallë që jetojnë në tokë dhe për cilësinë e prodhimeve bujqësore.





## FLETË PUNE

## Lulet e milingonës Ana dhe karkalecit Ardi

Ishte një ditë e nxehtë gushti. Milingona Ana dhe karkaleci Ardi po këndonin nën hijen e drurit të madh. Pas këngës ata biseduan se po afrohej dimri dhe duhej të siguronin ushqim për fëmijët e tyre.

Ditën e ardhshme, në livadhin ku kishin shtëpinë Ana dhe Ardi, nën hijen e drurit të madh erdhi një familje për piknik. Ana dhe Ardi menjëherë menduan se mund të shfrytëzojnë diçka nga ushqimi i tyre. Kur familja u largua, në vendin ku ata hëngrën ushqimin kishte thërrime. Milingona dhe karkaleci i morën thërrimet dhe i çuan në shtëpitë e tyre. Milingona Ana mendoi të thërriste urithin Edi që t'i ndihmonte për të gërmuar një shtëpi më të madhe. Edi me kënaqësi ofroi ndihmën e tij, pasi dëshironte shumë të ndihmonte miqtë të tij. Urithi Edi ishte një gërmues shumë i mirë. Ai e përfundoi punën shpejt dhe kështu tani Ana dhe Ardi kanë më shumë hapësirë në shtëpitë e tyre.

Vjeshta ngadalë po afrohej dhe filloi të binte shi. Një ditë uji i shiut hyri pak dhe në shtëpitë e Anës dhe Ardit. Duke e ditur se vjen vjeshta, dallëndyshet shkuan drejt jugut. Ato morën me vete dhe disa fara të ndryshme, duke menduar se janë ushqim i mirë për rrugën. Gjatë fluturimit mbi shtëpitë e Anës dhe Ardit, dallëndysheve u ranë disa fara.

Nga gjethet që bartën në ditët në vazhdim milingona dhe karkaleci, toka në shtëpitë e tyre u bë më pjellore, kështu që farat që u ranë dallëndysheve, pranverën e ardhshme mbinë lule shumëngjyrëshe.


Prandaj sot në këtë verë të nxehtë milingona Ana dhe karkaleci Ardi ndjehen shumë të kënaqur nën hijen e drurit të vjetër, duke e ndjerë aromën e luleve të reja në shtëpitë e tyre.





## FLETË PUNE

# Toka është flori



Një bujk, kur po vdiste, thirri të tre bijtë pranë dhe u tha: O bijtë e mi, në arën që e kam punuar gjithë jetës sime dhe që me drithë të saj ju kam ushqyer e ju kam sjellë në këtë moshë, në atë arë ju kam fshehur një enë të madhe të mbushur me flori.

Punojeni shumë dhe kërkoni në të gjitha anët e arës atë enë, që pastaj të mos vuani nga varfëria. Të tre vëllezërit, pas vdekjes së babait, zunë të punonin dhe gërmonin arën në të gjitha anët thellë e më thellë. Mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër. Po enën me flori nuk e gjetën.

Kur ara, duke u punuar më thellë, zu të jep mot për mot më tepër, të tre vëllezërit që nxirrin bukën e shtëpisë u tepronte edhe shumë për të shitur. Të hollat që merrnin nga këto të shitura i hidhnin në një enë për t'i ruajtur. Për pesë vjet ena u mbush përplot me florinj.

Atëherë vëllezërit e kuptuan se ku qenka ena me florinj që u tha i ati i tyre.



## FLETA E PUNËS



Ngjyrosni këtë vizatim dhe gjeni një titull për të.







Planifikimi ditor i temës Energjia

Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	I-II
Tema mësimore	Për gjithçka nevojitet dielli
Kohëzgjatja	2 orë mësimore
Rezultatet e të nxënit	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• rendit burimet e energjisë në natyrë;</li> <li>• shpjegon se pse energjia diellore është shumë e domosdoshme për jetën në Tokë;</li> <li>• liston forma të ndryshme të energjisë;</li> <li>• tregon me shembuj shndërrimin e energjisë në forma të ndryshme.</li> </ul>
Situata e të nxënit	Lojë me role “Njihni diellin”; Eksperimenti i tullumbaces; Përbërja e sanduiçit.
Fjalët kyç	Energjia, burim energjie, lloje energjie, energji e erës, energji elektrike, energji diellore, hidrocentral, turbinë.
Burimet materiale	Një shishe me qafë të vogël, një tullumbace, një tenxhere me ujë, furnellë elektrike, lëndë të ndryshme në klasë, fletë pune etj.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuhë shqipe, Arte pamore, Dituri natyre.

**Ora I – Për gjithçka nevojitet dielli**  
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Mësuesja/i e fillon mësimin me ndarjen e klasës në grupe, me nga katër nxënës, për të zhvilluar lojën me role “Të njohim Diellin” të fletës së punës, faqe 71. Nxënësit ndajnë rolet me njëri-tjetrin për zhvillimin e lojës. Prezanton lojën grupi i parë. Më pas mësuesja zbaton teknikën “Diskutim i drejtuar”. Njëkohësisht ftohen nxënësit të marrin pjesë në diskutim rreth pyetjeve?

- Çfarë dini për Diellin?
- Cili është roli i diellit në ekzistencën e bimëve, kafshëve dhe njerëzve?
- Cili është mesazhi i tekstit të dhënë.



Ftohen nxënësit të gjejnë shembuj nga jeta e përditshme që e tregojnë nevojën që kanë organizmat e gjallë për dritën e diellit. (p. sh luledielli drejtohet nga dielli; macet dëshirojnë që të ngrohen nën rrezet e diellit diell; njerëzit marrin rreze kur koha është e mirë).

Mësuesi/ja thekson se Dielli është yll. Kur drita e diellit mbërrin në Tokë, ajo shndërrohet në lloje të ndryshme të energjisë, të cilat pastaj mund të përdoret në shumë mënyra të ndryshme nga njerëzit. Tregohen shembuj duke shfrytëzuar informacionin nga pjesa hyrëse e mësimin.

Gjithashtu mësuesi/ja shpjegon se një pjesë e energjisë së diellit kthehet në hapësirë. Pjesa tjetër e energjisë mbetet në atmosferën e tokës, për shkak të gazeve që gjenden në ajër. Këto gaze janë si një batanije që e mbulojnë Tokën dhe luajnë rol natyror për ruajtjen e nxehtësisë së Tokës.

**Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja**

Mësuesja/si e ndan klasën në 9 grupe. Secilit grup i jep një ndërfishat e mëposhtme, të procesit të realizimit të një tavoline prej druri dhe metali. Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë për 4-5 minuta dhe të vizatojnë thjeshtë përmbajtjen e fishes. Më pas nxënësit vendosin në tabelë ose në një vend të dukshëm vizatimet sipas rrjedhës llogjike të përshkrimit të realizimit të tavolinës.

**Druri: Së pari, druri duhet të rritet, sipas mundësive vetëm me dritën e diellit. Prerja, transporti dhe përpunimi i drurit kërkon energji. Kjo energji fitohet nga lëndët djegëse natyrore.**

**Metalet: Gërmimi, transporti, prodhimi dhe përpunimi i metaleve janë të mundshme vetëm me përdorimin e makinave të ndryshme që punojnë me energji.**

**Transportimi i tavolinës së drurit deri te shkolla bëhet me mjet transportues që shfrytëzon karburant.**

**Ngjyrat në përgjithësi fitohen prej prodhimeve të naftës dhe prodhimi i tyre kërkon energji elektrike.**

**Karburantet (qymyri, nafta dhe gazi natyror) merren nga brendësia e tokës. Ato janë krijuar para milona viteve nga gjërat bimët dhe kafshët.**

**Energjia elektrike shpesh fitohet nga djegia e karburanteve ose përmes përdorimit të energjisë së ujit në hidrocentrale.**

**Burime të tjera të energjisë janë: mullinjët e erës dhe panelet diellore, të cilët shfrytëzojnë energjinë nga dielli.**

**Njerëzit që marrin pjesë në të gjitha fazat e prodhimit dhe transportit të tavolinës deri në shkollë, energjinë e marrin nga ushqimi.**

**Baza e gjithë zinxhirëve ushqimorë janë bimët, që e marrin energjinë nga dielli për të prodhuar lëndën organike.**

Më pas mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4-5 nxënës. Fton secilin grup që të zgjedhë sende të ndryshme të bëra nga druri, qelqi, metali, letra, plastika, lëkura ose qeramika. Gjithashtu sqaron se për t'u prodhuar secila prej këtyre sendeve, ka nevojë për energji. Secili organizëm rritet dhe lëviz. Burimi i të gjitha formave të energjisë është dielli.

Udhëzoni të gjitha grupet që 5-7 minuta të diskutojnë për idetë rreth rolit që e ka energjia e diellit në procesin e prodhimit të sendeve të ndryshme.

**Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Pas përfundimit të punës së grupeve mësuesi/ja fton një nxënës prej çdo grupi që të prezantojë rezultatet nga diskutimi para klasës.

Nxënësit komentojnë dhe bëjnë pyetje rreth punëve të njëri-tjetrit. Në fund mësuesi/ja zbaton teknikën "Rrjeti i diskutimit" me anë të pyetjes: A është i rëndësishëm dielli për jetën e njerëzve, kafshëve dhe bimëve? Pse?



Po	A është i rëndësishëm dielli për jetën e njerëzve, kafshëve dhe bimëve? Pse?	Jo

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë punën e grupeve të punës.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit ndërtojnë një pesëvargësh për “Diellin”.

1. Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër-p.sh Dielli)
2. Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës;
3. Rreshti i tretë janë tri fjalë që shprehin veprim të temës;
4. Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë, që shpreh qëndrimin për temën;
5. Rreshti i fundit është një fjalë sinonime, që ripërcakton thelbin e temës



**Ora II – Format e energjisë  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Mësuesja e fillon mësimin me format e energjisë dhe për të kuptuar ndryshimin e formave të energjisë zbatojmë eksperimentin e mëposhtëm.

Mësuesja/si jep udhëzimet e përkatëse:

1. Mbërtheni një tullumbace mbi qafën e shishes për të kapur ajrin brenda;
2. Vendosni shishen në një tenxhere të mbushur me ujë dhe më pas vendoseni tenxheren në furnelën elektrike;
3. Vini re se çfarë ndodh me tullumbacen, kur uji në tenxhere nxehet;
4. Vizatoni një figurë për të treguar se çfarë ka ndodhur me tullumbacen;
5. Lëreni ujin në tenxhere duke shtuar kuba akulli;
6. Vizatoni se çfarë ndodhi me tullumbacen kur uji u ftoh.

Mësuesi/ja shpjegon se si ndryshon forma e energjisë me anë të vizatimeve të realizuara gjatë eksperimentit të mësipërm.

Nxënësit ngjyrosin fletën e punës në faqe 78 “Burimet e energjisë” dhe diskutojnë mbi të.

**Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja**

Mëuesi/ja shkruan në tabelë temën “Format e energjisë” dhe pasi ndan nxënësit në grupe i fton ata të diskutojnë idetë me njëri – tjetrin të plotësojnë kolonën “Di”.

Diskutohen punët e nxënësve dhe ftohen të diskutojnë se çfarë pyetje kanë në lidhje me temën dhe t’i shkruajnë në kolonën “Dua të di”.

Di	Dua të di	Mësova

Më pas mësuesi/ja fton nxënësit të shikojnë gjysmën e parë të fletës së punës faqe 72, “Format e energjisë” në të cilën gjendet një sanduiç i thjeshtë.

Nxënësit diskutojnë për përbërjet e sanduiçit. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të ndjekin procesin e prodhimit të secilës përbërje dhe energjisë së përdorur në këto procese si dhe ndjek punën e nxënësve të çdo grupi. Ai/ajo i ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë me të dhëna shtesë. Më pas udhëzon nxënësit të shikojnë në gjysmën e dytë të fletës së punës faqe 72, “Format e energjisë” dhe pyeten nxënësit të tregojnë se çfarë shikojnë ata:

Pyetjet që mund të diskutohen janë:

- Çfarë ka ndodhur me energjinë që gjendet në drurin që përdoret për zjarr dhe ngrohje (energjia që gjendet në dru, kur digjet, shndërrohet në nxehtësi, prandaj ne ndiejmë ngrohtësi)?
- Çfarë lloj energjie përdorin kitaristi dhe daullexhiu dhe në çfarë ndryshon ajo (energjia mekanike i lëviz duart dhe ndryshon në tingull)?
- Si përgatitet ushqimi (duke e kthyer energjinë e gazit në nxehtësi)?
- Si e gjen fëmija rrugën në errësi (duke përdorur një elektrik dore, ku energjia e baterive shndërrohet në dritë)?
- Si lëviz autobuzi i lagjes (përmes djegies së naftës me lëvizjen e motorit)?

Mësuesja hedh në tabelë përgjigjet e pyetjeve duke u kujdesur që të jepen përgjigje në lidhje me çështjet kryesore.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja/si zbaton teknikën “Harta e konceptit”. Më pas nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën “Mësova”. Përfaqësuesit e grupeve paraqesin përpara klasës përgjigjet e pyetjeve dhe të tjerët bëjnë komente dhe vlerësime për punën e njëri-tjetrit. Në fund ftohen nxënësit që në grupe të punojnë për të krijuar një hartë koncepti për përdorimin dhe format e energjisë.

Pyetje ndihmëse për nxënësit mund të jenë:

- Cilat janë burimet e energjisë?
- Si shndërrohet energjia?
- Për çfarë është e domosdoshme energjia?


Nxënësit prezantojnë punët dhe në fund bëhet një përmbledhje në hartën e konceptit në tabelë.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës në grup, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë orës.

### Detyrë shtëpie:

Të shkruajnë një shembull tjetër nga jeta e tyre ku të tregohen format e shndërrimit të energjisë.



Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	I-II
Tema mësimore	Si të kursejmë energji
Kohëzgjatja	2 orë mësimore
Rezultatet e të nxënësve	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>shpreh përgjegjësinë e tij për kursimin e energjisë elektrike;</li> <li>tregon mënyra të kursimit të energjisë në jetën e përditshme;</li> <li>vlerëson mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve.</li> </ul>
Situata e të nxënësve	Si të kursejmë energji? Shtëpi më e ngrohtë. Loja "Kurse"
Fjalët kyç	Ruajtja e energjisë, rrymë, automat, fatura.
Burimet materiale	Fleta e punës ruajtja e energjisë, Testi "Çfarë dimë në lidhje me energjinë"
Lidhja me fushat/ lëndët e tjera	Gjuhë shqipe, Arte pamore, Dituri natyre.

## Ora I – A është e lehtë për të kursyer energji Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fillon orën e mësimin duke fikur dhe nderur disa herë dritën e klasës.

- Cili është funksioni i dritës?
- Si ndikon ndezja dhe fikja e dritës në klasë?

Gjatë diskutimeve të nxënësve mësuesi/ja sqaron se prodhimi dhe harxhimi i energjisë elektrike shkakton ndotje të mjedisit. Djegia e lëndëve të para të ngurta dhe të lëngshme është e shoqëruar me çlirimin e gazrave të dëmshme, pluhurit, tymit dhe ndotësve të tjerë. Ftohen nxënësit të japin shembuj për ndotjen që kanë vërejtur, të cilat janë shkaktuar nga prodhimi ose përdorimi i energjisë (tymi i oxhakut, gazet që dalin nga makinat kur ecin në rrugë, tymi i kamionëve ose soba e drurit që përdorim për tu ngrohur në shtëpi, etj.)

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë dilemën "Shtëpi e ngrohtë" dhe të shprehin mendimet për situatën. Më pas mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep një version të ndryshëm të fletës së punës "Si ta kursejmë energjinë". Nxënësve u jepet kohë që të diskutojnë për informacionet përkatëse nga fletët e punës dhe për atë idenë se si mund të zvogëlohet konsumi i energjisë. Gjithashtu mësuesi/ja orienton nxënësit që prezantimi duhet të jetë në formën e një interviste, demonstrimi etj. nga çdo grup. Gjatë këtij prezantimi çdo grup do të tregojë se cilat ndryshime të thjeshta të shprehive të ditës propozojnë ata që të kursehet energjia.

Pas çdo prezantimi nxënësit e tjerë komentojnë, vlerësojnë dhe shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me situatat e prezantuara.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fund mësuesi/ja shpërndan kopjet e testit "Çfarë dimë për energjinë" (fleta e punës faqe 70). Pas përfundimit diskutohen përgjigjet e nxënësve dhe theksohet se prodhimi dhe përdorimi i energjisë kanë ndikim serioz ndaj mjedisit.

Çdokush mund të ndihmojë duke kursyer energji.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës në grup, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë diskutimit të dilemës.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit ftohen që të hartojnë një plan për kursimin e energjisë në shtëpi, për të cilin duhet të bisedojnë edhe me prindërit e tyre. Për të realizuar këtë detyrë atyre ju duhet informacioni i fletëve të punës 73,74,75 ,76 “Si të kusejmë

energji elektrike në shtëpi”. (Fletët e punës mund të fotokopjohen e shpërndahen tek nxënësit, për më shumë informacion në familje.)

## Ora II – Për energjinë elektrike Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me prezantimin e detyrave të shtëpisë, planin për kursimin e energjisë elektrike në shtëpitë e tyre. Nxënësit për një kohë të shkurtër (4-5 minuta) do t’i përgjigjen me shkrim pyetjes:

- Si e mendoni jetën pa energji? Mësuesja/si zbaton teknikën “Shkrim i lirë”.

Në përfundim të shkrimit disa nxënës lexojnë atë që kanë shkruar dhe të tjerët bëjnë komente dhe diskutime për kursimin e energjisë.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit ushtrohen në punë dyshe të lexojnë pjesën “Energjia elektrike” në fletën e punës faqe 77. Më pas, renditin gabimet që bënë Agimi dhe Luani. Pas çdo gabimi nxënësit duhet të shkruajnë një këshillë. Pas përfundimit të punës nxënësit diskutojnë gabimet e Agronit dhe Luanit. Ftohen të hartojnë një plan veprimesh që të kursejnë energjinë elektrike dhe të paguajnë më pak në muajt në vijim.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit ndahen në dyshe dhe luajnë lojën “Kurse”. Mësuesi/ja jep udhëzimet e lojës dhe fton nxënësit të luajnë. Më pas ajo i fton nxënësit në punën në grup 4-5 nxënësish, për hartimin e një plani kursimi edhe për klasën e shkollën e tyre. Nxënësit shprehin mendimet tyre dhe sjellin shembuj nga jeta e tyre e përditshme. Kjo detyrë prezantohet në fund të orës së mësimi.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetë vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës në grup, prezantimeve dhe qëndrimeve të njëri tjetrit për ruajtjen e energjisë.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit hartojnë fletëpalosjen me faktet “Kursimi i energjisë” dhe i shpërndajnë në komunitet dhe në shkollë.





## DILEMA Shtëpi e ngrohtë

Familja juaj blen një shtëpi të re. Shtëpia është e bukur por ende nuk është mobiluar. Njëra prej detyrave tuaja është që të kujdeseni jo vetëm për ta bërë atë të këndshme por dhe që të keni gjithmonë një shtëpi të ngrohtë. Cila prej zgjidhjeve në vijim është më e rëndësishme për ju:

- Ngrohja e shtëpisë me pajisje elektrike;
- Ngrohja e shtëpisë me sobë me dru;
- Ngrohja e shtëpisë me sobë me gaz natyror.
- Përmirësimi i izolimit të mureve të jashtme dhe dritareve;
- Vendosja e paneleve diellore në çati;
- Blerja e të gjitha pajisjeve elektrike dhe llambave të ndriçimit që harxhojnë pak energji elektrike;
- Zgjedhje të tjera që mund të kursejnë energjinë elektrike.



## TEST Çfarë dimë për energjinë

	E SAKTË	E GABUAR
1 Energjia e diellit është burim i të gjitha formave të energjisë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Ndotës më i madh i mjedisit jetësor është lënda djegëse fosile.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Qymyri dhe nafta nuk do të shterojnë kurrë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Djegia e qymyrit e ndot mjedisin jetësor më shumë se gazi natyror.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë përshpejton ndryshimet negative në klimë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Ne mund të kursejmë energji në mënyra të thjeshta dhe të lehta.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Përmirësimi i izolimit në shtëpi kursen energji.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Bateritë diellore dhe panelet diellore do të jenë të dobishme vetëm në të ardhmen.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Në frigorifer nuk duhet të vendosim ushqim të nxehtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E gabuar 4. E saktë 5. E gabuar 6. E saktë 7. E saktë 8. E gabuar 9. E saktë





## FLETË PUNE Të njohim Diellin



# 1

### Sa larg është Dielli?

Dielli është 150 milionë kilometra larg nga Toka.

# 2

### Sa i madh është Dielli?

Gjigand! Mund të duket i vogël nga qielli, por kjo ndodh sepse ai është shumë larg nesh. Është rreth 1 milionë kilometra larg – më shumë se 100 Toka të vendosura përgjatë rrugës nga Toka tek Dielli.

# 3

### Nga çfarë përbëhet Dielli?

Dielli përbëhet më së shumti nga gazi hidrogjen, së bashku me pak helium dhe disa përbërës të tjerë më të vegjël.

# 4

### Si e dimë ne se nga çfarë përbëhet Dielli?

Duke studiuar dritën e tij. Secili nga gazet e ngrohtë në një yll prodhon një gjurmë të veçantë drite. Duke përdorur një instrument të quajtur spektroskop, astronomët mund të dallojnë se çfarë lloje gazi janë ato.

# 5

### Sa i nxehtë është Dielli?

Thellë në bërthamë, temperatura arrin një vlerë të habitshme prej 15 milionë gradë Celsius! Sipërfaqja e Diellit është afërsisht 6000 gradë Celsius.

# 6

### Çfarë e bën Diellin të shkëlqejë? A është Dielli në flakë?

Jo, procesi i djegies që ndodh në Diell është ndryshe nga ai që jemi mësuar të përjetojmë në Tokë. Dielli shkëlqen sepse bërthama e tij prodhon sasi shumë të mëdha energjie nëpërmjet një procesi që quhet “fuzioni bërthamor”.

Në çdo sekondë, 4 milionë ton hidrogjen të bërthamës së Diellit shndërrohen në helium dhe sasi të jashtëzakonshme energjie. Kjo energji ndjek rrugën e saj deri në sipërfaqen e Diellit, ku takohet me gazet që gjenden aty duke shkaktuar efektin e shkëlqimit.

# 7

### Sa i vjetër është Dielli?

Faktet tregojnë se Dielli shkëlqen prej afërsisht 5 miliard vite! Duket shumë i vjetër, por është më pak se gjysma e moshës së Universit, që është afërsisht 14 miliard vite i vjetër!

# 8


### A rrotullohet Dielli rreth Tokës?

Jo, Toka rrotullohet rreth Diellit. Mund të duket si e kundërta sepse Dielli duket sikur udhëton nëpër Qiell nga Lindja në Perëndim çdo ditë. Por kjo ndodh vetëm sepse Toka rrotullohet çdo ditë nga Lindja.





## FLETË PUNE Format e energjisë





## FLETË PUNE

## Si të kursejmë energji në shtëpi



Vendosni në anën e jashtme të mureve të shtëpive/banesave tuaja izolues ndaj të nxehtit apo të ftohtit.



Mbushni boshllëqet e dritareve nga ku mund të dalë ngrohtësia jashtë shtëpisë.



Vendosni në dyshemenë e shtëpisë shtresa izoluese ndaj të ngrohtit apo të ftohtit.



Ndërtesat e reja në rajonet me klimë të ftohtë duhet të kenë dritare të mëdha që janë në drejtim të jugut për të patur më shumë dritë dhe ngrohje nga dielli gjatë kohës së dimrit.



Vendosni pajisjet për ngrohje (radiatorët, sobat) nën dritare, që të mund ta ngrohin ajrin kur hyn brenda.



Ndërroni pajisjet e ngrohjes së ujit (si ai i dushit apo lavamanit) me modele më të reja dhe më ekonomike (nuk është domosdoshme që t'i ndërroni të gjitha menjëherë).





## FLETË PUNË

# Si të kursejmë energjinë kur gatujmë



Mbyllni mirë derën e furrës së sobës gjatë gatimit sepse kështu kursen energji.



Kur gatuhet në sobë, gjithë hapësira e saj duhet të shfrytëzohet, dhe kur ka mundësi, të gatujmë disa gjellë njëra pas tjetrës.



Përdorni tenxhere me presion, që kursejnë energji dhe kohë.



Përdorni enë diametri i të cilave në fund është i barabartë dhe më i madh se diametri i pllakës së sobës së gatimit.



Enët me cilat përgatitni ushqim duhet të kenë fund të rrafshhtë dhe të trashë.



Shkrijeni akullin e frigoriferit rregullisht.



Mos vendosni ushqim ose enë të ngrohta në frigorifer.



## FLETË PUNE

## Si ta kursejmë energjinë kur hekurosim, pastrojmë dhe lajmë



Përdorni hekur me avull.



Mbusheni lavatriçen plot para se ta ndizni. Gjithmonë zgjidhni programin më të përshtatshëm i cili mund të kursejë energji dhe kohë.



Rregullisht pastrojeni qesen e fshesës elektrike.



Ndërroni gypat e prishur të fshesës elektrike.





## FLETË PUNE

# Si të kursejmë energji gjatë ndriçimit të shtëpisë



Lyeni muret e dhomave me ngjyra të ndritshme.



Mbillni pemë më së paku 5 metra larg mureve të shtëpisë.



Pastroni gjithmonë dritaret.



Fikni dritat kur nuk ju nevojiten. Vendosni sensorë për lëvizje që t'i kontrolloni dritat e mjediseve të jashtme, në mënyrë që ato të fiken kur ju nuk keni nevojë.



Ndërroni llambat e vjetra me llamba që kursejnë energji, këto lloj llambash janë shumë të qëndrueshme (kanë jetëgjatësi deri shtatë vjet).



Mos i lini aparatet elektrike në gjendje gatishmërie. Pajisjet në gjendje të tillë harxhojnë energji elektrike edhe kur janë të fikura.





## FLETË PUNE Energjia elektrike



Ishte një ditë e ftohtë dimri. Vëllezërit Agroni dhe Luani mbetën vetëm në shtëpi, pasi prindërit atë fundjavë shkuan për ski në mal.

Agroni mori kompjuterin të luante me lojëra, ndërsa Luani u ul të shikonte një film vizatimor në televizor. Pasi luajti pak në kompjuter, Agroni u mërzi shpejt dhe u bashkua me vëllain për të parë televizor. Por ai nuk e fiku kompjuterin. Kur u errësua, fëmijët ndezën dritat në të gjithë shtëpinë - në dhomën e ndenjjes, në kuzhinë, në korridor dhe në dhomën e tyre. Në mbrëmje u bë ftohtë dhe Luani ndezi ngrohësen që punonte me energji elektrike. Atë natë fëmijët u shtrinë për të fjetur shumë vonë. Ata nuk i fikën fare dritat, në asnjë prej mjediseve të shtëpisë. Dritat ndriçonin nëpër të gjitha dhomat, edhe në korridor, ndërkohë që dhe kompjuteri, televizori e ngrohësja punonin pa pushim. E njëjta situatë vijoi edhe ditën në vazhdim.

Në fakt, asnjë banor i qytetit nuk mendonte për kursimin e energjisë elektrike. Agroni dhe Luani nuk ishin të vetmit që sillëshin në këtë mënyrë me energjinë elektrike.


Në ditën e tretë që ata ishin vetëm në shtëpi, nga ngarkesa e madhe në rrjetin elektrik, centrali elektrik i qytetit u dëmtua. Fëmijët nuk mund të shikonin dot televizor, nuk mund të përdornin dot kompjuterin apo të ngroheshin. As për të ngrënë nuk mund të gatuanin pa energji elektrike. Asnjë shtëpi nuk kishte energji. Kur erdhi mbrëmja ata kishin frikë të rrinin vetëm dhe në errësirë, e shkuan te fqinjët e tyre. Atje mësuuan që kishte ndodhur një defekt dhe i gjithë qyteti nuk kishte energji elektrike. Kaluan disa orë derisa defekti u rregullua.

Prindërit e Agronit dhe Luanit u kthyen ditën tjetër dhe mësuuan se çfarë kishte ndodhur.

Në fund të muajit, kur erdhi fatura mujore e energjisë elektrike, prindërit u habitën jashtë mase nga vlera e lartë që duhej të paguanin.



## FLETË PUNE Burimet e energjisë







## Shumëllojshmëria biologjike

**Organizmat e gjallë** ë Tokës grupohen në **lloje**. Lloji përbëhet nga një grup organizmash që janë të ngjashëm sipas pamjes, mënyrës së jetesës dhe sjelljes. Deri në fund të shekullit të 20-të, shkencëtarët kanë zbuluar dhe studiuar një pjesë të vogël të të gjithë organizmave të gjallë – rreth 1,5 milion lloje. Sipas përlogaritjeve, ekzistojnë rreth 4 deri në 5 milionë lloje të tjera, të cilat ende nuk janë zbuluar dhe përshkruar nga shkencëtarët.

Në planetin tonë, bashkë me njerëzit, jetojnë dhe **disa milionë lloje** bimësh, kafshësh dhe mikroorganizmash. Të gjitha këto përbëjnë atë që quhet shumëllojshmëria biologjike ose biodiversiteti.

Biodiversiteti është burimi natyror më i vlerësuar në planet. Ai përbëhet nga tre komponentë:

- **Shumëllojshmëria gjenetike.** Të gjitha llojet e Tokës trashëgojnë informacion gjenetik, i cili është çelësi i përshtatjes ndaj kushteve të mjedisit. Në të ardhmen, njerëzit ndoshta mund të rigjenerojnë disa lloje të zhdukura nëse kanë në dorë materialet e tyre gjenetike.
- **Shumëllojshmëria e llojeve.** Kushtet e ndryshme të mjedisit kushtëzojnë shumëllojshmërinë e madhe të formave jetësore. Llojet e reja janë krijuar përgjatë miliona viteve, ndërsa ato lloje që nuk kanë arritur të përshtaten ndaj kushteve në ndryshim, kanë ngordhur. Çdo lloj bimor dhe shtazor ka mjedisin e vet jetësor, prej nga merr të gjithë elementët e domosdoshëm për jetën: ajrin, ujin, ushqimin, hapësirën për të jetuar dhe strehimin. Kur mjedisi i një organizmi ndryshon, lloji përshtatet, zhvendoset në vend tjetër ose zhduket.
- **Shumëllojshmëria e ekosistemeve.** Kjo përfshin bashkësi të ndryshme jetësore të tilla si pyje, shkretëtira, fusha, lumenj, dete dhe oqeanë. Banorët e një ekosistemi ndërveprojnë midis tyre dhe me mjedisin jo të gjallë. Ekosistemet ekzistojnë për shkak të numrit të madh të llojeve, ku çdo lloj plotëson nevojat e veta për lëndë ushqyese, energji dhe informacion, duke nxitur kështu dhe ekzistencën e llojeve të tjera. Sa më të pasur janë ekosistemet me lloje, aq më të qëndrueshëm janë ata.



## Shumëllojshmëria biologjike

Termi shumëllojshmëri biologjike nënkupton shumëllojshmërinë e llojeve, të gjeneve dhe të ekosistemeve. Shtetet më të pasura me lloje janë Brazili (pellgu i Amazonës), Indonezia, SHBA, Rusia (Siberia), India dhe Kina.

### Biodiversiteti në numra

Bimë ose kafshë	Numri i llojeve		
	Në botë	Në Evropë	Në Shqipëri
<b>Bimë të larta</b>	259.630	12.500	1.800
<b>Peshqi</b>	34.000	546	445
<b>Amfibë</b>	7.000	85	15
<b>Zvarranikë</b>	10.000	151	36
<b>Shpendë</b>	10.000	800	323
<b>Gjitarë</b>	5.416	270	70

**Mbrojtja** e biodiversitetit është një kusht shumë i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sistemeve natyrore, pasi vetëm atëherë ato mund të ripërtërihen dhe të zhvillohen.

Mbrojtja e biodiversitetit është e rëndësishme për:

- **Sistemet natyrore**, të cilat kanë aftësi të vetë mirëmbahen, të mbrohen dhe të zhvillohen. Secili organizëm kalon nëpër ciklin e jetës të ushqimit dhe krijimit të lëndëve organike. Ata marrin pjesë në të gjitha proceset e natyrës. Organizmat ujorë pastrojnë ujin, grabitqarët sigurojnë kontrollin natyror të kafshëve të dëmshme, ndërsa insektet janë pjalmuesit kryesorë të botës bimore.
- **Njerëzit**, të cilët shfrytëzojnë lëndë të ndryshme (ushqim, dru, veshje), lëndë të para, kimikate dhe bimë mjekësore, për të ruajtur shëndetin njerëzor dhe për të plotësuar nevojat e tyre.



Në natyrë, **zhdukja e llojeve** është proces natyror. Studimet e fosileve kanë treguar se gjatë miliona viteve kanë ngordhur, me një ritëm mesatar, një deri në tre lloje çdo vit. Vlerësimet e stome tregojnë se mijëra lloje bimësh dhe kafshësh vdesin çdo vit, çka është mjaft shqetësuese. Shkaqet **më serioze** për zhdukjen e shpejtë të llojeve janë: ndotja si pasojë e zhvillimit ekonomik, përdorimi i madh i tokës pjellore, zhvillimi i transportit dhe rritja e i qyteteve. Sjellja e pakujdesshme e njeriut ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e shumëllojshmërisë biologjike përmes shkatërrimit të llojeve të kafshëve dhe të bimëve, ose në mënyrë indirekte, përmes shkatërrimit të vendbanimeve të tyre.

### Biodiversiteti në Shqipëri

**Shqipëria** ka një mjedis natyror të larmishëm. Përzjerja e ekosistemeve dhe e habitateve përfshin ato detare, bregdetare, ligatinat, deltat e lumenjve, dunat e erës, liqenet, lumenjtë, shkurret mesdhetare, pyjet, kullotat, livadhet dhe zonat e larta malore. Secili mjedis ofron larmi të pasur llojesh në bimë dhe kafshë.

Në këtë shumëllojshmëri biologjike ndikojnë shumë faktorë, si:

- faktorët klimatikë, ata gjeologjikë dhe relievi shqiptar,
- pozicioni gjeografik ndërmjet dy zonave kryesore biogjeografike (asaj të Evropës Qendrore dhe të zonës Mesdhetare);
- pozicioni i rëndësishëm në rrugëtimin e shpendëve shtegtarë;
- vija bregdetare e të dy deteve, Adriatik dhe Jon;
- ekzistenca e një shumëllojshmërie të madhe biologjike dhe e ekosistemeve të ujërave të ëmbla.



Shqipëria është e lidhur ekologjikisht me shtetet fqinje nëpërmjet ekosistemeve, liqeneve dhe lumenjve të përbashkët, si dhe nga migrimi i shpendëve dhe i organizmave detare.

Shqipëria ka rreth 3.250 lloje bimësh të larta, numër që përfaqëson 30% të florës evropiane, dhe 2.350 lloje bimësh të ulta, ku futen myshqet, algat dhe kërpudhat. Nga gjithë kjo larmi biologjike, 27 lloje bimësh gjenden vetëm në Shqipëri (këto quhen lloje endemike), ndërsa rreth 160 lloje janë lloje endemike në Shqipëri dhe në shtetet fqinje.

Midis llojeve endemike, një pjesë janë lloje relike, siç është *Forsythia europae*. Shqipëria është streha për 756 lloje kafshësh rruazore, ku përfshihen: 70 lloje gjitarësh, 323 lloje shpendësh dhe 36 zvarranikësh. Në lumenjtë dhe në liqenet e Shqipërisë rriten 64 lloje peshqish, ndërsa rreth 249 lloje peshqish u përkasin ujërave detare. Shqipëria është strehë për 91 lloje kafshësh të rrezikuara globalisht, ku përfshihen 21 lloje gjitarësh, 28 lloje peshqish, 18 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranikësh, 2 lloje amfibësh dhe 18 lloje kafshësh parruazore.

Ndër llojet më të rrezikuara në Shqipëri përmendim zambakun shqiptar, lulen genciana e verdhë, rrëqebullin, macen e egër, dhinë e egër etj.

Libri Kuq i Shqipërisë liston lloje të rrezikuara, të rralla dhe endemike, 573 lloje kafshësh (duke përfshirë rruazorët dhe parruazorët) dhe 320 lloje bimësh me lule, 45 lloje kërpudhash dhe 25 lloje bimësh detare. Shqipëria ka, gjithashtu, një bujqësi që duhet marrë parasysh – lidhur me shumëllojshmërinë gjenetike të 30 llojeve të bimëve ushqimore, që rriten në vend, si dhe të 9 racave dhish dhe të 5 racave delesh.

Gjithashtu, shumë zona me vlera të mëdha natyrore dhe piktoreske kanë mbijetuar, pavarësisht nga presionet që janë ushtruar mbi to. Këto zona kanë nevojë të mbrohen, me qëllim që të ruhet shumëllojshmëria biologjike dhe bukuria natyrore e peizazheve shqiptare.

### Trashëgimia dhe monumentet e natyrës

Trashëgimia është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo është vlerë e mjedisit natyror dhe, si e tillë, është natyrore. Por trashëgimia është edhe vlerë materiale e shpirtërore e shoqërisë dhe, si e tillë, është kulturore.

Në përbërje të e trashëgimisë natyrore ka objekte, habitate, ekosisteme më të veçanta, të rralla apo unike, relikte, endemike apo të rrezikuara për t'u zhdukur. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe shkencore, kulturore, didaktike, por edhe turistike. Këto vlera të veçanta ruhen dhe mbrohen edhe me forma e mënyra shumë më të rrepta, të përcaktuara saktë dhe me ligje të veçanta. Të gjitha këto objekte, habitate dhe ekosisteme të mbrojtura nga këto ligje cilësohen trashëgimi natyrore e veçantë.

**Monument natyre** është objekti i natyrës me vlera unike: shkencore, ekologjike, kulturore, historike, estetike, didaktike, fetare (një apo disa prej tyre); një habitat i një lloji të rrallë apo të kërcënuar ose me rëndësi të veçantë dhe me sipërfaqe deri 50 ha.

Kriteret që përdoren për përcaktimin e statusit Monument Natyror janë:

1. Objekti apo habitati duhet të ketë një apo disa vlera unike të thëna më lart.
2. Të jetë vetëm krijesë e natyrës; ndërsa habitati të ketë madhësi të mjaftueshme për ekzistencën e tij.
3. Të jetë i padëmtuar nga njeriu apo nga faktorë të tjerë natyrorë ose me mundësi ripërtëritjeje.

Monumenti i natyrës është një burim kulture dhe edukimi, burim i kënaqësisë shpirtërore, burim për punë kërkimore – shkencore. Ata duhet të njihen, të mbrohen dhe t'u trashëgohen brezave.



## Planifikimi ditor i temës Shumëllojshmëria biologjike

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Bimët dhe kafshët rreth nesh
<b>Kohëzgjatja</b>	4 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënësve</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>tregon për bimët dhe kafshët që rriten në zonën ku banon;</li> <li>rendit karakteristikat e bimëve dhe kafshëve që ai njej;</li> <li>tregon rëndësinë e bimëve dhe kafshëve për jetën e njerëzve;</li> <li>shpjegon më shembuj zinxhirin ushqimor.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënësve</b>	Kutia e Biodiversitetit Loja e Biodiversitetit Bima ime është ... Zinxhiri ushqimor
<b>Fjalët kyç</b>	Strukturë gjenetike, lloj, organizmat, shumëllojshmëria, biodiversiteti, ekosistem, komponentë, habitat, mjedis, riprodhon, pasardhës, gjenetikë, ligatinat, ekuilibër natyror, kënetat, moçalet, ujërat e cektë, gjiret bregdetare, algat, planktonet, ushqim natyror, betonizim, ndikim, investim, faktorë, zhdukje, dëmtim.
<b>Burimet materiale</b>	Tabelë me vizatime/foto/albumet me kafshë/bimë, foto të mjediseve pyll/livadh dhe lumë, shumës me ngjyra ose ngjyra, fletë pune, flip-chart, fletë format A4 , kartona.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Dituri natyre, Arte pamore, Gjuha shqipe.

### Ora I – Shumëllojshmëria biologjike Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesja fton nxënësit të vendosin fjalët sipas rendit alfabetik duke dhënë sqarimet e nevojshme. Më pas nxënësve u kërkohet të krijojnë një fjali për secilën fjalë të dhënë: strukturë gjenetike, lloj, organizmat, shumëllojshmëria, biodiversiteti, ekosistem, komponentë, habitat, mjedis, natyra, riprodhon, pasardhës, gjenetikë, ligatinat, ekuilibër natyror, kafshë, bimë, njerëz, kënetat, moçalet, ujërat e cektë, gjiret bregdetare, algat, planktonet, ushqim natyror, uji, oksigjeni, betonizim, ndikim, pylli, investim, faktorë, zhdukje, dëmtim, jetë, toka, thirrje, veprimtari, zakon.

A	B	C	Ç	D	DH
E	Ë	F	G	GJ	H
I	J	K	L	LL	M
N	NJ	O	P	Q	R
RR	S	SH	T	TH	U
V	X	XH	Y	Z	ZH

Mësuesi/ja shpjegon se:

- Organizmat e gjallë të Tokës grupohen në lloje. Llojin e përbën një grup organizmesh që janë të ngjashëm sipas pamjes, mënyrës së jetesës dhe sjelljes.
- Shumëllojshmëria biologjike është burim natyror dhe përbëhet nga tre komponentë:
  1. Shumëllojshmëria gjenetike. Të gjitha llojet e Tokës trashëgojnë informata gjenetike, sipas të cilave përshtaten në kushtet e mjedisit.
  2. Shumëllojshmëria e llojeve. Llojet e reja janë krijuar gjatë miliona viteve, ndërsa ato që nuk kanë arritur të përshtaten në kushtet që ndryshoheshin, kanë vdekur. Secili lloj bimor ose shtazor ka mjedisin e vet jetësor, prej nga i merr të gjitha kushtet e domosdoshme për jetë: ajër, ushqim, hapësirë jete dhe strehim.
  3. Shumëllojshmëria e ekosistemeve. Ekosistemi paraqet bashkim midis biobashkësive dhe hapësirës së tyre të jetës. Kjo përfshin bashkësi të ndryshme jetësore të tilla si pyje, shkretëtira, fusha, lumenjtë, dete dhe oqeanë.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesja/si e ndan klasën në grupe dyshe, përkatësisht bimë dhe kafshë, sipas tre mjediseve pyll/livadh dhe lumë. Më pas ajo/ai i jep fletën e punës për të plotësuar ushtrimin që të lidhë figurën përkatëse me përshkrimin e bimës apo të kafshës sipas mjedisit lumë/livadh/pyll.



Mësuesja/si zbaton teknikën diagramin e Venit për të tre mjediset si për bimët ashtu edhe për kafshët. Nxënësit prezantojnë punën e tyre sipas grupeve. Tregojnë dhe përshkruajnë karakteristikat e bimëve dhe kafshëve të mjedisit të përzgjedhur. Gjatë diskutimeve ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë ju nevojitet këtyre bimëve dhe kafshëve që të ekzistojnë (ajër, ujë, dritë, ushqim, ngrohje, hapësirë, vendbanim). Nxirni përfundimin se vendbanimet dhe llojet e bimëve dhe të kafshëve janë të ndryshueshme.



Gjithashtu jepni më shumë informacione rreth larmisë biologjike në shifra për në botë, Evropë dhe në Shqipëri si dhe mbi rëndësinë e mbrojtjes së tyre duke u bazuar në të dhënat e pjesës hyrëse.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe me nga 4-5 nxënës dhe i fton të vizatojnë mjedisin pyll/livadh/lumë dhe të presin e të ngjisin bimët e kafshët përkatëse të këtyre mjediseve. Nxënësit prezantojnë punimet e tyre në një galeri.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetë vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë prezantimeve si dhe gjatë diskutimeve.

### Detyrë shtëpie:

Të vizatojnë ose përshkruajnë bimë ose kafshë të tjera të këtyre mjediseve pyll/livadh/lum.

## Ora II – Pse bimët dhe kafshët janë të rëndësishme? Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimit fillon me lojën “Biodiversiteti”. Mësuesja/si e vendos klasën në një rreth. Numëron duke bërë një përsëritje të njëpasnjëshme me emërtime të tilla si:

- Gjen/Organizmat/Ekosistem/Shumëllojshmëri. E rinis përsëri numërimin në varg te nxënësit
- Nxënësit çohen në këmbë dhe lëvizin në mënyrë të lirshme nëpër klasë, duke u përzier me të tjerët dhe duke u prezantuar si komponentë të Biodiversitetit. Mësuesi thotë “Biodiversitet” dhe nxënësit bashkohen në katërshë sipas të njëjtit emërtim.



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësimi vazhdon me prezantimin e detyrave të shtëpisë për vizatimet e bimëve dhe kafshëve.

Mësuesi/ja shkruan të gjitha bimët dhe kafshët lumore, pyjore dhe livadhore në fleta A4. Këto vendosen në dysheme në tre grupe të mëdha sipas mjedisit pyll/livadh/lumë. Secili prej nxënësve zgjedh se çfarë do të donte të ishte dhe argumenton duke u ndihmuar nga fleta e punës në faqen 92 me titull "Zgjedhja ime".

Sikur të isha bimë, do të isha ....., sepse .....

Sikur të isha kafshë, do të isha ....., sepse .....etj.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja e ndan klasën në katër grupe dhe zbaton me nxënësit teknikën "Dora e verbër" për tekstet e koncepteve bimët/kafshët/kërpudhat/bakteret. Nxënësit prezantojnë punimet e tyre dhe mësuesja/si thekson rëndësinë e organizmave të gjalla.

Më pas mësuesi/ja parashtron nxënësve pyetjen:

- A ekzistojnë bimë dhe kafshë të dëmshme në natyrë?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre. Mësuesi/ja shpjegon dhe thekson se:

- Secili organizëm është i rëndësishëm në natyrë prandaj, ata nuk mund të grupohen si të dobishëm dhe të dëmshëm.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur dilemën "Një çift lejlekësh" dhe zgjidhin atë me ndihmën e mësuesit/es.



### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen gjatë komenteve, diskutimeve si dhe argumenteve që japin për rëndësinë e bimëve dhe kafshëve në natyrë.

### Detyrë shtëpie:

Të krijojnë një album me foto kafshësh dhe bimësh të zonës ku ata banojnë.

## Ora III – Bima ime është...

### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kjo orë mund të zhvillohet nga mësuesi/ja në ambiente të ndryshme.

Në klasë mësuesi/ja tregon albumin me lloje të ndryshme bimësh duke theksuar karakteristikat e tyre duke ftuar edhe nxënësit të tregojnë se çfarë ata dinë. Një mjedis tjetër mund të jetë edhe oborri i shkollës ose një park duke i orientuar nxënësit që të kërkojnë bimën që duan më shumë. Mësuesja udhëzon nxënësit që bimën duhet ta vëzhgojnë me kujdes, ta prekin e t'i marrin erë, pa e dëmtuar.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Më pas nxënësit përshkruajnë karakteristikat e saj sipas përshkrimit në vijim:

- Bima ime jeton në .....
- Bima ime është ..... (ndonjë karakteristikë të veçantë lartësi, lule, fryt, aromë, lëvore etj.)
- Bima ime është e rëndësishme, sepse ..... (bën hije, është e bukur, mund të hahet etj.)

Nxënësi duhet të numërojë sa më shumë veçori në varësi të njohjes së bimës dhe një veçori që kanë të përbashkët me këtë bimë.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja fton nxënësit me radhë të prezantojnë bimën e tyre pa ia thënë emrin dhe nxënësit e tjerë ta gjejnë se cila është ajo bimë sipas përshkrimit.

Ora zhvillohet në formë konkursi dhe fiton ai nxënës që gjen sa më shumë emrash bimësh.

Në fund zhvillohet pyetjet testuese nga situatat në «Pushime në mal» dhe në «Park».



**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësojnë njëri tjetrin për përshkrimin e bimëve dhe gjetjen e emrit të bimës sipas përshkrimit.

**Detyrë shtëpie:**

Të mbledhin informacione nga burime të ndryshme për bimë mjekësore që rriten në zonën e tyre dhe cilat janë vlerat kuruese të tyre.

## Ora IV – Zinxhiri ushqimor Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të prezantojnë albumet e kafshëve dhe bimëve të realizuar si detyrë shtëpie. Lexohen ose tregohen disa karakteristika të tyre.

Mësuesi/ja orienton diskutimet e nxënësve rreth mjedisit të bashkëjetesës jetësore të kafshëve dhe bimëve. Shkruhen në tabelë shembuj të mjedisëve të bashkëjetesës jetësore si: malet, lumenjtë, detet, liqenet, livadhet, fermat, fshatrat dhe qytetet.

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se:

- Bimët quhen prodhuese (bari, pemët, fryti), sepse prodhojnë ose (krijojnë) ushqim nga uji, kripërat minerale dhe energjia e diellit në gjethe. Lënda ushqimore mbetet te bimët deri sa nuk i hanë kafshët ose deri sa ato nuk vdesin dhe nuk shpërbëhen. Fton nxënësit të argumentojnë me shembuj bimësh që ata njohin
- Organizmat shtazorë që ushqehen me bimët dhe kafshët e tjera quhen konsumues (lepuri, ketri, insektet, kaprolli, lopa, delja, dhia, kali). Gjithashtu, kafshët që ushqehen me bimë ndihmojnë në lëvizjen qarkore të energjisë dhe materieve ushqimore. Bakteret dhe kërpudhat, të cilat kanë rol zbërthyes, i zbërthejnë organizmat e vdekur dhe me këtë i kthejnë materiet në tokë, prej ku lëvizja qarkore mund të fillojë përsëri.

Zinxhiri ushqimor tregon një lidhje të madhe midis organizmave bimorë dhe shtazorë në bashkësitë jetësore. Secili zinxhir ushqimor fillon me një bimë të gjelbër – prodhues i ushqimit, me të cilën ushqehet ndonjë kafshë barngrënëse – që quhet konsumues. Zinxhiri ushqimor përfundon me ndonjë kafshë grabitqare (shqiponjën, gjarpërinj, dhelprën, ujkun, ariun), e cila ushqehet me kafshën që ushqehet me bimë ose kafshë.

Në diskutim me nxënësit tregohet një shembull për zinxhirin ushqimor. P.sh lulen e ha krimbi, krimbin e ha bretkosa, bretkosën e ha gjarpri, gjarprin e ha bufi.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletët e punës faqen 94-95 për Ekosistemin dhe Zinxhirin ushqimor.

Nxënësit në punë dyshe presin fotografi të bimëve dhe kafshëve të ndryshme dhe i vendosin në dritaret e zinxhirit ushqimor. Më pas bëjnë lidhjen me shigjeta se me çfarë ushqehet secila kafshë.



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të plotësimit të fletës së punës, nxënësit prezantojnë zinxhirin ushqimor që ata kanë përgatitur. Nxënësit e tjerë bëjnë komente dhe vlerësime për punët e kryera.

Mësuesi/ja në vazhdimësi të diskutimeve pyet nxënësit:

- Çfarë do të ndodhte sikur një nga kafshët të mungonte në zinxhirin ushqimor?
- A mund të thoni pse janë të rëndësishëm zinxhirët ushqimorë.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri tjetrin për ndërtimin dhe prezantimin e një zinxhiri ushqimor

### Detyrë shtëpie:

Të vizatojnë ose të plotësojnë me foto një zinxhir ushqimor duke vënë edhe emrat e çdo pjesëmarrësi në këtë zinxhir.

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Për njerëzit dhe për natyrën
<b>Kohëzgjatja</b>	4 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon se kur ka ndryshime në mjedisin jetësor, disa organizma përshtaten, të tjerët shpërngulen, ndërsa disa vdesin;</li> <li>• renditin kafshë të cilat migrojnë dhe emigrojnë;</li> <li>• përcaktojnë vështirësitë me të cilat ballafaqohen shpendët gjatë migrimit dhe emigrimit;</li> <li>• rendit kafshë të cilat janë në zhdukje;</li> <li>• shpreh qëndrimin e tij për kujdesin ndaj kafshëve.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Lojë: Pylli dhe drurëprerësit Lojë: Shpërngulja nuk është e lehtë Lojë – Zinxhiri i jetës Shëtitje në plazh
<b>Fjalët kyç</b>	Pylli, drurëprerësit, shpërngulja, migrim, emigrim, zinxhiri i jetës.
<b>Burimet materiale</b>	7-8 litarë secili me gjatësi 3-4 metra, kartela me emra kafshësh, fletë punë, letër A4, kartona
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Arte pamore, Dituri natyre.

### Ora I – Pylli dhe drurëprerësit (Lojë me role) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kjo orë zhvillohet në oborrin e shkollës ose në park. Në fillim mësuesi/ja zhvillon një bisedë me nxënësit rreth veçorive të pyjeve në zonën ku ata jetojnë dhe përqendron bisedën në:

- Bimët që rriten në pyjet e zonës së tyre;
- Kafshët që rriten;
- Rojtarët e pyjeve dhe përgjegjësia e tyre;
- Drurëprerësit dhe puna e tyre.





**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Më pas mësuesi/ja u shpjegon nxënësve lojën “Pylli dhe druprerësi”. Me ndihmën e litarit (ose thjesht duke vizatuar në tokë) bëhen shtatë ose tetë rrrathë (me një diametër rreth një metër). Sqarohen nxënësit se këta rrrathë paraqesin një pyll të vjetër të banuar, me bimë dhe kafshë të ndryshme.

Ftohen 12-15 nxënës vullnetarë për zhvillimin e lojës dhe ndahen rolet. Dy prej tyre do të luajnë rolin e druprerësit. Të tjerëve iu jepen kartela me emra të kafshëve të ndryshme.

Loja fillon me shpërndarjen e kafshëve në pyll: vendosni një apo dy kafshë në mes të secilit rreth. Kur druprerësit vijnë në pyll, ata thonë se do të presin një pjesë të tij. Ata zgjedhin rrethin ku do të “presin” pemë (duke prishur formën e litarit ose fshirë rrethin nga toka. Kafshët e pyllit e braktisin vendbanimin e tyre dhe shpërngulen në një rreth tjetër ose duhet të ngordhin (varet nga kushtet se si do të vendosin). Ftohen nxënësit që me lëvizjet e tyre ta imitojnë mënyrën dhe shpejtësinë e shpërnguljes së tyre — duke fluturuar, kërcyer, zvarritur etj. Kur druprerësit të vijnë përsëri, ata do të “presin” një pjesë tjetër të pyllit, kafshët i braktisin vendbanimet e tyre, e kështu me rradhë e njëjta situatë përsëritet derisa të mbesin dy rrrathë. Në fund, vihet re që shumica e kafshëve janë grumbulluar në dy rrrathët e fundit. Loja zhvillohet dhe me nxënësit e tjerë të klasës.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas lojës, diskutoni me nxënësit për rastin se si ata ndiheshin kur e luanin këtë lojë.

- Çfarë duhej të bënin patjetër kafshët kur pylli i tyre u pre?

Fton nxënësit të tregojnë se çfarë ka ndodhur me organizmat e tjerë, siç janë bimët dhe kërpudhat gjatë prerjes së pyllit.

Sqaroni se në një mjedis të vërtetë, disa organizma mund të shkatërrohen menjëherë, disa janë të detyruar që vetë të përshtaten në ndryshimet e mjedisit jetësor, disa, arrijnë që të shpërngulen në vendbanime të ndryshme, ndërsa disa janë të dënuar që të ngordhin. Theksohet se aktiviteti i njeriut, në këtë rast, ka shkaktuar zvogëlimin e shumëllojshmërisë biologjike, kryesisht, përmes shkatërrimit të vendbanimeve të bimëve dhe kafshëve të pyllit.

- Si duhet vepruar në këtë rast?



**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet e dhëna gjatë diskutimeve dhe zvillimit të lojës.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit të shkruajnë një letër ose këshilla për druprerësit ose rojtarët e pyllit.

**Ora II – Shpërngulja nuk është e lehtë  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kjo orë mund të zhvillohet në park ose në oborr të shkollës. Nxënësve iu shpërndahen fletët e punës të faqes 106: “Të dhënat për shpërnguljen”. Ftoni nxënësit të japin shembuj të ndryshëm për shpërnguljen e kafshëve duke u bazuar në informacionin e dhënë ose në njohuritë e tyre të mëparshme.

Kafshët dhe shpendët që nuk shpërngulen	Kafshët dhe shpendët që migrojnë	Kafshët dhe shpendët që emigrojnë

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se do të luajnë një lojë të titulluar "Shpërngulja nuk është e lehtë".

Nxënësit do të grumbullohen si lejlekët e bardhë, që çdo vjeshtë shpërngulen në jug për ta kaluar dimrin, ndërsa në pranverë kthehen në veri në vendlindjet e tyre.

Shënoni në tokë dy rrrathë me largësi nga njëri-tjetri prej 20-30 metrash: njëri rreth do të përfaqësojë vendin për dimrim, ndërsa rrethi tjetër vendin e folesë. Siguroni katër-pesë vende midis dy rrrathëve si zona të sigurta, ku lejlekët do të mund të pushojnë gjatë shpërnguljes. Zona të sigurta mund të jenë pemët, shkëmbinjë e mëdhenj, moçalet ose disa vende të tjera natyrore, ku zogjtë mund të pushojnë para se të nisin përsëri fluturimin.

Ftoni nxënësit që të zgjedhin role ose le të tërheqin letrat, në të cilat shkruajnë rolet me zgjedhje të rastësishme. Dy nxënës do të kenë rolin e gjuetarëve (njeriu dhe grabitqari – dhelpra), duke i kujtuar nxënësit se të tjerët e kanë rolin e lejlekëve. Zogjtë lëvizin shumë shpejt, fluturojnë nga njëri rajon te tjetri, dhe kanë të drejtë të ndalen vetëm në zonat e sigurta gjatë kalimit të tyre. Gjuetarët mundohen që t'i gjuajnë zogjtë në kohën kur ata shpërngulen, por nuk mund të hyjnë në zonat e sigurta, në vendet për dimërim dhe fole.



Secili zog i gjuajtur del nga loja. Fillimin e secilës shpërngulje e njofton mësuesi. Gjatë shpërnguljes së parë, të gjitha zonat janë aktive. Por, para se të fillojë e dyta, tregojuni nxënësve se njëra prej zonave është kënetë e tharë dhe nuk mund të shfrytëzohet më. Para se të fillojë shpërngulja e tretë, sqarojuni se në një zonë tjetër të sigurt janë ndërtuar mullinjtë me erë, kështu që edhe ajo nuk mund të shfrytëzohet.

Vazhdoni me lojën deri sa të zhduken të gjitha zonat e sigurta. Përdorni arsye të ndryshme për shkatërrimin e zonave të sigurta — ndërtimin e fabrikave ose autostradës, shndërrimin e zonës me ujë në qendër rekreative etj.

Shënoni numrin e lejlekëve që kanë mbijetuar pas secilës shpërngulje. Është e qartë se ata do të gjuhen më lehtë nga gjuetarët, sepse ngelin gjithnjë e më pak zona të sigurta. Nëse lejlekët ankohen se kjo nuk është e drejtë, tregojuni se gjuetarët mundohen t'i gjejnë vendet ku pushojnë zogjtë gjatë fluturimit të tyre, dhe po ashtu, kur zona e sigurta janë shkatërruar, është shumë e vështirë që zogjtë të mbijetojnë gjatë shpërnguljes.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutoni me nxënësit se si janë ndjerë kur luajtën rolet dhe çfarë kishin më të vështirë. I kushtoni vëmendje të madhe faktit se gjatë shpërnguljes së vërtetë, e njëjtë si në lojë, vendet e pushimeve janë plot me gjuetarë dhe grabitqarë të cilët rrezikojnë jetën e zogjve gjatë shpërnguljes.

Jepni shembuj kërcënimesh të tjera që i rrezikojnë zogjtë, p.sh: kabllot elektrike, mungesa e ushqimit, helmet që përdoren në bujqësi ose njollat e naftës në shtretërit e lumenjve/deteve.

Sqarojuni nxënësve se shpërngulja e shpendëve është mënyra më e lehtë dhe më e sigurt që ata të ballafaqohen me dimrin, por në realitet nuk është kështu.

Shpërnguljet janë shpeshherë të rrezikshme për shpendët. Gjatë shpërnguljes, shpendëve iu nevojitet shumë energji, ushqim, vend për pushim. Ata duhet t'i shpëtojnë grabitqarëve dhe të jenë të aftë të gjejnë vëndbanime të përshtatshme kur të arrijnë.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për zhvillimin e lojës me role dhe për përgjigjet e dhëna gjatë diskutimeve.

### Detyrë shtëpie:

Të gjejnë të informacion për kafshët që janë në zhdukje në vendin tonë dhe nëse kanë informacion për zonën ku ata banojnë, e dhe masat që duhen marrë për ruajtjen e këtyre kafshëve.

## Ora III – Lojë: Zinxhiri i jetës Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë rëndësinë e diellit për jetën në tokë. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe i shkruajnë në tabelë. Theksohet se Dielli lidhet direkt me bimët sepse vetëm ato mund të marrin energjinë diellore dhe ta shndërrojnë në lëndë organike, të cilën organizmat e tjerë e shfrytëzojnë si energji. Për të treguar këtë mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë një lojë.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Lojën fillojeni me ndarje të roleve midis nxënësve. Një fëmijë është “Dielli”, disa janë “Shpërbërësit (si bakteret, kërpudhat etj)”, ndërsa të tjerët janë bimë dhe kafshë. Dielli direkt do të lidhet me bimën. Siç lidhen ato, çdo anëtar le të marrë një pjesë nga litari i gjatë, kështu që ata do të përfundojnë të lidhur në mënyrën të njëjtë siç janë të lidhur me zinxhirin e ushqimit. Duhet të ketë më shumë lidhje midis organizmave të ndryshëm — p.sh: të gjitha bimët të jenë të lidhura me diellin.

Pasi ta formoni zinxhirin ose rrjetën ushqimore, tregojuni nxënësve se po vjen dimër i ftohtë dhe se do të shkatërrojë disa prej bimëve prandaj ata nxënës ulen. Pas dimrit minjtë dhe vemjet (ose kafshët tjera) nuk kanë ushqim të mjaftueshëm dhe ngordhin, prandaj edhe ata nxënës ulen etj. Së shpejti të gjithë do të ulen, përveç diellit, tokës, ujit, ajrit dhe shpërbërësve. Shpërbërësit mund të kërcejnë lartë-poshtë për të treguar se janë të lumtur që kanë ushqim të mjaftueshëm. Flisni për atë se si ata do ti zbrërthejnë trupat në materiale bazë të cilat do ta pasurojnë tokën, me atë që bimët sërish do të rriten, ndërsa vemjet do të kenë çfarë të hanë, kështu që secili fëmijë ngrihet duke plotësuar tablonë ashtu siç ishte në fillim.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Bisedoni me nxënësit për atë se çdo organizëm i gjallë është njësoj i rëndësishëm në zinxhirin ushqimor. Theksojeni faktin se zhdukja e një lloji çon në zhdukjen direkte apo indirekte të llojeve të tjera që janë të lidhura me të. Ju thoni fëmijëve që njeriu me sjelljen e tij duhet të mbrojë dhe ndihmojë në ruajtjen e llojeve të ndryshme të botës së gjallë.

Në fund mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë testin e faqes 91: Kafshët dhe bimët. Diskutohen përgjigjet e nxënësve.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për zhvillimin e lojës me role si dhe vlerësohen për përgjigjet e dhëna gjatë testit: “Kafshët dhe bimët”.

**Detyrë shtëpie:**

Mësuesja fotokopjon fletën e punës në faqe 110. Ajo u jep detyrë shtëpie nxënësve të ngjyrosin dhe gjejnë një titull për vizatimin e tyre.

## Ora IV – Shëtitja në plazh Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë pjesën “Shëtitje në plazh” në fletën e punës faqe 109. Nxënësit diskutojnë veprimin e fëmijës dhe shprehin mendimet e tyre rreth fjalëve të plakut dhe djalit: “Ju jeni vetëm një djalë i vogël dhe ka mijëra vje deti përreth. Vërtet mendoni se mund të ndryshoni ndonjë gjë?”. Djaloshi e pa atë, kapi një yll deti nga rëra, e hodhi atë në det dhe tha: “E pra, për atë yll deti që e hodha unë në ujë, sapo kam ndryshuar diçka!”

Më pas fton mësuesi/ja pyet nxënësit :

- Po ju si do të kishit vepruar nëse do të ishit në vend të djalit?
- Çfarë mund të bëni ju, familja juaj dhe komuniteti ku ju jetoni për mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve, në rajonin tonë, në vendon tonë?



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe ju shpërndan fletët e punës që gjenden në faqet 96-108. Nxënësit e çdo grupi do të diskutojnë mbi informacionin e marrë nga këto fletë pune, japin ide dhe do të hartojnë një plan për ndihmën që mund të japin në mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve. Nxënësit mund të mbështeten dhe në skemën e mëposhtme:

---

*Në afërsi të shtëpisë/shkollës sime ka:*

Ne do të kishim mundur:

---

*Në rajonin tonë mund të gjejmë:*

Ne do të kishim mundur:

---

*Vendi ynë është krenar që është mbrojtës i bimëve dhe kafshëve në vijim:*

Që të vazhdojmë t'i mbrojmë këto bimë dhe kafshë, ne duhet që:

---

Gjithashtu nxënësit shkruajnë në një letër sikur flet një bimë ose kafshë e cila kërcënohet nga zhdukja.

Letra mund të fillojë kështu: "Njerëz të dashur, mos u çudisni , unë që po ju shkruaj jam lejleku i bardhë, (ose pelikani kaçurel, ose rrëqebulli, ose arriu i murmë) dhe po ju shkruaj sepse jeta ime ..... sepse.....".

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit prezantojnë punët. Komentojnë dhe shprehin mendimet e tyre rreth punëve të njëri-tjetrit në grup. Letrat e shkruara të çdo grupi pasi janë diskutuar nga nxënësit në klasë, vendosen në një vend ku mund të shikohet nga nxënësit e shkollë, sipas mundësisë të shkollës.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit dhe me ndihmë e komunitetit të prindërve planifikojnë aktivitete për organizimin e festës së 22 majit, Ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike.



#### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin për punë e tyre në grup, diskutimet dhe komentet e bëra për njëri-tjetrin.

#### Detyrë shtëpie:

Nxënësit prezantojnë punët e tyre në shtëpi dhe ftojnë pjesëtarë të familjes ose komunitetit ku jetojnë të organizojnë aktivitete, siç janë: ndërtimi i vend-ushqimit për zogjtë, mbjellja e pemëve etj.



## DILEMA

## Një çift lejlekësh

Një çift lejlekësh kanë bërë çerdhen mbi një shtyllë elektrike jo shumë larg shtëpisë suaj. Por rryma elektrike është e rrezikshme për lejlekët. Çfarë do të bëni?

- I dëboni lejlekët, sepse shqetësoheni për sigurinë e tyre.
- Ndërtoni një çerdhe tjetër në një vend të sigurt afër çerdhes ekzistuese.
- Thërrisni një elektrikist që të heqë rrymën elektrike prej andej.
- Thërrisni shoqatën për mbrojtjen e kafshëve.
- Asgjë, ju nuk ju pëlqejnë shumë lejlekët.
- Diçka tjetër.



## TEST

## Kafshët dhe bimët

	E SAKTË	E GABUAR
1 Kur mblidhen kërpudhat, është mirë që ato të priten me thikë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Kur pastrohen barërat e këqinj, është mirë që të shkulen me rrënjë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Kur mblidhen bimë mjekësore ose çaj është mirë që të shkulen dhe bimët e tjera që gjenden përreth tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Është mirë që të mblidhen vetëm kërmij të mëdhenj, duke i lënë të vegjëlit në vendbanimin e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Nuk ka problem nëse në kopësht vendosni helm që të mbroheni prej minjve apo dhe nga grabitqarët e kopshtit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Çerdhet e shpendëve që kanë fluturuar në pranverë duhet të shkatërrohen.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Nëse një kafshë e egër është e sëmurë duhet të largohet nga foleja/strofulla e saj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Është mirë që të jeni të qetë dhe të mos futeni në vendet, rezervatet e kafshëve që përdoren për fole dhe shumim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Nuk duhet të peshkoni në sezonin e shumimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E gabuar 4. E saktë 5. E saktë 6. E gabuar 7. E gabuar 8. E saktë 9. E saktë





## FLETË PUNE Nëse do të isha ...



Nëse do të isha **bimë**, do të isha

sepse



Nëse do të isha **kafshë**, do të isha

sepse



## FLETË PUNE Zgjedhja ime

### E IMJA

(emri i bimës ose kafshës së zgjedhur)

Shënoni me tik (✓) katrorët që janë të saktë në lidhje me bimën ose kafshën e zgjedhur nga ju ndërsa tek katrorët e tjerë shënoni shenjën X.

- |   |   |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> përdoret për ushqim                      | <input type="checkbox"/> është e këndshme                                   |
| <input type="checkbox"/> përdoret për prodhimin e ilaçeve         | <input type="checkbox"/> ruan përbërjen dhe prodhimtarinë e tokës           |
| <input type="checkbox"/> ka ngjyra të bukura                      | <input type="checkbox"/> shpesh është modeli i bukurisë                     |
| <input type="checkbox"/> përdoret për ngrohje                     | <input type="checkbox"/> ndihmon në pjalmimin e bimëve                      |
| <input type="checkbox"/> përdoret për prodhimin e rrobave         | <input type="checkbox"/> ndihmon në qarkullimin e lëndës organike në natyrë |
| <input type="checkbox"/> përdoret për qëllime shkencore/studimore | <input type="checkbox"/> është miku më i mirë i njeriut                     |
| <input type="checkbox"/> shfrytëzohet për ndërtim                 | <input type="checkbox"/> tjetër (plotëso)                                   |
| <input type="checkbox"/> shfrytëzohet për ushqim të kafshëve      |   |

Ja pra pse bima/kafsha ime është e rëndësishme për njerëzit dhe organizmat e tjerë të gjallë.



## FLETË PUNE

## Rëndësia e organizmave të gjallë



**Bimët** janë organizma që nuk lëvizin dhe kanë klorofil, i rëndësishëm për procesin e krijimit të lëndës — fotosintezës. Të gjitha bimët marrin frymë në mënyrë të pavarur, ushqehen, mund të shumohen dhe nuk e ndërrojnë vendin e banimit. Shumica e bimëve kanë rrënjë, trung dhe gjethe. Ekzistojnë shumë lloje të bimëve në Tokë. Ato kanë rol kryesor për jetën në vend, pasi çlirojnë oksigjen dhe prodhojnë ushqim për kafshët dhe njerëzit. Duke shfrytëzuar energjinë e diellit, bimët krijojnë lëndë ushqyese, dhe luajnë rolin e prodhuesit në vendbanimet e tyre. Bimët e mbetura në tokë para miliona vitesh u shndërruan në lëndë djegëse natyrore, që përdoret si burim energjie.



**Kafshët** janë organizma që kanë shqisa të ndryshme, janë të afta për lëvizje të pavarur dhe mund të shumohen. Kafshët, ndryshe nga bimët, janë të ndërtuara nga organe dhe sisteme organesh (sistemi nervor, sistemi i gjakut etj.). Të gjitha kafshët varen nga lëndët ushqyese që krijohen nga bimët, ndërsa energjinë e sigurojnë përmes konsumit të ushqimit. Prandaj, mund të themi që ekzistenca e kafshëve varet nga bimët. Kafshët marrin frymë duke thithur oksigjenin nga mjedisi dhe çliuar dioksidin e karbonit.



**Kërpudhat** janë shpërbërës të trupit të bimëve dhe të kafshëve të ngordhura. Disa kërpudha zhvillohen në rrënjët e drurëve, duke ndihmuar drurin të marrë ujin dhe kripërat minerale nga toka. Ekzistojnë shumë lloje kërpudhash.



**Bakteret** janë organizma të vegjël që nuk shihen me syrin e njeriut. Ata janë shpërbërës të lëndës organike dhe gjenden kudo në natyrë: ajër, ujë, tokë, bimë, kafshë, njerëz, produkte ushqimore etj. Bakteret marrin pjesë në krijimin dhe shkatërrimin e mineraleve dhe në pjellorinë e tokës. Ekzistojnë baktere që përdoren për prodhimin e ushqimit (si kosin, djathin). Disa baktere shkaktajnë sëmundje tek bimët, kafshët dhe njerëzit (p.sh. tuberkulozin, brucelozën). Mendohet se bakteret janë organizmat e parë që janë gjetur në Tokë.

**Kërpudhat dhe bakteret** kanë rëndësi të madhe për biosferën. Ata quhen shpërbërës pasi i zërthejnë lëndët ushqyese organike në lëndë jo organike. Në këtë mënyrë, zinxhiri ushqimor mbyllet dhe bimët i marrin lëndët jo organike për të krijuar sërish lëndë ushqyese. Shpërbërësit kontribuojnë në përmirësimin e pjellorisë së tokës.





## FLETË PUNE

# Ekosistemi dhe zinxhiri ushqimor

Ekosistemi është bashkësia e organizmave të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Ai është një sistem dinamik, në të cilin ushqimi dhe energjia janë në qarkullim të vazhdueshëm ndërmjet organizmave të gjallë dhe natyrës jo të gjallë. Shembuj të ekosistemeve të zakonshme janë pyjet, lumenjtë, liqenet, detet, livadhet, fermat dhe qytetet. Në ekosistem, bimët quhen prodhues meqë prodhojnë lëndë organike nga kripërat minerale, uji, dyoksidi i karbonit dhe energjia diellore, gjatë procesit të fotosintezës. Lëndët ushqimore përmbajnë elementët kryesorë: karbon, fosfor, squfur, azot dhe oksigjen.

Këta elementë merren nga toka, ajri apo uji. Elementë të tjerë si kaliumi, magnezi, kalciumi, hekuri, zinku, etj., qarkullojnë në ciklin e lëndëve ushqyese ndërmjet organizmave të gjallë, tokës, ujit dhe ajrit. Lëndët ushqyese që prodhohen nga bimët, kalojnë tek kafshët që ushqehen me bimë, e më pas tek kafshët e tjera, derisa organizmat ngordhin dhe lëndët zbërthehen sërish në lëndë jo organike.

Organizmat që ushqehen me bimë dhe kafshë të tjera quhen konsumatorë. Duke ngrënë bimët si ushqim, konsumatorët luajnë rol në ciklin e qarkullimit të energjisë dhe lëndëve. Një pjesë e lëndëve ushqyese mbetet tek këto organizma deri në vdekjen e tyre. Zinxhiri ushqimor dhe ai i energjisë tregon ndërvarësinë komplekse midis organizmave bimore dhe shtazorë në ekosistem. Prodhuesit janë në bazën e piramidës ushqimore dhe quhen “niveli i parë”. Në nivelin e dytë janë konsumatorët parësorë — organizmat që ushqehen me bimë. Në nivelin e tretë dhe të katërt të piramidës qëndrojnë konsumatorët grabitqarë më të mëdhenj (ose mishngrënësit), të cilët ushqehen me kafshë të tjera. Shumë shpesh, disa konsumatorë i përkasin më shumë se një niveli ushqimor.

Çdo ndikim në nivelet më të ulta ka pasoja në nivelet më të larta të ekosistemit. Nëse, për shkak të fatkeqësive të mëdha, si zjarre, përmbytje, ngrica, etj., apo për shkak të aktiviteteve të pakontrolluara të njeriut, si prerja e pyjeve, ndotjet kimike, mbetjet toksike, etj., sipërfaqe të mëdha me bimësi shkatërrohen, si rrjedhim zvogëlohet edhe ushqimi i konsumatorëve parësorë. Mungesa e ushqimit do të përcillet tek konsumatorët e mëdhenj, e kështu me radhë. Njerëzit janë të varur nga ndryshimet që ndodhin në zinxhirin ushqimor dhe atë të energjisë në ekosistem.







FLETË PUNE  
**Zinxhiri ushqimor**

A large, hand-drawn style template for a food chain diagram. It features a central yellow background with diagonal hatching. Six white rectangular boxes with black outlines are arranged in a 2x3 grid, intended for drawing organisms and their interactions in a food chain.



## FLETË PUNE Jeta në pyll 1



**Kukuvajka e pyjeve**  
(*Strix aluco*)



**Iriqi**  
(*Erinaceus europaeus*)



**Miu i lajthive**  
(*Eliomis quercinus*)



**Flutura-syblu**  
(*Inachis io*)



**Ahu**  
(*Fagus sylvatica*)



**Vidhi**  
(*Ulmus glabra*)



**Luleshtrydhja e pyllit**  
(*Fragaria vesca*)



### **Kukuvajka e pyjeve** (*Strix aluco*)

Ky shpend me një trup të mesëm ka sy të mëdhenj dhe të zi, si dhe pendë me shumë ngjyra, duke filluar prej ngjyrës së hirit deri te ngjyra e kuqe në kafe. Shumohet kryesisht në zbrazëtirat e drurit nëpër pyje, parqe dhe ferma me drunj. Mund të gjendet në afërsi të parqeve dhe qyteteve nëpër tërë Europën, me përjashtim të Irlandës dhe perëndimit të largët. Jeton në të njejtin vend tërë vitin dhe është aktiv në mbrëmje. Zëri i tij “huu hu” dëgjohet në pranverën e hershme dhe në vjeshtë. Ushqehet me minj dhe insekte, por edhe me zogj, përfshirë edhe bufat e vegjël.



### **Iriqi** (*Erinaceus europaeus*)

Koka dhe trupi i iriqit kanë gjatësi 25 cm, ndërsa bishti është i gjatë 3 cm. Peshon deri 1kg dhe jeton rreth 9 vjet. Trupi i tij është i mbuluar me 6.000 gjemba që janë të gjatë 2-3 cm, me ngjyrë kafe të errët me maja të bardha. Ka qime të verdha në kokë dhe fyt. Turirin e ka të spikatur, ndërsa sytë e vegjël. Iriqat jetojnë në parqe, kopshte, pyje dhe fusha. Gjendet gjithkund nëpër Evropë. Ata ushqehen me krimba, kërmij, merimanga, shumëkëmbësh, insekte, bretkosa, hardhuca dhe fryte. Të vegjlit lindin të verbër, lakuriq dhe pa gjemba. Iriqët dalin në mbrëmje. Kur paraqitet rrezik, ata mbështillen në formë topi dhe nuk lëvizin. Flejnë gjatë dimrit, të fshehur në gjethe ose në ndonjë vrimë.



## FLETË PUNE

## Jeta në pyll 1 (vazhdon)

**Miu i lajthive** (*Eliomis quercinus*)

Koka dhe trupi i miut të lajthive së bashku janë të gjatë rreth 15 cm, ndërsa vetëm bishti 10 cm. Lëkurën e ka me ngjyrë hiri, kafe dhe të kuqe në pjesën e sipërme të trupit, ndërsa të bardhë në pjesën e poshtme, ka maskë të zezë në fytyrë. Jeton në parqe, pemishte, pyje, vreshta, rajonet shkëmbore si dhe në ndërtesa të ngjashme me hambarë. Mund të gjendet në Evropë, Azi dhe në Azi të Vogël, Ushqehet me insekte, merimanga, shumëkëmbësh, kërmij, hardhuca, vezë, pemë dhe me lëvoret e drunjve. Ky është kafshë e natës, ngjitet në mure dhe drunj, dhe është kërcyes i mirë. Bie në gjumë nga tetori deri në prill në vrimat e drunjve ose në ndonjë vend të mbyllur.

**Flutura-syblu** (*Inachis io*)

Gjërësia e krahëve të fluturës-syblu është 6cm. Ka ngjyrë të kuqe në kafe në pjesën e sipërme të krahëve, ndërsa secili prej tyre në fund është zbukuruar me pika të mëdha që bien në sy. Pjesa e brendshme është tërësisht e zezë, ndërsa i shërben si mjet për tu fshehur kur është në gjumë. Në fillim të zhvillimit të saj flutura është vemje. Vemja është e gjatë deri në 45 mm. Ajo është e zezë me pika të vogla të bardha dhe këmbë të verdha dhe ka 11 palë gjemba të dendur. Kjo flutur jeton në vend të hapur, në kopshte, parqe dhe vende të tjera me lule. Gjendet në të gjithë Evropën, përveç veriut të largët. I lëshon vezët në gjethe, të cilat hahen më pas nga vemjet e vogla. Pikat me formë syri në krahët e tyre i frikësojnë dhe largojnë shumicën e grabitqarëve.

**Ahu** (*Fagus sylvatica*)

Ahu është një peme që rritet 30-40 m lartësi dhe ka një kurorë të madhe e të gjerë. Lëvorja është e lëmuar, e hollë dhe me ngjyrë hiri. Gjethet kanë formë ovale, me shkëlqim, me ngjyrë të gjelbër të errët që shndërrohet në ngjyrë kafe në stinën e vjeshtës. Lulet çelin menjëherë pas gjetheve të pranverës. Frytet janë trekëndshe, me ngjyrë kafe të shndritshme. Ahu në përgjithësi rritet në male, duke krijuar pyje të dendur.

**Vidhi** (*Ulmus glabra*)

Ky dru është i lartë prej 10-40 m dhe krijon kurorë të gjerë. Në fillim, lëvorja është e lëmuar, por më vonë bëhet e dendur, vrazhdë dhe me ngjyrë hiri. Gjethet kanë trung të shkurtër dhe në formë të vezës, me maja mprehta të theksuara dhe baza në formë të zemrës. Sipëfaqja e sipërme ka ngjyrë të gjelbër të errët, lëshatake dhe shumë e vrazhdë në prekje. Në fund të shkurtit paraqiten lule të kuqe, ndërsa fryti në formë të flatrave është i dukshëm para se të zgjerohen gjethet. Vidhi gjendet gjithkund në Europë, zakonisht në pyjet në rajone kodrinore dhe rrëzë maleve.

**Luleshtrydhja e pyllit** (*Fragaria vesca*)

Gjethet e luleshtrydhes së pyllit janë me majë të mprehtë dhe të vendosura tre në një bisht. Lulet kanë fletë të bardha dhe çelin nga muaji prill deri në korrik. Pjalmohen me ndihmën e bletëve, mizave, buburrecave dhe fluturave. Fryti duket si luleshtrydhe e vogël, me gjerësi rreth 1 cm dhe piqet nga muaji maj deri në shtator. Luleshtrydhja e pyllit rritet në pyje, barishte dhe shkurre. Më së shpeshti gjendet në rajonet me klimë mesatare si në Euroazi.





## FLETË PUNE Jeta në pyll 2



**Macja e egër evropiane**  
(*Felis sylvestris*)



**Baldosa**  
(*Meles meles*)



**Ketri i kuq**  
(*Sciurus vulgaris*)



**Miu i pyllit**  
(*Apodemus sylvaticus*)



**Dushku anglez**  
(*Quercus robur*)



**Murrizi**  
(*Crataegus monogyna*)



**Luleshtrydhja e pyllit**  
(*Fragaria vesca*)



### **Macja e egër evropiane** (*Felis sylvestris*)

Trupi i macës së egër evropiane është i gjatë 60-70 cm, ndërsa bishti rreth 30 cm. Lëkura e saj është ngjyrë hiri, e verdhë në kafe, me vija më të errëta. Mashkulli në krahasim me femrën, është më i madh dhe me ngjyrë më të errët. Duket si mace shtëpie me shumë ngjyra, bisht të dendur dhe të rumbullakët. Sytë i ka të verdhë në të gjelbër me bebëza vertikale. Macet e vogla kanë lëkurë të hollë, verdhoshe me njolla të errëta. Këto mace jetojnë në shumë vende, por kryesisht në pyje dhe shkurre nëpër Evropë. Macet e vogla prej dy deri në gjashtë javëshe, zakonisht të lindura në maj, e fillojnë jetën e tyre në strofollat e vendosura më shpesh në vrimat e drurëve, por ndonjëherë dhe në vrimat e braktisura të dhelprave dhe vjedullave. Hanë minj, zogj dhe gjitare të vegjël.



### **Baldosa** (*Meles meles*)

Baldosa është e gjatë deri në 90 cm, përfshirë edhe bishtin. Peshon 10-20 kg dhe mund të jetojë deri në 20 vjet. Baldosa ka këmbë të shkurtra, turi të gjatë dhe të shtypur, veshë të shkurtër dhe sy të vegjël. Pjesa e sipërme e trupit është me ngjyrë hiri, ndërsa pjesët anësore janë me ngjyrë kafe. Në kokë ka vija të zeza dhe të bardha, ekstremitete të zeza dhe thonj të gjatë e të mprehtë. Baldosa jeton në pyjet e përziera dhe në sipëfaqet me bar nëpër pyje.

Baldosat ushqehen me krimba, kërmij dhe me brejtës. Ato bien në gjumë në strofoll prej tetorit deri në shkurt. Jetojnë në çifte ose në grupe familjare të zgjeruara, nganjëherë në tunele që i gërmojnë vetë dhe banojnë aty me shekuj. Këto tunele përbëhen prej korridoreve të gjata deri në 40 metra dhe me "dhoma" të ndryshme.



## FLETË PUNE

## Jeta në pyll 2 (vazhdon)

**Ketri i kuq** (*Sciurus vulgaris*)

Koka së bashku me trupin e ketrit të kuq arrijnë një gjatësi prej 21-25 cm, ndërsa bishti i tij është i gjatë 15-20 cm. Jeton 10 deri në 12 vite. Lëkura e tij shpesh ka ngjyrë kafe ose të kuqe, por mund të ketë dhe ngjyrë të zezë në kafe. Pjesa e poshtme e trupit është e bardhë, ndërsa në fund të veshëve ka pupla nga qimet e gjata. Ketri i kuq jeton në pyje e parqe, dhe mund të gjendet në Evropë, Siberi, dhe Kore. Ai ushqehet me bimë dhe sytha gjethesh, fara drurësh, kërpudha, insekte, etj. Është aktiv tërë vitin, e ndërton strofullën lart në pemë me gjethe, myshk dhe degë të vogla druri. Kryesisht gjendet nëpër pemë, duke kërcyer nga një degë peme në tjetrën, ndërsa rallë gjendet në tokë për shkak të ushqimit.

**Miu i pyllit** (*Apodemus sylvaticus*)

Trupi i tij është i gjatë 7,5-11 cm, i mbuluar me lëkurë të verdhë në kafe dhe ka bark me ngjyrë hiri të çelur. Sytë dhe veshët e tij janë të mëdhenj, ndërsa bishti i tij ka gjatësi përafërsisht sa trupi i tij. Pjesën e poshtme e ka të bardhë e të mbuluar me qime të pakta. Miu i pyllit jeton në fusha, pyje, gardhe dhe në vende që nuk janë shumë të lagështa. Ndonjëherë, gjatë dimrit, vendoset në ndërtesa që i ka ndërtuar njeriu. Gjendet gjithkund nëpër Europë. Jeton në gropa që i ka gërmuar vetë nën dhe, me tunele të gjata e pjesë të veçanta për çerdhe dhe ushqim. Vrapon shumë shpejtë dhe ushqehet me fruta, fara, larva, kërpudha, etj.

**Dushku anglez** (*Quercus robur*)

Ky dru i madh rritet deri në 35 metra lartësi. Lëvorja në fillim është e lëmuar dhe me ngjyrë të kuqe në kafe, por më vonë shndërrohet në ngjyrë më të errët të hirtë dhe me të çara të forta. Frytet e dushkut ndryshe njihen me emrin lende, janë të mbeshjtjellë me një lëvozhgë në formë gote me bisht me gjatësi 5-12 cm. Dushku anglez është i rëndësishëm në të gjithë Evropën, përveç pjesës së largët të veriut. Disa kafshë, siç janë grifshat dhe ketrat, groposin lende si rezervë për dimër, prandaj ndonjëherë mund të vërehen drurësh të vegjël.

**Murrizi** (*Crataegus monogyna*)

Murrizi rritet si kaçube e dendur me gjemba, por mund të jetë dhe një dru i vogël me lartësi prej 12 metrash. Lëvorja e tij është me ngjyrë kafe të çelët dhe me ngjyrë qumështi. Gjethet janë të ndryshme, por kryesisht kanë tre ose katër çifte të rezhdave. Lulet e bardha paraqiten rreth fundit të majit dhe fillimit të qershorit dhe mbeten në ngjyrë rozë, siç çelin. Fryti është i vogël, në formën e mollës, me ngjyrë të kuqe të errët dhe piqet në shtator. Murrizi mund të gjendet kudo nëpër Evropë.

**Luleshtrydhja e pyllit** (*Fragaria vesca*)

Gjethet e luleshtrydhes së pyllit janë me majë të mprehtë dhe të vendosura tre në një bisht. Lulet kanë fletë të bardha dhe çelin nga muaji prill deri në korrik. Pjalmohen me ndihmën e bletëve, mizave, buburcave dhe fluturave. Fryti duket si luleshtrydhe e vogël, me gjerësi rreth 1 cm dhe piqet nga muaji maj deri në shtator. Luleshtrydhja e pyllit rritet në pyje, barishte dhe shkurre. Më së shpeshti gjendet në rajonet me klimë mesatare si në Euroazi.





## FLETË PUNE Jeta në livadhe 1



**Thithëlopa**  
(*Bufo bufo*)



**Qyqja**  
(*Cuculus canorus*)



**Bulkthi**  
(*Gryllus campestris*)



**Brumbulli**  
(*Bombus terrestris*)



**Tërfile i livadhit**  
(*Trifolium pretense*)



**Dredhja e arave**  
(*Convolvulus arvensis*)



**Murrizi**  
(*Crataegus monogyna*)



### **Thithëlopa** (*Bufo bufo*)

Arrin një gjatësi deri në 15 cm. Thithëlopa femër është më e madhe se mashkulli. Lëkura e saj është e vrazhdë, me ngjyrë hiri në kafe, e verdhë ose ngjyrë të kuqërremtë me lara të pakta ose pothuajse pa to. Thithëlopa jeton nëpër vendbanime me ujë dhe kohën më të madhe e kalon në ujë. Ajo jeton në Evropë, përveç Irlandës dhe Veriut të largët. Ky amfib i natës ushqehet më shumë me gjallesa të vogla.



### **Qyqja** (*Cuculus canorus*)

Qyqja është shpend me shtat të mesëm, me bisht të gjatë e të rumbullakët dhe krahë të theksuar. Mashkulli, pjesën e sipërme të gjoksit e ka ngjyrë hiri, ndërsa pjesën e poshtme me vija horizontale të bardha. Femra pjesën e sipërme mund ta ketë ngjyrë hiri ose kafe, me dy vija vertikale në stomak, gjoks dhe fyt. I përngjan skifterit. Qyqja përshtatet shumë lehtë në vendbanime të ndryshme, duke përfshirë të gjitha llojet e pyjeve dhe peizazhet bujqësore, malet dhe brigjet. Gjendet nëpër Evropë. Më shpesh ushqehet me insekte.



## FLETË PUNE

## Jeta në livadhe 1 (vazhdon)

**Bulkthi** (*Gryllus campestris*)

E gjatë deri në 3 cm, bulkthi kryesisht është e zezë, përpos në fillimin e krahëve, që ka ngjyrë kafeje dhe me bazë të verdhë. Në kokën e saj të madhe ka një antenë të bukur. Gjendet në Evropë, Azi të vogël dhe në Amerikën veriore dhe rajonet e thata me diell, siç janë livadhet, kopshtet dhe rrethojat në afërsi të rrugëve të fshatrave. E paaftë që të fluturojë, mashkulli e mbron territorin e tij me cicërimë nga maji deri në shtator, duke i fërkuar këmbët e pasme. Fshihet në vrima që i gërmon në tokë. Më shpesh ushqehet me bimë që përmbajnë shumë ujë.

**Brumbulli** (*Bombus terrestris*)

Brumbulli është i gjatë rreth 2 cm dhe ka një distancë mes krahëve deri në 43 mm. Në këmbët e pasme ka kosheren për grumbullimin e polenit. Aty brumbulli krijon një masë të madhe të polenit, pak të lagur me nektar. Më pas, kjo masë dërgohet në fole. Ky është një prej llojeve më të përhapura në Evropë, ndërsa jeton në çfarëdo lloj vendbanimi. Folenë e bën në tokë, ndonjëherë në vrimën e miut ose të urithit. Secila bashkësi e brumbujve ka një mëmë – femër të vetme që lëshon vezë, dhe një numër brumbuj femra që janë punëtorët. Kryesisht, në një familje brumbujsh ka minimumi 100 brumbuj, ndërsa bashkësitë më të mëdha mund të përmbajnë më shumë se 600 brumbuj.

**Tërfilli i livadhit** (*Trifolium pratense*)

Gjethet e tërfillit të livadhit janë të përbëra nga tre gjethëza me një shenjë të zbehtë në formën e “V” në qendër të secilës gjethëze. Trungjet e tyre degëzohen dhe janë të gjatë deri në 50 cm. Lulet me ngjyrë rozë janë grupuar në krye të kurorave. Tërfilli i livadhit rritet në hapësira të hapura, veçanërisht në livadhe dhe kullota me ujë.

**Dredhja e arave** (*Convolvulus arvensis*)

Dredhja e arave zvarritet dhe ngjitet në lartësi duke u zgjeruar, ndërsa trungjet e saj rriten deri në 200 cm gjerësi, duke u rritur në drejtimin kundërorar. Gjethet kanë formën e majës së shigjetës, ndërsa lulet e tyre janë në formën e hinkës me njyra të bardha dhe rozë. Dredhja e arave rritet në shkretëtira, në barëra dhe zona të punuara. Shpesh ngjitet pas trupit të drithrave që rriten në fushë.

**Murrizi** (*Crataegus monogyna*)

Murrizi rritet si kaçube e dendur me gjemba, por mund të jetë dhe një dru i vogël me lartësi prej 12 metrash. Lëvorja e tij është me ngjyrë kafe të çelët dhe me ngjyrë qumështi. Gjethet janë të ndryshme, por kryesisht kanë tre ose katër çifte të rezhdave. Lulet e bardha paraqiten rreth fundit të majit dhe fillimit të qershorit dhe mbeten në ngjyrë rozë, siç çelin. Fryti është i vogël, në formën e mollës, me ngjyrë të kuqe të errët dhe piqet në shtator. Murrizi mund të gjendet kudo nëpër Evropë.





FLETË PUNE

Jeta në livadhe 2



**Huta**  
(*Buteo buteo*)



**Nuselala**  
(*Mustela nivalis*)



**Miu i arave**  
(*Clethrionomys glareolus*)



**Kërmilli i vreshtës**  
(*Helix pomatia*)



**Flokësa njëvjeçare**  
(*Poa annua*)



**Luleshurdha**  
(*Taraxacum officinalis*)



**Gjethi madhor**  
(*Plantago major*)



**Huta** (*Buteo buteo*)

Rritet deri në 50 cm gjerësi, me distancë të krahëve deri në 125 cm. Ka krahë të gjerë, qafë të shkurtër dhe bisht me një madhësi mesatare në fluturim. Ngjyra ndryshon, nga kafe e errët në të kuqe si kafe, deri në të bardhë me njolla. Shpesh ka një ngjyrë të zbehtë në gjoks. Shumohet në pyje në lartësi nga niveli i detit, ndërsa folenë e ka në pemë. Mund të shihet në rrethinat ose në shtyllat e korrentit, ku ka ndaluar për të vëzhguar prentë e saj. Ajo haset më tepër në pranverë. Ushqehet me minj, por dhe me zogj, gjarpërinj, hardhuca, bretkosa, ndërsa ndonjëherë me insekte dhe krimba të ujërave.



**Nuselala** (*Mustela nivalis*)

Me gjatësi trupi rreth 11-26 cm dhe bisht 4-9 cm të gjatë, nuselala është mishngrënësi më i vogël në Evropë. Ka një trup të gjatë e të hollë, këmbë të shkurtra dhe bisht të shkurtër. Ka ngjyrë kafe, ndërsa stomakun me ngjyrë të bardhë. Në Evropën Perëndimore, nuselala është në ngjyrë të bardhë gjatë dimrit. Rritet në vendbanime të ndryshme nëpër Evropë, Azi dhe Amerikën Veriore, siç janë pyjet, fushat dhe kopshtet. Shfaqet dhe në vende në afërsi të drejtëpërdrejt me njerëzit. Kjo kafshë është aktive gjatë natës. Shpesh ushqehet me brejtës të vegjël, siç janë minjtë, por, gjithashtu gjuan dhe shpendët e insektet.





## FLETË PUNE

## Jeta në livadhe 2 (vazhdon)

**Miu i arave** (*Clethrionomys glareolus*)

Koka dhe trupi i këtij lloj miu arrijnë një gjatësi deri në 12 cm, ndërsa bishti deri në 7 cm. Pjesa e sipërme është më ngjyrë kafe në të kuqe, ndërsa pjesa e poshtme me ngjyrë hiri. Të vegjlit kanë ngjyrë kafe më të çelët gati në të kuqe. Jeton në pyje, rrethina dhe shkurre, si dhe në kopshtet e fshatrave.

Gjendet pothuajse në të gjitha vendet nëpër Evropë. Është aktiv edhe ditën edhe natën, ushqehet me fara, fryte, gjethe, myshk, kërpudha dhe kafshë të tjera të vogla. Zakonisht, pjell tre deri shtatë të vegjël në çdo sezon.

**Kërmilli i vreshtës** (*Helix pomatia*)

Shtëpiza e kërmillit të vreshtës ka diametër 6-7 cm, formë të rrumbullakët me ngjyrë kafe të çelur, ngjyrë hiri ose të verdhë, dhe vija që janë të renditura përgjatë gjerësisë. Ka katër antenna (dy çifte), me sytë në antenat e poshtme. Shpërngulet në vendbanime të ndryshme, siç janë gardhet e

gjelbra, kopshtet, parqet, zonat me bar dhe pyjet. Gjendet kudo nëpër Evropë. Kërmijtë jetojnë deri në tre vjet. Gjatë dimrit, kërmijtë i mbyllin vrimat e guaskave të tyre. Po ashtu, reagojnë edhe në periudhat e gjata të thatësirës që të kursejnë ujë. Më aktive janë në kushte të lagështa, veçanërisht në mëngjes për shkak të vesës së mëngjesit. Ushqehen me bimë barishtore.

**Flokësa njëvjeçare** (*Poa annua*)

Flokësa një vjeçare rritet deri në 30 cm lartësi dhe ka gjethe të gjelbra të ndritshme, që dalin prej fidanëve rrafshorë. Kalaveshët e luleve kanë disa degë. Lulet pjalmohen përmes erës ose dhe vetë, madje edhe pa u hapur lulja. Flokësa një vjeçare ka një sistem rrënjor të dobët. Rritet mirë në fusha me ujë dhe me shumë diell. Mund të rritet mirë dhe në kushte me gjysëm hije. Në rajonet bregdetare ose në fushat me temperaturë mesatare, ku barërat ujiten rregullisht, flokësa një vjeçare mund të mbijetojë gjatë gjithë vitit. Në fushat më të ngrohta gjatë verës thahet. Gjendet në toka të punuara, në vende me bar dhe në kopshte.

**Luleshurdha** (*Taraxacum officinalis*)

Luleshurdha ka disa gjethe të vendosura në mënyrë qerthullore. Trungu ku gjendet lulja është i zbrazët dhe i gjatë 50 cm. Ka lule të verdha, ndërsa fara e saj ka strukturë në formë çadre, që shërben si parashutë kur fryn era. Kur gjethet ose kërcelli thyhen, rrjedh një lëng si qumësht. Rritet në vende të

ndryshme të braktisura, kryesisht nëpër livadhe, përgjatë rrugëve dhe në kopshte, në të gjithë Evropën.

**Gjethi madhor** (*Plantago major*)

Është bimë e qëndrueshme, me gjethe të gjera. Lulet e vogla të errëta grupohen në lulesa. Kërcelli ku gjendet lulja është i gjatë deri në 50 cm. Lulja më poshtë në kërcell hapet e para dhe rrathët e thekëve ngjyrë vjollcë ngjiten gradualisht drejt kurorës së lules. Rritet në hapësirë të hapur dhe shpesh shihet në rrugët e trotuareve. Është e zakonshme në të gjithë Evropën.





## FLETË PUNE Jeta në lumë



**Lundërza**  
(*Lutra lutra*)



**Bretkosa e gjelbër**  
(*Rana ridibunda*)



**Krapi**  
(*Carassius carassius*)



**Stema**  
(*Palomena prasina*)



**Kallami**  
(*Phragmites australis*)



**Thjerrza e ujit**  
(*Lemna minor*)



**Maraska**  
(*Utricularia vulgaris*)



### **Lundërza** (*Lutra lutra*)

Trupi i lundërzës është i gjatë 70-80 cm, ndërsa bishtin e ka të gjatë 40 cm. Mashkulli është më i madh dhe më i rëndë në krahasim me femrën. Kokën e ka të rrafshët, ndërsa veshët e rumbullakët dhe të vegjël. Lëkurën të shndritshme dhe ngjyrë kafe. Te shputat e këmbëve ka lëkurëza dhe kthetra për notim. Lundërza jeton në të gjitha fushat që kanë rrjedhje ujore, e ndonjëherë edhe në rajonet bregdetare. Gjendet në të gjithë Evropën, Amerikën Veriore dhe Euroazi. Është aktive në agim dhe gjatë natës. Ato notojnë shumë mirë dhe zhyten, duke i mbyllur veshët dhe vrimat e hundës kur zhyten. Lëkura e tyre është e qëndrueshme ndaj ujit, nën lëkurë kanë një shtresë që përmban ajër e cila i mban ngrohtë. Strofulla e tyre gjendet në tunele nën tokë, rrënjët e drurit, shkëmbinjët, trungjet, shkurret dhe brigjet, ndërsa zakonisht futet nën sipërfaqen ujore. Lundërza ushqehet më shumë me peshq, por dhe me shpendë ujorë, bretkosa, gafore dhe kërmij.



### **Bretkosa e gjelbër** (*Rana ridibunda*)

Bretkosa e gjelbër është bretkosa më e madhe në Evropë dhe rritet deri në 15 cm. Trupi i saj mund të jetë me shumë ngjyra. Shpina e saj është e zezë, ndonjëherë me njolla të errëta. Mashkulli ka filluska të mëdha të zëshme në anët e gojës, të cilat kur fryhen, marrin ngjyrë hiri. Bretkosa e gjelbër jeton në moçale të ndryshme në Evropën Qendrore, Azinë e Vogël, dhe në disa pjesë të Afrikës Veriore. Kur gjuajnë, ato kalojnë shumë kohë afër brigjeve, lumenjve dhe kënetave. Periudhën e riprodhimit e kanë gjatë prillit dhe majit, gjatë kësaj periudhe meshkujt lëshojnë tinguj gjatë gjithë natës. Femrat lëshojnë rreth 700 dhe 13.000 vezë që ngjiten në bimët e ujit. Ato më shpesh ushqehen me insekte, por dhe me bretkosa e peshq të tjerë, ndonjëherë dhe me brejtës të vegjël. Gjahun e kapin me gjuhën e tyre elastike. Flenë nën ujë.



## FLETË PUNE

## Jeta në lumë (vazhdon)

**Krapi** (*Carassius carassius*)

Krapi mund të rritet deri në 51 cm gjatësi. Penda e kurrizit është e gjatë, e fortë dhe e dhëmbëzuar. Ngjyrat e kurrizit variojnë nga ngjyrë ulliri në të gjelbër, të kuqe në kafe, derisa në afërsi të bishtit marrin ngjyrën e mjaltit, me njolla të errëta në formë rrethi. Gjymtyrët e tjera janë me ngjyrë të kuqe të hapur në të bronztë. Ky lloj krapi gjendet në të gjithë Evropën në ujërat e qeta dhe në lumenjtë që rrjedhin shumë ngadalë në ultësira. Ai përballon mirë kushtet me sasi të vogël të oksigjeni dhe jeton në kënetat me derdhje të herëpashershme të ujërave të freskëta dhe në moçale. Ushqehet me vertebrorë të vegjël dhe bimë ujore.

**Stema** (*Palomena prasina*)

Stema është një insekt me mburojë të gjelbër, trup të rrafshët në formën e mburojës dhe është e gjatë rreth 10-15 mm. Në pranverë dhe në verë ka ngjyrë të gjelbër të çelët, por në vjeshtë, përpara stinës së dimrit, merr ngjyrën e bronzit të errët në të gjelbër. Stema jeton në pyje, shkurre dhe në afërsi të zonave ujore. Gjendet në pjesën më të madhe të Evropës. Metamorfoza e këtij lloji kalon nëpër pesë faza, gjatë të cilave ajo e humbet mburojën e saj. Në secila fazë stema merr ngjyra të ndryshme, ndërsa krahët e shkurtër paraqiten në fazën e fundit. Ky insekt ka pjesë të veçanta në gojë për të thithur, të cilat i përdor për të thithur lëngun bimor nga një grup i gjerë drurësh, shkurrësh dhe bimësh të larta. Në Evropë ajo paraqitet si dëmtues i vogël, që më së shumti dëmton fasulen.

**Kallami** (*Phragmites australis*)

Kallami bimor i ujit rritet deri në 6 metra lartësi. Fidanët horizontal janë të fortë, të dellëzuar dhe rriten në sipërfaqen e tokës ose nën të, duke mundësuar rritjen e rrënjëve të trungut të fortë për së gjeri. Në trung mbahen gjethet e gjera, që arrijnë një gjatësi prej 20-40 cm. Ka kurorë të madhe me ngjyrë vjollcë; ndërsa në fund të pranverës merr ngjyrën e hirit. Kallami rritet nëpër vendbanime tokësore të lagështa, siç janë brigjet e lumenjve, të kënetave, të moçaleve dhe të liqeneve. Shpesh haset në toka të ndotura përgjatë rrugëve, kanale dhe pellgje me ujë.

**Thjerrza e ujit** (*Lemna minor*)

Thjerrza e ujit është ndër bimët më të vogla të lulëzuara në botë. Bimët e veçanta të thjerrzave të ujit janë të holla, të rrumbullakta, me pllaka të gjelbra të ndritshme dhe secila me një rrënjë. Ajo gjendet në kanale midis bimëve të tjera të mugulluara ose mblidhet në një grumbull që lundron në sipërfaqen e ujit. Nuk ka gjethet të vërteta. Trupi në formën e gjethes quhet tallus. Ka një formë rrethore, pothuajse ovale, me diametër 2-5 mm. Gjethet janë të holla dhe shikohen me vështirësi. Lundron lirshëm në kënetat me ujë të freskët, moçalet, liqenet dhe rrjedhat e qeta. Përhapet shpejt nëpër shtretërit e ujërave që janë të pasur me lëndë ushqyese.

**Maraska** (*Utricularia vulgaris*)

Maraska është bimë nënujore mishngrënëse, e cila noton lirshëm në det. Gjethet e saj janë të buta dhe të ndara bukur nën ujë, ndërsa lulet e saj janë me ngjyrë të verdhë të hapur. Shfrytëzon kurthe të vogla për kapjen e gjallesave të vogla, madje edhe peshq të vegjël të cilët afrohen deri te kurthi. Shfrytëzon lëngjet për ngordhjen e gjahut, dhe siguron lëndën ushqyese për të cilën ka nevojë. Duke notuar lirshëm në ujërat e cekëta të liqeneve, moçaleve, kënetave dhe lumenjve në anën veriore të Tokës, maraska jeton në vende ku ka shumë mikroorganizma.





## FLETË PUNE

# Të dhënat për shpërnguljen



Kafshët shpërngulen periodikisht për shkak të shumimit, gjetjes së ushqimit, ndryshimit të stinëve të vitit, ndryshimit të gjatësisë së ditës dhe natës, si dhe për arsye të tjera.



Shumë shpendë, siç janë: lejkët, dallëndyshet, patat dhe rosat e egra, vijnë nga veriu që ta kalojnë dimrin në vende më të ngrohta, të cilat ndodhen në jug.



Vetëm disa lloje shpendësh mund të fluturojnë përtej hapësirave të mëdha ujore pa pushuar siç janë oqeanet.



Shpërngulja e kafshëve mund të bëhet në distanca të vogla. Harabeli polar shpërngulet në vjeshtë nga fushat në qytete; disa zogj kur koha ftohet, zbresin nga vendet më të larta malore në zona më të ulëta fushore.



Shpërngulja e kafshëve mund të zgjasë për periudha të shkurta kohore, por ka dhe shpërngulje që zgjasin me vite. Për shembull ngjala europiane shkon në Detin e Sargasit për t'u shumëuar, duke udhëtuar rreth 10.000 km.



## FLETË PUNE

## Çfarë dimë për...

**Rrëqebulli i Ballkanit** (*Lynx lynx balcanicus*)

**Përshkrimi:** Rrëqebulli i Ballkanit është kafshë gjitare e familjes së maceve me madhësi të mesme, në gjatësi 80-130 centimetra. Ai ka këmbë të fuqishme dhe putra të mbështjella, të cilat veprojnë si rrëshqitëse. Gjithashtu, ka bisht të shkurtër, tufa qimesh të zeza në majë të veshëve dhe në pjesën e poshtme të barkut qime me ngjyrë të bardhë.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Rrëqebulli i Ballkanit është një nënloj i rrëqebullit euroaziatik, i cili është më i rrezikuari nga gjithë popullatat e *Lynx lynx* në botë. Ai është i përhapur në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë dhe potencialisht në Malin e Zi. Mali i Munellës është streha kryesore e rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri, ku numërohen të paktën 4 individë të ndryshëm, ndërsa në të gjithë vendin gjenden jo më pak se 10 individë.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Rrëqebulli është një kafshë misterioze dhe e turpshme. Preja kryesore e rrëqebullit është kaprolli, dhia e egër, lepujt dhe disa shpendë. Rrëqebulli është kryesisht aktiv gjatë natës, ndërsa ditën e kalon duke pushuar në zagvra drurësh ose vende të tjera të fshehta. Rrëqebulli i rritur jeton në vetmi dhe nuk ka armiqt natyrorë.

**Kjo kafshë mbresëlënëse është viktimë e veprimtarisë së njeriut. Rreziqet më kryesore janë gjuetia e paligjshme dhe shkatërrimi i habitatit të tij nga njeriu.**

**Kukuvajka** (*Athene noctua*)

**Përshkrimi:** Ky buf i vogël afërsisht me një gjatësi prej 25 cm, ka një kokë të madhe, të gjërë dhe të rumbullakët, këmbë të gjata dhe bisht të vogël. Ka ngjyrë kafe me njolla të bardha. Ai është i bardhë nën pendët e larme në të kafta dhe ka sy të verdhë.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Bufi i vogël më tepër rritet në hapësirë të hapur, të përzier me fusha, pyje, dërrasa, kopshte, parqe, shkëmbinj dhe gjysëmshkretëtira. Haset kudo nëpër Evropë, përveç Irlandës dhe Veriut të Largët.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Bufi i vogël pjesërisht është gjallesë ditore, i cili shpesh mund të shihet nëpër degë. Ushqehet me minj, krimba, insekte, shpendë, amfibë dhe zvaranikë. Bën folenë në vrimat e drurëve, të ndërtesave ose të shkëmbinjve. Është më i njohur për zërin e tij të ashpër “kii-ivv”.

**Ky zog mbresëlënës shpesh përmendet në mite, tregime fantastike dhe besime popullore.**

**Pupëza** (*Upupa epops*)

**Përshkrimi:** E gjatë rreth 27 cm, pupëza është një nga zogjtë më karakteristike të Evropës. Koka, qafa dhe kafazi i krahërorit kanë ngjyrë roze që bie në sy, krahët bardhë e zi, kurrizi dhe bishti janë me vija. Sqepi i tij i gjatë dhe i ngushtë është pak i lakuar nga poshtë. Ka pendë të drejta në majë të kokës, prandaj duket si një udhëheqës i indianëve.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Zog shtegtar i cili jeton nëpër livadhe të hapura të rrethuara dhe nëpër shkurre. Gjendet nëpër Evropë, përveç Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Evropës Veriore.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Kënga e pupëzës është e ngjirur “uupp-uup-uup”, e cila përsëritet disa herë. Bën folenë në vrimat e drurëve ose të mureve. Nëse të vegjëlit janë të shqetësuar, ata lëshojnë një lëng me aromë të pakëndshme. Ushqehet kryesisht me insekte.

**Ky zog mbresëlënës dallohet lehtë në bazë të pamjes së tij të jashtme dhe të këngës.**





## FLETË PUNE

### Çfarë dimë për... (vazhdon)



#### Breshkën e kënetës (*Emys orbicularis*)

**Përshkrimi:** E gjatë 36 cm, breshka e kënetës mund të jetojë deri në 70 vjet. Guaska e saj është pothuajse e rrafshtë, ngjyrë kafe në të zezë madje edhe e gjelbër dhe ngjyrë hiri me vija ose pika ngjyrë të hapur. Këmbët, qafa, koka dhe bishti janë ngjyrë hiri me njolla të verdha.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Banon në të gjitha zonat me ujëra të ëmbla dhe gjysëm të njelmëta të kënetave madje edhe të moçaleve të vogla dhe gjendet në Europë dhe në Azinë Lindore.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Breshka e kënetës ushqehet me bretkoca, peshq, gjallesa uji dhe kafshë të ngordhura.

**Breshka e kënetës varet shumë nga menaxhimi i kënetave.**  
**Tharrja e kënetave, në fakt është dënim me vdekje për to.**



#### Bretkoca e drurit evropiane (*Hyla arborea*)

**Përshkrimi:** E gjatë deri në 5 cm, me lara majë gishtërinjve, bretkoca e drurit evropiane ka ngjyrë të ndryshme, varësisht nga mjedisi ku jeton, temperatura dhe lagështia. Mund të jetë ngjyrë hiri në kafe ose e gjelbër e hapur.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Banon nëpër drurët gjetherënës e shkurre dhe mund ta hasim në Evropën Qendrore e Jugore.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Kjo bretkocë ngjitet shumë mirë në pemë. Dimrin e kalon nën shkëmbinj, drurë ose në gjelbërim. Gjatë sezonit të shumimit, mashkulli bën thirrje me tingujt, të cilët i lëshon nga fyti dhe mund të dëgjohen në një largësi prej 1 km. Është aktive kryesisht natën, por edhe gjatë ditës. Ushqehet me gjallesa të vogla.

**Kjo shtazë mbresëlënëse njihet me lehtësi. Shumimi varet nga mbijetesa e pellgjeve ujore.**



#### Bleta (*Apis mellifera*)

**Përshkrimi:** Bleta i përshtatet më së miri mënyrës së vet të jetesës. Bletët punëtore dhe ato jo punëtore rriten deri në 15 mm gjatësi, ndërsa mëma e kosheres arrin deri në 20 mm. Barkun e ka kryesisht të kaftë me vija të errëta dhe të hapura. Të gjithë trupin e ka të mbuluar me qime të buta, ndërsa në këmbët e prapme ka një thithëse të veçantë për të mbledhur polenin.

**Vendbanimi dhe hapësira:** Popullata e egër e bletëve jeton në rajone shkëmbore dhe malore, por njerëzit shpesh mbajnë bletë me qëllim që të prodhojnë mjaltin. Ato gjenden në Europë, Afrikë dhe Azi.

**Shprehitë dhe të ushqyerit:** Kolonitë e bletëve kanë shumë bletë punëtore, disa jo punëtore dhe një bletë mëmë. Ato kanë një sistem komunikimi dhe shoqëri shumë të zhvilluar. Bletët e mjaltit mbledhin polen dhe prodhojnë mjaltë, i cili shërben si ushqim gjatë stinës së dimrit. Mjalti dhe larvat ruhen në hoje të bëra nga dylli. Bletët shfrytëzojnë systemin e sinjaleve për të këmbyer informacion për fushat e luleve. Në dimër, ato rrahin krahët me qëllim që të ruajnë temperaturën konstante në koshere. Në situatat kur duhet të mbrohen, kafshojnë me thumbin e tyre dhe pastaj vdesin.

**Disa shkencëtarë mendojnë se telefonat celularë i hutojnë bletët dhe i zvogëlojnë popullatat e tyre.**



## FLETË PUNE

# Shëtitja në plazh



Diku përgjatë bregut të detit, në perëndim të diellit, po shëtiste një plak. Sa u qetësua stuhia dhe plaku kënaqej duke thithur ajrin e pastër plot jod. Ishte zhytur në mendime kur pa një fëmijë. Fëmija merrte diçka nga rëra dhe e hidhte në ujë. Plaku ishte kureshtar dhe shkoi që të shohë nga afër. Fëmija mori një yll deti nga rëra dhe e hodhi sërish në det, mes valëve që ledhatonin bregun. Më në fund, plaku vërejti se bregu i detit ishte mbushur me qindra, ndoshta mijëra, yje deti. Stuhia i kishte nxjerrë ata aty.

- Çfarë bën!? - i tha plaku. - Ti je një fëmijë i vetëm, ndërsa këtu ka mijëra yje deti.
- Vërtet mendon se mund të ndryshosh diçka?

Djaloshi e shikoi, mori një yll deti nga rëra, e hodhi në det dhe tha:  
- Ja, për këtë yll deti, unë sa ndryshova gjithçka!

### Detyrë për të menduar në shtëpi:

Çfarë mund të bëjmë unë dhe familja ime që të ndihmojmë për mbrojtjen e bimëve, në rajonin tonë, në vendin tonë (propozoni ide dhe nëse është e mundur bisedoni për to me familjen tuaj):

#### 1 Në afërsi të shtëpisë sime ka:

Ne do të kishim mundur:

#### 2 Në rajonin tonë mund të gjejmë:

Ne do të kishim mundur:

#### 3 Vendi ynë është krenar për bimët dhe kafshët që jetojnë këtu, si:

Që t'i mbrojmë këto bimë dhe i kafshëve ne duhet që:





## FLETA E PUNËS



Ngjyros dhe gjej një titull për vizatimin.







## Burimet natyrore

Kur flasim për **burimet natyrore**, kuptojmë ato elementë të cilët mund t'i marrim nga mjedisi dhe t'i përdorim me qëllim përmirësimin e jetës sonë. Disa nga këto burime natyrore gjenden direkt në natyrë, si energjia diellore, ajri, uji i liqeneve dhe i lumenjve, bimët dhe kafshët. Disa burime të tjera, si ujërat nëntokësore, lëndët djegëse (nafta, qymyrguri) dhe mineralet, mund të gjenden vetëm pas gërmimit dhe përpunimit të tyre.

Burimet natyrore mund të jenë **të ripërtëritshme** dhe **të paripërtëritshme**. Burimet e ripërtëritshme natyrore mund të gjenerohen përsëri me kalimin e kohës. Ne mund ta shfrytëzojmë sot fuqinë e erës për të krijuar energji, dhe të nesërmen do të kemi përsëri erë.

Burimet natyrore të paripërtëritshme do të humbasin pasi ne t'i kemi shfrytëzuar ato. Në tokë ka rezerva të mëdha naftë, por ato do të harxhohen pasi ne t'i kemi përdorur të gjitha rezervat e naftës. Njerëzit kërkojnë vazhdimisht rezerva të reja të burimeve natyrore, por edhe ato një ditë do të shterojnë. Ruajtja e burimeve natyrore duke shfrytëzuar më pak, duke ripërdorur ato që ne kemi dhe duke ricikluar materialet për t'i përdorur përsëri, mund të ngadalësojë procesin e shterimit të burimeve.



Nëse ajri, uji, toka dhe llojshmëria e botës së gjallë shfrytëzohen në mënyrë të paarsyeshme, këto burime të ripërtëritshme natyrore nuk do të mund të ripërtërihen më. Për këtë arsye, sot po mendohet për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ka të bëjë me sasinë maksimale të një burimi natyror, i cili mund të përdoret për qëllimet tona pa kërcënuar rigjenerimin e tij natyror. Përdorimi i madh i burimeve natyrore sjell shkatërrimin e të mjedisit.



Planifikimi ditor i temës Burimet natyrore

Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	I-II
Tema mësimore	Pasuritë natyrore
Kohëzgjatja	2-3 orë mësimore
Rezultatet e të nxënët	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• rendit pasuritë natyrore të ndryshme që njerëzit shfrytëzojnë në jetën e përditshme;</li> <li>• klasifikon pasuritë natyrore të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme;</li> <li>• shpreh qëndrimin e tij/saj se si të shfrytëzojë si duhet pasuritë natyrore.</li> </ul>
Situata e të nxënët	Qyteti i mrekullueshëm; Të peshkojmë ose jo peshq; Loja – Kujdesi për brezat e ardhshëm.
Fjalët kyç	Pasuritë natyrore, pasuritë natyrore të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme, nafta, gazi natyror, energjia diellore, energjia e erës, brezat e ardhshëm.
Burimet materiale	Fletë pune, letër, hartë e Shqipërisë, etj.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuha shqipe, Arte, Dituri natyre.

**Ora I – Burimet natyrore**  
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë pjesën: “Qyteti i mrekullueshëm” në faqe 117, pastaj fëmijët punojnë në dyshe që të renditin mrekullitë e qytetit dhe të plotësojnë tabelën e mëposhtme.



Veprimi	Pasoja
1. Ndërtuan rrugë	1. Shkatërruan brigjet me rërë dhe bimët.
2.	2.

Diskutohen punët e nxënësve. Nxënësit shprehin qëndrimet e tyre rreth veprimeve të njerëzve dhe pasojave që janë shfaqur nga këto veprime. Më pas mësuesi/ja fton nxënësit të thonë se si i kuptojnë fjalët: “Ata të cilët shpejtojnë të pasurohen, shpeshherë përfundojnë pa gjë”. Gjatë diskutimit nxënësve u kërkohet të thonë se çfarë marrin njerëzit nga natyra (për shembull, prodhime bujqësore, fruta, mish, peshk, ujë, ajër, minerale, energji etj) dhe shkruhen në tabelë.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se pasuritë natyrore janë të ripërtëritshme ose të paripërtëritshme.

Më pas nxënësit të plotësojnë në tabelën e mëposhtme me emrat e pasurive natyrore të energjisë dhe materialeve në vijim:

- Nafta, gazi natyror, energjia diellore, energjia e erës.
- Bimët, kafshët, ujërat e ëmbla (lumenjtë, liqenet, burimet), toka, ajri, minarale t, (hekuri, metalet e tjera), materialet për ndërtim (argjilë, gurë, rërë) etj.

Pasuri	
Të ripërtëritshme	Të paripërtëritshme

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit prezantojnë punët e tyre. Mësuesi/ja e drejton diskutimin e nxënësve për të identifikuar anët pozitive dhe negative të llojeve të ndryshme të pasurive natyrore. Theksohet se njerëzit sot shfrytëzojnë pasuri natyrore më tepër se në çfarëdo kohe tjetër në historinë e njeriut. Mësuesi/ja fton nxënësit që të diskutojnë për prodhimin e letrës, lapsit si dhe pasuritë natyrore. Në diskutim me nxënësit mësuesi liston disa nga pasuritë natyrore që gjenden me shumicë në vendin tonë.

Tregohen në hartën e Shqipërisë se ku gjenden këto pasuri natyrore në vendin tonë: P.sh liqenet, lumenjtë, pyjet, pusët e naftës etj. si dhe diskutohen dhe shkruhen në tabelë pasuritë natyrore që gjenden në zonën ku ata jetojnë.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës individuale.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit duhet të gjejnë informacion për shfrytëzimin dhe shpërdorimin e pasurive natyrore në zonën ku ata jetojnë dhe pasojat që janë shfaqur nga këto veprime.

**Ora II – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve****Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me lojën "Bingo", në oborrin e shkollës. Mësuesja ju jep secilit fletëne punës faqe 118, për t'u plotësuar dhe organizon lojën e bingos.

Më pas mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë dilemën "Të peshkojmë ose jo peshq" faqe 115 dhe të shfaqin mendime e tyre se si do të vepronin ata në situatat e dhëna.

Më pas mësuesi/ja u shpërndan fletën e punës në faqen 116: "E qëndrueshme – E paqëndrueshme". Nxënësit lexojnë fjalitë dhe zgjedhin nga dy foto që përshtaten me secilën fjali të dhënë. Pas përfundimit të punës nxënësit shprehin qëndrime e tyre në lidhje me situatat e dhëna si dhe sjellin përvojat e tyre nga jeta e përditshme. Theksohen rregullat dhe shkruhen në tabelë:

- Mos peshkoni më tepër se sa është e nevojshme;
- Mos harxho ujë më tepër se sa ke nevojë;
- Mos i shkatërro bimët, ato të japin jetë.



## Burimet natyrore

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se njerëzit vazhdimisht duhet të përipiqen që të kenë jetë sa më të mirë. Shumë njerëz preferojnë të shfrytëzojnë pasuri natyrore dhe shërbime për përfitim të shpejtë, por harrojnë pasojat që vijnë prej këtyre aktiviteteve për të ardhmen.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja thekson se pasuritë natyrore duhet të shfrytëzohen me kujdes sepse ne duhet të mendojmë dhe për brezat e ardhshëm. Kjo për arsye që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm është shfrytëzimi maksimal të pasurive të ripërtëritshme natyrore të cilat ende munden të përdoren. Për shembull, prerja e pemëve duhet të bëhet me planifikim që pemët të mos rallohen e të zhduket pylli. Zhvillimi i qëndrueshëm varet nga vendi në vend, nga rajoni në rajon. Për të shpjeguar më mirë shfrytëzimin e pasurive natyrore të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme mësuesi /ja i fton nxënësit të luajnë lojën "Kujdes brezat e ardhshëm". Për zhvillimin e lojës nevojiten fisha (shirita) letrash të cilat hidhen në një enë më të madhe, ato janë në vend të ushqimeve. Pastaj në disa fletë të tjera shënohen fjalët:



Brezi i 1-rë, Brezi i 2-të, Brezi i 3-të, por ashtu që, për shembull, për 14 pjesëmarrës do të kishte nga dy fletë me fjalën

Brezi i 1-rë, katër fletë me Brezi i 2-të dhe tetë fletë me Brezi i 3-të. Domethënë numri përmbjllës i fletëve të shënuara të jetë gjithsej 14. Nëse kemi 28 nxënës, numri dyfishohet dhe kështu me radhë.

Loja fillon duke u ndarë fëmijëve fletët me përzgjedhje të rastësishme. Secili duhet të shohë se çfarë shkruhet në fletë.

Pastaj u tregohet ena ku gjenden fishat e letrave. U shpjegohet fëmijëve se fishat e letrave në enë, në fakt, paraqesin pasuritë e paripërtëritshme natyrore në Tokë. Pastaj kërkohet nga të gjithë ata që kanë fletë, në të cilën shkruan Brezi i 1-rë të dalin përpara dhe të vijnë para enës. U jepet qese plasmasi dhe u lejohet që të marrin nga ena me ushqime sa të duan. Pastaj, ftohen nxënësit nga Brezi i 2-të. Të njëjtën gjë bëjnë dhe ata. Pasi të marrin edhe ata, vërehet se rripat e letrave në enë pakësohen dhe gjithnjë e më pak mbesin për të tjerët. Madje mund të ndodhë që të mos mbesin fare për gjeneratën e 3-të. Vazhdon loja nëse ka akoma fisha letrave në enë dhe për Brezi i 3-të, etj. deri sa në enë të mos ketë fisha letrave.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas lojës, ftohen nxënësit të shprehin qëndrimet e tyre se:

- Çfarë do të ndodhë nëse fishat e letrës do të ishin burime të paripërtëritshme natyrore?

Orientohet diskutimi i nxënësve me shembuj konkretë rreth shfrytëzimit të paarsyeshëm të pasurive natyrore dhe pasojat e tyre në zonën ku ata jetojnë. Për shembull: Për pyjet, lumenjtë, etj. Më pas mësuesi/ja u shpërmdan nxënësve testin "Çfarë dimë për pasuritë natyrore?" faqe 115.

Diskutohen dhe vlerësohen punët e nxënësve.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë punës në grup, prezantimeve, diskutimeve dhe mendimeve që shfaqin gjatë orës.

### Detyrë shtëpie:


Të shprehin qëndrimet e tyre me anë të vizatimit ose me shkrim për mbrojtjen e pasurive natyrore në zonën ku ata jetojnë.



## DILEMA

## Të peshkojmë ose jo peshq

Ju dhe prindërit tuaj shkoni në një udhëtim tregëtor në një liqë të bukur, ku mund të peshkoni. Rregullat e peshkimit thonë se familja juaj mund të peshkojë deri në dhjetë peshq gjatë qëndrimit tuaj. Ditën e pare peshkimi shkon ngadalë dhe ju mund të peshkoni vetëm tre peshq të vegjël. Mirëpo, ditën e dytë jeni më të lumtur dhe vetëm për disa orë do ti peshkoni shtatë peshq të mëdhenj. Ju e dini se ekzistojnë disa rregulla në lidhje me sasinë e peshqve që mund të kapni. Çka duhet të bëni?



- Vazhdoni me peshkimin pa marrë parasysh asgjë.
- I hidhni peshqit e vegjël në liqen dhe vazhdoni me peshkimin, duke shpresuar se tre peshqit në vijim do të jenë më të mëdhenj.
- Do të ndërprisni peshkimin dhe do ti përgatisni peshqit, të cilët i keni peshkuar.
- Do të ndërprisni peshkimin dhe vendosni të pushoni e të kënaqeni me pamjen e liqenit dhe mjedisin përreth.
- Diçka tjetër.



## TEST

## Çfarë dimë për burimet natyrore?

	E SAKTË	E GABUAR
1 Burimet natyrore janë të mira materiale, të cilat i marrim nga natyra me qëllim që ti plotësojmë nevojat dhe dëshirat tona.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Mund të peshkojmë peshq sa të duam dhe gjithmonë do të ketë edhe më tepër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Energjia e diellit është burim i ripërtëritshëm dhe i pashterur i energjisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Njerëzve u nevojiten vetëm ajri i pastër, uji i pijshëm, ushqimi i shijshëm dhe një shtëpi si vendbanim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Burimet natyrore të naftës po mbarojnë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Duke ricikluar materialet dhe sendet që nuk na duhen më ne kursejmë pasuritë natyrore dhe energjinë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Kur presim pemë, duhet të mbjellim pemë të reja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E saktë 4. E pasaktë 5. E saktë 6. E gabuar 7. E saktë






FLETË PUNE


# E qëndrueshme — E paqëndrueshme

Udhëzim: Fotokopjoni fletën e punës dhe ua ndani nxënësve. Prisi fotografitë dhe vendosni në një vend të përshtatshëm sipas udhëzimeve të dhëna.


Lexoni fjalitë nën secilin çift. Zgjidhni dy foto, të cilat shkojnë me secilën fjalë. Vendosni në dritaren e majtë fotografitë që tregojnë pasuri natyrore, ndërsa në dritaren e djathtë fotografinë e asaj çfarë ne marrim nga këto burime.




**Kur peshkojmë peshq të vegjël,  
duhet ti kthejmë ata përsëri në ujë.**





**Kur priten pemë,  
duhet të mbillen të reja.**



**Uji nuk duhet të harxhohet  
më shpejt se sa ripërtëritet.**



**Me gjueti nuk duhet të zvogëlohet  
numri i kafshëve.**





## FLETË PUNE

## Qyteti i mrekullueshëm



Na ishte një qytet i vogël buzë detit. Ishte shumë i bukur, me det të pastër, të kaltër, rërë të butë si mëndafshi dhe pyje të gjelbër përgjatë bregdetit.

Njerëzit e quajtën atë të mrekullueshëm dhe jetonin në të, të qetë dhe të lumtur. Gjuanin peshq, mirëprisnin turistët në shtëpitë e tyre dhe u ofronin shëtitje në pyllin e afërt ose udhëtim me anije. Gatuanin ushqime të shijshme e të shëndetëshme duke përdorur perimet dhe frutat e që prodhoheshin në rrethinën e afërta të qytetit.

Një ditë banorët e Qytetit të mrekullueshëm u mbledhën në kuvend dhe vendosën që ta ndryshojnë qytetin e tyre dhe ta shndërrojnë në një qendër të madhe tregtare dhe turistike, e cila kështu do t'u jepte më shumë mundësi për të fituar më tepër. Filluan me prerjen e pyllit dhe filluan të ndërtojnë hotele të reja. Gjithashtu, ndërtuan rrugë të gjera përgjatë bregdetit, duke i shkatërruar brigjet me rërë dhe bimët. Shumë turistë vinin në Qytetin e mrekullueshëm me makinat e tyre, çka bëri që qyteti të bëhej shumë i zhurmshëm. Çdo ditë kamionët sillnin ushqime dhe prodhime nga vendet e largëta me qëllim që ti përmbushin nevojat e turistëve. Mbetjet filluan të shtohen. Qyteti i mrekullueshëm vazhdimisht rriste hapësirën e tij.

Pothuajse asgjë nuk mbeti nga ai qyteti i vogël. Ai u ndryshua dhe nuk mund të njihet më. Njerëzit tani më nuk mendonin më për Qytetin e mrekullueshëm si për një vend të bukur ku të shkonin për pushime dhe turistët nuk vinin më. Njerëzve, të cilët kishin vite që jetonin në Qytetin e mrekullueshëm filloi t'u mungojë qyteti i tyre i vogël plot gjelbërim e bukuri natyrore siç kishte qenë vite më parë.

Një ditë, një i huaj erdhi në sheshin qendror të qytetit, pikërisht aty ku mbledheshin njerëzit në mbrëmje.

Ai qëndroi aty një kohë të gjatë, duke i dëgjuar njerëzit se çfarë bisedonin, e në fund vendosi tu tregojë një histori.

Historia e tij është në vijim:

Njëherë e një kohë, na ishte një pulë e veçantë. Çdo ditë ajo bënte nga një vezë të artë, e cila shkëlqente si dielli i vogël në kotec. Pronari i pulës e kontrollonte peshën e vezës çdo ditë. Vazhdimisht ankohej pse ato nuk ishin më të mëdha dhe thoshte: "Ndoshta thjesht duhet ta vras fare këtë pulë. Patjetër brenda barkut të saj fshihet një pasuri e tërë. Nëse

ndonjë ditë do ti hap barkun, do të bëhem njeriu më i pasur në botë".

Këto mendime i vinin në kokë sa një ditë vendosi ta vrasë pulën dhe ti hapte barkun. A mund të mendoni tronditjen e tij kur kuptoi se barku i pulës nga brenda ishte i njejtë me atë të çdo pule tjetër në botë! Filloi të shkulte flokët e tij nga



dëshpërimi dhe qante pa pushim, por gjithçka ishte e kotë.

Si njëri lakmitar ai humbi edhe vezët edhe pulën. I panjohuri shikoi që njerëzit e qytetit ishin të trishtuar dhe iu tha: "Ata të cilët shpejtojnë të pasurohen, shpeshherë përfundojnë pa gjë".





## FLETË PUNE Bingo

Udhëzimet: Përdor ngjitës për të vendosur objektet mbi katrorët e Bingos. I pari që gjen pesë në radhë, fiton lojën.

Një shkop	Një luledele	Një petal luleje	Një guralec i vogël	Një gjethe të madhe jeshile
Një insekt	Një gjethe	Një gjethe tërfili	Një guralec me ngjyrë të zezë	Një degë peme që ngjan si një "y"
Një copë lëvore peme	Një gur që i ngjan një sendi ose objekti	Hapësire bosh	Një farë	Një lajthi
Një gur i lëmuar	Një gjethe e gjelbër	Një gur i dhëmbëzuar	Një fije bari e vyshkur	Një copë druri
Një lule e vogël	Një gjethe e tharë	Një kon pishe	Një copë mbeturinë	Pak dhe





## Popullsia

Toka gjithnjë e më tepër po bëhet e **mbipopulluar**. Në këtë periudhë, më tepër se 7 miliardë njerëz jetojnë në planetin Tokë. Nëse rritja e popullsisë mbetet e njëjtë, deri në mesin e këtij shekulli (viti 2050) në Tokë do të ketë më tepër se 10 miliardë njerëz. Shkaku kryesor për këtë gjë është fakti se, më tepër njerëz lindin se sa vdesin. Në ditët e sotme, njerëzit jetojnë një jetë **më cilësore** dhe **më të gjatë** për shkak të ndryshimeve në mënyrën e jetesës. Me shtimin e popullsisë rritet nevojja për shfrytëzimin më të madh të pasurive natyrore në Tokë. Numri më i madh i njerëzve, gjithashtu, nënkupton kërkesë më të madhe për ushqim dhe për ujë të pijshëm, si rrjedhojë dhe nevojë të shtuar për sipërfaqe më të madhe prodhuese. Problemi i mbipopullimit është shumë serioz, nuk mund të veprohet në drejtim të zgjidhjes së tij. Duke e shqyrtuar gjendjen e tanishme të numrit të njerëzve dhe aftësinë e mjedisit që t'i sigurojë burimet e domosdoshme natyrore dhe kushtet e duhura për jetesë, shumë vende ndër marrin masa që ta kontrollojnë këtë gjendje. Ndonjëherë natyra arrin ta kontrollojë numrin e njerëzve në një mënyrë të rëndomtë dhe mizore, përmes katastrofave dhe fatkeqësive natyrore (tërmete, përmblytjeve, sëmundjeve dhe epidemive). Në vendet evropiane ka një rritje të vogël të popullsisë. Në disa pjesë të veçanta në botë është vërejtur **rënie e lindshmërisë së** popullatës, ndërsa në disa rajone të veçanta mbipopullim i saj.



### Planifikimi ditor i temës Popullsia

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Çfarë do të thotë rritje e popullsisë?
<b>Kohëzgjatja</b>	3 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>shpjegon me anë të shembujve se çfarë nënkupton me rritje të popullsisë;</li> <li>rendit shkaqet e lëvizjes së popullsisë;</li> <li>demonstron se pasuritë natyrore të Tokës janë të kufizuara.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Loja “Sa hapësirë ka në rreth?”. Loja “Mos u nxe me rritjen e popullsisë”. Loja “Tregoj, diskutoj dhe argëtohem”. “Sa nxënës grumbullon rrethi prej litari?”. Lojë “Ku dëshiron të jetosh?” Tregimi “Mollët”. Sa fëmijë mund të luajnë në parkun e lodrave?
<b>Fjalët kyç</b>	Popullsia, rritje, dyfishim, migrim, emigrim, fshat, qytet.
<b>Burimet materiale</b>	Shkumës, litar, gotë me ujë, fletë pune për nxënësit, etj.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Matematikë, Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.

#### Ora I – Çfarë do të thotë rritje e popullsisë? Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja shkruan në tabelë vargun e numrave të mëposhtëm dhe fton nxënësit të gjejnë rregullin e formimit të tij. 1, 2, 4, 8, 16, 32, 64. Më pas u shpjegon nxënësve se ashtu si rritja e vargut të numrave të dyfishuar bëhet dhe rritja e popullsisë. Për të konkretizuar këtë pohim nxënësve u jepet shembulli i mbjelljes së një degë. Mbjellim në një vazo një degë të një bime. Pas një periudhe të caktuar degën e ndajmë në dy pjesë, të cilat prapë do t’i mbjellim. Kur edhe këto të rriten dhe të lëshojnë fletë, secilën nga degët përsëri e ndajmë në dy pjesë të tjera. Fitojmë gjithsej katër degëza. Ky proces përsëritet me ndarjen e numrit të degëve dhe në këtë mënyrë fitohet një numër më i madh i bimëve të reja.

Më pas mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Për sa kohë do të mbushet vazoja nëse vazhdojmë ta përsërisim procedurën? Nxënësit diskutojnë dhe shprehin qëndrimet e tyre rreth përgjigjeve të njëri-tjetrit.



**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtarinë “Sa hapësirë ka në rreth?”.

Në tokë, mësuesi/ja vizaton një rreth me diametër prej afër 2 metra. Fton njërin nga nxënësit që të qëndrojë në qendër dhe pyet se a ka mjaft hapësirë në rreth. Fton një nxënës tjetër vullnetar që t’i bashkohet të parit dhe i parashtron pyetjen:

-Po tani a ka mjaft hapësirë në rreth? Fton dhe dy nxënës të tjerë të futen në rreth. Përsëritet e njëjta pyetje. Veprimtaria vazhdon duke ftuar të bashkohen me ta dhe katër nxënës, pastaj tetë, e kështu me radhë duke parashtruar të njëjtën pyetje.

Në fund, pyetini nxënësit:

- A mund ky proces i rritjes së popullsisë të zgjasë, e të zgjasë përjetësisht?

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja/i shkruan në tabelë fakte të tilla si:

- Popullsia e botës rritet me 1.8% në vit.
- rreth 780 vjet më vonë për çdo metër katror do të ketë 1 person.
- 2400 vjet më vonë, masa e tokës do të jetë e barabartë me masën e njerëzve.

Mësuesi/ja fton nxënësit të gjejnë e të krahasojnë numrin e rritjes së popullsisë ndër vite. Nxënësit punojnë në punë dyshe duke renditur se cilët janë faktorët që kanë kontribuar në rritjen e përgjithshme të popullsisë në botë gjatë 150 viteve të fundit?

Viti	Numri i popullsisë	Viti
1800	1 miliard njerëz	1800
130 vjet më vonë	2 miliard njerëz	1930
30 vjet më vonë	3 miliard njerëz	
15 vjet më vonë	4 miliard njerëz	
13 vjet më vonë	5 miliard njerëz	
12 vjet më vonë	6 miliard njerëz	
8 vjet më vonë	6.5 miliard njerëz	

Nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth këtij procesi. Më pas mësuesi/ja u tregon nxënësve se Toka gjithnjë e më tepër po bëhet e mbipopulluar. Në këtë periudhë, më tepër se 7 miliardë njerëz jetojnë në planetin Tokë. Nëse rritja e popullsisë mbetet e njëjtë, deri në mesin e këtij shekulli (2050) do të ketë më tepër se 10 miliardë njerëz në Tokë. Shkaku kryesor për këtë gjë është fakti se, më tepër njerëz lindin se sa vdesin. Në ditët e sotme, njerëzit jetojnë një jetë më cilësore dhe më të gjatë për shkak të ndryshimeve cilësore në mënyrën e jetesës.

Gjithashtu mësuesi/ja u tregon nxënësve të dhëna për rritjen e popullsisë në Shqipërisë sipas informacionit të dhënë duke shpjeguar njëkohësisht konceptet Migrim dhe Emigrim.

Mësuesja fton nxënësit të ndahen në dyshe dhe të luajnë së bashku lojën “Mos u nxe” faqe 128. Nxënësit zbatojnë rregullat e lojës që janë të paraqitura në fletën e punës.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetë vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimeve dhe veprimtarive të zhvilluara.

**Detyrë shtëpie:**

Ftoni nxënësit që të zgjedhin një nga rastet e tabelës që ata dëshirojnë të përgjigjen.

Jepni shkakun dhe zgjidhjen që ju mendoni.

Veprimi	Shkaku	Pasoja
Mësuese Blertës i janë caktuar 52 nxënës në klasën e saj të Biologjisë, por ajo ka vetëm hapësirë vetëm për 35.		
Derdhja e naftës në Gjirin e Meksikës ka dëmtuar shumë organizma ujorë që jetojnë në rajonin e këtij Gjiri.		
Një popullatë me lepujt dhe një popullatë drerësh ushqehen me të njëjtat bimë në të njëjtin ekosistem.		
Uragani Katrina detyroi mijëra njerëz të largohen nga New Orleans.		
65 milionë vjet më parë, një asteroid i madh u përplas me Tokën. Si rezultat, sasi të mëdha hiri u shpërndanë në atmosferën e Tokës.		



### Ora II – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja e fillon mësimin me përgjigjet e detyrës së shtëpisë.

Më pas vazhdon me lojën “Tregoj, diskutoj dhe argëtohem”, ku nxënësit tregojnë dhe diskutojnë rreth faktorëve të rritjes dhe zvogëlimit të popullsisë sipas udhëzimeve të dhëna në fletën e punës 127.

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4-5 nxënës dhe çdo nxënësi i jep fletën e punës 124 ku paraqitet dilema: “Sa fëmijë mund të luajnë në parkun e lodrave?”. Nxënësit diskutojnë me njëri – tjetrin brenda grupit se si do ta zgjidhin këtë problem dhe pastaj prezantojnë zgjidhjet e tyre para klasës.

Mësuesi/ja orienton diskutimet e nxënësve drejt propozimeve konkrete për shfrytëzimin e fushës së lojës.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se me rritjen e popullsisë kemi dhe rritje të nevojave për shfrytëzimin më të madh të pasurive natyrore në tokë si dhe energjisë. Numri më i madh i njerëzve, gjithashtu, nënkupton kërkesë më të madhe për ushqim dhe për ujë të pijshëm, e gjithashtu nevojë të shtuar për sipërfaqe më të madhe punuese.

Për të konkretizuar më mirë këtë mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë lojën: “Sa nxënës mund të grumbullojë rrethi i bërë nga litari?”. Loja do t’ju shërbejë për paraqitjen e problemit me pasuritë e pasurive natyrore dhe numrin e njerëzve. Nxiten nxënësit që të imagjinojnë se rrethi i realizuar nga litari paraqet planetin Tokë dhe pasuritë e saj natyrore: mineralet, energjinë, ujin etj. Ftoni njërin nga nxënësit që të futet në rrethin prej litari. Pyeteni se a ndihet mirë dhe se a është hapësira – “pasuria natyrore” e mjaftueshme. Ftohet një nxënës tjetër të futet në rreth pranë të parit. Përsëriteni pyetjen dhe për të nxënësin e dytë. Ftoni gjithnjë e më tepër nxënës që t’i bashkëngjiten dy të parëve, gjithnjë duke e përsëritur pyetjen e njëjtë. Vazhdoni derisa të ketë hapësirë në rreth dhe më pas pyeten nxënësit:

- A ekziston mundësia që të këputet litari nëse nxënësit vazhdojnë të hyjnë në të?
- Çfarë do të bëhej me planetin Tokë nëse ndodhë e njëjta gjë?
- Si duhet vepruar që njerëzit të kenë pasuri natyrore të nevojshme për të jetuar?

#### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja i fton nxënësit të lexojnë pjesën “Mollët” në faqe 125 dhe të shkruajnë se si do t’ua kishin ndarë ata mollët fëmijëve. Duke i argumentuar përgjigjet. Nxënësit prezantojnë zgjidhjet e tyre për situatën “Mollët”. Ata diskutojnë dhe shprehin argumentet e tyre rreth zgjidhjes së problemit. Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë shembuj të ngjashëm për ta paraqitur problemin e rritjes së popullatës dhe pasuritë e kufizuara natyrore. Nxënësit mund të sjellin shembuj që vijnë nga jeta e tyre e përditshme dhe qyteti/lagjia ku ta banojnë, ose për mbipopullimin e qyteteve në vendin tonë dhe problemeve që dalin për ujë të pijshëm, hapësira të gjelbra etj. Për të konkretizuar këto probleme mësuesi/ja tregon një shembull: Ju tregon nxënësve një gotë me ujë. Më pas pyet nxënësit:

- A mjafton kjo gotë me ujë për gjithë nxënësit në klasë që kanë etje?

Nxënësit shprehin mendime dhe më pas tregojnë rreth kujdesit që duhet të tregojnë për shfrytëzimin e pasurive natyrore.

#### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarive në grup si dhe gjatë diskutimeve dhe mendimeve që japin gjatë orës.

#### Detyrë shtëpie:

Nxënësit të gjejnë informacion për shfrytëzimin pa kriter të pasurive natyrore në zonë ku ata jetojnë dhe pasojat që janë shfaqur nga këto veprime, për të organizuar një ekspozitë në ditën e popullsisë.



### Ora III – Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë duke përdorur teknikën e 5 pyetjeve idenë “Njerëz, toka është shtëpia jonë”, të cilat shkruhen në tabelë nga mësuesja.

Më pas nxiten nxënësit të shkruajnë disa nga veprimet që bënë njerëzit ndaj mjedisit dhe pasojat që erdhën si rezultat i këtyre veprimeve.

Veprimet	Pasojat	Zgjidhja

Në fund mësuesi fton nxënësit të zgjidhin dhe pyetjen dilemë: “Çdo të thotë më shumë njerëz në Tokë?”

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Lojë – Ku dëshiron të jetosh?

Mësuesi/ja ndan klasën me shumës në dy pjesë dhe shënon mbishkrimet : Qyteti dhe Fshati.

Fton nxënësit të thonë se ku kanë më shumë dëshirë të jetojnë në fshat apo në qytet dhe pse? Nxënësit sipas dëshirave të tyre ndahen në vendin përkatës në fshat apo në qytet. Pasi të gjithë nxënësit janë ndarë, mësuesi i numëron të dyja grupet. Rezultati i numërimit duhet të nxisë diskutim të mëtejshëm midis mësuesit dhe nxënësve për shpërndarjen e barabartë, përkatësisht të pabarabartë të popullsisë midis fshatit dhe qytetit.

Për të treguar përparësitë e përzgjedhjes së nxënësve në fshat apo në qytet, mësuesi u shpërndan nxënësve fletën e punës faqe 126 “Ku dëshiron të jetosh”. Nxënësit plotësojnë secili në punë të pavarur dëshirat e tyre.



**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit prezantojnë punën e tyre dhe i bëjnë pyetje njeri-tjetrit. Në fund mësuesi u shpjegon nxënësve se më e mira për zhvillimin e shoqërisë duhet të jetë një shpërndarje e barabartë e popullsisë në qytete dhe në fshatra.

Në fund mësuesi/ja fton nxënësit të plotësojnë testin: “Rritja e popullsisë” në fletën e punës 127. Diskutohen zgjedhjet e nxënësve.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për testin “Rritja e popullsisë”.

**Detyrë shtëpie:**

Të gjejnë informacion për problemet që ka qytetit i tyre (Tirana) si rezultat i rritjes së popullsisë.





## DILEMA

# Sa fëmijë mund të luajnë në parkun e lodrave?

Në lagjen tuaj banojnë shumë familje që kanë dy ose tre fëmijë. Parku i lodrave aty pranë nuk ka vend për të luajtur të gjithë fëmijët e lagjes suaj. Shpesh fëmijët që luajnë aty fillojnë të grinden me njëri tjetrin, sepse hapësira është e vogël e ata shpesh përplasen midis tyre. Por ju duhet ta zgjidhni këtë problem, por si?



- Sa herë që do të dëshirosh të luash në këtë park lodrash, ti do të shkosh i pari dhe nuk do të lejosh askënd tjetër që të luaj aty veç shokëve të tu;
- Do të shkosh të luash në parkun e lodrave edhe pse ka shumë fëmijë; asgjë nuk mund të të pengojë për të luajtur;
- Do të kërkosh ndihmë nga prindërit – që t'i drejtohen kryetarit të bashkisë për të ndërtuar një park të ri lodhrash më të madh dhe me një fushë të re loje;
- Diçka tjetër.

Zhvilloni diskutim me nxënësit për propozimet e ofruara dhe nxitni ata të propozojnë ide të reja rreth shfrytëzimit të parkut të lojrave.



## TEST

# Rritja e popullsisë

	E SAKTË	E GABUAR
1 Në planetin tonë ka vende, me popullsi të dendur.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Në dhjetë vitet e ardhshme, numri i njerëzve në botë nuk do të rritet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Njerëzit, në dallim nga kafshët, mundohen shumë më tepër që ta përshtasin mjedisin natyror në plotësim të nevojave të veta.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Në të ardhmen, pasuritë natyrore të Tokës (toka bujqësore, ushqimi, uji, energjia) do të jenë të mjaftueshme për të gjithë popullsinë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Me shtimin e popullsisë rritet nevoja për shfrytëzimin më të madh të pasurive natyrore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E saktë 4. E gabuar 5. E saktë



## FLETË PUNE


### Mollët

Gjyshja Zoja dhe gjyshe Leta janë fqinje me njëra tjetrën. Gjyshja Zoja ka dy nipër, ndërsa gjyshja Leta ka gjashtë. Në kopshtin e gjyshes Zojës dhe gjyshes Letës ka nga një pemë molle, e cila i pjek frutat e saj çdo verë. Kur mbaron shkolla nipërit vijnë tek gjyshet e tyre për të kaluar ditët e pushimeve verore. Kështu ndodhi edhe kësaj vere. Fëmijët si fëmijë, sapo mbërinin në shtëpi niseshin menjëherë drejt kopshtit për tek pema e mollës së gjyshes së vet.

Për çudi të madhe, këtë verë në të dyja mollët numri i frutave të pjekur ishte i njëjtë, plot 12 mollë ndodheshin në secilën pemë.

Duke ditur këto fakte, secili prej nxënësve të shkruaj se si do t'ua kishte ndarë mollët fëmijëve dhe ta arsyetojë përgjigjen e tij.

- Nga sa mollë të pjekura do të marrë secili fëmijë nga mollët e gjyshes së vet?
- Cili nga ata do të ketë më shumë mollë?
- Pse ndodh kështu?
- Sa mollë do të marrë secili nëse ata i ndajnë mollët e të dy pemëve në mënyrë të barabartë?





FLETË PUNE

# Ku dëshiron të jetosh?



Dua të jetoj në qytet sepse:

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



Dua të jetoj në fshat sepse:

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....








## FLETË PUNE

## Tregoj, diskutoj dhe argëtohem

Nxënësit fillojnë lojën duke vendosur një laps në mes të rrethit. Nxënësit rrotullojnë lapsin në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës, aty ku ndalon maja e lapsit nxënësit tregojnë dhe diskutojnë rreth faktorëve të rritjes dhe zvogëlimit të popullsisë, duke respektuar rregullat e lojës.



Sektori me ngjyrë të kuqe: Trego rreth rritjes së numrit të popullsisë (Një ngjyrë në rrethor).



Sektori me ngjyrë blu: Trego rreth zvogëlimit të numrit popullsisë. (Tre ngjyra në rrethor).



Sektori me ngjyrë të verdhë: Ktheju përsëriti dhe njëherë (Vetëm një ngjyrë në rrethor).



Sektori me ngjyrë jeshile: Trego shembuj nga jeta (Një ngjyrë në rrethor).



## FLETË PUNE Mos u nxeh

Vendoseni fletën e lojës në qendër të tavolinës. Secili lojtar ka të drejtë të hedh zarin vetëm një herë, duke kaluar kështu me radhë nga njëri tek tjetri. Duke u bazuar tek numri që të bie, lotari i përgjigjet pyetjes që ndodhet tek ai kuadrat, më pas vijon loja me lojtarin tjetër me hedhjen e zarit dhe përgjigjen e pyetjes së tij. Lojtari që shkon i pari tek kutia që tregon “Mjedis i Pastër” është dhe fituesi i lojës.

**1**  
Trego për popullsinë e qytetit ku ju jetoni.

**2**  
Mbro një lloj nga zhdukja duke hedhur 6

**3**  
Mjedis i ndotur

**4**  
Higjenë e mirë personale

**5**  
Aksidente

**6**  
Aksidente

**11**  
Ndotja e ujit

**10**  
Ushqime bio

**9**  
Aksidente

**8**  
Teknologjia

**7**  
Ktheju mbrapsh 2 katrorë

**12**  
Ajri i pastër

**13**  
Ktheju mbrapsh 2 katrorë

**14**  
Shpyllëzimi

**15**  
Trego rreth cilësië së ajrit në qytetin tënd

**16**  
Kujdesi shëndetsor

**17**  
Luftrat

**18**  
Trego rreth pasojave të luftrave për popullsinë

**21**  
Mjedis i pastër

**20**  
Ktheju mbrapsh 2 rrethorë

**19**  
Trego se çfare janë ndryshimet klimatike



## Konsumi dhe mbetjet

Nevojat e konsumatorit në ditët e sotme janë në rritje të vazhdueshme dhe njerëzit, me vetëdije ose jo, po shtojnë gjithnjë e më shumë llojin e prodhimeve dhe të shërbimeve që ata përdorin. Lehtësitë e transportit që ekzistojnë sot, mundësojnë që llojet më të ndryshme të prodhimeve të vijnë nga vendet e largëta dhe të bëhen pjesë e jetës së përditshme.

**Tregu konsumator** është i tejmbushur nga reklamat për produkte dhe shërbime të reja. Gradualisht, **konsumi po bëhet** pjesë shumë e rëndësishme e jetës së njerëzve, duke kërkuar kohë e të ardhura financiare të mjaftueshme.

**Prodhimi** dhe paraqitja e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme në të kaluarën kërkonte shumë kohë dhe punë. Njerëzit ishin të vetëdijshëm për vështirësitë dhe shpenzimet që i shoqëronin prodhimet, transportimin dhe shpërndarjen e të mirave materiale. Në të kaluarën, mënyra e jetës kërkonte ruajtjen dhe kujdesin për produktet, me qëllim për t'i përdorur sa më gjatë.

Në kohën e sotme, më shpesh përdoren produktet me **një përdorim**. Kjo është arsyeja që shoqëria e sotme quhet shoqëri **konsumatore**.

Cilat janë pasojat nga rritja e konsumit?

- **Rritja e konsumit të burimeve natyrore dhe të energjisë.** Për shembull, sasia e minierave dhe e mineraleve që shfrytëzohen nëpër botë dyfishohet çdo 15 vite.
- **Përdorimi i më shumë lëndëve që ndotin ajrin, ujin dhe tokën në mjedis.** Mbetjet shtëpiake dhe ato nga industria grumbullohen në venddepozitime mbetjesh; ujërat e zeza dhe ujërat e ndotura të industrisë derdhen në lumenj, liqene dhe dete; ndërsa gazrat që shkarkohen nga automjetet dhe impiantet industriale lëshohen në ajër.
- **Rritja e popullsisë.** Aktualisht, vlerësohet se popullsia në Tokë është rreth 7 miliard njerëz. Në fillim të shekullit të 20-të, numri i popullsisë mezi arriti në 2 miliard, ndërsa në mesin e shekullit të 21-të pritet një popullsi prej 10 miliard njerëz.

Të gjitha këto situata, paraqesin **sfida serioze** për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë sot.



Ka ardhur koha që njerëzit të mendojnë dhe të veprojnë duke përdorur të mirat materiale dhe shërbimet me mençuri dhe vetëdije.

Njerëzit duhet të krijojnë shprehi që:

- të përdorin të mira materiale, të cilat janë cilësore dhe kanë qëndrueshmëri më të lartë.
- të nxisin prodhuesit të bëjnë produkte duke përdorur materiale të ricikluara dhe energji të ripërtëritshme.
- të mbështesin aktivisht riciklimin e materialeve.
- të nxisin përdorimin e shumëfishtë të produkteve.
- të kërkojnë futjen e proceseve prodhuese nga burime të reja natyrore dhe të energjisë së ripërtëritshme.
- të gjejnë mënyrat më të mira dhe miqësore me mjedisin për të transportuar dhe dërguar prodhimet në largësi të ndryshme.



Lënda e para shndërrohet në **mbetje** si pasojë e proceseve të prodhimit dhe të konsumit. Tepricat e panevojshme të një produkti pasi konsumohet, quhen mbetje. Mbetjet mund të shfrytëzohen përsëri, të përpunohen, të digjen në fabrika të veçanta (me qëllim zvogëlimin e vëllimit) ose të groposen në venddepozitim.

Menaxhimi i mbetjeve përfshin tre hapa themelore, të cilët duhet të zbatohen nga secili nga ne me qëllim zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve në mjedis. Këto hapa janë:

**Refuzimi.** Të gjithë duhet të refuzojmë përdorimin e produkteve të panevojshme, duke zvogëluar në këtë mënyrë sasinë e mbetjeve në kosh. Duhet treguar kujdes në sasinë e produkteve që blejmë, duke vlerësuar sipas nevojës që kemi. Është mirë që kur bëjmë pazar të përdorim çantë prej cope, e jo qese plastike.

**Ripërdorimi.** Disa produkte mund të përdoren përsëri në një moment të dytë dhe të mos hidhen menjëherë në koshin e mbetjeve. Për këtë, para se të hedhim në kosh një produkt apo një veshje, duhet të mendojmë: Nëse mund ta përdorim përsëri atë? Duhet të jemi krijues dhe të mendojmë më shumë mënyra të reja për përdorimin e sendeve, si për shembull, kutitë e këpucëve për të ruajtur lodrat, kanoçet e aluminit për të vendosur lapsat dhe stilolapsat, etj.

**Riciklimi.** Është proces gjatë të cilit gjërat e përdorura (shishet e qelqit, kartonët dhe letrat e tjera, kanoçet, shishet e plastikës etj.) dërgohen në fabrikë për t'u ricikluar me qëllim përfitimin e produkteve të reja, të cilat mund të përdoren përsëri. Me këtë, mundësohet kursimi i burimeve natyrore dhe zvogëlimi i mbetjeve në venddepozitim.



## Planifikimi ditor i temës Konsumi dhe mbetjet

Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	III
Tema mësimore	Krijimi i mbetjeve
Kohëzgjatja	3 orë mësimore
Rezultatet e të nxënit	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon aftësi për vëzhgimin dhe njohjen e mbetjeve;</li> <li>• ndan mbetjet sipas materialit themelor të prodhuar;</li> <li>• shpreh përgjegjësinë e tij për mbrojtjen e mjedisit duke ricikluar mbetjet.</li> </ul>
Situata e të nxënit	Çfarë ka në kosh? Kush e ndot shkollën? Semafori për mbetjet.
Fjalët kyç	Konsumi, mbetje, kosh, riciklim.
Burimet materiale	Qese plastike, dorëza mbrojtëse, shishe qelqi, shishe plastike, konservë alumini, gazetë, copë rrobash, banane, hekur, fletë pune.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arte.

## Ora I – Krijimi i mbetjeve

### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja u tregon nxënësve koshin e mbetjeve të klasës dhe pyet:

- Ç'kuptoni me fjalën "mbetje";
- Çfarë mund të gjejmë në koshin e mbetjeve?

Renditen në tabelë llojet e mbetjeve që janë gjetur në kosh. Më pas mësuesi/ja fton nxënësit sjellin përvojat e tyre për kujdesin ndaj mbetjeve. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se shoqëria sot është një shoqëri konsumatore që harxhon sasi të mëdha energjise dhe pasuri natyrore dhe krijon aq shumë mbetje duke ndotur kështu ajrin, ujin dhe tokën.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Për të dëshmuar dhe më pas për ta diskutuar këtë deklaratë mësuesi/ ja fton nxënësit në veprimtarinë: Kush e ndot shkollën? Nxënësit ndahen në grupe dhe vëzhgojnë mbetjet e oborrit të shkollës ose rreth saj. Nxënësit mbajnë shënime në fletën e punës të faqe 140 "Mbetjet tona" që u është shpërndarë paraprakisht. Mbetjet ndahen sipas materialit themelor (p.sh. metal, letër, mbetje ushqimore, plastikë, qelq). Nxënësit mund t'i organizojnë këto të dhëna në tabela ose me grafikë.

#### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit prezantojnë punë e tyre sipas grupeve. Diskutojnë rreth llojeve të mbetjeve që janë gjetur. Mësuesi/ja u tregon nxënësve rreth llojeve të mbetjeve dhe në diskutim me nxënësit renditen pasojat që vijnë nga këto mbetje.

Gjithashtu nxënësit përzgjedhin alternativat e sakta në situatat e dhëna.



### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetritin gjatë përzgjedhjes së alternativave, punës në grup si dhe diskutimeve e veprimtarive të zhvilluara.

### Detyrë shtëpie:

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve për të plotësuar në shtëpi fletën e punës faqe 141 "Mbetjet e shtëpisë". Gjithashtu i jepet edhe letra e parë për prindërit që gjendet në fletën e punës faqe 144.

## Ora II – Krijimi i mbetjeve Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të prezantojnë punën "Mbetjet e shtëpisë" Diskuton me nxënësit rreth artikujve që kanë sjellë për Qendrën e Riciklimit dhe u shpjegon se lëndët e para bëhen mbetje si pasojë e prodhimit dhe konsumit.

Më pas mësuesi/ja u tregon nxënësve shishe plastike, konserva alumini, gazeta, copa nga rroba të vjetra, lëvore banane dhe mbeturina nga hekuri. Pyesni nxënësit se a krijohen mbetje të njëjta në shtëpitë e tyre, si dhe lloje të tjera të mbetjeve, të cilat mund t'ju kujtohen, e të cilat i krijojnë familjet e tyre. Renditen përgjigjet e nxënësve në tabelë.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4-5 nxënës dhe parashtron punën kërkimore duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- Cilat materiale nuk do të shpërbëhen?
- Cilët materiale do të shpërbëhen të parat? Për cilët prej tyre procesi i shpërbërjes do të zgjasë më tepër se zakonisht?
- Cilët nga këto mund të ripërdoren përsëri ose të përpunohen?

Pas përfundimit të punës së grupeve mësuesi/ja organizon diskutimin nga i cili do të dalin ide të ndryshme për aktivitete, të cilat do të mund të ndërmerren për:

- shisheet e qelqit (të mbledhura, të lara, të futura përsëri në përdorim);
- shisheet e plastikës (të mbledhura, të ndara, të shtypura, të paketuara),
- konserva alumini, kanoçe (të mbledhura, shtypura me qëllim të zvogëlimit të vëllimit, të paketuara).



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja fton nxënësit të japin mendimet e tyre rreth pyetjeve si:

- A mund të përdoret përsëri gota bosh e larë e kosit?
- Çfarë bëni me letrën e përdorur? Etj.

Në fund theksohet se mbledhja dhe riciklimi i mbetjeve kërkon pjesëmarrje të gjithë shoqërisë, duke filluar nga familja, e cila mund ta ndajë mbetjet shtëpijake dhe ta çojë në pikat e specializuara për menaxhimin e mbetjes dhe përpunimin e saj.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetritin gjatë zhvillimit të veprimtarive në grup si dhe gjatë diskutimeve dhe mendimeve që japin gjatë situatave të parashtruara.

### Detyrë shtëpie:

Në punë në grup të ndërmarrin nisma për grumbullimin e mbetjeve të ndara sipas materialit bazë.

## Ora III – Krijimi i mbetjeve Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja parashtron para nxënësve dilemën e mëposhtme dhe i fton në diskutim:

Një ditë të bukur ju shkoni për piknik me familjen tuaj në një park. Pasi mbaroni piknikun, familja juaj fillon të largohet pa i mbledhur mbetjet e hedhura rreth e përçark vendit ku ka qenë ngritur tenda e piknikut. Çfarë do të bëni ju?

- Ju nuk i lejoni ata që të largohen pa mbledhur mbetjet e hedhura sa andej këndeje;
- Prisni që ata të largohen, të mbledhin tendën dhe pastaj ju i mblidhni vetë mbetjet e hedhura pa kujdes në park;
- Mendoni se dikush tjetër duhet të shqetësohet për mbetjet e hedhura pa kujdes.
- Bashkia duhet të dërgojë dikë në park që të grumbullojë përditë mbetjet që njerëzit lënë pas piknikut.
- Koshat e mbetjeve ishin larg nga vend i piknikut dhe ju jeni i vogël për ti pastruar dhe grumbulluar ato.
- Diçka tjetër.

Gjatë diskutimit ftohen nxënësit të tregojnë përvoja nga jeta e tyre e përditshme.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Në vazhdimësi të diskutimit të dilemës mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtarinë “Semafori për mbetje”. Qëllimi i veprimtarisë është që nxënësit të nxiten të mendojnë para se të hedhin diçka në koshin e mbetjeve. Në një fletë ose karton vizatohet një semafor dhe shënohen tri dritat: e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër, ndërsa në fushat e tyre shkruani tekstin.

- *Drita e kuqe me tekstin:* Mos hidh, mund ripërdorësh ose të dorëzohet në pikën grumbulluese dhe të çohet në përpunim. Pse hedh?
- *Drita e verdhë:* Mendo nëse është mbetje që duhet hedhur në kosh apo mund të shfrytëzohet sërish për diçka tjetër?
- *Drita e gjelbër:* Hidhe mbetjen në kosh, ajo nuk mund të riciklohet.

Vendosni semaforin pranë koshit të mbetjeve dhe udhëzoni nxënësit që të shikojnë semaforin para se të hedhin diçka në kosh.

Nxënësit veprojnë duke simuluar objekte të ndryshme që mund të hidhen në kosh dhe më pas zhvillohet diskutimi midis nxënësve se:

- A duhet vërtet sendi të përfundojë në kosh?
- A ka mënyrë tjetër?

Të gjitha materialet e nxënësve klasifikohen sipas grupeve të përbërësve bazë të tyre.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe sjellin situata të ngjashme nga jeta e tyre e përditshme.

Në fund mësuesi/ja parashtron pyetjen: Si do të veprësh me shishen plastike të përdorur? Ajo fton nxënësit të përzgjedhin alternativën e duhur. Diskutohet alternativa e përzgjedhur.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarisë si dhe gjatë diskutimeve dhe qëndrimeve të tyre.

### Detyrë shtëpie:

Të bëjnë një hulumtim për mbetjet që ata ndajnë në shtëpi dhe të tregojnë se cilat nga këto mbetje mund të përdoren përsëri ose përpunohen.



Fusha	Shkencat e natyrës
Shkalla	I-II
Tema mësimore	Festivali i mbetjeve
Kohëzgjatja	3 orë mësimore
Rezultatet e të nxënësve	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>menaxhon ndarjen e mbetjeve sipas materialit themelor të prodhuar;</li> <li>planifikon veprimtari për ripërdorimin e sendeve, objekteve etj;</li> <li>shpreh përgjegjësinë e tij për mbrojtjen e mjedisit duke ricikluar.</li> </ul>
Situata e të nxënësve	Zërat e pazakontë. Çfarë konsumatori jam unë? Treni i mbetjeve. Festivali i mbetjeve.
Fjalët kyç	Festivali i mbetjeve, planeti Tokë, qelq, plastikë, letër, metal.
Burimet materiale	Kuti nga kartoni, shishe dhe gota nga plastika, konservat nga alumini, gazeta, revista të vjetra, sendet e mbetjeve të sjella nga fëmijët, gërvshërë, laps, letër, gërvshërë, ngjitës.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.

### Ora I – Festivali i mbetjeve Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesja e fillon orën e mësimin me vjershën “Shishja është e riciklueshme” në fletën e punës faqe 145 duke e recituar atë si marsh.

Mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimin e tyre rreth pyetjeve:

- Çfarë mbeturinash selektoni në shtëpi?
- Cilat nga këto mbeturina mund të përdoren përsëri ose përpunohen?

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë pjesën “Zërat e pazakontë” në faqen 143 të fletës së punës dhe me pas në punë dyshe të plotësojnë tabelën:

Personazhet	Problemi	Zgjidhja e problemit
Letra		
Plastika		
Qelqi		
Planeti Tokë		

Nxënësit prezantojnë zgjidhjet e tyre për problemin që kanë: Letra, Plastika, Qelqi dhe Planeti Tokë. Nxënësit shprehin mendimet dhe qëndrime të tyre rreth zgjidhjeve të njëri-tjetrit.





Në vazhdimësi mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth fjalëve:

- *Eja të bëjmë një aksion pastrimi. Eja t'i mbledhim të gjithë shokët tanë, t'ju themi se çfarë dëgjuam dhe t'i përvishemi punës. T'i mbledhim këto mbetje dhe ta shpëtojmë planetin tonë të çmueshëm.*

Më pas nxënësin ushtrohen në punë me grupe me nga 4-5 veta për të planifikuar veprimtari sipas qëndrimeve të tyre për shpëtimin e planetit tokë.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur

Çdo grup prezanton veprimtaritë që ka planifikuar. Ftohen nxënësit e çdo grupi që të shkruajnë një mesazh në tabelë për mbrojtjen e planetit Tokë. Nxënësit shprehin vlerësime për punën e njëri-tjetri.

#### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimeve, qëndrimeve dhe planifikimit të punëve në grup.



#### Detyrë shtëpie:

- Të shkruajnë vazhdimin e tregimit “Zërat e pazakontë” sipas imagjinatës së tyre.
- Të gjejnë informacion se si prodhohet letra.

## Ora II – Çfarë konsumatori jam unë Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë nga informacionet që kanë marrë për detyrë shtëpie se si prodhohet letra. Më pas nxënësit nxiten të thonë mendimet e tyre se cilat janë pasojat e prodhimit të letrës në mjedis dhe si zgjidhet problemi.

Pasojat e prodhimit të letrës për mjedisin	Zgjidhja e problemit

Mësuesi/ja thekson mesazhin që del nga veprimtaria se: “Riciklimi i letrës mbron mjedisin”.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Zhvillohet veprimtaria “Çfarë konsumatori jam unë?” që gjendet në faqe 142 të librit.

Diskutohet me nxënësit për shpenzimin e letrës në rastin e parë gjatë përdorimit të lirë të letrës dhe në të dytin pasi t’i keni udhëzuar që me kujdes ta shfrytëzojnë letrën. Ftohen nxënësit të bëjnë vlerësimin e tyre duke i dhënë përgjigje pyetjes: “Çfarë konsumatori jam unë?”

Kjo veprimtari mund të zhvillohet dhe si garë midis paraleleve me titullin “Çfarë konsumatorësh jemi ne” (për letër, fletore, markera, bllok për vizatim etj).

**Shënim për mësuesin:** Kjo veprimtari mund të zhvillohet për disa ditë dhe mund të shpallet dhe një konkurs midis klasave paralele “Çfarë konsumatori jemi ne”.



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në diskutim me nxënësit propozoni organizimin e një aksioni për mbledhjen e letrës dhe plastikës së përdorur. Nxënëset u jepet modeli i një plani veprimi si më poshtë. Ndahet klasa në grupe me nga 4-5 veta dhe udhëzohen se planin e veprimtarive duhet ta bëjnë sa më konkret në bazë të mjedisit ku jetojnë si dhe të përcaktohen saktë afatet kohore të zhvillimit të veprimtarive.

- Vendosni bashkëpunim me Njësinë Bashkiake për sigurimin e shpërblimeve.
- Shpalleni datën e organizimit të aksionit. Ftoni njerëzit që të marrin pjesë përmes: fletëpalosjeve, ftesave, gazetave lokale, radios lokale ose stacioneve TV.
- Siguroni kuti kartoni, të cilat do t' i përdorni për mbledhjen e plastikës dhe letrës.
- Ditën e ngjarjes, procesin e mbledhjes së mbetjeve merreni me seriozitet. Nëse është e mundur, siguroni peshore dhe matni masën e asaj që është sjellë dhe shënioni se nga kush është sjellë. Ndani shpërblime.
- Shpallni rezultatet përfundimtare dhe vendosni se a duhet të ndani shpërblim për ndotësin më të madh apo grumbulluesin më të mirë të mbetjeve.
- Mos harroni – ngjarja e juaj është mirë të publikohet në shtyp.

Nxënësit prezantojnë plane e tyre sipas grupeve dhe shprehin mendime për punët e njëri-tjetrit.

Në fund zhvillohet testi: “Konsumator i përgjegjshëm”. Diskutohen zgjidhje alternativave.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarive në grup, zgjidhjes së testit, diskutimeve dhe mendimeve që japin gjatë situatave të parashtruara.

### Detyrë shtëpie:

Në punë në grup të ndërmarrin nisma për grumbullimin e mbetjeve të ndara sipas materialit themelor.

U jepet fëmijëve letra e prindërve, për të realizuar trenin e mbetjeve që gjendet në fletën e punës duke përcaktuar edhe shkronjën e alfabetit që do të gjejë objektin.

## Ora III – Treni i mbeturinave Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja zhvillon veprimtarinë “Treni i mbetjeve”. Mësuesi/ja përdor shkronjat e alfabetit për të identifikuar artikujt që janë të riciklueshëm ose që mund të konsiderohen mbetje. Mësuesi/ja i cakton çdo fëmijë një shkronjë të alfabetit dhe secili prej tyre duhet të gjejë në thesin e përbashkët objektin që fillon me atë shkronjë, duke e bashkëngjitur në copën e kartonit të prerë në formën e vagonëve me shkronjën përkatëse.

Ndihmojini të shkruajnë emrin e sendit dhe shkronjës që ajo fillon në vagonin e trenit të shkronjave. “Lidh” vagonat e trenit së bashku në rend alfabetik me copëza fijesh. Trenin e mbetjeve vendoseni në murin e klasës dhe ftoni çdo nxënës të flasë për vagonin e tij të trenit.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve veprimtaritë që do kryejnë për përgatitjen e ekspozitës “Festivali i mbetjeve”. Nxënësit ndahen në grupe sipas prirjeve dhe dëshirave të tyre .P.sh:

- Grupi që do të krijojë skulptura me kuti kartoni ose alumini.
- Grupi që do të krijojnë stoli dhe shirita prej letre ose rrobe.
- Grupi që do të krijojë kostume për paradën e modës me materiale të përdorura ose të vjetra, plasmas ose letër gazete,
- Grupi i koncertit që do të krijojë vargje origjinale në prozë ose poezi me temë përdorimi i mbeturinave ose të krijojë melodi me tingujt e mbeturinave të ndryshme.
- Grupi i përgatitjes së ftesave dhe posterave.

Nxënësit zhvillojnë të pavarur punën e tyre sipas grupeve. Mësueset mund të ndihmojnë nxënësit edhe me sugjerimet që janë dhënë në fletën e punës për realizimin e këtij festivali. Ky aktivitet mësimor mund të zhvillohet dhe për dy orë. Mësuesi vendos vetë për kohëzgjatjen e tij.



**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Për datën e prezantimit të ekspozitës vendoset bashkërisht me nxënësit. Gjatë prezantimit mund të ftoni nxënësit nga klasat e tjera, prindërit, përfaqësues të bashkisë si dhe biznesmenë vendorë të cilët mund të sigurojnë shpërblime simbolike për fituesit.

Ekspozita mund të promovohet dhe në TV si dhe rrjete sociale për të sensibilizuar njerëzit të mendojnë rreth mbrojtjes së mjedisit duke ricikluar mbetjet e tyre.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarive në grup si dhe për produktet e krijuar nga mbetjet.

**Detyrë shtëpie:**

Të realizojnë rolin e caktuar në grupin e punës.

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	HI
<b>Tema mësimore</b>	Kujdesem për mjedisin
<b>Kohëzgjatja</b>	1 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>shpreh përgjegjësinë e tij/saj ndaj mjedisit;</li> <li>tregon me shembuj kujdesin që tregon për të mirën e përbashkët në komunitetin ku jeton;</li> <li>bashkëvepron me të tjerët/at në klasë për të zgjidhur probleme të ndryshme;</li> <li>vlerëson rëndësinë që ka kujdesi ndaj mjedisit për të ardhmen.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënit</b>	Mjedise të ndryshme të ndotur.
<b>Fjalët kyç</b>	Zhvillim shoqëror, përgjegjësi, ricikloj, grupoj, e mira e përbashkët.
<b>Burimet materiale</b>	Fletë pune, laptop.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arte.

**Ora I – Kujdesem për mjedisin  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimi fillon me prezantimin nga mësuesi/ ja në videoprojektor ose me foto të disa pamjeve të mjediseve të ndryshme të ndotura. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth mjediseve të paraqitura dhe renditen në tabelë ndotësit e secilit mjedis. Më pas, mësuesi/ja orienton nxënësit/et të vërejnë foton në fletoren e punës dhe të diskutojnë rreth pyetjes: Çfarë ndodh nëse hedh mbetjet në klasën ku mësojmë?

Plotësohet tabela:

Veprim	Pasojë



## Konsumi dhe mbetjet

Nxënësit/et lexojnë dhe shprehin mendimet e tyre rreth pasojave që vijnë nga ndotja e mjedisit. Parashtrohet pyetja: “Si tregoj kujdes ndaj mjedisit?”. Nxënësit/et sjellin përvojat e tyre jetësore se si veprojnë me mbetjet dhe si kujdesen për mbrojtjen e mjedisit.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë fotot dhe të lexojnë fjalitë përkrah tyre.

Në situatën e parë, nxënësit/et në punë individuale të pavarur, renditin materialet që riciklojnë dhe më pas plotësojnë me shkrim se çfarë ndodh nëse nuk grupojmë mbetjet.

Unë ricikloj: .....

Çfarë ndodh nëse nuk hedh në vendin e caktuar mbetjet? .....

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et prezantojnë, komentojnë dhe vlerësojnë punët e njëri/a-tjetrit/ës.

Në situatën tjetër, nxënësit/et plotësojnë me shkrim se çfarë nuk duhet të shpërdorohet në shtëpi dhe në shkollë.

Çfarë nuk duhet të shpërdorohet në shtëpi? .....

Çfarë nuk duhet të shpërdorohet në shkollë? .....

Më pas, mësuesi/ja i fton të tregojnë me shembuj kujdesin që tregojnë për kursimin e ujit, energjisë elektrike, etj.

Në situatën tjetër, nxënësit/et i përgjigjen me shkrim pyetjeve:

“Pse duhet të mbjell pemë?” .....

Çfarë lloj pemësh duhet të mbjell në mjedisin tim? .....



Ftohen nxënësit/et të prezantojnë punët dhe të tregojnë shembuj të ngjashëm me situatat, duke u bazuar në të përditshme të tyre. Theksohet rëndësia që ka kujdesi ndaj mjedisit për të ardhmen e tyre dhe të gjithëve.

Më pas mësuesja orienton nxënësit/et të ngjyrosin fletën e punës që gjendet në faqet 147-148. Më pas ata e e përshkruajnë atë me fjalët e tyre dhe gjejnë një titull për të. Një nga mesazhet e vizatimit mund të jetë “Shpëtoni Tokën! Ndaloni përdorimin e qeseve plastike!”.

Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre se pse nuk duhet të përdorim qese plastike. Më pas, mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe. Çdo grup përgatit një poster, sipas dëshirës, për të ftuar banorët e komunitetit të mbrojnë mjedisin.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të punës së grupeve, nxënësit/et prezantojnë posterat, komentojnë dhe vlerësojnë punët e njëri/a-tjetrit/ës.

Në varësi të kushteve të klasës dhe shkollës, mësuesi/ja mund të planifikojë veprimtari konkrete me nxënësit për kujdesin ndaj mjedisit. Kjo veprimtari mund të zhvillohet e integruar edhe me lëndë të tjera.

Në fund mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimet rreth fjalive Veprim — Pasojë:

- Unë kujdesem për mjedisin.
- Unë kujdesem për të mirën e përbashkët.

### Vlerësimi:

Gjatë orës së mësimit, nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën për punë e tyre në grup.

### Detyrë shtëpie:

Nxënësve u parashtrihen disa detyra shtëpie, për shembull:

- Vendosja e posterave në mjediset publike të komunitetit të tyre;
- Veprimtari konkrete për mbrojtjen e mjedisit.



DILEMA

## Mbetje, kudo vetëm mbetje

Një ditë të bukur ju shkoni për piknik me familjen tuaj në një park. Pasi mbaroni piknikun, familja juaj fillon të largohet pa i mbledhur mbetjet e hedhura rreth e përçark vendit ku ka qenë ngritur tenda e piknikut. Çfarë do të bëni ju?

- Ju nuk i lejoni ata që të largohen pa mbledhur mbetjet e hedhura sa andej këndeje;
- Prisi që ata të largohen, të mbledhin tendën dhe pastaj ju i mblidhni vetë mbetjet e hedhura pa kujdes në park;
- Mendoni se dikush tjetër duhet të shqetësohet për mbetjet e hedhura pa kujdes.
- Bashkia duhet të dërgojë dikë në park që të grumbullojë përditë mbetjet që njerëzit lënë pas piknikut.
- Koshat e mbetjeve ishin larg nga vend i piknikut dhe ju jeni i vogël për ti pastruar dhe grumbulluar ato.
- Diçka tjetër.



TEST

## Konsumator i përgjegjshëm

	E SAKTË	E GABUAR
1 Në shoqërinë e sotme shpenzohet pa masë dhe pa menduar për brezat e ardhshëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Sa më shumë të konsumojmë aq më pak burime dhe energji harxhojmë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Në kohën e sotme shumica e materialeve mund të riciklohen.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Ripërdorimi bën që mbetjet të pakësohen.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Ricklimi i zvogëlon burimet e pasurive natyrore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Sendet duhet të shfrytëzohen maksimalisht dhe jo vetëm një herë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Letra dhe plastika nuk mund të riciklohen.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Nëse i hedhim shishet e plastikës pa i shtypur, ato zënë më shumë vend.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Përdorimi i qeses së pambukut gjatë blerjes është më i mirë për mjedisin jetësor se sa përdorimi i qeseve të plastikës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E saktë 4. E gabuar 5. E gabuar 6. E saktë 7. E gabuar 8. E saktë 9. E saktë





## FLETË PUNE

# Mbetjet tona

1 Studioni materialet themelore nga të cilat është krijuar mbetja që gjendet në koshin e klasës suaj.

### Materialet bazë

### Numri i gjërave të gjetura në koshin e mbetjeve



Metal



Letër



Materiale organike



Plastikë



Qelq

2 Sa është pesha e mbetjeve që hedhin poshtë nxënësit e një klase për një ditë të vetme?

3 Nëse secila prej klasave të shkollës suaj krijon po aq mbetje sa klasa juaj, sa mbetje krijohet në shkollën tuaj gjatë një dite?





## FLETË PUNE

# Mbetjet e shtëpisë

Studioni mbetjet që hidhen në shtëpinë tuaj, duke vendosur kuti të mëdha kartoni pranë koshit të mbetjeve. Shënioni mbi kuti emrat në vijim: për plastikë, metal, letër, shishe qelqi, karton dhe lloje të tjera të paketimeve. Iu kërkoni anëtarëve të familjes që të mos i hedhin sendet e vjetra në kosh por ti mbledhin ato nëpër kutitë, ndërsa mbetjet që dalin nga ushqimi (mbetje t që dalin nga pastrimi i perimeve apo frutave, apo dhe shishe të thyera qelqi etj.) duhet të hidhet në koshin e mbetjeve si zakonisht. Ky është një projekt studimi që do të zgjasë vetëm një javë. Më pas plotësoni të dhënat në tabelën mëposhtëme.

### Materialet e mbledhura

### Numri i copëve



Shisheet e qelqit



Shisheet plastike



Kanoçe alumini, metal



Letër



Karton



Paketime tjera



Materiale tjera (si mbetje pambuku, druri etj)

Emri i studiuesit:

Studimi filloi më:

Përfundoi më:

Numri i anëtarëve të familjes:





## FLETË PUNE

# Çfarë konsumatori jam unë?



Merrni një sasi të caktuar letre (një pako letër A4) dhe u thoni nxënësve që kjo letër do të shërbejë për vizatim dhe për përdorim në klasë.

Mos ju përmendni asgjë që kjo pako me letër duhet të përdoret sa më gjatë dhe se nxënësit duhet ta kursejnë dhe ta shfrytëzojnë racionalisht atë. Lejoni ata që ajo të përdoret spontanisht (secilit të mund të marrë aq sa i duhet).

Ju si mësues shënojeni datën kur e keni dhënë letrën dhe deri kur kjo letër do të përdoret, përkatësisht deri kur do të zgjasë përdorimi i kësaj pakoje. Letrën e shfrytëzuar dhe të vizatuar mund ta mbledhni në një kuti kartoni.

Pasi ajo të harxhohet plotësisht, informoni nxënësit që letra mbaroi, por ju përsëri ju jepni një pako të re letre për ta harxhuar. Kësaj radhe i përmendni fjalët në vijim: Ju lutem përdoreni (shkruani) në të dy anët e letrës, të shfrytëzohet çdo pjesë e saj. Thjesht, tregojuni nxënësve që kësaj here të jenë të kujdesshëm gjatë përdorimit të letrës. Shënoni datën kur e keni dhënë letrën për përdorim dhe deri kur ajo do t'ju shërbejë nxënësve. Mos harroni të grumbulloni të gjitha punimet e nxënësve.

Përsëri ruani të gjitha punimet e nxënësve, për arsye se ato do t'ju jenë të dobishme për fundin e këtij ushtrimi.

- Krahasoni kohën e përdorimit të letrës (herën e parë dhe të dytë).
- Numëroni se sa punime i keni në njërën e sa në tjetrën kuti.
- Bisedoni se kur letra u përdor më me shumë kujdes?
- Kërkojuni nxënësve që të mendojnë edhe për herë të tjera kur janë në rolin e konsumatorit.





## FLETË PUNE

# Zërat e pazakontë

**Arianiti:** Përshëndetje Arta! E shoh se edhe ti ke paske ardhur herët.

**Arta:** Përshëndetje Arianit! Më vjen mirë që të shoh.

**Arianiti:** Çfarë të rejash kemi? Si je?

**Arta:** Asgjë të re vetëm gjëra të vjetra... (ndërpret) Urdhëro?

**Arianiti:** Çka? Çfarë the?

**Arta:** Unë, asgjë, por dëgjova disa zëra!

**Arianiti:** (i habitur) edhe unë e dëgjova të njëjtën. Shshshsh! Dëgjo, mbetjet e hedhura aty po flasin! E dëgjon?

**Arta:** Po... Por, si është e mundur!? (e habitur) Eja të dëgjojmë se çfarë thonë!



**Letra:** O zot, o zot! U lodha vazhdimisht të jem në të njëjtin vend, e palëvizshme, e ndotur, e pashfrytëzuar. Kam mbi një javë gjendem në këtë vend. Askujt nuk i kujtohet të më largojë prej këtu dhe të më vendosi në koshin e riciklimit të letrës, e më pas të më përpunojë. Atëherë do të bëhesha e bukur, e pastër, e dobishme, por ndoshta edhe me aromë të mirë. Uh, e mjera unë... kush do të presë një vit që të shpërbëhem dhe të shpëtojë nga këto vuajtje!



**Plastika:** Lum si ti! Për mua një vit nuk është asgjë. Ti nuk duhet të ankohesh, një vit është pak! Unë këtu rri e ndotur, e ekspozuar në shi, erë, borë, prej mëse katër muajsh. E mjera unë. Që të shpërbëhem, duhet të presë pesë shekuj! dëgjon, pesëqind vjet! Do të dëshiroja që të jem në koshin e riciklimit, që pastaj të më dërgojnë në fabrikën më të afërt të përpunimit, që të më pastrojnë dhe përsëri të më përdorin dhe prapë të bëhem e bukur dhe e dobishme!



**Qelqi:** E mjaft më! Nuk mund t'ju dëgjoj! Mos u ankoni! Të paktën ju një ditë do të zhdukeni! (i hidhëruar) E çfarë të them unë!? Unë do të jetoj vazhdimisht, asnjëherë nuk do të shpërbëhem. Vazhdimisht do ti shikojë këta nxënës, shkatërrues të pasjellshëm ndaj mjedisit se si më shkelin në oborrin e shkollës. (i pikëlluar) Eh, sikur të isha në ndonjë kosh të posaçëm për qelq, e jo kështu i hedhur dhe i ndotur! Deri më tani mbi një qind herë do të më kishin përpunuar! Aspak nuk ndjehem mirë!



**Planeti Tokë:** Ndalni pak! Nuk jeni për tu ankuar. Pse mendoni vetëm për veten tuaj? Unë vazhdimisht jam i ndotur. Mbjaj peshën e të gjitha mbetjeve, të hedhur me shekuj më parë, por tanimë gjithnjë e më tepër bëhet e padurueshme. Nuk mund të duroj më. Ju lutem të ndaloni së ankuari, sepse nëse vazhdon kështu, unë do të shkatërrohem, ndërsa edhe ju bashkë me mua do të shkatërroheni. Po e harxhoj fuqinë e fundit.



**Arta dhe Arianiti:** (shikojnë njëri-tjetrin të habitur, të hutuar, me shumë ide në kokë).

**Arta:** Arian, eja të bëjmë një aksion pastrimi. Eja ti mbledhim të gjithë shokët tanë, t'ju themi se çfarë dëgjuam dhe t'i përvishemi punës. Ti mbledhim këto mbetje dhe ta shpëtojmë planetin tonë të çmuar!



### FLETË PUNE Letra e dytë



*I dashur prind,*

Më ....., ne do të krijojmë një  
"Tren mbeturinash A-Z".

Fëmijës suaj i është caktuar shkronja ".....". Ndhmoni fëmijën tuaj të gjejë një objekt të pastër nga koshi i mbetjeve që fillon me këtë shkronjë. Për shembull, A: një kuti bosh alumini e prishur kafshësh; Z: një zinxhir i vërtetë; D: Disk ;Q: send ose objekt qelqi, etj .

Ju lutem na dërgoni vetëm një copë të objektit të mbetjes. Sigurohuni që është i pastër, më i vogël dhe jo shumë i rëndë.

Ne shpresojmë që fëmijët do të fillojnë të kuptojnë që ka një larmi të madhe sendesh që mund të kenë një cikël të ri jete dhe jo të përfundojnë si mbetje pa vlerë tek koshi i shtëpisë.

*Faleminderit për ndihmën tuaj,*



### FLETË PUNE Letra e parë



*I dashur prind,*

Meqenëse riciklimi është një mënyrë e rëndësishme për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve shtëpiake, ne kemi ngritur në shkollën tonë Qendrën e Riciklimit në kuadër të Shkollës Qendër Komunitare. Në këtë qendër, fëmija juaj praktikon riciklimin dhe si të ripërdoren gjërat. Ne kemi nevojë për ju për të na ndihmuar të mbledhim disa artikuj për të mirë funksionuar kjo qendër.

Ju lutemi ndihmohuni fëmijët tuaj që të mbledhin dhe të sendet e listës së mëposhtme.

*Faleminderit për bashkëpunimin  
Qendra e Riciklimit*

Sendet që po kërkojmë përfshijnë:

- Një shumëllojshmëri të kutive me madhësi të ndryshme (kuti këpucësh, ushqimesh, dhuratash etj);
- Tubi prej kartoni që shërben si mbajtësja e letrës higjienike;
- Letra e paketimit të dhuratave;
- Kartonët e vezëve (letër dhe plastik);
- Kutitë kartoni qumështi (madhësi të ndryshme letre dhe plastike);
- Revistat e vjetra, kartat e përshëndetjes, letër ambalazhi, postë;
- Tasat e kosit (sidomos me kapak të pastër);
- Kanoçe për kafe, coca-cola, etj
- Mbulesa plastike;
- Mbështjellëse kartoni për pica;
- Pëlhurë, fije dhe shirita fjongoje;
- Kopsa, fara, fasule të thata, bizele;
- Kavanoza qelqi
- Të tjera: .....



## FLETË PUNE Vjersha e këngë ritmike

“Shishja është e riciklueshme”

Shishja riciklohet,

Shishja riciklohet,

Shishja riciklohet.



---

### Variacionet:

Gazeta është ricikluar,. . .

Kutia e aluminit riciklohet,. . .

Shporta plastike riciklohet,. . .

Kanaçja e aluminit mund të riciklohet,. . .

“Nëse ju ndihmoni të ricikloni”

Duartrokit.

Nëse ju ndihmoni të ricikloni,

Duartrokit.

Nëse ju ndihmoni të ricikloni,

Atëherë toka jonë më e pastër do të jetë,

Nëse ju ndihmoni të ricikloni,

Duartrokit.



---

### Variacionet:

Mbylli këmbët tuaja, uleni kokën tuaj, bërtisni “Urra”





## FLETË PUNE

# Modele sendesh të ricikluara

Ne mund tu japim një jetë të re sendeve të ndryshme, duke i ricikluar ato. Disa shembuj të thjeshtë jepen më poshtë:



### Mbajtëse lapsash e stilolapsash

Mund të mbliidni disa rrotulla letrash higjienike. Ato zbukurohen me letra të bukura të paketimit të dhuratave dhe i vendosini atyre një fund të sheshtë, kështu do të kishit një mbajtëse lapsash që ta mbanit në tryezën tuaj të studimit.



### Zhurma e erës nga çelësat e vjetër

Të gjithë ne kemi kaç shumë çelësa të padobishëm nëpër shtëpi. Pritni litarët me gjatësi të ndryshme dhe i lidhni në një unazë për të shpuar, sic tregohet në figurë.



### Një aeroplan me kapëse e shkopinj

Fotografia është vetë shpjeguese. Duhet ta përshkruaj këtë tani? Ju mund të përdorni këtë ide të veçantë dhe kërkoni fëmijën tuaj që të bëjnë këtë aeroplan për projektin e tij të shkollës nga mbetjet, duke përdorur vetëm shkopinj akulloresh dhe një kapëse rrobash.



### Breshkë letre

Duke përdorur një pjatë letre dhe disa letra me ngjyrë, ju mund ta bëni këtë breshkë shumë të bukur letre.





## FLETË PUNE

Ngjyrosni dhe gjeni një titull për vizatimin.





## FLETË PUNE

Ngjyrosni dhe gjeni një titull për vizatimin.





## Shoqëria dhe mjedisi

Të gjithë njerëzit janë pjesë e një **shoqërie**. Kjo shoqëri mundëson një sërë të mirash, si shtëpi, punë, argëtim, e shumë gjëra të tjera të nevojshme për të jetuar. Shumica e njerëzve janë të kënaqur me mënyrën e tyre të jetesës dhe me atë që kanë, por disa të tjerë jo. Me qëllimin për të patur kushte sa më të mira jetese, njerëzit shfrytëzojnë të mirat natyrore. Të gjitha aktivitetet e njeriut, siç janë: prodhimi dhe konsumi, shfrytëzimi i minierave, i pyjeve dhe i ujërave, ndërtimet e mëdha në sipërfaqet e lira të gjelbra dhe të tjera, kanë ndikim serioz ndaj mjedisit.

Që një **shoqëri të jetë e qëndrueshme duhet të arrihet një** baraspeshë midis mënyrës së jetesës dhe natyrës. Njerëzit po i shfrytëzojnë maksimalisht burimet natyrore - ujin e pijshëm, ajrin, drutë për ngrohje, sipërfaqet e tokës për rrugë e ndërtime pa fund, etj., ndërkohë që nuk kontribuohet aspak në ripërtëritjen e këtyre burimeve. Njerëzit duhet të kujdesen për zhvillimin e qëndrueshëm të vet natyrës, pasi ajo nuk mund të na sigurojë lëndë të parë më shumë seç mundet. Ndërtimi i shoqërisë së qëndrueshme është një proces i gjatë, ku çdo individ duhet të kontribuojë me sjelljen dhe veprimet e tij në ruajtjen e të mirave në Tokë dhe në botën e gjallë. Në këtë mënyrë, edhe brezat e ardhshëm do të mund të kenë **kushte për një jetë më të mirë** duke ruajtur natyrën.

Sfida me të cilën përballen shoqëria sot është që rritja ekonomike të mos sjellë ndikime madhore në mjedis si pasojë e konsumit të shtuar, e përdorimit të paqëndrueshëm të burimeve natyrore dhe e prodhimit të mjetëve. Të kesh një kompjuter në çdo dhomë të shtëpisë apo një makine për çdo anëtar të familjes nuk mund të quhet sukses i ekonomisë nëse ne vazhdojmë të zhdukim llojet e bimëve apo të kafshëve, të shkatërrojmë pyjet, të gërmojmë malet e lumenjtë, të ndryshojmë klimën, të ndotim ajrin dhe ujin etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi i shoqërisë që mundëson përparimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve dhe njëkohësisht mbrojtjen e natyrës dhe të botës së gjallë.



### Planifikimi ditor i temës Shoqëria dhe mjedisi

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës dhe ato shoqërore
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Zhvillimi shoqëror dhe mjedisi
<b>Kohëzgjatja</b>	2-3 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënësve</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>demonstron se ka kufizime në natyrë të cilat nuk mund të tejkalohen;</li> <li>analizon ndryshimet negative në mjedis të cilat çojnë në konflikt;</li> <li>shpreh përgjegjësinë e tij/saj ndaj mjedisit jetësor duke treguar se nëpërmjet bashkëpunimit dhe tolerancës, mund të tejkalohen vështirësitë;</li> <li>vlerëson atë që mund t'i japë brezit të ardhshëm duke ndarë me të tjerët/at përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga jeta e përditshme.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënësve</b>	Lumi i lirë. Baraspesha. Sfida. Si mund të ndihmoj unë? Aeroplanë për zhvillim të qëndrueshëm.
<b>Fjalët kyç</b>	Zhvillim shoqëror, përgjegjësi, baraspeshë, shpërngulje, zhdukje.
<b>Burimet materiale</b>	2 gota të ujit me madhësi të ndryshme, letër me ngjyrë, markera, fletë pune.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arte pamore, Vendlindje, VJK etj.

### Ora I – Zhvillimi shoqëror dhe mjedisi Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjeve:

- Cila është lidhja midis madhësisë së vendbanimit dhe numrit të organizmave që jetojnë në të?
- Cilët janë faktorët e rëndësishëm që përcaktojnë popullimin e organizmave në një vend?

Shkruhen në tabelë faktorët si: ushqimi, uji, mjedisi, hapësira.

Mësuesi/ja thekson se popullimi i një habitati vlen për gjithë organizmat e gjallë si për njerëzit që mund të përshtaten më lehtë me ndryshimet e kushtet e mjedisit jetësor, ashtu dhe për bimët dhe kafshët për të cilat përshtatja është më e vështirë. Theksohet se përshtatja e organizmave në një mjedis jetësor ndryshon në varësi të:

- Ndryshimeve të stinëve të vitit.
- Fatkeqësive natyrore (për shembull, përmbytjeve, stuhive, acareve, vullkanet etj).
- Ndikimit të aktiviteteve të njeriut.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Për të ilustruar kapacitetin e popullimit të një vendbanimi mësuesi/ja merr një gotë të mbushur me ujë të pijshëm dhe u tregon nxënësve se ky është një ekosistem i populluar me bimë dhe kafshë të ndryshme. Ky ekosistem ka një kapacitet të caktuar për krijesat të cilat banojnë në këtë vendbanim. Më pas fton nxënësit që të shikojnë një ekosistem të vogël. Për këtë qëllim përdor një gotë më të vogël. Mësuesi/ja fillon derdhjen e ujit nga gota më e madhe në atë më të vogël. Kur gjysma e gotës së vogël është e plotë, pyeten nxënësit:





- A ka ende vend për kafshët dhe bimët?

Më pas vazhdon derdhjen e ujit deri sa të mbushet gota e vogël dhe pyeten nxënësit nëse ekosistemi ka arritur kapacitetin e tij mbajtës.

Vazhdon derdhja e ujit në gotë të vogël deri sa të mbushet plot dhe pyeten nxënësit:

- Çfarë po ndodh me ujin e tepërt?

Fton nxënësit të shprehin mendimin e tyre për situatën duke pasur parasysh organizmat e gjalla.

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se bimët nuk mund të përshtaten lehtë nga një mjedis në një tjetër. Fton nxënësit të sjellin shembuj bimësh, që nuk përshtaten dot në një mjedis tjetër dhe kështu që ato vyshken shpejt. Gjithashtu nxënësve u shpjegohet se dhe kafshët nuk përshtaten lehtë në një mjedis tjetër për këtë arsye ose shpërngulen ose vdesin. Nxënësit plotësojnë tabelën me shembuj kafshësh.

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Emrat e kafshëve që shpërngulen	Shkaku i shpërnguljes

Mësuesi/ja fton nxënësit të prezantojnë punët dhe diskutojnë rreth shembujve të njëri-tjetrit. Më pas nxënësit shikojnë dhe diskutojnë rreth kujdesit ndaj kafshëve, shpendëve për mjedisin ku jetojnë dhe ushqimet duke nxjerrë në pah edhe përgjegjësinë e tyre në këtë proces.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrin gjatë prezantim të punëve.

**Detyrë shtëpie:**

Të shkruajnë shembuj të tjerë kafshësh dhe bimësh që nuk përshtaten në mjedisin ku nxënësit jetojnë.

**Ora II – Zhvillimi shoqëror dhe mjedisi  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimin fillon me lojën “Abrakadabra” që gjendet në faqe 164. Mësuesja/si shtron pyetjen se “Cilat janë kushtet që e bëjnë një vend të mirë për të jetuar?”. Për këtë na vjen në ndihmë pikërisht kjo lojë. Udhëzimet e lojës janë në fletën e punës. Gjatë diskutimit mësuesi/ja thekson se kjo situatë është më ndryshe me njerëzit. Njerëzit mund të përshtaten shumë më lehtë në kushte të reja dhe të ballafaqohen me vështirësi të ndryshme. Por, krahas kësaj përshtatje, tejkalimi i kapacitetit të mjedisit, shpeshherë shkakton probleme. Ftoni nxënësit të tregojnë kushtesh e gjetura nga zgjidhja e lojës. Shkruhen mendimet e nxënësve të përmbledhura në tabelë duke realizuar pyetjet Kush? Kur? Ku? Si? Pse?.



Gjatë diskutimit u shpjegohet nxënësve se paraardhësit tanë kanë menduar kur kanë vendosur se ku do të shpërngulen. Në fund, shtëpitë në grupe apo bashkësi janë bërë fshatra, më pas janë rritur dhe janë krijuar qytetet. Bashkësitë e reja të krijuara kanë zhvilluar raporte komplekse edhe me bashkësitë fqinje.



Sot krahas zhvillimit të qytetërimit modern dhe arritjeve të larta të teknologjisë, mirëqenia dhe siguria e njerëzve varen nga mbrojtja e mjedisit dhe nga përdorimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore. Shumë shpesh presionet dhe problemet në rajone të ndryshme fillojnë nga problemet ekologjike

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Për të konkretizuar pohimet e mësipërme mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tregimin “Lum i lirë” në faqe 158 të librit, duke zbatuar teknikën e “Ditari dypjesësh”. Mësuesi pyet nxënësit për fragmentin më të bukur, të komentuar nga ata. Nxënësit ndihmohen nga tabela e punuar nga nxënësit në fletore.

Fragmenti	Komenti

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë shënuar mendimet e tyre, u kërkoni disa prej tyre t’i thonë para klasës. Pas leximit ftohen nxënësit të diskutojnë rreth pyetjeve në vijim:

- *Çfarë ishte uji i lumit?* (Pasuri natyrore, i cili u shërben edhe njerëzve edhe mjedisit jetësor të dy fshatrave).
- *Përse lumi ishte i kënaqur kur afrohej pranë detit?* (Lumi ishte i kënaqur sepse arrinte t’u jepte sasi të barabartë të ujit të gjitha fshatrave dhe në fund të derdhej i qetë në det.)
- *Për çfarë arsye kryeplaku nga fshati më i lartë propozoi ndërtimin e pendës?* (Për shkak të dëshirës për një jetë më të pasur dhe më të mirë. Nuk ka asgjë të keqe në këtë dëshirë, sepse dëshira e natyrshme e të gjithë njerëzve është që të zhvillohen dhe të jetojnë më mirë.)
- *Çfarë gabimesh kanë bërë njerëzit nga fshati i sipërm?* (Ata vendosën që të shfrytëzojnë pothuajse të gjithë pasurinë ujore pa marrë parasysh nevojat e njerëzve në fshatin e poshtëm gjë që solli pasoja serioze.)

Mësuesi/ja fton nxënësit në punë dyshe të renditin pasojat që rrodhën nga gabimet e njerëzve të fshatit të sipërm.

- *Cilat janë pasojat?*  
(Zhdukja e bimëve dhe kafshëve, zvogëlimi i rendimenteve, prerja e pyjeve, varfëria dhe shpërngulja e njerëzve nga fshati i poshtëm, problem midis dy fshatrave, humbja e marrëdhënieve miqësore dhe traditave.)

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Gjatë diskutimit mësuesi/ja përmbledh në tabelë përgjigjet e nxënësve sipas shembullit të mëposhtëm:

Gjendja	Ndryshimi	Arsyeja	Gabimet	Pasojat

- *Gjendja* – uji (pasuria natyrore); përdorimi i tij ishte i balancuar, i shfrytëzuar në mënyrë të barabartë nga të gjithë.
- *Ndryshimi* – kryeplaku vendos që të ndërtojë pengesë për ujin e lumit.
- *Arsyeja* – dëshira për zhvillim dhe jetë më të mirë në fshatin e sipërm.
- *Gabimet* – nuk menduan për nevojën që kishin për ujë njerëzit në fshatin e poshtëm dhe mjedisi në vijim të rrjedhës së ujit.
- *Pasojat* – humbja e bimëve dhe kafshëve, varfëria e njerëzve, shpërngulja dhe grindja.

Duhet të theksohet që kur merren vendime të rëndësishme ato duhet të diskutohen me të gjithë njerëzit që kanë interesa të ndryshme por dhe ndonjëherë të kundërta. Pasojat jo çdoherë mund të parashikohen lehtë dhe shumë shpesh sjellin probleme serioze. Me qëllim që të shmangen ndërlikimet dhe situatat kritike, të gjitha shkaqet dhe pasojat duhet të shqyrtohen më herët.



Kjo nuk është e lehtë dhe shpeshherë nevojitet kohë, durim, dhe respekt i përbashkët për Tokën e cila është shtëpia jonë. Pas çdo situatë mësuesi/ja fton nxënësit të përzgjedhin alternativat e sakta.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit për punët e kryera në shtëpi dhe përgjigjet e dhëna për tregimin “Lum i lirë”.

**Detyrë shtëpie:**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të bisedojnë me prindërit e tyre për tregimin “Lum i lirë” si dhe t’i pyesin ata se si do të vepronin ata për zgjidhjen e këtij problemi.

**Ora III – Shoqëria dhe mjedisi  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve


Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë dilemën: “Vjedhje në pyll” në faqen 157 të fletës së punës. Nxënësit shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me dilemën. Më pas ftohen nxënësit të shprehin mendimin e tyre rreth pyetjes:

- Cilat do të ishin pasojat nëse pyjet do të ishin prerë nga paraardhësit tanë?

Renditen në tabelë pasojat që mund të rrjedhin nga ky aktivitet.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se si ka qenë raporti midis natyrës dhe njeriut më parë dhe se si ka ndryshuar në ditët e sotme. Për këtë vizaton në tabelë një peshore siç është treguar më poshtë.



Në fillim nxënësve u tregohet dhe shënohen lidhjet midis njerëzve dhe natyrës në fillim të historisë së shoqërisë njerëzore. Për shembull:

Njerëzit kanë mbledhur fruta dhe perime, kanë kultivuar bimë, gjuanin dhe i zbusnin kafshët, mbledhnin dru për ngrohje dhe jetonin në shtëpi, të cilat ishin të ndërtuara me thjeshtësi. Shënojeni këtë informacion në kolonën e djathtë.

Bisedohet për popullsinë në një të afërme jo aq të largët (prej kur ka zhvillim teknologjik) dhe për atë se çfarë teknologjie kanë pasur njerëzit atëherë. Diskutohet për atë se shoqëritë në të kaluarën e kanë prishur baraspeshën midis njerëzve dhe natyrës.

Theksohet se në të kaluarën njerëzit nuk kanë mundur ta prishin baraspeshën e sistemeve natyrore.

Në të njëjtën mënyrë, analizohen dhe pasuritë natyrore dhe aktivitetet e njeriut në shoqërinë bashkëkohore.

Nxënësit dinë nga mësimet e mëparshme se ajri, uji, toka, bimët dhe kafshët nuk kanë ndryshuar shumë. Njerëzit, deri diku, e kanë zhvilluar aftësinë e tyre që të shfrytëzojnë lëndë të parë dhe materiale të reja. Nga ana tjetër, aktivitetet e njeriut (për shembull, gjermimi për zhvillimin e industrisë dhe transportit, prodhimi i energjisë për fitimin e rrymës elektrike dhe ngrohjes, prerja e pyjeve, hapja e kanaleve, gjuajtja e peshqve dhe gjuetia e kafshëve) janë të pafundme. Shënohen këto të dhëna në kolonën e djathtë.



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në përmbllje të diskutimit mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth çështjes më poshtë me anë të teknikës së vijës së vlerës:

- *A mund të shpresojmë se ekziston mundësia që peshorja të mbahet e barazpeshuar?*  
Po Jo
- *Çfarë duhet të bëjnë njerëzit?*

Renditen veprimet që duhet të bëjnë njerëzit.

Më pas, nxënësit e ndarë sipas grupeve japin argumentet e tyre.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit gjatë diskutimeve, në bazë të përzgjedhjes së argumenteve që japin për çështjet në diskutim.

### Detyrë shtëpie:

Të bëjnë një kërkim për lidhjen e njeriut me natyrën më parë dhe sot në mjedisin ku ata jetojnë.

## Ora IV – Shoqëria dhe mjedisi Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tregimin *“Kush është më i forti?”* në faqen 159 të fletës së punës. Më pas nxënësit pyeten:

-Si përfundoi debati midis Diellit dhe Erës?

-Çfarë kuptoi Era nga ky debat me diellin?

Si i kuptoni fjalët në fund të tregimit: Një buzëqeshje e ngrohtë dhe një fjalë e këndshme mund të arrijnë më tepër se fuqia.

Gjatë diskutimit të pyetjeve të tregimit mësuesi/ja u tregon nxënësve se në shoqërinë e sotme njerëzit përballen me probleme dhe konflikte të llojeve të ndryshme. E rëndësishme është zgjidhja e tyre të jetë sa më e shpejtë dhe në dobi të njerëzve. Për zgjidhjen e problemeve njerëzit bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Për të konkretizuar se si njerëzit bashkëveprojnë për zgjidhjen e problemeve mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tregimin *“Sfida”* në faqe 161 dhe përrallën *“Repa e stërmadhe”* në faqe 160. Më pas nxënësve u ndahen rolet e tregimit dhe përrallës dhe organizohet dramatizimi me role. Pas dramatizimit mësuesi/ja i pyet nxënësit:

- Çfarë u bëri më shumë përshtypje në këto tregime?
- Cili nga tregimet ishte më interesante?
- Po në jetën e përditshme si veprojnë njerëzit për zgjidhjen e problemeve?

Nxënësit tregojnë shembuj nga e përditshmja e tyre.

Theksohet rëndësia e secilit pjesëmarrës dhe nevoja e bashkimit të përpjekjeve të njerëzve për zgjidhjen e problemeve në mjedisin jetësor. Nëse do të bënim një analogji ndërmjet përrallës dhe mundësive që ka shoqëria e sotme moderne për të zgjidhur problemet. Mendoni sikur secili nga personazhet e përrallës të luajë rolin e një përfaqësuesi të një institucioni, për shembull: gjyshi mund të luajë rolin e një organizate ndërkombëtare, gjyshja mund të luajë rolin e shtetit, mbesa mund të luajë rolin e pushtetit vendor, qeni mund të bëjë pjesën e sektorit të biznesit, macja mund të jetë një organizatë joqeveritare, ndërsa miu një individ i komunitetit.

Interpretoni sërish përrallën, duke iu referuar roleve të reja, ku “repa” përfaqëson një problem të veçantë lumor (p.sh. ndotjen e ujit).

Nxirni përfundime për rëndësinë e çdo pjesëtari dhe nevojën për të bashkuar forcat.



Vëreni se si zgjidhja e një kauze të përbashkët mund të bashkojë edhe “armiqtë” si qenin dhe macen apo macen dhe miun.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja shkruan në tabelë proverbin: “Ne e huazojmë natyrën nga fëmijët tanë” dhe fton nxënësit të diskutojnë rreth kuptimit dhe rëndësisë së tij.

Në kontekst të proverbit, renditen në tabelë përgjegjësitë e secilit brez për atë pasardhës.

Nxënësit ftohen t’i argumentojnë mendimet e tyre me shembuj të ndërlidhur me mjedisin jetësor në qytetin ose fshatin ku ata jetojnë. (p.sh, gjendja e ujit në afërsi të lumit ose liqenit, kërcënimet për llojet e veçanta të kafshëve dhe bimëve etj.).

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë përgjigjeve të pyetjeve, dramatizimit, komenteve dhe qëndrimeve të tyre për zgjidhjen e problemeve.

### Detyrë shtëpie:

Të paraqesin pritjet dhe idetë e tyre për jetën në të ardhmen me anë të vizatimit ose me shkrim me temë: “Toka pas njëqind vitesh”.

## Ora V – Zhvillimi shoqëror dhe mjedisi jetësor Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të prezantojnë detyrat e tyre të shtëpisë për jetën në të ardhmen. Pas prezantimeve mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se secili është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme. E rëndësishme për secilin është që t’i përgjigjemi pyetjes:

- *Çfarë do të mund të bëj unë për ta ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë?*


Për të nxitur nxënësit që të shprehin më mirë mendimet, mësuesi/ja vizaton në tabelë trungun e një druri gjetherënës në dimër, pa gjethe si dhe u shpërndan pesë fletë letre me ngjyrë, të cilat më parë janë prerë në formë të gjetheve. I fton nxënësit që të diskutojnë mendimet e tyre në grupe me nga 4-5 veta dhe më pas të shkruajnë në secilën fletë, diçka që ata do të mund të bënin që ta përmirësojnë jetën në bashkësi.

Theksohet që duhet që të jenë të kujdesshëm që mos të shkaktojnë dëm për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin. Mësuesi/ja u rikujton nxënësve aktivitetet e lidhura me punën e tyre nga orët e mëparshme (Për shembull, mbjellja e drunjve, kujdesi për lulet dhe kafshët, kursimi i energjisë dhe i ujit, shëtitja, biçikleta, oborri i pastër i shkollës, selektimi dhe riciklimi i mbeturinës etj).

Të gjitha grupet në mënyra të ndryshme i prezantojnë idetë e tyre dhe i ngjisin “Fletët” në degët e drurit. Në fund të këtij aktiviteti, rezultati do të jetë një dru i mrekullueshëm i larmishëm i krijuar përmes përpjekjeve të përbashkëta të klasës.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja paraqet para nxënësve skemën e mëposhtme dhe fton nxënësit të diskutojnë rreth përgjegjësisë së secilit për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.



Më pas fton nxënësit të ndahen në dy grupe dhe ulen në karrige përballë njëri – tjetrit në dy rreshta paralel, të larguar disa metra.

Çdo nxënës bën aeroplan prej letre dhe nxënësit shkruajnë në të një porosi që përmban: Dëshira dhe propozime për fëmijët e tjerë të Tokës, politikanë apo organizata kombëtare dhe ndërkombëtare etj për natyrën, ujin, tokën, ajrin, familjen, shoqërimin, ushqimin etj.

Mësuesi u shpjegon nxënësve që të mendojnë për pyetjen:

- *Çfarë është e nevojshme, e domosdoshme dhe e rëndësishme për të gjithë ne, për jetën në Tokë duke dhënë mesazhin për banorët e tjerë të botës?*

Çdo nxënës shkruan për shembull: Uji është i domosdoshëm dhe duhet t'a ruajmë! E hedh aeroplanin drejt grupit tjetër, ndërsa nxënësi përballë e kap dhe e lexon me zë. E komenton ose shton diçka tjetër në fletë dhe pastaj e hedh drejt grupit. Gjithashtu hedh edhe aeroplanin e vet. Dy nxënës nga grupi tjetër e vazhdojnë veprimin me hedhjen e dy aeroplanëve. Veprimi i njëjtë përsëritet. Në një moment mësuesi e përfundon lojën dhe numëron sa aeroplanë ka secili grup. Vullnetarët i lexojnë porositë me zë dhe mund t'i shkruajnë në tabelë. Qëllimi i lojës është që në mënyrë krijuese të nxiten nxënësit të japin ide për natyrën, botën e gjallë, mënyrën e jetesës si dhe përgjegjësitë e gjithë banorëve të tokës. Aeroplanët mbeten si kujtim për nxënësit ose mund të varen në tavanin e klasës ku mund t'i shohin edhe nxënësit e tjerë.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe. Çdo grupi u shpërndahen faqen 162-163 të fletores së punës me informacion për Kalendarin mjedisor. I fton nxënësit që të përgatisin një kalendar të mjedisit jetësor dhe në çdo muaj të nënvizojnë ditët kur shënohen festat e mjedisit jetësor, aktivitetet tuaja ekologjike shkollore, piknikë në natyrë. Nxënësit udhëzohen që mund të vendosin fotografi nga aktivitetet e tyre, vizatime sipas dëshirës ose lloje bimësh dhe kafshësh. Kalendarin mund ta bëni në letër ose në tabak kartoni. Pas përfundimit nxënësit prezantojnë punën e tyre dhe përzgjidhet me votë se cili ishte kalendar i përgatitur më mirë.

Në fund mësuesi/ja zhvillon me nxënësit testin: “Zhvillimi i qëndrueshëm” që gjendet në faqe 157.

Kontrollohen, vlerësohen dhe diskutohen zgjidhjet e alternativave.

### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarisë, diskutimeve, qëndrimeve të tyre si dhe zhvillimit të testit.

### Detyrë shtëpie:

Të përgatitin një kalendar mjedisor individualisht dhe ta vendosin në shtëpinë e tyre.





## DILEMA Vjedhje në pyll

Jeni duke shëtitur në pyllin e bukur që gjendet afër fshatit tuaj dhe shihni dikë që po pret pemë në pyll për të bërë dru për ngrohje. Më pas, gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi ju takoni rojtarin e pyllit, i cili ju pyet se a keni parë dikë duke prerë pemë. Çfarë do të bënit?

- Do të thoni se nuk dini asgjë dhe nuk keni parë askënd.
- Do të pranoni se e dini kush e ka bërë këtë.
- Do ti thoni rojtarit të pyllit se keni dëgjuar diçka në drejtimin krejt të kundërt.
- Nuk do ti thoni rojtarit të pyllit asgjë, por do ti thoni një miku se jeni i shqetësuar në lidhjet me prerjen e pemëve në pyll.
- Diçka tjetër.



## TEST Zhvillimi i qëndrueshëm

	E SAKTË	E GABUAR
1 Faktorët më të rëndësishëm, të cilët krijojnë lidhjen midis madhësisë së vendbanimit dhe numrit të individëve në të janë uji, ushqimi, strehimi dhe hapësira e mjaftueshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Lidhja midis madhësisë së vendbanimit dhe numrit të individëve në të vlenë për të gjitha krijesat e gjalla, përveç njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Bimët dhe kafshët e kanë më vështirë t'u përshtaten ndryshimeve të mëdha në mjedis krahasuar me njerëzit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Aktivitetet e njeriut nuk ndikojnë në lidhjen midis madhësisë së vendbanimit dhe numrit të individëve që jetojnë në këtë mjedis.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Sot shumë shpesh presionet dhe konfliktet vijnë bashkë me problemet në mjedis.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Të gjithë janë përgjegjës për mbajtjen e mjedisit jetësor të pastër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Kur njerëzit thonë: ne e huazojmë natyrën nga fëmijët tanë, mendojnë se fëmijët duhet të punojnë më tepër në kopsht.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Fëmijët nuk duhet të kujdesen për mjedisin jetësor. Të rriturit kujdesen për gjithçka.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E saktë 2. E gabuar 3. E saktë 4. E gabuar 5. E saktë 6. E saktë 7. E saktë 8. E gabuar





## FLETË PUNE Lum i lirë



Një herë e një kohë, na ishte një lumë i thellë, ngjyrë blu, i cili buronte zhurmshëm nga nga një liqen i madh, lart në mal.

Lumi rridhte vrullshëm nëpër kullotat malore. Më pas, lumi kalonte nëpër një pyll të madh, duke i dhënë një pjesë të ujit të tij drurëve, bimëve dhe kafshëve përgjatë rrugës. Të tjera rryma të vogla i bashkangjiteshin lumit gjatë rrugës së tij. Kalonte nëpër fusha dhe livadhe dhe ujërat e tij ishin shtëpi për shumë peshq dhe krijesa të tjera të lumit. Në fund, lumi takonte detin dhe derdhej i lumtur në të, pasi kishte bërë kaq shumë vepra të mira gjatë udhëtimit të tij të gjatë.

Lumi ishte shumë i rëndësishëm për një fshat, i cili ndodhej në rrjedhën e sipërme të tij. Banorët e fshatit i kullosnin kafshët e tyre në luginën e lumit, gjuanin ose mblidhnin fruta e manaferra. Një fshat tjetër shtrihej në rrjedhën e poshtme të lumit, banorët e të cilit mbillnin dhe korrnin fushat e tyre, rrisnin kafshë dhe gjuanin peshq në të.

Ndonjëherë ata shkonin të gjuanin në pyll. Këta fshatarë ishin të lumtur, po ashtu dhe lumi. Shpesh, banorët nga të dy fshatrat bënin tregti mes tyre, vizitonin njëri tjetrin, festonin së bashku, madje dhe i martonin djemtë dhe vajzat e tyre. Vitet kalonin dhe kjo miqësi sa vinte e rritej më shumë.

Në këtë mënyrë, të dy fshatrat jetonin në paqe dhe harmoni, deri ditën kur kryeplaku i fshatit të sipërm propozoi ngritjen e një dige në lumë. “Nëse ne ndërtojmë një digë, do të krijojmë një liqen”, iu tha ai banorëve, “Do të mund të gjuajmë më shumë peshq dhe do të kemi më shumë ujë

për të vaditur më shumë tokat bujqësore, dhe në këtë mënyrë do të kemi më shumë para. Do të ndërtojmë një hidrocentral të vogël elektrik, i cili do të verë në punë sharrat elektrike në punishtet tona. Do të jetojmë më mirë dhe do të kemi më shumë begati”. Fshatarët ranë dakort dhe ndërtoan digën, duke lënë vetëm një pjesë të vogël të ujit të lumit të rridhte tatëpjetë. Ata i shtuan tokat bujqësore, rritën numrin e bagëtive, por çdo ditë e më shumë pemë pritëshin për tu përpunuar në punishtet e tyre.

Ndryshimet u vërejtën shpejt në fshatin e poshtëm. Uji që vinte në fushat dhe kullotat e tyre ishte gjithnjë e më i pakët dhe nuk rridhte gjithmonë kur nevojitej. Vaditja e tokave bëhej gjithnjë e më e vështirë dhe peshqit rriteshin gjithnjë e më pak. Ndonjëherë kishte përmbytje më të mëdha. Fshatarët ishin gjithnjë e më pak të lumtur.

Komunikimi midis banorëve të dy fshatrave u ndërpre dhe nuk organizoheshin më gosti të përbashkëta. Disa nga të rinjtë e fshatit të poshtëm u larguan, duke u shpërngulur gjetkë në kërkim të një jete më të mirë. Midis atyre që mbetën, filloi grindja. Në këtë mënyrë, lumturia dhe paqja u zhdukën nga të dy fshatrat.





## FLETË PUNE

**Kush është më i forti?**

Shumë kohë më parë Dielli dhe Era ishin miqtë më të ngushtë. Ata loznin të lumtur, por gjithashtu, ishin edhe shumë krenarë. Njëherë ata u grindën se kush është më i forti.

“Kur unë të filloj të fryj në pyll — tha Era — i lakoj pemët dhe i lëkund gjethet e tyre.

“Unë jam më i forti sepse ngroh tokën — tha Dielli — shkrij borën dhe e shndërroj ujin e liqeneve dhe lumenjve në avull “.

Kështu ata u grindën gjatë, por asnjëri nuk dëshironte ta pranonte se tjetri është më i fortë. Papritur ata panë një njeri që po ecte në fushë. Njeriu kishte veshur një xhaketë prej lëkure.

“Eja e t’i masim fuqitë !”, — vazhdoi Era. — “Ai i cili do të arrijë që njeriut t’ia heqë pallton nga trupi, ai është më i forti”.

“Ti e ke radhën!”, — u pajtua Dielli.

E para e provoi Era fuqinë e vet. Filloi të fryjë aq shumë sa u mundua që të hyjë nën xhaketën e njeriut me qëllim për t’ia hequr atë. Njeriu e mbante xhaketën e tij fort rreth vetes, e përkulte kokën dhe vazhdonte të ecte nëpër fushë. Era fryu e fryu, por nuk mundi që t’ia hiqte dot njeriut xhaketën. Së shpejti era u lodh dhe hoqi dorë e turpëruar.

Pastaj i erdhi radha Diellit. Ai filloi të qeshë dhe i drejtoi rrezet e tij të nxehta mbi njeriun. Njeriu vazhdonte të ecte por djersët po i bulonin ballin. Kështu që ngadalë e hoqi xhaketën, e hodhi mbi shpatull dhe vazhdoi të ecte.

Kështu Dielli dhe Era e përfunduan debatin e tyre. Era kuptoi se një buzëqeshje e ngrohtë është më e fortë se çfarëdo frymë në botë.

E njëjta gjë mund të ndodhë edhe në jetë: një buzëqeshje e ngrohtë dhe një fjalë e këndshme mund të arrijnë më tepër se fuqia.





FLETË PUNE

## Rrepa e stërmadhe



Gjyshi mbolli disa fara rrepash. Farat e rrepave u rritën dhe një rrepë u bë e stërmadhe. “E dua këtë rrepë të stërmadhe në tavolinë”, tha gjyshi. Ai e tërhoqi fort, por nuk mundi ta shkulte.

Gjyshi thirri gjyshen: “Më ndihmo ta shkul këtë rrepë të stërmadhe”.

Së bashku ata tërhoqën e tërhoqën, por nuk mundën ta shkulnin.

Gjyshja thirri mbesën: “Na ndihmo ta shkulim këtë rrepë të stërmadhe”.

Dhe që të tre tërhoqën e tërhoqën, por nuk mundën ta shkulnin.

Mbesa thirri qenin: “Na ndihmo ta shkulim këtë rrepë të stërmadhe”.

Të katërt ata tërhoqën e tërhoqën, por nuk mundën ta shkulnin.

Qeni thirri macen: “Na ndihmo ta shkulim këtë rrepë të stërmadhe”.

Të pestë ata tërhoqën e tërhoqën, por nuk mundën ta shkulnin atë.

Macja thirri miun: “Na ndihmo ta shkulim këtë rrepë të stërmadhe”, tha ajo.

Që të gjashtë ata tërhoqën e tërhoqën dhe... puf doli rrepa e stërmadhe!

Dhe të gjithë shijuan rrepën në tryezë...





## FLETË PUNE Sfida

Kastrioti i vogël jetonte në lagjen afër pyllit. Çdo ditë luante në pyllin e mrekullueshëm dhe shoqërohej me banorët e tij. Ketri ishte i shqetësuar në fytyrën e tij ai pa pikëllim. Kastrioti i vogël e kuptoi se duhej të ndiqte ketrin, diçka kishte ndodhur në pyll, e ketri donte t'ia tregonte atij. Pasi bënë një copë rrugë të ngushtë, para tyre doli një grumbull i madh mbetjesh. Një grumbull i madh plehrash, gërmadhash urbane dhe mbeturinash. Kastrioti u habit. E dinte se duhet të reagoje shpejt. Donte që ta pastronte vetë, por kuptoi se kjo nuk është e mundshme. Vrapoi drejt prindërve të tij. Morën një karrocë dhe lopata dhe erdhën te grumbulli. Por, kur panë se kishte shumë mbetje nuk do të mund t'i pastronin vetëm, vendosën që të thërrasin fqinjët. Ata sollën me vete edhe thasë prej plasmasi. Filluan të punonin bashkërisht, por akoma puna nuk po përfundonte. Kjo nuk mjaftonte. Për këtë arsye, vendosën që të thërrasin, e cila me siguri do t'i ndihmonte. Kur dëgjuan se për çfarë bëhej fjalë ata erdhën menjëherë dhe u përfshinë në aksion. Pastruan të gjithë së bashku dhe puna vërtetë dha rezultat.

Por, në fund u doli problemi, se ku do i çonin dhe me se do t'i largonin mbetjet. Problemin mund ta zgjidhte vetëm shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të bashkisë. Ata i lajmëruan dhe automjeti special i bashkisë erdhi. Mbetjet e grumbulluara i ngarkuan dhe i dërguan në vendin përkatës. Në fund vendosën dhe disa tabela me mbishkrime për ndalimin e të hedhjes së mbetjeve në pyll.





## FLETË PUNE Kalendari mjedisor



### 2 Shkurt • Dita botërore e ligatinave

Kjo ditë festohet nga komunitetet nëpër botë, të cilat e promovojnë vetëdijen publike për vlerën dhe funksionimin e ekosistemeve ligatinore kënetave për mjedisin jetësor dhe për njerëzit.



### 21 Mars • Dita e pranverës

Organizohen aktivitete, siç janë mbjellja e luleve dhe pemëve duke theksuar shtimin e sipërfaqes së gjelbër.



### 22 Mars • Dita botërore e ujit

Vendimi për festimin e kësaj dite është marrë kohë më parë, sepse burimet e ujit të pijshëm janë shumë të rëndësishëm mjedisin dhe njerëzit. Njerëzit duhet të ndërgjegjësohen për ndotjen e burimeve ujore dhe të fillojë ta kursejë ujin.



### 7 Prill • Dita botërore e shëndetësisë

Organizata botërore shëndetësore (OBSH) është themeluar në këtë ditë në vitin 1948. Mjedisi është një nga faktorët kryesor që ndikon shëndetin tonë.



### 22 Prill • Dita e planetit Tokë

Në vitin 1970, një grup njerëzish në SHBA protestuan me qëllim që ta tërheqin vëmendjen në botë drejt problemeve të ndotjes dhe degradimit mjedisor. Prej atëherë kjo ditë festohet nëpër botë si Dita e planetit Tokë.



### 14 dhe 15 Maj • Dita ndërkombëtare e shpendëve shtegëtar

Kjo ditë e mbështet mbrojtjen e shpendëve dhe e rrit vetëdijen për ta përmes vëzhgimit të tyre. Çdo vit, njerëzit në mbarë botën ndërmarrin veprime dhe organizojnë aktivitete publike, si festival shpendësh, programe edukuese, ekspozita dhe ekskursione në natyrë për të festuar Ditën Botërore të Shpendëve Migratorë.



### 22 Maj • Dita ndërkombëtare e shumëllojshmërisë biologjike

Dita ndërkombëtare e shumëllojshmërisë biologjike është shpallur nga ana e Kombeve të Bashkuara me qëllim që të rritet vetëdija për temat që lidhen me mbrojtjen e kafshëve dhe bimëve.





## FLETË PUNE

## Kalendari mjedisor (vazhdon)



## 5 Qershor • Dita botërore e mjedisit

Kjo është dita më e rëndësishme ndër të gjitha ditët mjedisore, ku theksi vihet në nxitjen e ndërgjegjësimit dhe të veprimit në mbarë botën për të mbrojtur mjedisin tonë. Dita Botërore e Mjedisit konsiderohet si “dita e njerëzve” për të ndërmarrë një veprim në mbrojtje të Tokës apo për të sjellë një ndryshim.



## 17 Qershor • Dita botërore e luftës kundër shkretëtirëzimit

Qëllimi i kësaj dite është ndërgjegjësimi i publikut mbi degradimin e tokës dhe tërheqja e vëmendjes në zbatimin e Konventës, përmes dokumentarëve të shumtë, konferencave e takimeve, dhe ekspozitave mbi bashkëpunimet ndërkombëtare për të luftuar shkretëtirëzimin dhe efektet e thatësirës.



## 16 Shtator • Dita ndërkombëtare për mbrojtjen e shtresës së Ozonit

Mbyllja e vrimës në shtresën e ozonit është vërejtur 30 vjet pas nënshkrimit të Protokollit. Si rrjedhojë e natyrës së gazeve përgjegjëse për hollimin e shtresës së ozonit, efektet kimike të tyre pritet të ndjehen dhe përgjatë 50-100 vjetëve të ardhshme.



## 28 Shtator • Dita e konsumit të gjelbër

Problemi i konsumit dhe ndikimi i tij ndaj mjedisit jetësor është sferë e cila paraqet kujdesin kryesor në botën e tanishme. Duhet të kuptohet seriozisht rëndësia e riciklimit dhe ripërdorimit dhe të kultivohet vetëdija te njerëzit për këtë.



## E hëna e parë e Tetorit • Dita botërore e habitatit

Qëllimi i kësaj dite është reflektimi mbi gjendjen e qyteteve tona dhe mbi të drejtën themelore të njerëzimit për një strehë të përshtatshme. Gjithashtu, kjo ditë synon të kujtojë botën se të gjithë ne kemi fuqinë dhe përgjegjësinë për të modeluar të ardhmen e habitatit tonë.



## 4 Tetor • Dita botërore e kafshëve

Në këtë ditë, grupet për mbrojtjen e kafshëve, dhe individë nga e mbarë bota organizojnë aktivitete të posaçme me qëllim që ta rrisin vetëdijen publike për çështjen e kafshëve dhe ti inkurajojnë njerëzit që të mendojnë se si ne, si njerëz, sillemi ndaj kafshëve.



## 11 Dhjetor • Dita ndërkombëtare e maleve

Malet janë të rëndësishme për jetën. Kjo ditë është një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e maleve në jetën tonë dhe për të theksuar rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të maleve.





FLETË PUNE

Loja abracadabra

Pyetja:

“Cilat janë kushtet që e bëjnë një vend të mirë për të jetuar?”

Udhëzime:


Gjeni prodhimet e mëposhtme. Duke respektuar renditjen përputhni prodhimin me shkronjën në Kutinë e Kodeve. Plotësoni vijat dhe gjeni përgjigjen pyetjes.

$4 \times 6 =$ 1	$9 \times 6 =$ 5	$1 \times 6 =$ 9	$5 \times 5 =$ 13	$9 \times 9 =$ 17	$18 \times 2 =$ 21
$8 \times 7 =$ 2	$1 \times 24 =$ 6	$2 \times 16 =$ 10	$9 \times 2 =$ 14	$10 \times 3 =$ 18	$15 \times 2 =$ 22
$4 \times 3 =$ 3	$8 \times 4 =$ 7	$64 \times 1 =$ 11	$12 \times 3 =$ 15	$18 \times 3 =$ 19	$9 \times 2 =$ 23
$5 \times 6 =$ 4	$8 \times 8 =$ 8	$6 \times 6 =$ 12	$5 \times 8 =$ 16	$3 \times 3 =$ 20	$16 \times 4 =$ 24

<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	,	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	,	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	,
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	,	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	.

6	40	64	9	54	36	30	32	18	81	25	56	24	12
A	E	Ë	D	M	R	I	J	T	H	S	SH	U	Q

Përgjigjet: Ushqim, ujë, ajër, strehë, dritë.



## Jetë e shëndetshme

Shëndeti i mirë dhe mirëqenia kërkojnë një mjedis të pastër dhe të harmonizuar me faktorët fizikë, psikologjikë, socialë dhe estetikë. Mjedi duhet parë si një burim që luan rol të madh në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në rritjen e mirëqenies.

Për të jetuar në mënyrë të shëndetshme, të gjithë faktorët duhet të funksionojnë në barazpeshë ndërmjet tyre.

Shumë njerëz mendojnë se **ushqimi** është i vetmi faktor i rëndësishëm për një jetesë të shëndetshme. Por, kjo nuk mjafton. Shumë faktorë të tjerë janë të rëndësishëm për të patur një jetë të shëndetshme dhe të balancuar, krahas ushqimit të shëndetshëm, si:

- Aktiviteti fizik
- Çlodhja dhe argëtimi
- Leximi dhe muzika
- Bisedat, diskutimet dhe lojërat shoqërore
- Drekat dhe festat familjare
- Kafshët shtëpiake



**Ushqimi** është gjithçka që konsumohet në ditë — çfarë hahet dhe pihet. Është shumë e rëndësishme të bëjmë kujdes se çfarë hamë. Ushqimi duhet të jetë i **shumëllojshëm**, i zgjedhur mirë dhe të jetë me prejardhje bimore dhe shtazore. Mbi të gjitha, ushqimi duhet të jetë i freskët, të përmbajë elementë të shumëllojshëm ushqyesish, i bollshëm që të të ngopë dhe të shpërndahet në disa vakte ditore.

Ushqimi që konsumojmë nuk duhet të përmbajë kimikate, siç janë konservuesit. Në asnjë mënyrë nuk duhet të përdorim ushqimin e shpejtë dhe të gatshëm (fastfood). Mënyrën e të ushqyerit shëndetshëm duhet ta kultivojmë që në fëmijëri.





Ushqimi është më i shëndetshëm kur ndahet me njerëzit më të afërt. Dreka në familje është e rëndësishme për një jetë familjare në harmoni.

Për një mënyrë të shëndetshme të jetës kontribuojnë **aktivitetet fizike** dhe sportive. Është mirë që dita të fillojë me gjimnastikë, por më e rëndësishme është që gjatë ditës të kryhen edhe aktivitete të tjera fizike. Rekomandohet ecja në natyrë, lëvizja me biçikletë, lojëra me moshatarët në zona të hapura për të kaluar kohën e lirë në shoqëri, lojëra futbollit, volejbollit e basketbollit, etj.

Nuk është aspak i shëndetshëm qëndrimi me orë të gjata para kompjuterit e televizorit apo lojërave në celular, pasi mund të shkaktohen dëmtime të syve, deformime të ndryshme të trupit, vetmi dhe ftohtësi individuale.

Mënyrë e shëndetshme e jetesës nënkupton dhe një **higjienë** të rregullt. Higjiena nënkupton mbajtjen **pastër të trupit** dhe të hapësirës ku jetojmë, punojmë, mësojmë dhe shoqërohemi.

Larja (bërja dush) në mënyrë të rregullt dhe larja e flokëve janë pjesë të higjienës personale. Gjithashtu, këtu futen dhe veshja e rrobave të pastra dhe të lara. E rëndësishme është larja e duarve para çdo vakti të ngrënies, larja e syve çdo mëngjes, prerja e thonjve rregullisht, si dhe larja e dhëmbëve para se të flemë në darkë dhe kur zgjohemi në mëngjes.

Hapësira në të cilën qëndrojmë duhet të jetë e pastër dhe gjithmonë e ajrosur. Gjithashtu, duhet të mbajmë pastër edhe oborrin e shkollës, fushat e sportit dhe gjithë hapësirën përreth nesh.



Çdo organizëm ka nevojë të **çlodhet** (të pushojë), pas një pune të vështirë apo pas një aktiviteti fizik. Shëtitjet në natyrë, soditja e peizazhit, ngarja e biçikletës, etj., ndihmojnë për një çlodhje sa më të plotë të trupit dhe të mendjes.

Krijimi i miqësive të reja apo bisedat me miqtë janë pjesë e **argëtimit**. Argëtimi i ndihmon njerëzit që ta plotësojnë jetën me bukuri, lumturi dhe me momente të këndshme. Pjesë e argëtimit janë leximi, vajtja në kinema me shokët, udhëtimi në vende të ndryshme, etj.

Për një jetesë të shëndetshme, organizmit i nevojitet dhe një gjumë i shëndetshëm dhe i rehatshëm. Rreth tetë orë gjumë në natë janë të mjaftueshme për një çlodhje të plotë të trupit.

Krahas argëtimit dhe shoqërimit me njerëz tjerë, njeriu ka nevojë të përkujdeset edhe për **kafshët shtëpiake**. Kur një person mban një kafshë shtëpiake dhe luan me të, ndihet më i plotësuar, më i qetë dhe më i dashur. Njëkohësisht, ai duhet të jetë i vetëdijshëm se mban përgjegjësi për kafshën, për t'a ushqyer, për t'a mbajtur pastër dhe të shëndetshme, për t'a nxjerrë shëtitje, etj. Si shpërblim, kafsha shtëpiake tregon afërsi, dashuri dhe besnikëri të madhe ndaj personit që kujdeset për të.





Planifikimi ditor i temës Jetë e shëndetshme

Fusha	Shkencat e natyrës dhe ato shoqërore
Shkalla	III
Tema mësimore	Jetë e shëndetshme
Kohëzgjatja	6 orë mësimore
Rezultatet e të nxënit	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• liston vlerat që kanë për të, ushqimi, higjiena, pushimi, lojërat, miqësia me kafshët shtëpijake etj.;</li> <li>• dallon shprehitë jo të shëndetshme të ushqyerit dhe të jetesës;</li> <li>• rendit rregulla që duhet të respektojë për një jetë të shëndetshme;</li> <li>• argumenton me shembuj nga jeta pse plotësimi i nevojave, si: ushqimi, higjiena, veshja, lojërat, mësimi, pushimi etj., përbëjnë një të drejtë që i takon si atij, ashtu edhe të tjerëve;</li> <li>• bën dallimin midis dy llojeve të ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme;</li> <li>• demonstron gatishmërinë e tij/saj për të ndjekur rregullat e regjimit ditor në të përditshmen e tij/saj për një jetesë të shëndetshme.</li> </ul>
Situata e të nxënit	Situatat e zhvillimit shoqëror nga Paketa Junior. Situata jetësore nga e përditshmja e nxënësve.
Fjalët kyç	Shprehitë (jo) të shëndetshme, ushqimi i shëndetshëm/ jo i shëndetshëm, sport, pushim, argëtim, mjek, kujdes shëndetësor, vaksinim, regjim ditor, mëngjes, drekë, darkë, zemra.
Burimet materiale	Tregimi: “Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes”, fletët e punës: “Lista e këshillave”, “Familja Gashi përmes fotografive dhe vizatimeve”, regjimi ditor.
Lidhja me fushat/lëndët e tjera	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art pamor.

**Ora I – Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes  
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tregimin për familjen Gashi në faqen 173 të librit dhe në punë dyshe nxënësit shkruajnë shprehitë pozitive dhe negative, të cilat i praktikon familja Gashi.

Shprehitë pozitive	Shprehitë negative	Po unë?

Diskutohen punët e nxënësve dhe ftohen të tregojnë nëse njohin ndonjë shok, i afërm, ose ata vetë që ngajnë me personazhet e këtij tregimi.

**Hapi i dytë:** Ndërtimi i njohurive të reja

Pas diskutimit, mësuesi/ja u shpërndan nxënësve faqen 175 të fletës së punës “Lista e këshillave”. Nxënësit ushtrohen në punë në grup (4-5 nxënës) dhe udhëzohen që ata tani do të jenë në rolin e mjekut ose të këshilltarit, i cili duhet të bëjë një listë me këshilla dhe rekomandime, të cilat do të çonin në ndryshimin e shprehive të zakonshme të përditshme të mënyrës së jetesës të familjes



Gashi. Pas përfundimit mësuesi/ja fton nxënësit që në grupe të prezantojnë punën e tyre në role para klasës. Në vazhdimësi mësuesi/ja fton nxënësit sipas grupeve të hartojnë një grafik i cili do t'i drejtohet familjes Gashi e që ka të bëjë me mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe komunikimin efektiv midis anëtarëve të kësaj familjeje. Për të kryer këtë punë mësuesi/ja u shpërndan nxënësve faqen 174 të fletës së punës me temë "Familja Gashi përmes fotografive dhe vizatimeve", e cila do t'i ndihmojë për të paraqitur situatat, por mund të shtojnë dhe ide të tjera vetë nxënësit e klasës.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të punës, çdo grup prezanton idetë dhe punët e tyre. Mësuesi/ja fton nxënësit të përzgjedhin punët më të mira të cilat do të ndihmojnë prindërit duke theksuar se si duhet të kujdesen për fëmijët e tyre me qëllim që t'ju mundësojnë atyre një mënyrë të shëndetshme të jetesës.



#### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë prezantimit të punëve, diskutimeve, përzgjedhjes së alternativës së situatës në Paketën Junior.

#### Detyrë shtëpie:

Të prezantojnë në familjen e tyre grafikun me temë: "Familja Gashi përmes fotografive dhe vizatimeve" dhe të diskutojnë rreth veprimtarive në familjet e tyre.

## Ora II – Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth temës: "Jetë e shëndetshme". Në tabelë renditen të gjitha rregullat (ushqimi i shëndetshëm, sport, pushim, argëtimi, kujdes shëndetësor, vaksinim, regjim ditor) që duhen respektuar për të pasur një jetë të shëndetshme. Nxënësit diskutojnë rreth situatës dhe sjellin shembuj nga e përditshmja e tyre.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletët e punës 175-176 me temë: "Lista e këshillave për një jetë të shëndetshme". U shpjegohet se në fushat "Respektoj /Nuk respektoj/ Si t'i përmirësoj shprehitë" të shkruajnë për shprehitë e jetës së tyre.

Insistohet që nxënësit të jenë të vërtetë, sepse vetëm kështu ata do të mund të realizojnë fotografinë reale për mënyrën e jetesës së tyre. Nëse ata kanë shënuar për disa nga rregullat "Nuk i respektoj", ftohen që të shkruajnë se si t'i përmirësojnë shprehitë e tyre për një jetë të shëndetshme. Shprehitë e reja le t'i shkruajnë në kolonën e fundit.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të punës nxënësit ftohen të prezantojnë para klasës "Jetesën e tyre të shëndetshme". Diskutohen rregullat që duhet të respektojnë dhe ato që duhet të përmirësojnë si dhe kërkohet që të argumentojnë me shembuj nga jeta se plotësimi dhe respektimi i rregullave është përgjegjësi për të patur një shëndet sa më të mirë.

#### Vlerësimi:

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit për punët e tyre në veprimtarinë "Jetesë e shëndetshme" si dhe për respektimin e rregullave për një jetë të shëndetshme.

#### Detyrë shtëpie:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit t'u tregojnë fletën e punës të plotësuar prindërve të tyre dhe të bisedojnë rreth rregullave që duhet të zbatohen për një jetë të shëndetshme.



### Ora III – Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Për këtë orë mësimi, mësuesi/ja fton në klasë një mjek për t’u folur nxënësve rreth kujdesit për shëndetin. Fillimisht nxënësit ushtrohen të lexojnë dilemën “Shëtitja” në faqen 172 të librit dhe të shprehin mendimet e tyre rreth zgjidhjes së alternativave të saj. Në vazhdim të diskutimit mësuesi/ja fton nxënësit të flasin për kujdesin që tregojnë për shëndetin duke u përqendruar tek higjiena vetjake dhe pasojat që vijnë nga mos mbajtja e një higjienë të mirë, marrja me sport dhe gjithçka bëjnë ata për të pasur një shëndet të mirë. Nxiten nxënësit që të japin shembuj konkretë nga përvojat e tyre ose të tjerëve rreth temës së diskutimit. Të gjitha rregullat që nxënësit nxjerrin gjatë diskutimit, mësuesi/ja i shkruan të strukturuar në tabelë.

#### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Pasi dëgjohen të gjitha mendimet e nxënësve, mësuesi/ja fton mjekun/en t’u shpjegojë këshillat që duhen ndjekur për të pasur një shëndet të mirë. Disa prej këshillave të cilat mësuesi/ja i shkruan dhe në tabelë mund të jenë:



- Lani dhëmbët 2 herë në ditë (mëngjes dhe në darkë);
- Lani duart para çdo vakti dhe pas përdorimit të tualetit;
- Hani 3 herë në ditë, ushqim të shëndetshëm;
- Bëni banjë sa herë të jetë e nevojshme;
- Flini 10-12 orë në ditë;
- Vizitohuni dhe vaksinohuni;
- Merruni me sport.

Gjatë bisedës me mjekun/en nxënësit/et tregojnë se si veprojnë për t’i zbatuar ato gjatë jetës së përditshme. P.sh. sa herë në ditë i lajnë dhëmbët dhe kur? etj. Mësuesi/ja ftohen nxënësit të tregojnë konkretisht veprimet që përdorin gjatë larjes së dhëmbëve. Gjithashtu ajo demonstron përdorimin e rubinetit gjatë larjes së dhëmbëve me furçë. Mjekja/u u shpjegon nxënësve kuptimin e fjalës vaksinim dhe rreziqet që vijnë nga mosvaksinimi. Diskutimi vazhdon për dobinë e marrjes me sport, llojet e sporteve për moshat përkatëse, pushimit, shoqërizimit dhe për fjetjen 10-12 orë në ditë.

Më pas mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletën e punës me temë “Regjimi ditor” në faqe 178, të cilën e punojnë të pavarur për të vendosur numrat sipas radhës së veprimeve.

#### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et prezantojnë regjimin e tyre ditor para klasës dhe shprehin mendimet rreth veprimeve që bëjnë ndryshe me ato të paraqitura në fletën e punës. Nxënësit bëjnë pyetje dhe komente rreth veprimeve të njëri-tjetrit. Në përfundim mësuesi/ja shkruan në tabelë dhe diskutohen fjalitë:

Veprim	Pasojë

- Unë kujdesem për veten.
- Unë kam shëndet të mirë.

#### Vlerësimi:

Gjatë orës së mësimi, nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për:

- komentet dhe pyetjet që i drejtojnë njëri-tjetrit gjatë diskutimit;
- plotësimin dhe prezantimin e veprimtarive të regjimit ditor.



### Detyrë shtëpie:

Nxënësve u parashtrohet si detyrë shtëpie të paraqesin me shkrim regjimin e tyre ditor dhe ta vendosin në dhomën e tyre

## Ora IV – Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve faqen 177 “Menyja ime shtatëditore” të fletores së punës. Nxënësit në punë të pavarur shkruajnë se çfarë zakonisht kanë ngrënë gjatë një jave. Më pas fton vullnetarë që dëshirojnë të lexojnë se me çfarë janë ushqyer gjatë javës ndërsa nxënësit e tjerë dëgjojnë me kujdes me qëllim që të mund të marrin pjesë në debat. Japin komentet se cili nga shokët/shoqet është ushqyer shëndetshëm.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Pas leximit të fletëve të punës, renditen në tabelë disa ushqime të shëndetshme dhe jo të shëndetshme. Mësuesi/ja për këtë orë mësimi mund të ftojë edhe ndonjë person profesionist (pediatër, dietolog, kuzhinier etj). Ky person mund të ndihmojë që të përcaktojnë më mirë të ushqyerit e shëndetshëm dhe atë jo të shëndetshëm, si dhe gjatë diskutimit të japë këshilla dhe sqarime për nevojën dhe rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm si një nga parakushtet themelore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Më pas, nxënësit ushtrohen në punë të pavarur për të bërë analizën e mënyrës së vet të ushqyerit që është evidentuar në listë. Me stilolaps me ngjyrë blu qarkohet ajo që i përket ushqimit të shëndetshëm, ndërsa me stilolaps të kuq të qarkohet ose fshihet me gomë ajo që është ushqim jo i shëndetshëm.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit të punës secili nxënës numëron qarkimet blu dhe të kuqe dhe në këtë mënyrë ai vlerëson veten se si ushqehet.

Paraqiten punët e nxënësve para klasës dhe nxënësi, i cili ka më shumë fusha blu mund të theksohet si shembull para nxënësve të tjerë.



### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit gjatë prezantimit të punëve të tyre, komenteve dhe qëndrimeve të tyre për një ushqyerje të shëndetshme.

### Detyrë shtëpie

Të paraqesin para prindërve “Menynë e tyre shtatëditore” dhe të diskutojnë rreth ushqimeve të shëndetshme.

## Ora V – Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimi fillon me një bisedë me nxënësit për nevojën e ngrënies së ushqimit të shumëllojshëm dhe në sasi të mjaftueshme për zhvillim të rregullt dhe të shëndetshëm. Më pas mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletën e punës në faqe 179 “Pjata ime e ushqimeve”. Nxënësit ushtrohen në punë të pavarur për të zgjedhur dhe vizatuar ushqimin e tyre të shëndetshëm duke u bazuar në figurat ose përvojën e tyre. Pas përfundimit nxënësit i ngjiten punët e tyre në tabelë dhe mësuesi/ja u thotë që diskutimi i tyre do të bëhet në fund të orës për të nxjerrë se cila pjatë përmban ushqimin/et më të shëndetshëm/me.



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shfaq foto të tilla si:  
 “Buka”; “Frutat”; “Perimet”; “Veza”; “Qumështi dhe prodhimet e tij”; “Mishi dhe produktet e mishit”; “Peshku”; “Mjalti”; “Lëngjet”; “Uji”; “Çaji dhe bimët mjekësore” dhe “Arroret”.

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 veta. Çdo grup do të vizatojë piramidën e të ushqyerit me ushqimet përkatëse ose mund ta përgatisë atë duke ngjitur foto ushqimesh. Gjithashtu çdo grupi i kërkohet që të listojnë ushqimet jo të shëndetshme që ata njohin.



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pas përfundimit çdo grup prezanton para klasës piramidën e ushqimit si dhe listën e ushqimeve jo të shëndetshme. Nxënësit e tjerë japin mendime dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit. Më pas diskutohet “Pjata ime e ushqimeve” e cila u punua në fillim të orës. Nxënësit reflektojnë mbi punët e tyre dhe përzgjidhen fituesit. Në përmbyllje mësuesi/ja u shpërndan nxënësve testin “Jeto shëndetshëm” në faqen 172 të librit. Nxënësit e plotësojnë në punë të pavarur dhe në fund vlerësohen për alternativat e përzgjedhura.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të veprimtarisë individuale dhe në grup, diskutimeve, qëndrimeve të tyre si dhe zhvillimit të testit.

### Detyrë shtëpie:

Duke u bazuar në njohuritë e marra për një ushqyerje të shëndetshme, të përgatisin pjatën e tyre të ushqimeve dhe t’ua tregojnë prindërve.

## Ora VI – Jeta e shëndetshme kërkon një ekuilibër midis zhvillimit fizik, mendor dhe shpirtëror

### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kjo orë mësimi do të zhvillohet në natyrë, në një park ose lulishte apo në një lëndinë të gjelbëruar. Për zhvillimin e kësaj ore mësimi do t’ju ndihmojë fleta e punës që ndodhet në faqen 180 të librit. Ju së bashku me nxënësit do të zhvilloni disa ushtrime të thjeshta joga.

Joga është një sistem gjithëpërfshirës për zhvillimin fizik, mendor dhe shpirtëror. Për zhvillimin fizik, joga ofron një seri pozicionesh. Ashtu si tregohen dhe në ilustrime fëmijët mund të bëjnë pozicionet e lules, pemës, bretkosës etj.

Gjatë realizimit të këtyre pozicioneve trupi ndodhet në një gjendje të qetë, frymëmarrja bëhet e thellë, e cila në mënyrë të natyrshme sjell më shumë oksigjen në qarkullimin e gjakut.

Lejoni që gjatë realizimit të këtij aktiviteti të dëgjohen tingujt e natyrës.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të jogës dhe flasin mbi emocionet e tyre gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

### Detyrë shtëpie:

Duke u bazuar në njohuritë e marra mbi jogën ata u demostrojnë prindërve disa prej ushtrimeve në shtëpi.



## DILEMA Shëtitje

Bashkë me shokun tënd nisesh për një shëtitje në park. Por, në këtë moment qielli errësohet dhe fillon të bjerë një shi i fuqishëm. Ju futeni poshtë një strehe dhe diskutoni se çfarë duhet të bëni:

- Do të ktheheni në shtëpi, sapo të pushojë shiu;
- Do ta ftosh shokun në shtëpinë tënde ku mund të luani në kompjuter ose do të shikoni TV.
- Do të qëndroni poshtë stehës deri sa të pushojë shiu dhe më pas do vijoni shëtitjen.
- Do të ktheheni në shtëpi të merrni çadrat dhe do të vijoni shëtitjen në park.
- Diçka tjetër.



## TEST Jeto shëndetshëm

	E SAKTË	E GABUAR
1 Mënyra e shëndetshme e të ushqyerit nuk është e rëndësishme për jetën e njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Që të jesh i shëndetshëm, duhet të ushqehesh me ushqim të shumëllojshëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Ushqimi duhet të konsumohet përmes disa vakteve të caktuara.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Ngrënia e tepërt është shumë e dëmshme për shëndetin.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Të luash me kompjuter është më mire sesa të luash futboll.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Në higjienën personale përfshihet vetëm bërja e dushit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Gjumi nevojitet për pushimin e njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Kujdesi për kafshët shtëpiake është një detyrim vetëm i prindërve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Njeriu mund të jetojë i vetëm, pa pasur nevojë për askënd.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E gabuar 2. E saktë 3. E saktë 4. E saktë 5. E gabuar 6. E gabuar 7. E saktë 8 E gabuar 9. E gabuar





## FLETË PUNE

# Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes

Albani dhe Albana janë fëmijët e familjes Gashi. Prindërit e tyre janë shumë të mërziur me ta. Ata gjithmonë ua kanë plotësuar të gjitha dëshirat dhe kërkesat e fëmijëve të tyre. Fëmijët vendosnin vetë se çfarë do të blinin kur shkonin në dyqan. Kështu që qeset e tyre ishin të mbushura me lloje të ndryshme të patatinave, çokollatave, bonboneve, lëngjeve, lëpirëse, karamele e çdo gjë tjetër. Në shtëpi Albani dhe Albana uleshin pranë kompjuterit ose televizorit dhe me orë të tëra qëndronin para tyre duke ngrënë nga gjërat e blera. Kjo ishte përditshmëria e dy fëmijëve. Kur shokët e tyre i ftonin që të luanin, Albani dhe Albana asnjëherë nuk shkonin. Shpesh shkonin për vizita tek miqtë e prindërve të tyre, dhe aty pinin edhe pije të gazuara. Ata qëndronin atje deri në orët e vona, ndërsa binin në gjumë pas mesnate. Në mëngjes ishin nervoz, të lodhur, ndërsa gjatë orëve të mësimi ishin të rraskapitur dhe të papërqëndruar. Gjatë kohës së pushimit ata shpesh ziheshin me moshatarët e tyre. Mësuesja e vërejtë këtë sjellje të tyre dhe thirri menjëherë prindërit e tyre në shkollë. Pas një bisede të gjatë, prindërit kuptuan se fëmijët e tyre nuk po zhvilloheshin si duhet intelektualisht. Për këtë shkuan tek mjeku dhe kërkuan ndihmë. Mjeku i ftoi prindërit që t'i shpjegonin se çfarë hanë fëmijët e tyre, sa kohë kalojnë duke mësuar, e sa duke luajtur, zbavitur, shëtitur dhe argëtuar, sa herë në javë merren me sport dhe sa herë brenda ditës kalojnë para televizorit dhe kompjuterit.

Pas shpjegimit, mjeku u dha këshillat në vijim:

### Lista e këshillave



Patjetër ta ndryshoni mënyrën e të ushqyerit të fëmijët tuaj, sepse kjo është ...



Menjëherë t'i regjistroni në ndonjë aktivitet sportiv



E treta



E katërta



E pesta





FLETË PUNE

## Familja Gashi përmes fotografive dhe vizatimeve



Në dyqan



Dreka familjare



Ushqimi në shkollë



Loja me shokë



Shëtitja në park



Dhoma e Albanit  
dhe Albanës







FLETË PUNE

# Lista e këshillave për një jetë të shëndetshme

Që jeta jonë të jetë sa më e shëndetshme duhet të respektojmë rregullat në vijim	Respektoj	Nuk respektoj	Si ti përmirësojë shprehitë
 <p>Ha shpesh fruta dhe perime</p>			
 <p>U shmangem ëmbëlsirave</p>			
 <p>Shpesh eci në këmbë</p>			
 <p>Bëj sport</p>			
 <p>Shkoj në këmbë deri në shkollë dhe kthehem</p>			
 <p>Para kompjuterit kaloj më pak se një orë në ditë</p>			
 <p>Gjatë kohës së lirë shpesh luaj lojëra të ndryshme me shokët e mi në natyrë</p>			
 <p>Në mbrëmje bie në gjumë herët</p>			





FLETË PUNE

Lista e këshillave për një jetë të shëndetshme (vazhdimi)

Që jeta jonë të jetë sa më e shëndetshme duhet të respektojmë rregullat në vijim	Respektoj	Nuk respektoj	Si ti përmirësojë shprehitë
 <p>Gjumi im zgjat tetë orë</p>			
 <p>Kam hobin tim</p>			
 <p>Më pëlqen të lexoj libra</p>			
 <p>Në televizor shikoj vetëm emisione të përshtatshme për moshën time</p>			
 <p>Të paktën një herë në javë unë me familjen ime dalim shëtitje në natyrë</p>			
 <p>Për çdo të papritur dhe problem këshillohem nga prindërit e mi</p>			
 <p>Gjërat dhe dhomën time i rregulloj vetë</p>			
 <p>Në mbrëmje bisedoj me prindërit e mi se si e kam kaluar ditën dhe nëse kam pasur ndonjë problem</p>			





FLETË PUNE

# Menyja ime shtatëditore

	Mëngjesi	Zëmra	Dreka	Zëmra	Darka
E hënë					
E martë					
E mërkurë					
E enjte					
E premtë					
E shtunë					
E diel					





## FLETË PUNE Regjimi ditor

Shënoni rradhen e veprimeve duke filuar me numrin 1 deri tek numri 12.

Cilat janë veprimet që ju kryeni gjatë ditës? Shikoni me kujdes ilustrimet para se të shënoni numrin në krah të ilustrimit.







FLETË PUNE

## Pjata ime e ushqimeve

Vizatoni brenda në pjatë ushqimet tuaja të preferuar të shëndetshëm duke u bazuar në figurat e mëposhtme ose përvojën e tyre.





## FLETË PUNE

# Joga, fëmijët dhe natyra



### Sillu si pemë

Pozicioni pemës: Qëndro në një këmbë. Përkul gjurin tjetër dhe vendos shputën e këmbës mbi pjesën e brendshme të këmbës. Vërtitu si pema në erë! Njëherë nga njëra anë, pastaj nga ana tjetër.



### Sillu si ylber

Shtrihuni në dysheqe. Ngrini barkun lart duke harkuar trupin sa më shumë që të mundeni dhe pretendoni se jeni një hark ylberi.



### Sillu si gjarpër

Shtrihuni barkazi. Çojini duart mbrapa dhe mundohuni të prekni majat e gishtave të këmbëve me duart tuaja, duke u përkulur sa më shumë mbrapa.



### Sillu si gamile

Uluni në gjunjë. Përkulni trupin mbrapa sa të mundeni dhe mundohuni të mbështeteni me duart tuaja mbi shputat e këmbëve.



### Sillu si flutur

Pozicioni këpucë-bërësit: Ulu mbi shputat e këmbëve dhe drejto kurrizin. Përkuli këmbët me shputat e ngjitura me njëra tjetrën. Përplasi krahët në ajër si krahët e fluturës.





## Ndryshimet klimatike

**Moti** nënkupton dukuritë momentale të diellit, reve, shiut, borës dhe erës. Moti mund të ndryshojë brenda ditës ose përgjatë një jave.

**Klima** përfshin kombinimin e kushteve të caktuara të motit në një rajon gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Kur themi se një rajon ka klimë të thatë ose të lagësht, kjo varet nga shumë faktorë, siç janë: relievi (malet, luginat, lumenjtë), lartësia mbi nivelin e detit, afërsia me detin, etj. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në temperaturën mesatare të rajonit dhe në sasinë e reshjeve që bien. Klima në një rajon të caktuar përcakton se cilat bimë dhe kafshë mund të jetojnë aty. Nga klima, gjithashtu, kushtëzohet puna që do të bëjnë njerëzit, ushqimi që do të hanë, ndërtimi i shtëpive dhe shumë gjëra të tjera.

Moti mund të ndryshojë brenda ditës, ndërsa për ndryshimin e klimës nevojiten qindra vjet. Në të kaluarën, ndryshimi i klimës ishte thjesht **proces natyror**, ndërsa sot ndryshimet klimatike po ndodhin si pasojë e **aktiviteteve të njeriut** (zhvillimi i teknologjisë, industrisë, transportit, etj.). Klima po ndryshon me ritme shumë të shpejta dhe pasojat janë gjithnjë e më të mëdha e më të ndjeshme për njerëzit: vera është bërë më e nxehtë dhe dimri më i ftohtë, pranvera dhe vjeshta janë më të shkurtra, fenomenet natyrore (përmbytje, thatësira, zjarre masive) janë më të shpeshta.

Ligatinat, si ekosisteme ujore, luajnë një rol shumë të madh në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike. Këto ekosisteme veçse kanë një jetë të pasur biologjike (lagunat, kënetat, ose moçalet) luajnë një rol të madh në zbutjen e fatkeqësive natyrore (përmbytjet dhe stuhitë) që ndodhin si pasojë e motit të keq.

Lagunat e menaxhuara mirë ndihmojnë komunitetet t'i mbijetojnë motit ekstrem dhe të zvogëlojnë dëmet nga këto fenomene. Lagunat bregdetare mbrojnë nga përmbytjet dhe shërbejnë si zonë "sfungjer" ndaj vërshimit të ujit dhe erozionit të tokës. Ndërsa liqenet dhe rezervuarët thithin dhe ruajnë reshjet e tepërta, duke reduktuar përmbytjet, dhe në kohë thatësire ato çlirojnë ujin e grumbulluar.

Si rezultat i ndryshimeve klimatike, vihet re një rritje e vazhdueshme e katastrofave natyrore. 90% e këtyre katastrofave janë të lidhura me ujin — përmbytjet, rritja e nivelit të deteve, vërshimi i lumenjve, etj. Arsyja e rritjes së numrit dhe shpeshtësisë së këtyre dukurive lidhet dhe me degradimin e ligatinave. Në 100 vitet e fundit janë zhdukur 64% e ligatinave të botës. Shkalla aktuale e humbjes është 1% në vit, më e shpejtë se çdo ekosistem tjetër.



**Ngrohja globale.** Të gjitha matjet tregojnë se temperatura në sipërfaqen e Tokës është në rritje të vazhdueshme. Ky proces quhet ngrohje globale dhe është shkaktar i ndryshimeve klimatike në mbarë botën. Që të kuptohen arsytet të cilat shkaktojnë ngrohjen globale, duhet të kuptohet efekti serrë. Rikujtojmë që planeti Tokë është i mbrojtur nga mbështjellësi ajror i ashtuquajtur atmosferë, i cili gjatë ditës na mbron nga rrezet e forta të diellit, ndërsa gjatë natës



ruan temperaturën në nivelin normal për jetën në Tokë. Në fakt, përbërja e atmosferës kontrollon shkallën e ngrohjes së planetit. Ajo, në masën më të madhe, përbëhet nga oksigjeni dhe azoti - pa këto dy gazra nuk do të ekzistonte jeta në Tokë.

**Efekti serrë.** Bimët e gjelbra **krijojnë ushqim** duke thithur dyoksidin e karbonit nga ajri dhe lëndët ushqyese nga toka. Organizmat e gjallë, përmes procesit të frymëmarrjes, e kthejnë dyoksidin e karbonit në ajër. Gjithashtu, edhe gjatë procesit të djegies në ajër çlirohen dyoksidi i karbonit dhe gazra të tjera. Të gjithë këto gazra quhen gazra serrë. Thithja dhe çlirimi i dyoksidit të karbonit në natyrë duhej të ishte në barazpeshë. Por njeriu e prish këtë barazpeshë me djegien gjithnjë e më shumë të lëndëve

djegëse. Për këtë arsye, sasia e dyoksidit të karbonit dhe e gazrave të tjera në ajër rritet vazhdimisht. Dyoksidi i karbonit në ajër (atmosferë) luan të njëjtin rol me atë të xhamave në një serrë. Ai lejon që rrezet e diellit të arrijnë deri në sipërfaqen e Tokës, por nuk lejon që nxehtësia të braktisë atmosferën. Kështu, sipërfaqja e Tokës bëhet gjithnjë e më e nxehtë. Ngrohja e sipërfaqes së Tokës njihet si "efekti serrë". Efekti serrë është i rrezikshëm, pasi shkakton ngrohje të vazhdueshme të të gjithë sipërfaqes së Tokës, e njohur ndryshe si ngrohje globale. Ngrohja globale mund të shkaktojë shkrirjen e akullnajave dhe, si pasojë, rritjen e nivelit të oqeanëve dhe deteve në mbarë botën, duke sjellë përmbytje të mëdha. Për të ngadalësuar **ngrohjen globale** dhe parandalimin e **përmbytjeve katastrofike**, njerëzit duhet të përpiqen të zvogëlojnë çlirimin e gazrave në atmosferë dhe të shfrytëzojnë burime të energjisë që nuk krijojnë gazra serrë.

### Planifikimi ditor i temës Ndryshimet klimatike

<b>Fusha</b>	Shkencat e natyrës
<b>Shkalla</b>	I-II
<b>Tema mësimore</b>	Serra
<b>Kohëzgjatja</b>	3 orë mësimore
<b>Rezultatet e të nxënës</b>	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan efektin serrë;</li> <li>• shpjegon lidhjen mes ngrohjes globale dhe ndryshimit të klimës;</li> <li>• dallon shkaktarët e "Ngrohjes globale";</li> <li>• krahason konceptin "Ngrohje globale" me konceptin "Serrë";</li> <li>• tregon rreth rrolit të njerëzve për ngadalësimin e ngrohjes globale.</li> </ul>
<b>Situata e të nxënës</b>	Serra eksperiment. Loja: Ku do të shkojnë arinjtë e bardhë?
<b>Fjalët kyç</b>	Moti, klima, ndryshime klimatike, efekti serrë, ngrohja globale, përmbytjet katastrofike.
<b>Burimet materiale</b>	Qese, fletët e punës: "Kopshti i Enit", 8-12 copë kartoni, fletë të bardha me format A4 etj.
<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b>	Gjuha shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Dituri natyre.





## Ora I – Serra Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja shkruan në tabelë titulli i mësimit “Serra” dhe fton nxënësit të tregojnë se çfarë informacioni kanë për të. Serrat janë të ndërtuara me qelq ose me plastikë. Ato janë ndërtime të veçanta ku kultivohen bimët. Ato shpesh shfrytëzohen për kultivimin e luleve, perimeve ose frutave. Gjatë diskutimit me nxënësit theksohet se qelqi dhe plastika që shfrytëzohet për ndërtimin e serrës, ruajnë nxehtësinë brenda saj dhe i ndihmon bimët që të rriten dhe zhvillohen më shpejt.

Mësuesja/si ndan klasën në dy grupe. Njërin grup e mbulon me një qese dhe i fton nxënësit të lexojnë tregimin “Kopshti i Enit” faqe 188 dhe parashtron pyetjet:

- Si veproji Eni?
- Si do të vepronit ju?

Pasi nxënësit përfundojnë leximin e pjesës mësuesja i pyet:

- Ku është jeta më e mirë për të gjitha krijesat, në ajër të pastër apo brenda në serrë?

Gjatë diskutimit renditen anët pozitive dhe negative të serrave.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Në vazhdimi të diskutimit mësuesi/ja i fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit për Efektin serrë. Nxënësit udhëzohen për përdorimin e shenjave sipas teknikës së INSERT-it.

V pohon se informacioni që lexuan është i njohur prej tyre.

+ nëse një pjesë e informacionit është e re për nxënësit.

- nëse informacioni që lexuan është i ndryshëm nga ai që dinin.

? informacioni është i paqartë ose duhet të dinë më shumë rreth këtij informacioni.

Efekti serrë — Bimët e gjelbra krijojnë lëndë organike duke thithur gazin e dyoksidit të karbonit nga ajri, si dhe materie të tjera nga toka. Gjatë frymëmarrjes (kafshët, njeriu), kthejnë në ajër dyoksidin e karbonit, sepse ata e çlirojnë gjatë frymë nxjerrjes. Gjithashtu, edhe gjatë procesit të djegies në ajër lëshohet dyoksidi i karbonit, si dhe gazra të tjera dhe të gjithë këto gazra quhen gazra serrë. Thithja dhe çlirimi i dyoksidit të karbonit në natyrë do të duhej të jetë në barazpeshë.

Por, njeriu e prish këtë baraspeshë me djegien gjithnjë e më tepër të karburanteve dhe për këtë arsye sasia e dyoksidit të karbonit dhe e gazrave të tjera në ajër rritet vazhdimisht. Dyoksidi i karbonit në ajër — në atmosferë luan rol të njëjtë me atë të qelqit në serrë. Ai i lëshon rrezet e diellit deri në sipërfaqen e Tokës, por nuk lejon që nxehtësia ta braktisë atmosferën. Kështu, sipërfaqja e Tokës nuk mund të ftohet dhe bëhet gjithnjë e më nxehtë. Kjo ngrohje e sipërfaqes së Tokës është quajtur efekti serrë.

Pasi mbarohet leximi i tekstit dhe nxënësit vendosin shenjat mësuesi/ja drejton pyetje.

- Cili është informacioni i njohur për ju?
- Çfarë informacioni të ri nxorët gjatë leximit?
- Cilat janë pyetjet që keni?

Gjatë diskutimit me nxënësit bëhet përmbledhja e informacionit në tabelën e mëposhtme.

V	+	-	?



### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në përmblyllje mësuesi/ja ndan klasën në grupe me 4-5 nxënës. Më pas fton nxënësit të hartojnë një pesëvargësh për "Efektin serrë".

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë prezantimit të punëve, diskutimeve dhe përmbledhjes së njohurive me pesëvargëshin për "Efektin serrë".

### Detyre shtëpie:

Të mbledhin informacion nga prindërit ose interneti për bimët që rriten në serra në vendlindjen e tyre dhe shërbimet që u bëhen.

## Ora II – Serra Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Ora e mësimit fillon me zhvillimin e eksperimentit për matjen e temperaturës në një serrë të improvizuar. Për këtë nevojitet një vazo qelqi ose një plasmë dhe dy vazot në të cilat janë mbjellë dy lule. Me vazot e qelqtë ose plasmë mbulojmë njërin saks, ndërsa tjetrin e lëmë të pambuluar. Që të dyja vazot i lëmë jashtë në diell. Gjatë ditëve matet temperatura nën enën e qelqtë /plasmë. Nxënësit me ndihmën e mësuesit mbajnë shënime ndryshimet e temperaturës me qëllim që të shihet se si rritet temperatura.

### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Duke u bazuar në të dhënat e temperaturave të matura në serrën e improvizuar, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se me këtë eksperiment dëshmohet se ena e qelqtë ose plasmë, luajnë një rol të madh për mbajtjen e nxehtësisë. Gjithashtu u shpjegohet nxënësve e se ky proces i njëjtë ndodh dhe në planetin Tokë si pasojë e efektit serrë ku rolin e mbajtjesit të nxehtësisë e luajnë gazrat.

Më pas fton nxënësit të lexojnë informacionin e mëposhtëm për ngrahjen globale.



*Efekti serrë është i rrezikshëm, sepse shkakton ngrohje të vazhdueshme të gjithë sipërfaqes së Tokës. Ky proces është quajtur ngrohje globale, e cila nga ana tjetër, shkakton ndryshime klimatike në mbarë botën. Nëse vazhdon ngrohja globale mund të shkaktojë shkrirjen e akullnajave në malet e larta dhe në kodrinat polare të polit të Jugut dhe të Veriut të Tokës. Shkrirja e masave të mëdha të akullta do ta ngrinte nivelin e oqeanëve botërore dhe të gjitha detrat, ndërsa kjo do të shkaktojë përmblyllje të mëdha. Midis të tjerave, shumë nga qytetet e mëdha në botë do të fundosin. Me qëllim që të ngadalësohet ngrohja globale dhe të ndërpriten përmblylljet dhe katastrofat, njerëzit duhet vazhdimisht t'a zvogëlojnë çlirimin e gazrave të qelqta në atmosferë dhe nëpër fabrikat, fermat dhe shtëpitë e tyre, të shfrytëzojnë burime të energjisë, të cilat nuk krijojnë gazra të qelqta.*

Pas leximit mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetje me "Pse" për të përqendruar vëmendjen e tyre në lidhjet shkak – pasojë.

- Pse ka ndryshuar klima në planetin Tokë?
- Pse temperatura në sipërfaqen e tokës po rritet vazhdimisht?
- Pse duhet të zvogëlohet lëshimi i gazrave të qelqta?
- Pse është i dëmshëm çlirimi i gazeve për shëndetin e gjallesave?

Ftohen nxënësit të japin mendimet e tyre rreth pyetjeve dhe të ndërtojnë pyetje vetë duke u bazuar dhe në informacione të tjera që ata kanë marrë. Mësuesi kujdeset që nxënësit të ndërtojnë njohuritë të sakta duke u bazuar në fakte konkrete.

Për të përmbledhur njohuritë e nxënësve shënohen në tabelë sipas shembullit më poshtë.




	Çfarë po mësoj në këtë çast?	Çfarë di rreth kësaj teme?	Marrëdhënia shkak pasojë e mundshme
Pse?	Pse është rritur temperatura në planetin Tokë?	Kanë ndodhur ndryshime klimatike.	Shkaku: Çlirimi i gazrave të dëmshme.
	Pse është i rrezikshëm efekti serrë?  Pse duhet të ngadalësohet ngrohja globale?  Etj...	Është rritur temperatura në planet.  Efekti serrë është i dëmshëm për të gjitha gjallesat.  Etj...	Pasoja: Efekti serrë  Etj...

**Hapi i tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në përmbyllje mësuesi/ja organizon nxënësit në punë në grupe me 4-5 veta për të krahasuar “Ngrohjen globale” me “Serrat”.

Pas plotësimit të diagrameve mësuesi/ja fton nxënësit sipas grupeve të prezantojnë punë e tyre. Nxënësit e tjerë shprehin mendimet dhe në tabelë përmbledhen ngjashmëritë dhe ndryshimet më kryesore të dy koncepteve. Për shembull:



**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit gjatë punëve në grup, diskutimeve dhe mendimeve që japin gjatë orës.

**Detyrë shtëpie:**

Mësuesi/ja ju shpërndan fletën e punës që është në fund të mësimin, e cila do të duhet të ngjyrosët nga fëmijët dhe i udhëzon ata të shpjegojnë me fjalët e tyre atë çfarë paraqitet në ilustrim.

**Ora III – Serra**  
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Hapi i parë:** Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë dilemën “Me çfarë do ta ngrohim shtëpinë?” në faqen 187 të fletores së punës. Pas leximit nxënësit diskutojnë rreth alternativave të zgjidhjes së saj.



### Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Më pas mësuesi/ja fton nxënësit në zhvillimin e lojës “Ku do të shkojnë arinjtë e bardhë?”

Qëllimi i lojës është që fëmijët të kuptojnë se aktivitetet njerëzore sjellin ndryshimin e kushteve klimatike dhe se me shkrirjen e akullit në pole zvogëlohet hapësira jetësore e një lloji kafshe në rrezik.

Për zhvillimin e lojës nevojiten 8-12 copë kartoni (të prera në katrorë me dimensione rreth gjysmë metri) ose fletë të bardha me format A4.

Radhiten kartonët në dysheme në mënyrë që të grupohen në mesin e klasës dhe të paktën nga anët ose këndet do të takohen me kartonët fqinjë.

Shpjegojuni nxënësve se kartonët paraqesin sipërfaqen e akullit të Veriut dhe se çdo karton paraqet një copë akulli. Në Polin e Veriut jetojnë arinjtë e bardhë, të cilat paraqesin një nga llojet e kafshëve të kërcënuara të goditura drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike.

Në çdo copë të kartonit le të vendoset nga një nxënës. Nxënësit ftohen që të paramendojnë gjoja se ata janë arinjtë e bardhë të vegjël. Pastaj u shpjegoni se ashtu si ngrohet klima po ashtu edhe shkrihet akulli në Polin e Veriut dhe arinjtë e bardhë janë të detyruara që të shpërngulen dhe të jetojnë në hapësirën e vogël të akullit e cila u ka mbetur.

Pastaj, tërhiqni kartonët një nga një (duke filluar nga periferia e deri te kartonët në brendësi) dhe i ftoni nxënësit, të cilët qëndrojnë në atë copë që të zhvendosen dhe të gjejnë hapësirë në ndonjë copë tjetër të kartonit (ose në dy të fqinjëve, në mënyrë që njëra këmbë do të qëndrojë në një copë të kartonit, ndërsa tjetra në copën fqinje), e cila tani është zënë nga nxënësi tjetër. Ndërpriteni lojën kur doni të vlerësoni se nxënësit me të vërtetë tani nuk kanë më vend dhe se vazhdimi i lojës nuk është i sigurt. Ftoni nxënësit të japin mendimet e tyre rreth mesazhit që përcjell loja.

### Hapi i tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja fton nxënësit të ushtrohen në punë dyshe për të shkruajné rreth rolit të njerëzve në ngadalësimin e ngrohjes globale duke i dhënë përgjigje pyetjes së mëposhtme.

*“Çfarë duhet të bëjnë njerëzit me qëllim që të ngadalësohet ngrohja globale dhe të ndërpriten përmbytjet e katastrofat natyrore që lidhen me ngrohjen globale.”*

Disa nga përgjigjet mund të jenë: *Njerëzit duhet vazhdimisht ta zvogëlojnë çlirimin e gazrave serrë në atmosferë dhe duhet që nëpër fabrikat, fermat dhe shtëpitë e tyre të shfrytëzojnë burime të energjisë, të cilat nuk krijojnë gazra serrë etj.*

Mësuesi ka fotokopjuar fletën e punës, faqe 189 “Banka e ujit”. Historia e kësaj Flete Pune jep informacion të thjeshtuar në lidhje me rolin e ligatinave (mjediseve lagunore, apo kënetave) për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore si përmbytjet, etj.

Mësuesi pasi shpërndan fletën e punës, ndan rolet dhe iu kërkon personazheve që ta lexojnë historinë.

Më pas mësuesi dhe nxënësit diskutojnë.

Kjo histori mund të realizohet edhe si lojë me role, sipas dëshirës së mësuesit dhe sa të njohura janë lagunat për komunitetin e zonës ku ndodhet shkolla.

Më pas mësuesi/ja shpërndan fletën e testit për “Sa di për klimën?” në faqen 187 të librit.

Vlerësohen dhe diskutohen zgjidhjet e alternativave.

### Vlerësimi

Nxënësit vetëvlerësojnë njëri-tjetrit gjatë diskutimeve, zhvillimit të veprimtarive, zgjidhjes së alternativave që lidhen me zvogëlimin e ngrohjes globale dhe efektet e saj mbi planetin dhe jetën e gjallë. si dhe zgjidhjes se testit për ndryshimet klimatike.

### Detyrë shtëpie

Të bëjnë vizatime ose postera për ndërgjegjësimin e njerëzve për zvogëlimin e ngrohjes globale.






DILEMA

## Me çfarë do ta ngrohim shtëpinë?

E dimë se gjatë ditëve të dimrit çdo shtëpi ngrohet në mënyra të ndryshme. Por gjithashtu, e dimë se që të ngrohen shtëpitë tona dhe hapësirat në të cilat qëndrojmë, nevojitet shfrytëzimi i një sasive të madhe të energjisë. Gjatë periudhës së dimrit ka edhe ditë më të ngrohta, por përgjithësisht është e nevojshme që t'i ngrohim shtëpitë tona. Çfarë do të bënim?

- Do ta ngrohim shtëpinë duke përdorur sobë me dru, sepse në planet ka shumë pemë e nuk prish punë nëse harxhojmë disa;
- Do të ngrohemi duke përdorur soba që punojnë me gaz, sepse na kushton më pak;
- Do të ngrohemi duke përdorur soba ose kalorifer që punojnë me energji elektrike, është dimër e nuk ka problem nëse fatura e energjisë është e lartë.
- Diçka tjetër? Për shembull, Çfarë?



TEST

## Sa di për klimën?

	E SAKTË	E GABUAR
1 Klima asnjëherë nuk ndërron, çdoherë është e njëjtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Në ndryshimet klimatike ndikon zhvillimi i shpejtë i industrisë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Aktivitetet e njeriut nuk ndikojnë në ndryshimet klimatike.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Gazrat e dëmshme të serrës e mbajnë nxehtësinë në planetin Tokë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Ngrohja globale do të thotë nxehtësi gjithnjë e më e madhe në planet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Përgjegjësinë që planeti ynë të jetë i pastër dhe i pandotur e kanë vetëm të rriturit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Duke kursyer energji elektrike ngrohja globale zvogëlohet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Vetëm me përdorimin e qymyrit, naftës dhe gazit natyror do ta ndërpresim ngrohjen globale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Ngrohja globale ndikon pozitivisht mbi shëndetin e njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përgjigjet: 1. E gabuar 2. E gabuar 3. E saktë 4. E gabuar 5. E saktë 6. E gabuar 7. E saktë 8. E gabuar 9. E gabuar





## FLETË PUNE Kopshti i Enit

Eni së bashku me nënën e saj ishin për vizitë te gjyshja e vet. Gjithë ditën, gjyshja e saj kujdesej për bimët e mbjella në kopsht. Pas disa ditësh, gjyshja shkoi për vizitë te motra e saj, e cila jetonte në një qytet tjetër. Kujdesin për shtëpinë dhe kopshtin duhej ta merrte Eni dhe mamaja e saj.

Të nesërmen në mëngjes, mamaja e Enit shkoi në punë, ndërsa Eni rrinte në dritare dhe shikonte lulet në kopsht.

Mbasdite, Eni doli në kopsht për ti soditur lulet nga afër dhe të shihte se për çfarë kishin ato nevojë. Kur hyri në serrën e mbuluar me plasmas, u shqetësua shumë. Lulet ishin të vyshkura, sepse atë ditë nuk ishin ujitur. Eni menjëherë i ujiti, por pavarësisht kësaj, gjendja e tyre nuk u përmirësua. Qëndroi për disa minuta në serrë dhe mendonte se cila ishte arsyeja për këtë gjendje të tillë të luleve. Përnjëherë ajo vetë u ndje keq, po ndjente shume vapë dhe po i merrej fryma sepse i mungonte ajër i pastër. Me vrap doli jashtë, mori frymë thellë dhe menjëherë u ndje më mirë. Në këtë moment e kuptoi arsyen se pse bimët ishin vyshkur. Edhe bimët kanë nevojë për ajër të pastër.


Ajo menjëherë i hapi dritaret e serrës me qëllim që të ajroset.





## FLETË PUNE Banka e ujit\*

Lexoni me kujdes historinë e paraqitur nëpërmjet figurave dhe ilustrimeve më poshtë. Cilët janë personazhet e kësaj historie? A mund ta lexoni atë si një lojë me role? Cili është mesazhi që ajo sjell?




\*Ky aktivitet është marrë nga faqja e Konventës Ramsar përgatitur në kuadër të ditës së Ligatinave 2016.





## FLETA E PUNËS

Ngjyrosni këtë vizatim dhe gjeni një titull për të.







**Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore  
Zyra në Shqipëri**

në bashkëpunim me shkollën

.....  
vërteton se nxënësi/nxënësja

.....  
përfundoi me sukses programin “Paketa e Gjelbër Junior”

.....  
**Mësuesi/Mësuesja**

.....  
**Data, vendi**

